



REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT




INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

Draft

HARTA ZONALE E KOSOVËS

2020 – 2028+

Nëntor, 2020





REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT

HARTA ZONALE E KOSOVËS

2020 – 2028+



Dokument i hartuar nga:



INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

nën përkrahjen e Grupit Punues Ndërministror
dhe strukturave relevante të sektorëve të Qeverisë së Kosovës.

Prishtinë

Nëntor, 2020

Përmbajtja

Shkurtesat	5
I. HYRJE.....	10
1. Baza Ligjore.....	10
2. Qëllimi.....	10
3. Procesi	10
4. Raporti nga shqyrtimi publik	12
5. Planet strategjike sektoriale	14
5.1. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM (2016-2021)	14
5.2. STRATEGJIA PËR KONSOLIDIMIN E TOKËS BUJQËSORE 2010-2020	14
5.3. STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT 2013 – 2022	15
5.4. STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2012-2025	16
5.5. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMI KULTURORE (TK).....	16
5.6. STRATEGJIA E SHËNDETËSISË - 2017-2021.....	17
5.7. STRATEGJIA TRANSPORTIT MULTIMODAL 2015-2025	17
5.8. PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021	18
5.9. STRATEGJIA E ENERGJISË 2016 – 2025	19
5.10. STRATEGJIA E UJËRAVE	20
5.11. STRATEGJIA PËR ZVOGËLIM TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË	20
6. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+.....	22
6.1. Vizioni nga PHK.....	23
6.2. Qëllimet dhe objektivat nga PHK	23
6.3. Prioritetet strategjike	24
6.4. Analiza e qëllimeve dhe objektivave dhe përshtatja e tyre me kërkesat aktuale	25
6.5. Prioritetet strategjike të modifikuara	26
II. ZONAT E ZHVILLIMIT HAPËSINOR	27
1. ZONAT RAJONALE STATISTIKORE.....	28
2. ZONAT BUJQËSORE.....	31
3. ZONAT PYJORE	33
4. ZONAT E INFRASTRUKTURËS TEKNIKE	35
5. ZONAT URBANE	41
6. ZONAT RURALE	44
7. ZONAT E BANIMIT.....	45
8. SIPËRFAQET E MBROJTURA	46
9. ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA	49
10. ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË MINERAL.....	50
Zonat ekonomike.....	50
11. ZONAT E SHËRBIMEVE - ARSIMI	51
12. ZONAT E SHËRBIMEVE - SHËNDETËSIA.....	52
13. ZONAT TURISTIKE	53
14. ZONAT REKREATIVE SPORTIVE	56
15. ZONAT E GJEORREZIQEVE NË KOSOVË	57
16. ZONAT UJORE	60
17. GURTHYESIT, LËNDËT MINERALE NDËRTIMORE DHE INDUSTRIALE	63
18. ZONAT QYMYRMBAJTËSE	64
19. ZONA USHTARAKE-SIGURISË	66
III. KUSHTET PËR ZHVILLIM / NDËRTIM / DISPOZITAT PËR ZBATIM	68
KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME	68
Kushtet për formësim arkitektonik	69
Kushtet për efikasitet të energjisë	70
Kushtet për mbrojtje nga zjarri	71
KUSHTET ZHVILLIMORE SPECIFIKE	72
1. MBULUESHMËRIA E TOKËS PËR KOSOVËN (CLC2018)	72
2. PËRNPJESA DHE GRIDI I ZONIMIT.....	72
3. ZONAT E VEÇANTA.....	72

3.1.	Zonat ekzistuese.....	72
3.1.1	PARKU KOMBËTAR “BJESHKËT E NEMUNA”	72
3.1.2	MONUMENTI I NATYRËS “UJËVARAT E MIRUSHËS”	73
3.1.3	PARKU KOMBËTAR “MALI SHARR”	73
3.1.4	ZONA E MBROJTUR DHE ME INTERES TË VEÇANTË “BETEJA E KOSHARES”	74
3.1.5	ZONA ME INTERES TË VEÇANTË „SHP.UÇK. KLEÇKË DHE DIVJAKË”	74
3.1.6	ZIV “FUSHA E MIHJES SË RE”	75
3.2.	Zonat e reja – procedura e shpalljes	76
4.	ZONA E INFRASTRUKTURËS TEKNIKE	79
4.1.	ZONA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE	79
4.2.	ZONA E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE	81
4.3.	ZONA E AERODROMEVE	82
4.4.	ZONA E INFRASTRUKTURËS SË ENERGISË ELEKTRIKE	83
4.5.	ZONA E INFRASTRUKTURËS SË ENERGISË TERMIKE	84
4.6.	ZONA E INFRASTRUKTURËS SË GAZIT NATYROR	85
4.7.	ZONA E INFRASTRUKTURËS UJORE	85
4.8.	ZONA E INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE	87
4.9.	ZONA E DEPONIVE RAJONALE TË MBETURINAVE	88
4.10.	ZONA E DEPONIMIT TË MBETURINAVE TË RREZIKSHME	89
5.	ZONAT UJORE	89
5.1.	Zonat ujore sipërfaqësore	89
5.2.	Zonat e mbrojtura sanitare në ujë rrjedhat e hapura	90
5.3.	Zonat e mbrojtura sanitare të akumulacioneve dhe liqeneve	90
5.4.	Zonat ujore nëntokësore	90
5.5.	Zonat e mbrojtura sanitare në akuiferet intergranular	90
5.6.	Zonat e mbrojtura sanitare në akuiferet karstik	91
5.7.	Kushtet zhvillimore	91
6.	ZONAT BUJQËSORE	94
7.	ZONAT PYJORE	95
8.	SIPËRFAQET E MBROJTURA	97
8.1.	ZONAT E TRASHËGIMISË KULTURORE	97
8.2.	ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS	98
9.	ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA	99
10.	ZONAT E BANIMIT	99
11.	ZONAT URBANE	101
12.	ZONAT RURALE	102
13.	ZONAT MBISHTRESORE	102
13.1.	Zonat me rrezikshmëri të përmytjes	102
13.2.	Zonat erozive	103
13.3.	Zonat e rrëshqitjeve dhe rrokullisjeve të shkëmbinjve	104
13.4.	Zonat sizmike	104
13.5.	Zonat e pasurive minerale	106
13.6.	Zonat me potencial për akumulacione ujore	106
13.7.	Zonat e akuifereve	107
13.8.	Zonat e ndikuara nga zhurma	107
14.	ZONAT E SHËRBIMEVE - SHËNDETËSIA	108
15.	ZONAT E SHËRBIMEVE - ARSIMI	109
16.	ZONAT E SIGURISË	109
17.	ZONAT E OBJEKTEVE TË KATEGORISË SË III-TË	110
18.	ZONAT EKONOMIKE	112
IV.	PLANI I VEPRIMIT	114
V.	ADMINISTRIMI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT	131
	HARTAT	136
	PRIORITETET STRATEGJIKE NË RAPORT ME QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM	165
	PJESËMARRËSIT NË HARTIMIN E DOKUMENTIT	166
	Literatura:	167

HARTA ZONALE E KOSOVËS

Shkurtesat

AACK	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CEMAT	Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për planifikim hapësinor/rajonal
DPHNB	Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
EUROSTAT	Zyra e Statistikave të Unionit Evropian
ESDP	Perspektiva Evropiane për Planifikim Hapësinor
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
GPNM	Grupi Punues ndër-Ministror
HZKos	Harta Zonale e Kosovës
HZKom	Harta Zonale e Komunës
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
INSPIRE	Infrastruktura për Informacione Hapësinore në Evropë
KE	Këshilli i Evropës
KK	Kuvendi Komunal
KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
LN	Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim
LPH	Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
NUTS	Nomenklatura e njësive territoriale për statistika
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
PHK	Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+
PHZV	Planet Hapësinore për Zona të Veçanta
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
TK	Trashëgimia Kulturore
UA	Udhëzim Administrativ
WTTC	Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit
ZR	Zona Rurale
ZU	Zona Urbane
ZV	Zonat e Veçanta
ZVM	Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Përkufizimet

Shprehjet e ndryshme që janë përdorë në dokument e kanë kuptimin si në vazhdim, ndërsa shprehjet tjera relevante mund të gjenden në Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe udhëzimet administrative përkatëse. Një pjesë e konsiderueshme e shprehjeve dhe termave të përdorura janë konsideruar si të nevojshme gjatë hartimit të Hartës Zonale të Kosovës dhe Hartave Zonale Komunale. Literatura e përdorur për përkufizimin e tyre është Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për planifikim hapësinor/rajonar (CEMAT).

- **“Harta Zonale e Kosovës”**: Është dokument i planifikimit hapësinor i nivelit qendror, në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor;
- **“Zonë”**: Zona paraqet një grup të parcelave kadastrale fqinje me përcaktim të njëjtë të shfrytëzimit të tokës, zhvillimit apo të mbrojtjes dhe ruajtjes, duke përdorur përkufizimet e zonave në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor;
- **“Kushtet zhvillimore”**: Këto janë kushte të obligueshme për t’u plotësuar me qëllim të kontrollimit të vendndodhjes, dendësisë, shfrytëzimit të tokës dhe karakterit të zhvillimit. Si pjesë e tyre mund të jenë edhe kushtet ndërtimore;
- **“Kushtet ndërtimore”**: kushtet ndërtimore, si janë përcaktuar në nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor;
- **“Zonat mbishtresore”**: Zonat mbishtresore paraqesin teknikën e zonimit që përdoret për vendosjen e kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore alternative në kuadër të një sipërfaqeje specifike të vendit që kërkon vëmendje të veçantë, siç përshkruhet në nenet 14 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 10/2016 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës (UA HZKos);
- **“Normat teknike të Planifikimit Hapësinor”**: dokumenti i cili përcakton kërkesat themelore për hartimin e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- **“Ndryshim-plotësimet”**: Janë ndryshimet apo plotësimet që janë lejuar t’i bëhen dokumentit të miratuar të Hartës Zonale të Kosovës e të cilat bëhen vetëm në përputhje me nenet 35, 36 dhe 37 të UA HZKos dhe me nenin 9 të Ligjit për Planifikim Hapësinor;
- **“Përrjashtimet”**: Përrjashtimet paraqesin një devijim të lejuar nga kushtet zhvillimore apo kushtet ndërtimore, në përputhje me nenin 38 të UA HZKos;
- **“Jo konformitetet”**: Jo konformiteti nënkupton një shfrytëzim ekzistues, ndërtesë ose parcelë kadastrale që nuk është në harmoni me kërkesat aktuale të zonimit dhe trajtohet në pajtim me nenin 39 të UA HZKos;
- **“Bashkëpunimi ndërkufitar, transnacional, ndër-rajonar”**: Bashkëpunimi territorial ndërmjet qeverive nacionale, rajonale dhe lokale është një element i rëndësishëm i integritetit evropian. Ai ka për synim largimin e ndikimeve negative të kufijve shtetëror në zhvillimin territorial;
- **“Bashkëpunimi territorial”**: Bashkëpunimi territorial nënkupton zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta që lidhen me politikat e zhvillimit territorial për zonat që i përkasin juridiksioneve të ndryshme administrative. Bashkëpunimi territorial është veçanërisht i rëndësishëm përgjatë kufijve kombëtarë, por gjithashtu edhe ndërmjet njësive administrative të të njëjtit shtet;
- **“Ekosistemi urban”**: Ekosistemi urban nënkupton komunitetin e bimëve, kafshëve dhe qenieve njerëzore që e banojnë mjedisin urban. Edhe pse kjo është një zonë fizikisht e dominuar nga strukturat e ndërtuara të tilla si objekte, rrugë, kanalizime dhe linja të energjisë elektrike, ajo gjithashtu përfshin një mozaik të pasur të hapësirave të gjelbra (parqet, oborret, gjelbërimin rrugor, hapësirat e gjelbra, rrjedhat ujore urbane, peizazhet e rregulluara komerciale dhe parcelat e pa ndërtuara) që janë mushkëritë e ekosistemit urban;
- **“Konurbacioni”**: Konurbacioni paraqet një bashkim apo rrjet të pandërprerë të lagjeve urbane të cilat janë integruar fizikisht për shkak të rritjes së popullsisë dhe zgjerimit të vendbanimit. Konurbacioni është formë policentrike e aglomeratit;

- **“Kohezioni territorial”**: Koncepti i kohezionit territorial është objektivi kryesor i zhvillimit territorial në Parimet Udhëzuese dhe ESPD. Edhe pse është i përfshirë në dokumentet zyrtare të nivelit më të lartë, koncepti i kohezionit territorial deri më tani nuk ka marrë një përkufizimi zyrtar. Kryesisht, ai konsiderohet si plotësim i objektivave të kohezionit ekonomik dhe social dhe synon promovimin e një zhvillimi harmonik dhe homogjen të gjithë territorit;
- **“Lidhshmëria”**: Lidhshmëria e një vendbanimi ose lagjeje urbane specifike ka të bëjë me numrin, natyrën dhe kapacitetin e lidhjeve të transportit dhe komunikimit/telekomunikacionit me vendbanimet tjera urbane dhe rrjetet kryesore;
- **“Menaxhimi i tokës”**: Menaxhimi i tokës mund të përkufizohet si proces i menaxhimit të shfrytëzimit dhe zhvillimit të burimeve të tokës në mënyrë të qëndrueshme;
- **“Menaxhimi i pellgut ujor”**: Menaxhimi i pellgut ujor i referohet menaxhimit të burimeve ujore në pellgun e ujit, i cili përbëhet nga rrjedha e lumit kryesor, të gjitha degët e tij, si dhe ujërat nëntokësor. Aktivitetet e menaxhimit të ujërave përfshijnë parandalimin e vërshimeve, kontrollin e aktiviteteve të cilat kanë ndikim në nivelin dhe kualitetin e burimeve ujore (nxjerrja e ujit, ndotja e përqendruar dhe e shpërndarë) dhe të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të sistemit hidrologjik të pellgut;
- **“Partneritetet urbano-rurale”**: Ndërveprimet urbano-rurale mund të përkufizohen si lidhje në hapësirë (të tilla si flukset e njerëzve, mallrave, parave, informacionit dhe mbeturinave) dhe lidhjet midis sektorëve (për shembull, në mes të bujqësisë, shërbimeve dhe prodhimit). Në kuptim të përgjithshëm, ato gjithashtu përfshijnë aktivitete "rurale" të cilat zhvillohen në qendrat urbane (si bujqësia urbane) dhe aktivitete të cilat shpesh klasifikohen si "urbane"(të tilla si prodhimi dhe shërbimet) të cilat ndodhin në zonat rurale vendbanime;
- **“Peizazhi”**: Sipas Konventës evropiane të Peizazhit, “peizazhi nënkupton një zone të caktuar, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i së cilës është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyral dhe/ose njerëzor”;
- **“Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, zonimi”**: Planifikimi i shfrytëzimit të tokës është degë e politikës publike e cila përfshin disiplina të ndryshme, të cilat synojnë organizimin dhe rregullimin e shfrytëzimit të tokës në mënyrë të efektshme. Kjo nënkupton rregullimin e planifikuar, estetik dhe shkencërisht të bazuar të tokës, burimeve, objekteve dhe shërbimeve, me synim të sigurimit të efikasitetit hapësinor, fizik, ekonomik, social dhe mjedisor, shëndetit dhe mirëqenies së komuniteteve urbane dhe rurale;
- **“Park biznesi”**: Parku i biznesit ose zona e biznesit/punës është një pjesë e tokës në të cilën janë të grupuara shumë zyra dhe objekte tregtare. Parqet e biznesit janë grupime të aktiviteteve terciare dhe ndryshojnë nga parqet industriale (aktivitete prodhuese) ose parqet teknologjike (aktivitetet në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit të teknologjisë). Parqet e biznesit zakonisht gjenden në zonat periferike në pikat më të qasshme të rrjetit rrugor metropolitan;
- **“Planifikimi me pjesëmarrje”**: Planifikimi me pjesëmarrje është formë specifike e aktiviteteve të planifikimit të zbatuara nga autoritetet publike, kryesisht në nivel lokal, i cili ju mundëson qytetarëve të përfshihen në procesin e planifikimit;
- **“Partneriteti publiko-privat”**: Partneritet publik-privat është marrëveshje formale (zakonisht kontratë) me të cilën organet publike (qeveria qendrore, rajonale ose lokale) dhe një ose më shumë subjekteve private vendosin që të bashkëpunojnë në ndërtimin e aseteve ose ofrimin e shërbimeve;
- **“Projektet e zhvillimit hapësinor”**: Projektet e zhvillimit hapësinor janë projekte të hartuara ose të kontrolluara nga institucionet publike, të cilat kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin territorial në nivele të ndryshme. Projektet e zhvillimit hapësinor mund të përfshijnë punët infrastrukturore, përparimin ekonomik dhe zhvillimin e zonave të veçanta, masat për rehabilitim urban, restaurimi ekosistemeve të dëmtuara, etj.;
- **“Planifikimi Hapësinor”**: Planifikimi hapësinor i referohet metodave përmes së cilave sektori publik ndikon në shpërndarjen e njerëzve dhe aktiviteteve në hapësirë në nivele të ndryshme, si dhe në vendndodhjen e zonave të ndryshme të infrastrukturës, rekreacionit dhe zonave të natyrës;

- **“Qasshmëria (Eng.Accebility)”**: Qasshmëria i referohet lehtësisë së arritjes në destinacion¹. Përveç qasshmërisë fizike e cila sigurohet përmes infrastrukturës së transportit, lidhshmëria përmes sistemeve të avancuara të telekomunikacionit e ndihmon përmirësimin e lidhjeve virtuale të zonave;
- **“Rrezik natyror/Kërcënim natyror/Fatkeqësi natyrore”**: Shumë ngjarje në natyrë përbëjnë rrezik për jetën, mjedisin e ndërtuar dhe atë natyror, përderisa ato kërcënojnë jetën e njerëzve e të kafshëve dhe mund të shkaktojnë dëmtime serioze habitateve të tyre. Për këtë arsye, vendbanimet e njerëzve, aq sa është e mundur, duhet të mbrohen nga rreziqet natyrore përmes masave adekuata parandaluese. Sipas intensitetit të tyre, efekteve dhe dëmeve që shkaktojnë, këto ngjarje natyrore (ose rreziqe) mund të konsiderohen si fatkeqësi natyrore. Prandaj, fatkeqësia natyrore është pasojë e ndërthurjes së kërcënimit natyror dhe aktiviteteve të njeriut². Kërcënimet kryesore natyrore përfshijnë: orteqet, thatësitrat, tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e tokës, shpërthimet vullkanike, tsunamit, tornadot, ciklonet, zjarret e pyjeve, etj.;
- **“Struktura urbane/Rrjeti i vendbanimeve”**: Vlerësimi morfologjik/funksional dhe analiza e qyteteve, qyteteve dhe vendbanimeve tjera e bën të mundur identifikimin e strukturës së tyre. Strukturën urbane e përbëjnë elementet dhe funksionet kryesore të cilat shfaqen brenda një zone urbane, të tilla si: morfologjia e qyteteve (kompakte ose e shpërndarë, me një ose më shumë qendra), shpërndarja e zonave urbane sipas vjetërsisë së tyre (mesjetare, e pasluftës, etj.), dhe funksioneve kryesore (veprimtaritë komerciale, banimi, industria, rekreacioni, etj.), shpërndarjes sociale dhe organizimit (zonat e varfëra dhe të braktisura, zonat e të pasurve, zonat me përqindje të lartë të emigrantëve, etj.), karakteristikat kryesore të transportit dhe akset e komunikacionit (sistemi i rrugëve e transportit publik);
- **“Shtigjet kulturore”**: Shtigjet kulturore janë itineraret të cilat lidhin elemente të rëndësishme të trashëgimisë dhe të traditave për të dëshmuar ose ilustruar periudha të veçanta dhe ngjarje të historisë evropiane. Shtigjet kulturore i karakterizon një dinamikë hapësinore dhe virtuale e cila nuk është veçori e peizazhit kulturor i cili për nga natyra është më statik dhe i kufizuar;
- **“Vlerësimi strategjik i ndikimit në mjedis (VSM)”**: Vlerësimi i strategjik i ndikimit në mjedis nuk i referohet ndikimeve të mundshme të projekteve individuale (si në rastin e Vlerësimit të ndikimit në mjedis), por ndikimeve të mundshme të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.
- **“Zgjerim i pakontrolluar urban”**: Zgjerimi i pakontrolluar urban është shtrirja e paplanifikuar dhe e pakontrolluar e zhvillimit urban në zonat përreth kufirit të qytetit. Ky term gjithashtu përdoret për të treguar rritjen gjeografike ekspansive, të shpejtë dhe nganjëherë të papërgjegjshme të një zone përkatëse urbane;
- **“Zonë e braktisur (Eng. Derelict area)”**: Zona të braktisura (zakonisht urbane) janë ato zona të cilat kanë pësuar një rënie të konsiderueshme ekonomike, me një industri në rënie apo të braktisur, me biznese dhe shtëpi të mbyllura, magazina të boshatisura, mjedis të degraduar dhe praktikisht me rrugë boshe gjatë natës. Disa zona të braktisura janë gjithashtu të kontaminuara dhe mund të konsiderohen si tokë *broënfie*ld. Zonat e braktisura janë shkak kryesor i përkeqësimit të mjedisit në zonat urbane;
- **“Zona funksionale urbane (Eng.Functional Urban areas-FUA)”**: Zona funksionale urbane paraqet zonën e ndikimit të një qyteti. Ajo zakonisht përcaktohet në bazë të të dhënave statistikore (për shembull të dhënat mbi fluksin e udhëtimeve ditore);
- **“Zonat peri-urbane”**: Zonat peri-urbane janë zona të cilat janë në një formë të tranzicionit nga zonat strikte rurale në ato urbane. Këto zona shpesh përfaqësojnë puqitjen direkte ndërmjet urbanes dhe rurales dhe përfundimisht mund të evoluojnë në zona plotësisht urbane. Zonat peri-urbane janë vende komponenti kryesor i të cilave janë njerëzit : ato janë mjedis të banuara;
- **“Programet e veçanta të banimit”**: banim i përshtatshëm dhe i përbalueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t’i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave dhe kanë nevojë për ndihmën e shtetit;³

¹ CEMAT.

² Po aty;.

³ Ligji Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit;

- **“Banim i përballueshëm”** (Eng. Affordable housing): sigurimi i banimit në tregun e banesave për familjet ose individët që kanë pagë mesatare: në Sektorin Publik (Administrata), Sektorin Privat dhe Ndërmarrjet publike;
- **“Sektori publik”**: Të gjithë të punësuarit, të cilët marrin pagë nga Buxheti i Kosovës janë përfshirë në sektorin publik;
- **“Sektori privat”**: Të gjithë të punësuarit, të cilët punojnë pranë ndërmarrjeve private (bizneset private), për të cilët ndërmarrjet paguajnë taksat dhe kontributet e tyre;
- **“Ndërmarrjet publike”**: Ndërmarrjet publike përfshijnë të gjitha ndërmarrjet, që janë në pronësi publike, ose janë themeluar me fonde publike, ose sipas ligjit publik dhe nuk janë autoritete publike, ose pjesë të autoriteteve publike;⁴
- **“Njësi e banimit – banesë”**: Banesë konvencionale apo vend jokonvencional i banimit të zakonshëm ku njerëzit janë duke jetuar në kohën e regjistrimit të popullsisë;⁵
- **“Zona rurale/Fshati”**: Zonë e përkufizuar në nivel vendbanimi, e cila karakterizohet me dendësi të ulët të popullsisë dhe infrastrukturë elementare sociale/teknike, ku veprimtaria kryesore e banorëve është bujqësia.

Në kuadër të Hartës Zonale Komunale, zona rurale/fshati janë vetëm hapësirat e banuara dhe hapësirat e planifikuara për zgjerimin e fshatit, ndërsa përmbajtjet tjera (toka bujqësore, pyjore, ujore etj.) duhet të trajtohen në kategoritë tjera të zonimit;

- **“Zonë urbane/Qyteti”**: Një zonë e urbanizuar dhe e definuar në nivel të vendbanimit e cila karakterizohet me densitet të lartë të popullsisë dhe me rrjet të zhvilluar të infrastrukturës së transportit dhe të infrastrukturës tjetër teknike dhe sociale.

Në aspektin hapësinor, Autoritetet lokale janë të obligueshme të përcaktojnë kufirin e zonave urbane/qyteteve për komunat e veta përkatëse. Pjesë e këtyre zonave duhet të jenë edhe sipërfaqet e planifikuara për zgjerimin e zonës urbane/qytetit, dhe sipas mundësive edhe përkufizimi i pjesës së vjetër të zonave urbane/qyteteve.

Përmbledhje ekzekutive

I gjithë procesi i hartimit të dokumentit që ka qenë shumë transparent dhe gjithpërfshirë, i bazuar në rregullat ligjore në fuqi dhe në përvojën e deritashme të fituar gjat hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për nivelin qendror të qeverisjes. Fillimisht, është bërë shqyrtimi i Planit Hapësinor në fuqi, me fokus në listën e qëllimeve dhe objektivave me qëllim të verifikimit të tyre me nevojat aktuale të zhvillimit hapësinor të vendit. Është konfirmuar se pjesa më e madhe e tyre janë ende relevante, ndërkohë që disa prej tyre me ndërhyrje të vogla i kemi përshtatur me kërkesat aktuale. Rezultat i këtij veprimi është Lista e Prioriteteve Strategjike, e cila është trajtuar përmes Zonave Zhvillimore që është përmbajtja kryesore e Kapitullit të II-të në dokument. Për të gjitha zonat e trajtuara është përdorur skema e njejtë, pas një përshkrimi të shkurtër për gjendjen aktuale, janë dhënë rekomandimet dhe veprimet e duhura për përmirësim.

Pjesë e veçantë e dokumentit janë Kushtet Zhvillimore (Kapitulli i III-të) të cilat në fakt janë rregulla që duhet të respektohen gjatë zbatimit të veprimeve të planifikuara. Bazë për përcaktimin e tyre kanë qenë ligjet, udhëzimet administrative dhe normat teknike në fushën e planifikimit hapësinor. Në vazhdim të procesit, me ndihmën e anëtarëve të Grupit Punues por edhe të përfaqësuesve jo anëtar të sektorëve të Qeverisë, të gjitha veprimet janë përmbledhur në Planin e Veprimit (Kapitulli i IV-të), i cili ofron informatat të bollshme për realizimin e veprimeve për të gjitha zonat e trajtuara në dokument. Më tutje, dokumenti vazhdon me mënyrën dhe listën e institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe zbatimin e dokumentit, për të përfunduar me setin e hartave, në të cilat janë të vendosura të gjitha veprimet me ndikim hapësinor.

⁴ ASK, Seria 5: Statistikat Sociale Niveli i pagave në Kosovë 2012-2017;

⁵ ASK, Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011;

I. HYRJE

1. Baza Ligjore

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) dhe Harta Zonale e Kosovës (HZKos) janë dokumentet kryesore të sektorit të planifikimit hapësinor që rrjedhin nga Ligji për Planifikim Hapësinor. Me ndryshimin e Ligjit të realizuar në vitin 2013, Harta Zonale si dokument bëhet pjesë e sistemit të planifikimit hapësinor në të dy nivelet e qeverisjes. Sipas këtyre ndryshimeve është Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në nivelin qendror dhe Drejtoritë përkatëse nga niveli lokal i qeverisjes, përgjegjëse që në afate të caktuara kohore të nxjerrin këto dokumente të rëndësishme sektoriale. Në këtë drejtim, MEA përmes Institutit për Planifikim Hapësinor dhe strukturave tjera përgjegjëse ka filluar procesin e hartimit të Hartës Zonale të Kosovës. Ky veprim është në përputhje të plotë me bazën ligjore në fuqi, sipas të cilës janë të përcaktuara subjektet dhe përgjegjësit e tyre në këtë proces. Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr.04/L-174, Neni 9, pika 1.4., paragrafi 1.4.2.) Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me strukturat e veta përkatëse përveç tjerash është përgjegjëse për hartimin dhe bashkërendimin e Hartës Zonale të Kosovës. Duke iu referuar të njëjtit Ligj (Neni 8, pika 2., paragrafi 2.2.) Qeveria e Kosovës është subjekti përgjegjës për shqyrtimin dhe aprovimin e dokumentit, i cili përfundimisht aprovohet nga Kuvendi i Kosovës (Neni 7, pika 2., paragrafi 2.3.) si subjekti më i rëndësishëm i këtij procesi.

Në mbështetje të këtij aktiviteti është edhe Udhëzimi Administrativ Nr.10./2016 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës. Sipas udhëzimit në fjalë HZKos hartohet në bazë të Planit Hapësinor në fuqi (Neni 40), dhe sipas po të njëjtit udhëzim (Neni 9, paragrafi 1.5.) pjesa hyrëse e dokumenti në mes tjerash duhet të bëjë: “Përfshirjen e ndryshimeve eventuale në strategjitë sektoriale të qeverisë që nga miratimi i Planit Hapësinor të Kosovës. Duhet të bëjë përfshirjen e veprimeve, masave dhe aktiviteteve që kanë ndodhur pas miratimit të PHK-së në fuqi (në këtë rast PHK 2010-2020+)”.

2. Qëllimi

Qëllimi kryesor i hartimit dhe i hyrjes në fuqi të Hartës Zonale të Kosovës është koordinimi i zhvillimeve hapësinore në të gjithë territorin e vendit. Përmes veprimeve, masave dhe aktiviteteve që janë njëra nga pjesët e rëndësishme të dokumentit, do të bëhet e mundur implementimi i politikave, qëllimeve dhe objektivave të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Në hartë do të përcaktohen zonat për të cilat do të vendosen kushtet zhvillimore të obligueshme për të gjitha subjektet pjesëmarrëse në implementim. Me qëllim të ndërprerjes së dukurive negative që po ndodhin në hapësirë, Harta Zonale e Kosovës do të jetë instrumenti praktik, me të cilin do të bëhet më i lehtë zbatimi dhe monitorimi i veprimeve të planifikuara.

3. Procesi

Duke pasur parasysh argumentet e mësipërme ligjore, duke qenë të vetëdijshëm për presionin gjithnjë në rritje për zhvillim dhe duke qenë në dijeni për fillimin e këtij aktiviteti në disa qendra komunale, është vendosur për fillimin e procesit të hartimit të Hartës Zonale të Kosovës. Argument tjetër me rëndësi për fillimin e këtij procesi ka qenë edhe fakti se një pjesë e konsiderueshme e qëllimeve dhe objektivave të planifikuara në Planin Hapësinor të Kosovës në fuqi ishin në përputhje maksimalisht me kërkesat aktuale. Ky ka qenë momenti më i përshtatshëm për fillimin e një aktiviteti të tillë, i cili nën koordinimin dhe monitorimin e strukturave përgjegjëse të Ministrisë, ka bërë të mundur harmonizimin e veprimeve të të dy niveleve të qeverisjes. Paralelisht me punën që është bërë në hartimin e dokumenteve, ky moment ka qenë gjithashtu i përshtatshëm për ti konsoliduar instrumentet ligjore, për ti mënjeluar në maksimum paqartësitë dhe për ta vendosur në nivelin e duhur komunikimin e nevojshëm horizontal dhe vertikal me të gjithë pjesëmarrësit në proces. Procesi i hartimit të dokumentit është gjithëpërfshirës, prandaj e konsiderojmë se pjesëmarrja dhe përfshirja e sektorëve tjerë në proces ka qenë e një rëndësie të veçantë. Përkrahja dhe ndihma e ofruar nga pjesëmarrësit ka qenë vendimtare në përmbajtjen përfundimtare dhe suksesin e dokumentit në përgjithësi.

Sipas vendimit të nxjerrë më 16.04.2018, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit përkatësisht Instituti për Planifikim Hapësinor konfirmohen si bartës të procesit të hartimit të Hartës Zonale të Kosovës. Duke u bazuar në vendimin në fjalë me kërkesë dhe me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MEA-së është themeluar Grupi Punues Ndërmintor, me qëllim të përkrahjes së plotë të Institutit për Planifikim Hapësinor, anëtarët e të cilit kanë qenë përgjegjës për koordinimin e grupit. Anëtarët tjerë të grupit kanë qenë përfaqësuesit e të gjithë sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës, të gatshëm dhe përgjegjës që të ofrojnë ndihmën dhe përkrahjen e nevojshme. Në përkrahje të grupit kanë qenë edhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, përfaqësues nga bota akademike, përfaqësues të kompanive dhe organizatave joqeveritare që merren me çështje relevante. Ndihmë dhe bashkëpunim është kërkuar gjithashtu edhe nga profesionistët dhe ekspertët e pavarur të fushave dhe drejtimeve të caktuara me ndikim në procesin e hartimit dhe në përmbajtjen përfundimtare të dokumentit.



Vendimi për hartimin e Hartës Zonale të Kosovës

Bazë e mirë për procesin e hartimit të Hartës Zonale të Kosovës ka qenë seti prej afërsisht pesëdhjetë indikatorëve, të fushës së planifikimit hapësinor dhe urban. Analiza, matja dhe trajtimi i indikatorëve në fjalë ka qenë përpjekje e suksesshme, për të pasqyruar gjendjen aktuale dhe për të nxjerrë rekomandimet e duhura për disa nga çështjet e rëndësishme dhe me ndikim në planifikimin e ardhshëm hapësinor të vendit.

4. Raporti nga shqyrtimi publik

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, konkretisht Instituti për Planifikim Hapësinor, sipas nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, për finalizimin e draft-dokumenti HZKos, ka organizuar “Shqyrtimin Publik”, për të inkurajuar pjesëmarrjen transparente të publikut, me qëllim të përfshirjes së komenteve (vërejtjeve dhe sugjerimeve) lidhur me ndikimet e mundshme sociale, ekonomike dhe mjedisore në vend, për të ngritur cilësinë e dokumentit, para dorëzimit të tij për miratim përfundimtar në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës. Ministria me akt të veçantë përcakton përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, njoftimit publik, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të debatit publik, trajtimin e peticioneve, si dhe përgatitjen e raportit shqyrtues të propozimeve dhe vërejtjeve publike.

Gjatë finalizimit dhe procesit të shqyrtimit publik të draft HZKos janë organizuar disa takime konsultuese:

Takimet Konsultuese në Qendrat Kryesore Rajonale të Kosovës - Me qëllim të finalizimit sa më të kompletuar të draft-dokumentit “Harta Zonale e Kosovës”, janë mbajtur shtatë takime konsultuese, nëpër qendrat kryesore të rajoneve statistikore në Kosovë.

N.R.	Data e takimit	Vendi i takimit	Pjesëmarrës / Zyrtarët përgjegjës nga Komunitat
1	21.05.2019	Salla e Kuvendit Komunal Gjakovë	Junik, Malishevë dhe Rahovec
2	24.05.2019	Salla e Kuvendit Komunal Pejë	Deçan, Klinë dhe Istog;
3	28.05.2019	Salla e Kuvendit Komunal Prizren	Dragash, Mamushë dhe Suharekë
4	30.05.2019	Salla e Kuvendit Komunal Ferizaj	Hani Elezit, Kaçanik, Shtërpçë dhe Shtime;
5	06.06.2019	Salla e Kuvendit Komunal Mitrovicë	Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan dhe Zubin Potok;
6	07.06.2019	Salla e Kuvendit Komunal Gjilan	Kamenicë, Novobërdë, Ranillug, Partesh, Klllokot dhe Viti;
7	11.06.2019	Salla në objektin e Ri të Komunës Prishtinë	Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan dhe Drenas.

Figura 1. Tabela me agjendën e takimeve konsultuese nëpër qendrat rajonale statistikore. Burimi: IPH Maj 2019.

Procesi i “Shqyrtimit Publik” për draft dokumentin Harta Zonale e Kosovës 2020-2028+ është hapur më 19.06.2019, në Prishtinë, në Sallën e Konferencave në objektin e Qeverisë (ish Rilindja) në të cilin morrën pjesë më tepër se 120 pjesëmarrës.

Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor ky proces zgjatë 60 ditë me radhë, gjatë të cilës periudhë të gjithë qytetarët e Kosovës mund të kontribuojnë me rekomandime dhe vërejtje që do të ndikojnë në përmbajtjen përfundimtare të dokumentit, i cili është publikuar në Ueb faqen e MEA-së:MEA-rks.org.



Figura 2. Foto nga hapja solemne e shqyrtimit publik të draft-“Hartës Zonale të Kosovës”, në Prishtinë

Gjatë këtij procesi, janë organizuar një seri e takimeve tematike me profesionistë dhe grupe të interesit duke i përfshirë edhe qytetarët e interesuar:

Takimet konsultuese me drejtues dhe profesionistë nga Programe zhvillimore dhe GPNM - Takime konsultuese me drejtues dhe profesionistë nga UNDP-ja dhe 15 pilot komunitet dhe Takime konsultuese me anëtarë të GP për hartim të “Strategjisë së Zhvillimit Rajonal”;

Takimet konsultuese me drejtues dhe profesionistë të agjencive - sektorëve qeveritar – janë organizuar në lokalet e sektorëve të ndryshëm të qeverisjes qendrore: Takimi konsultues me drejtues dhe profesionistë të sektorit të Trashëgimisë Kulturore në MKRS, Takimi konsultues me drejtues dhe profesionistë të Agjencisë Statistike të Kosovës (ASK) si dhe Takimi konsultues me delegatët e Kuvendit të Kosovës – anëtarë të Komisionit Funkcional Parlamentar (KFP) për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Takimet konsultuese me studentë dhe profesorë të UP-së Hasan Prishtina – janë organizuar: Takimi konsultues me studentë dhe profesorë të Departamentit të Gjeografisë pranë Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore (FSHMN) dhe Takimi konsultues me studentë dhe profesorë të Fakultetit të Arkitekturës.

Qëllimi kryesor i organizimit të këtyre takimeve konsultuese ishte njoftimi i pjesëmarrësve me sfidat dhe metodologjinë e punës së përvetësuar gjatë procesit të hartimit të draft-Hartës Zonale të Kosovës, si dhe debati e diskutimi i përmbajtjes së vet materialit të grumbulluar e të renditur në draft-dokument, të rëndësishme të veçantë për sektorin e planifikimit hapësinor, për të dy nivelet e qeverisjes.

Komente të pranuar me shkrim përmes adresës elektronike - Përveç komenteve të deritanishme të adresuara nëpër takimet e organizuara rajonale e sektoriale, gjatë periudhës 60 ditore të Shqyrtimit Publik, janë pranuar edhe komente tjera me shkrim, nga: zyrat e organizatave ndërkombëtare, nga drejtoritë përkatëse komunale dhe nga sektorë të ndryshëm të Qeverisë së Kosovës.

Në të gjitha takimet por edhe në bazë të komenteve të pranuar janë diskutuar çështje të ndryshme që kanë rezultuar me pyetje-përgjigje, komente dhe sugjerime të adresuara nga drejtues dhe ekspertë profesional nga sektorët përkatës. Ndër temat më të diskutuara nga të pranishmit ishin:

- PHK dhe HZKos (zbatueshmëria); Hartimi i VSM; Planet për Zonat e Veçanta; Planet Rregulluese të Hollësishme;
- Infrastruktura - rrugore (zgjerimi dhe ndërtimi i linjave të reja: Autostrada e Dukagjinit; Autostrada e Anamoraves; Rruga nacionale Deçan - Plavë (Mali i Zi); Aksi i ri rrugor që lidhë Kosovën me Maqedoninë; Infrastruktura Hekurudhore; Infrastruktura e Gazit Natyror;
- Ndarja Rajonale Statistike (NUTS III); Përcaktimi i kufirit të Zonave Urbane dhe Rurale; Përcaktimi i kufijve të komunave në HZKos;
- Zonat e Veçanta; Zonat e Turizmit; Trashëgimia kulturore; Lokacioni për ndërtimin e Stadiumit Kombëtar; Hidrocentralet;
- Zhvillimi social (Shpërndarja adekuate e shëndetësisë; Migrimi i popullsisë dhe Banimi - raporti në mes të njësive të banimit dhe të njësive të zbrazëta);
- Gurëthyesit; Pastrimi dhe Ripyllëzimi i pyjeve;
- Përpjesa e Hartës; Kostoja e financiare e HZKos; etj.

Pjesëmarrja e publikut gjatë hartimit dhe procesit të shqyrtimit publik të draft dokumentit të HZKos – Në takime kanë marrë pjesë përfaqësues nga: drejtoritë relevante të Planifikimit, Urbanizimit, Mbrojtjes së Mjedisit, Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Infrastruktura, Arsimit, Kulturës e Shëndetësisë, nga niveli lokal (komunitet) dhe niveli qendror, komuniteti i biznesit, kompanitë projektuese (hartues të planeve komunale të VSMS-së) dhe kompani private, shoqëria civile si dhe profesionistë të fushave, studentë, profesor universitar, etj.

Një variant i raportit të zgjeruar nga procesi i shqyrtimit publik për “Hartën Zonale të Kosovës” do të jetë dokument i veçantë, pjesë e paketës që do të dorëzohet për aprovim përfundimtar në Kuvendin e Kosovës.

5. Planet strategjike sektoriale

Të gjitha sektorët e rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës janë të përfshirë në procesin e hartimit të këtij dokumenti. Përpos pjesëmarrjes së drejtpërdrejt në grupin punues përkrahës, janë shqyrtuar dhe trajtuar të gjitha dokumentet që mbulojnë planet për zhvillimin e ardhshëm të sektorëve. Në vijim janë të renditura përmbledhjet e disa prej këtyre dokumenteve, në kuadër të të cilave i kemi veçuar qëllimet dhe objektivat kryesore që në një mënyrë kanë efekt në zhvillimin e ardhshëm hapësinor të Kosovës.

5.1. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM (2016-2021)

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021) është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës, nga të cilat më kryesorja është vetë koordinimi i politikave zhvillimore dhe proceseve institucionale, të identifikuar nga studime të ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Ky dokument i formës së një strategjie ombrellë, do të mundësojë krijimin e sinergjive ndërmjet nismave të ndryshme, parandalimin e proceseve të dyfishta institucionale, efikasitet më të lartë të punës, orientimin e përkrahjes nga partnerët zhvillimorë, si dhe vendosjen e një boshti të fuqishëm orientues për institucionet e Kosovës dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve.

Hisedarë të këtij dokumenti janë të gjithë – institucionet shtetërore, sektori privat, shoqëria civile, partnerët zhvillimorë, etj. SKZH po ashtu dallon nga dokumentet e tjera për orientimin e politikave, sepse si i tillë përfshinë periudhë kohore përtej mandatit të një qeverie dhe është fokusuar në prioritetet e rëndësishëm të lartë. Si dokument orientues i politikave zhvillimore nuk adreson të gjitha aspektet e qeverisjes, por vetëm ato që lidhen me zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik dhe social. Për më tepër, ai përfaqëson një dokument nismash zhvillimore të cilat janë objektiva kombëtare që kanë konsensus të gjerë shoqëror. Njëkohësisht, SKZH është në harmoni të plotë me proceset e tjera strategjike, sikurse procesin e integritimit në BE përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) apo Programit për Reforma Ekonomike (PRE). Masat e parapara në SKZH janë kryesisht të sinkronizuara me prioritetet e reformave ekonomike dhe institucionale të nevojshme për integritimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Strukturalisht, SKZH është e ndarë në katër shtylla tematike:

- Kapitali njerëzor;
- Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë;
- Zhvillimi i industrive konkurruese; dhe
- Zhvillimi i infrastrukturës.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim synon që t'i orientojë resurset financiare të shtetit drejt ndërtimit të asetëve strategjike të infrastrukturës të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit. Në sektorin e energjisë, çështja e sigurisë së furnizimit do të adresohet përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja të bazuara në linjit, ndërkohë që do të shqyrtohen mundësitë për përdorimin e burimeve të ripërtërishtme nga uji dhe biogasi. Çështja e kostos do të adresohet përmes diversifikimit të burimeve të importit dhe uljes së konsumit me anë të masave të efikasitetit. Infrastruktura e transportit rrugor do të zgjerohet përmes përfundimit të autostradave ndërkombëtare që janë në ndërtim e sipër dhe nisjes së ndërtimit të autostradave rajonale, ndërkohë që do të bëhet edhe modernizimi i linjës së vetme hekurudhore ndërkombëtare për të lehtësuar transportin e mineraleve për eksport dhe të prodhimeve bujqësore. Masa të veçanta do të sigurojnë edhe investime që do të mundësojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke siguruar balancë mes nevojave zhvillimore dhe kujdesit ndaj mjedisit.

5.2. STRATEGJIA PËR KONSOLIDIMIN E TOKËS BUJQËSORE 2010-2020

Strategjia për Konsolidimin e Tokës përbën një udhërrëfyes mjaft të rëndësishëm, si dhe një dokument bazë për politikën dhe planet e veprimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë Zhvillimit Rural, për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe menaxhimit të drejtë të tokës. Strategjia e Konsolidimit të Tokës ka për synim rregullimin e tokave me qëllim të rritjes së sipërfaqes së saj, shfrytëzimin më racional dhe me

këtë rritjen e konkurrencës së fermës, rregullimin pronësor juridik, planifikim të shfrytëzimit të tokës, mbrojtjen e ambientit, diversifikimin e ekonomisë rurale, rritjes së të ardhurave dhe përmirësimit të jetës së popullatës që jetojnë në zonat rurale.

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të bujqësisë varet shumë nga përgatitja dhe zbatimi i drejt i politikave të tokës. Këto politika janë çelës i kontrollit të degradimit të tokës dhe përmirësimit të shfrytëzimit të tokës bujqësore, duke u bazuar në kapacitetet e saj prodhuese.

Politika e përgjithshme e transformimit të sektorit bujqësor të Republikës së Kosovës është e përfshirë në Planin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-13 dhe i azhurnuar 2009-2013. Konsolidimi i tokës do të jetë një instrument i rëndësishëm në implementimin e objektivave që kanë të bëjnë me tokën:

- Ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin bujqësor, shpesh i shprehur si nevojë “për rritjen e madhësisë së fermës”;
- Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve, pasi janë për së tepërmi të fragmentuara;
- Zhvillimi i komunitetit vendor, duke përfshirë ripërtëritjen e fshatrave, që në shkallë të ndryshme mund të përfshijnë edhe riorganizimin e tokës.

Qëllimi i përgjithshëm është që të sigurojnë shfrytëzim racional të tokës bujqësore, zgjedhjen e çështjes së pronësisë, sigurimin e zotërimit të tokës, rritjen e madhësisë së fermës, konkurrencës në treg, zhvillimin e infrastrukturës për popullatën rezidente në ato vende, mbrojtjen e ambientit, trashëgiminë kulturore dhe ndihmën për të zhvilluar aktivitete alternative bujqësore. Qëllimet dhe objektivat e strategjisë janë aktuale edhe në ditët e sotme, ka ende shumë nevojë për shfrytëzim racional, për zgjidhjen e pronësisë dhe problemeve tjera që lidhen me tokën bujqësore.

5.3. STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT 2013 – 2022

Sot mjedisi është një shqetësim global dhe një sfidë e përbashkët, me të cilën përballen vendet e pasura dhe të varfra, të zhvilluara dhe ato në zhvillim. Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) të Kosovës duhet të konsiderohet si pjesë e strategjisë afatgjate të zhvillimit të vendit. Qëllimi i SMM-së është të jep përgjigje në kërkesat e tashme dhe të ardhme të Republikës së Kosovës, si dhe trajtojë veçanërisht obligimet për menaxhimin e mjedisit në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar. Ky është një dokument i cili përcakton objektivat dhe prioritetet për të gjithë sektorët e mjedisit, të cilat duhet të zbatohen përmes Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis.

Prioritetet e përgjithshme

Nga këndvështrimi ndërkombëtar, prioritetet kryesore afatgjate për sektorin e mjedisit janë:

- Përmirësimi i cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët;
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe kulturor.

Prioritetet specifike

1. Sigurimi i instrumenteve financiare dhe ekonomike, duke përfshirë edhe krijimin e Eko-Fondit për mbrojtjen e mjedisit;
2. Themelimi dhe funksionimi i rrjetit monitorues të mjedisit në gjithë Kosovën, duke u dhënë përparësi ndotësve të mëdhenj industrialë dhe “pikave të nxehta”;
3. Rritja graduale e qasjes në ujë të pijshëm, rrjetin e ujërave të zeza dhe deponimit të mbeturinave komunale, me mbështetjen e programeve të trajtimit të ujërave të zeza dhe riciklimit të mbeturinave;
4. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore;
5. Shtimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura të natyrës, Zhvillimi i programeve arsimore, fushatave të ndërgjegjësimit dhe mbështetja për projektet shkencore të fokusuar në mjedis;
6. Aplikimi i koncepteve të efqienc të energjisë në të gjithë sektorët e përdoruesve të energjisë.

OBJEKTIVAT

1. Kompletimi i legjislacionit dhe harmonizimi me acquis të BE-së dhe zbatimi i tij;
2. Integrimi i mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët, në mënyrë që të jetë pjesë e politikave të përgjithshme zhvillimore dhe programeve (të zhvillimit të sektorit);
3. Ulja graduale e ndotjes së ajrit, ujit, tokës;
4. Ngritja e nivelit të administrimit të mbeturinave dhe ujerave;
5. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazheve natyrore;
6. Ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore.

5.4. STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2012-2025

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social i Kosovës dhe mirëqenia e qytetarëve varet në masë të madhe nga planifikimi dhe zbatimi i reformave strukturore ekonomike. Reformat në fjalë mundësojnë shfrytëzimin optimal të resurseve natyrore dhe njerëzore të Kosovës dhe hapjen e rrugës për zhvillimin e sektorit në përgjithësi.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës është një dokument i Qeverisë së Kosovës që krijon mundësi reale për shfrytëzimin sa më racional dhe zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve minerare. Ky dokument synon të jetë udhërrëfyes për institucionet relevante, për menaxhim të përgjegjshëm të pasurive minerale me qëllim të valorizimit të resurseve ekzistuese dhe identifikimin e resurseve të reja minerale.

Qëllimi primar i kësaj strategjie është të krijojë kushtet për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit mineral, i cili kontribuon në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës është hartuar në bazë të vizionit ekonomik të Qeverisë së Kosovës, ku zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, forcimi i sektorit mineral, miratimi i legjislacionit adekuat, reforma strukturore ekonomike dhe edukimi i gjeneratave të reja janë parimet bazë për të ardhmen ekonomike të Kosovës. Kjo strategji bazohet në katër shtylla themelore. Këto shtylla paraqesin kornizën për krijim të politikave dhe planeve të veprimit, të cilat definojnë se si institucionet dhe sektori mineral do të angazhohen për hulumtimin dhe zhvillimin e resurseve minerare si dhe zhvillimin e sektorit mineral në tërësi. Katër shtylla themelore përmes të cilave do të bëhet i mundur realizimi i strategjisë janë:

1. Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqje të investimeve;
2. Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe Institucionale në sektorin mineral;
3. Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit;
4. Përkujdesja për mjedisin;

5.5. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMI KULTURORE (TK)

Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturor 2017-2027 është strategji gjithëpërfshirëse e Qeverisë së Kosovës për fushën e trashëgimisë kulturore, e cila synon vendosjen e kornizave afatgjata dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë, duke synuar avancimin e sistemit dhe mekanizmeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

Në kontekstin e reformës institucionale dhe ligjore, Strategjia merr rolin e udhërrëfyesit për avancim të institucioneve të TK dhe të sistemit të mbrojtjes, nëpërmjet koordinimit ndërinstitucional dhe në përputhje me orientimin e Kosovës kundrejt Prioriteteve të Partneritetit Evropian dhe anëtarësim në UNESCO.

Qasja e integruar është karakteristikë tjetër e veçantë e cila promovon sistemin e ruajtjes, mbrojtjes, përfshirjes në plane, përdorimit dhe prezantimit të TK të Kosovës sipas parimeve ndërkombëtare dhe trendëve të zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror, kulturor dhe mjedisor.

Sa i përket edukimit, promovimit, komunikimit dhe ndërgjegjësimit të vazhdueshëm qytetar, Strategjia e kthen fokusin te roli i pakontestueshëm që ka TK në nxitjen e ndjenjës së identitetit kulturor dhe të përkatësisë, promovim dhe lehtësim të dialogut ndërkulturor dhe ndër-fetar dhe si burim i frymëzimit për gjeneratat e reja.

Strategjia shtjellohet përmes Qëllimeve të listuara më poshtë, të cilat ndahen në objektiva, masa dhe projekte që paraqesin formën më të detajuar të aktiviteteve për realizimin e saj.

Disa nga Qëllimet dhe objektivat që në mënyrë indirekte ndërlidhen me fushën e planifikimit hapësinor:

Q1. Sistemi ligjor dhe institucional i mbrojtjes;

O1. Avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale;

Q2. Qasja e integruar në mbrojtje;

O2. Qasja e integruar në mbrojtje të TK, drejt zhvillimit të qëndrueshëm;

O3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore;

Q3. Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar.

O4. Promovimi i trashëgimisë kulturore;

O5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

5.6. STRATEGJIA E SHËNDETËSISË - 2017-2021

Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017–2021 është dokumenti kryesor që përcakton drejtimin dhe qasjen strategjike afatmesme të zhvillimit të sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës. Qëllimi i këtij dokumenti është jetësimi i vizionit për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta për të gjithë qytetarët e vendit.

Karakteristikat demografike të popullatës orientojnë zhvillimin e sistemit shëndetësor kah ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës, duke fuqizuar kujdesin parësor si shtyllë të sistemit shëndetësor, me theks të veçantë në promovim të mënyrave të shëndetshme të jetesës. Strategjia reflekton prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, qeverisjen e mirë, fuqizimin e sundimit të ligjit, promovimin e partneritetit publiko privat, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe mirëqenien sociale. Gjithashtu, Strategjia adreson sfidat dhe synimet drejt arritjes së Qëllimeve zhvillimore strategjike (QZhS / SDG) që kanë të bëjnë me shëndetin.

Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021 shtjellohet përmes Qëllimeve të listuara më poshtë të cilat më tutje ndahen në Objektiva, masa dhe projekte që paraqesin formën më të detajuar të aktiviteteve për realizimin e saj.

Q1. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit,

Q2. Sigurimi i financimit të qëndrueshëm shëndetësor,

Q2. Riorganizimi i sektorit shëndetësor

5.7. STRATEGJIA TRANSPORTIT MULTIMODAL 2015-2025

Kjo Strategji parasheh modelet e zhvillimit të infrastrukturës së transportit, realizimi i të cilave do të bëjë që Republika e Kosovës të ketë një infrastrukturë të zhvilluar të transportit e njëkohësisht, të ketë qasje më të lehtë në tregjet ndërkombëtare të mallrave, të shërbimeve dhe në tregjet e punës. Me këtë Strategji përcaktohen qartë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës së transportit në tërësi, për ndërtimin e rrugëve moderne, që lidhen me korridoret pan-evropiane, ndërtimin e infrastrukturës bashkëkohore të transportit hekurudhor, ajror, detar dhe të infrastrukturës për komunikime elektronike, me

çka do të krijohen kushte për transport të sigurt dhe respektimin e kriterëve ndërkombëtare për ruajtjen e mjedisit jetësor.

Përveç çështjeve thelbësore, që kanë të bëjnë me infrastrukturën e transportit, me ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e saj, në dokument janë paraparë edhe aktivitete përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës, realizimi i të cilave përputhet dhe e përplotëson Programin e Qeverisë për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata rajonale dhe ndërkombëtare të transportit.

Objektivat strategjike që dalin nga ky dokument janë:

Objektiva strategjike 1: Lidhja me korridoret pan-evropiane - Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajta e infrastrukturës së transportit, e cila është e integruar në korridoret pan-evropiane dhe është në harmoni me standardet ndërkombëtare;

Objektiva strategjike 2: Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve - Krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit;

Objektiva strategjike 3: Përmirësimi i sigurisë në komunikacion dhe i mbrojtjes së mjedisit;

Objektiva strategjike 4: Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare - Anëtarësimi dhe bashkëpunimi i Kosovës me organizatat ndërkombëtare në fushën e transportit;

Objektiva strategjike 5: Ndërtimi i strukturës funksionale - Strukturë funksionale me resurse njerëzore të mjaftueshme, të motivuara dhe kompetente për sektorin e transportit.

5.8. PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë është dokumenti bazë për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë në periudhën 2017-2021. Qëllimi i këtij plani është të përcaktojë kahet e zhvillimit të sistemit të arsimit, në mënyrë që arsimit të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Fjalët kyçe të planit të ri strategjik janë: gjithë përfshirja, cilësia dhe llogaridhënia.

Vlerësimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 dhe analiza e gjendjes, ka qenë baza për planifikimin e ri pesëvjeçar. Procesi i planifikimit është organizuar në shtatë fusha tematike (qëllimet dhe objektivat) që mbulojnë të gjitha segmentet relevante të arsimit në Kosovë:

Q1. Pjesëmarrja dhe gjithë-përfshirja;

Q1.01. Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin para-universitar.

Q2. Menaxhimi i sistemit arsimor;

Q2.01. Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe llogaridhënie;

Q3. Sigurimi i cilësisë;

Q3.01. Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Q4. Zhvillimi i mësimdhënësve;

Q4.01. Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Q5. Mësimdhënia dhe të nxënit;

Q5.01. Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë.

Q6. Arsimit dhe aftësimi profesional dhe arsimit të rritur;

Q6.01. Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.

Q7. Arsimit të lartë;

Q7.01. Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkim shkencor, krijimtari artistike, inovacion dhe ndërkombëtarizim.

5.9. STRATEGJIA E ENERGJISË 2016 – 2025

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2016 – 2025 është dokument themelor afatgjatë për zhvillimin e sektorit të energjisë, që bazohet në analizën e problemeve dhe mënyrën më të përshtatshme të zgjidhjes tyre, duke përcaktuar një vizion me pesë objektivat kryesore:

Vizioni: Strategjia e Energjisë synon krijimin e një sektori të zhvilluar të energjisë të padëmshëm për mjedisin dhe shëndetin që mbështetë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenien shoqërore në Kosovë në kuadër të një tregu të lire dhe konkurrues.

Ky vizion synohet të arrihet përmes këtyre 5 objektivave:

1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm e cilësor me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike;
2. Integrimi i Kosovës në Tregun Rajonal të Energjisë;
3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja;
4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror; dhe
5. Përmirësimi i shfrytëzimit më eficient të energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe të mbrojtjes mjedisit sipas kërkesave të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe të MSA-së.

Për arritjen e këtyre objektivave strategjike janë rekomanduar edhe politikat dhe masat më të përshtatshme për realizimin e qëllimit themelor (misionit): “Krijimi i kushteve që siguron furnizim të besueshëm e cilësor të energjisë elektrike, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse, të afta për përbashkimin e kërkesave në rritje, duke pasur parasysh larminë e burimeve, aftësinë blerëse të konsumatorëve, shfrytëzimin maksimal të burimeve të ripërtëritshme, mos dëmtimin e mjedisit dhe konkurrencën e lirë”.

Ndërsa, masat kryesore për arritjen e objektivave janë:

- Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike për të mbuluar kërkesat e konsumatorëve dhe ato rregulluese të sistemit, në kushte të operimit brenda një tregu të përbashkët me Shqipërinë;
- Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes duke rritur eficiencën e reduktuar kostot;
- Plotësimi kushteve për integrimin e Kosovës në tregun e përbashkët rajonal të energjisë si dhe zbatimin e detyrimeve që dalin nga Marrëveshja për Themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe MSA-ja;
- Zgjerimi i kapaciteteve në sistemet ekzistuese të energjisë termike dhe përgatitja e kushteve për ndërtimin e sistemeve të reja;
- Përgatitja e kushteve për zhvillimin e sistemit të gazit natyror;
- Përmirësimi i shfrytëzimit eficient të energjisë dhe plotësimi i obligimeve sipas TKE-së dhe MSA-së për eficiencë të energjisë;
- Shfrytëzimi më i madh i potencialeve të energjisë nga burime të ripërtëritshme dhe plotësimi i obligimeve të TKE-së dhe MSA-së për BRE-të;
- Integrimi i tregut të energjisë me atë të republikës së Shqipërisë;
- Përmirësimi i kushteve mjedisore gjatë aktiviteteve të operatorëve të sektorit të energjisë sipas një plani kombëtar të veprimit për mjedisin, duke i plotësuar kërkesat e TKE-së dhe MSA-së si dhe harmonizuar ato me politikat e sigurisë së furnizimit të energjisë e deri në fillim të operimit të kapaciteteve të reja dhe atyre të rehabilituara.

5.10. STRATEGJIA E UJËRAVE

Strategjia për Ujëra është një nga dokumentet kryesore të planifikimit të resurseve ujore në Republikën e Kosovës. Ky dokument është detyrim ligjor ku adreson dhe orienton zhvillimet politike, operative dhe investive në sektorin e ujërave për periudhën 20 vjeçare. Qëllimi i Strategjisë është që të ofroj një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të sektori të ujërave duke dhënë përgjigje të gjitha kërkesave për sa i takon: Furnizimit me ujë, Ujë për ujitjen e tokave bujqësore, Ujë për industrinë, për sport dhe rekreacion, dhe Ujë gjenerimin e energjisë.

Strategjia Shtetërore e Ujërave ka për qëllim të jep përgjigje ne tri elemente bazike:

1. Shfrytëzimin e qëndrueshëm;
2. Trajtimin e ujërave të ndotura; dhe
3. Mbrojtjen nga ujërat.

Objektivat synohen të arrihet përmes zhvillimit të projekteve përmes planit për Investime që përmbledh projektet me prioritet të përcaktuara nga MEA në bashkëpunim me sektorët tjerë, të cilët direkt apo indirekt janë të lidhur me sektorin e ujërave ose shfrytëzojnë sasi të konsiderueshme të ujit në zhvillimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të tyre.

Qëllimet dhe objektivat kryesore të Strategjisë janë:

Q1. Ruajtja dhe mbrojtja e resurseve ujore

- Q1.01. Përcaktimi i zonave të mbrojtura sanitare, zonave strategjike, Natyra 2000 ashtu siç janë të përcaktuara në kreun IX të ligjit të ujërave Nr.04/L-147;
- Q1.02. Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura nga amvisëria;
- Q1.03. Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura nga industria nxjerrëse dhe përpunuese;
- Q1.05. Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura (infrastruktura Urbane);
- Q1.06. Monitorimi i parametrave të shkarkimit të ujërave të ndotura.

Q2. Ekonomizimi – valorizimi ekonomik i resurseve ujore (shfrytëzimi i qëndrueshëm)

- Q2.01. Furnizimi me ujë të pijshëm;
- Q2.02. Ujitja e tokave bujqësore;
- Q2.03. Furnizimi me ujë të Industrisë ushqimore, industrinë nxjerrëse dhe përpunuese;
- Q2.04. Gjenerimi e energjisë elektrike;
- Q2.05. Rritja e peshkut;
- Q2.06. Turizmi, sporti dhe rekreacioni;
- Q2.07. Vetëdijesim për ekonomizim të resurseve ujore;
- Q2.08. Parandalim i tej shfrytëzimit, etj.

Q3. Mbrojtja dhe menaxhimi i situatave që mund të ndodhin - thatësia dhe vërshimet,

- Q3.01. Vërshimet (rregullimi i segmenteve lumore, masat biologjike, muret mbrojtëse, gabionet, argjinaturat, ngritje të terrenit me mbushje etj.);
- Q3.02. Erozioni (prita malore, pyllëzim, mbrojtje të pyjeve, etj.);
- Q3.03. Kullimi (kanale drenazhimi etj.);
- Q3.04. Tharja (kanale drenazhimi, mbushje, injektive, etj.);
- Q3.05. Thatësia (sistemet për paralajmërime të hershme);
- Q3.06. Ndryshimet klimatike.

5.11. STRATEGJIA PËR ZVOGËLIM TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË

Kjo strategji përfshinë periudhën 2016 - 2020 dhe është një dokument themelor që ka për qëllim të bashkërendojë punën nga akterët në nivel lokal, ministritë e linjës si dhe donatorët vendorë dhe të huaj, për të zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë dhe njëkohësisht duke kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm të Kosovës.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT KRYESORE TË STRATEGJISË

Q.1. Integrimi i Zvogëlimit të Rrezikut në politika dhe plane zhvillimore si dhe mbikëqyrja;

- Q1.01. Integrimi i politikave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si dhe zbatimi i ligjshmërisë me qëllim të menaxhimit dhe qeverisjes së rreziqeve;
- Q1.02. Forcimi i mekanizmave institucional dhe kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e strategjisë;
- Q1.03. Lobimi për angazhimin politik si dhe marrja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia;
- Q1.04. Rritja e mbështetjes financiare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë;
- Q1.05. Harmonizimi i ligjeve/politikave sektoriale me standardet e vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve;

Q.2. Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (FNFT);

- Q2.01. Rritja e aftësive për gjenerimin e informacioneve (statistikave dhe të dhënave të ndryshme) për FNFT;
- Q2.02. Forcimi i kapaciteteve për grumbullimin, vlerësimin dhe analizimin e informatave, si dhe plotësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave për fatkeqësitë natyrore;
- Q2.03. Zgjerimi i kapaciteteve të reja të institucioneve në nivel qendror dhe lokal për sistemin e paralajmërimit të hershëm;
- Q2.04. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional për paralajmërimin e hershëm në lidhje me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;
- Q2.05. Mbështetja e hulumtimeve, këmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit me institucione shkencore dhe akademike me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve ekzistuese dhe parandalimi i rreziqeve të reja;

Q.3. Krijimi i komuniteteve të sigurta dhe të qëndrueshme nga fatkeqësitë


- Q3.01. Përmirësimi i komunikimit dhe shpërndarjes së informacioneve në mes institucioneve përkatëse për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;
- Q3.02. Vetëdijësimi dhe sensibilizimi i komunitetit për rëndësinë e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore përmes fushatave mediatike, rrjeteve sociale, trajnimeve, ushtrimeve si dhe masave mbrojtëse;
- Q3.03. Organizimi dhe ngritja e strukturave për mbrojtje-shpëtim dhe ndihmë (SMSHN);
- Q3.04. Përfshirja dhe organizimi i të rinjve dhe shoqërisë civile në SMSHN me qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;

Q.4. Vetëdijësimi dhe nxitja e institucioneve dhe subjekteve për rreziqet nga FNFT

- Q4.01. Promovimi dhe zhvillimi i instrumenteve dhe programeve që hartojnë standarde, kode, udhëzime operacionale, plane, projekte, etj;
- Q4.02. Përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit mes institucioneve relevante në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve;
- Q4.04. Zhvillimi i standardeve të cilësisë të tilla si çertifikimi dhe mirënjohja për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë me pjesëmarrjen e sektorit privat, shoqërisë civile, organizatave dhe shoqatave;
- Q4.05. Promovimi dhe mbështetja e marrëveshjeve për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar;
- Q4.06. Sigurimi i informacionit cilësor, vlerësimi, krijimi i statistikave/databazave si dhe monitorimi i trendeve për rreziqet e reja nga fatkeqësitë natyrore;
- Q4.07. Promovimi i protokolleve rajonale për lehtësimin e shkëmbimit të kapaciteteve dhe krijimin e lehtësirave për reagim emergjent gjatë dhe pas fatkeqësive.

6. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+

Procesi i hartimit të dokumentit të Hartës Zonale të Kosovës ka filluar me shqyrtimin e Planit Hapësinor në fuqi, për të cilin fillimisht janë analizuar të dhënat e shfrytëzuara gjatë procesit të hartimit të dokumentit. Si rezultat i kësaj analize është angazhimi në trajtimin e indikatorëve themelor në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, me të cilët është ndërtuar një bazë e re e të dhënave, e cila i përgjigjet maksimalisht gjendjes aktuale në terren. Gjendja dhe trendi i prezantuar në të gjithë indikatorët e trajtuar, ka bërë të mundur nxjerrjen e rekomandimeve për ndryshimin e gjendjes për indikatorët dhe çështjet përkatëse. Kjo ka qenë baza nga e cila ka filluar analiza dhe shqyrtimi i kapitullit të tretë dhe të katërt të Planit Hapësinor në fuqi, përkatësisht analiza dhe shqyrtimi i qëllimeve, objektivave dhe veprimeve të planifikuara në dokument. Sipas kësaj analize mund të konstatohet se pjesa më e madhe e qëllimeve dhe objektivave është në përputhje me situatën aktuale të zhvillimeve hapësinore në territorin e Kosovës.



Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+



Vendimi për miratimin e PHK-së

Harta Zonale e Kosovës është dokument që rrjedhë nga Ligji për Planifikim Hapësinor, sipas të cilit plani hapësinor i deritashëm ndahet në dy dokumente. Pjesa e parë e dokumentit është Plani Hapësinor, i cili përfundon me prioritetet strategjike dhe planin e veprimit për arritjen e tyre. Lista e prioritetëve strategjike rrjedhë nga koncepti i zhvillimit hapësinor, i bazuar në analizën dhe shqyrtimin e skenarëve për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të vendit. Skema e përvetësuar e konceptit me të cilën definohet korniza e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, është rezultat i qëllimeve dhe objektivave që rrjedhin nga Vizioni për të ardhmen e Kosovës. Kjo është pjesa e dokumentit në të cilën janë vendosur strukturat kryesore për zhvillimin dhe organizimin hapësinor të vendit. Sipas këtij organizimi, Kosova ndahet në katër zona, të cilat janë caktuar në bazë të tipareve që janë karakteristike për këto zona dhe të cilat në aspektin hapësinor shtrihen në shtatë rajone. Këto tipare janë unike për secilën prej tyre në kuadër të të cilave janë të përfshira potencialet zhvillimore, karakteristikat gjeografike dhe veprimtaritë ekonomike që zhvillohen në këto zona. Emri i zonës prezanton një formë të identitetit të zonës, e cila në hartë paraqitet me ngjyra të caktuar dhe në të njëjtën kohë është pjesë e rajonit përkatës me qendrën e saj kryesore. Zonat në fjalë janë:

- **Thesari i Kosovës** (Hapësira e gjelbër) - industriale, shërbyese tregtare – paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Mitrovica si qendër kryesore dhe Vushtrria, Skenderaj, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku si komuna më të vogla të cilat gravitojnë në Mitrovicë.

- **Porti i Kosovës** (Hapësira e kaltër) - administrative, shërbyese, tregtare, agro-industriale, turistike – paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Prishtina si qendër kryesore dhe kryeqendër e Kosovës, Obiliqi, Podujeva, F. Kosova, Lypjani, Drenasi dhe Shtime që gravitojnë në qytetin e Prishtinës.
- **Urat e Kosovës** (Hapësirat e verdha) - shërbyese tregtare, agro-industriale e turistike - paraqesin pjesët juglindore dhe jugperëndimore të Kosovës, të përbërë nga komunat: 1) Ferizaj, Gjilan, Kaçanik, Shtërpce, Kamenicë, Novobërdë dhe Viti, në qendër me qytetet e Ferizajt dhe Gjilanin; 2) Gjakovë, Deçan, Rahovec dhe Malishevë në qendër me qytetin e Gjakovës.
- **Kopshtet e Kosovës** (Hapësirat e portokallta) - kulturore-turistike, shërbyese tregtare, agro-industriale paraqesin pjesët perëndimore/veriperëndimore dhe jugore të Kosovës, të përbërë nga komunat: 1) Pejë, Klinë dhe Istog me qytetin e Pejës në qendër; 2) Prizren, Suharekë dhe Dragash me qytetin e Prizrenit në qendër.

Pjesë e rëndësishme e këtij organizimi është shpërndarja, zhvillimi, struktura dhe rrjeti i vendbanimeve i bazuar në: madhësinë (nr. i banorëve, territori), funksionin dhe shërbimet që ofrohen - si kritere vendimtare, na bazë të të cilave është vendosë hierarkikja/niveli i vendbanimeve. Sipas kësaj hierarkie, Prishtina vazhdon ta mbajë nivelin e Kryeqendrës administrative të Kosovës; Niveli dytë i hierarkisë së vendbanimeve janë Qendrat e mëdha (Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe Gjilani); Niveli i tretë janë Qendrat e vogla (të gjitha qytetet tjera); dhe niveli i fundit janë Fshatrat si njësi apo niveli më e vogël i vendbanimeve.

Prej fillimit e deri në aprovimin e dokumentit procesi ka qenë gjithëpërfshirës, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të të gjitha institucioneve relevante nga të dy nivelet e qeverisjes. Pjesë e procesit kanë qenë profesionistë të fushave të ndryshme, organizata të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare aktive në Kosovë dhe një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të interesuar. Në kuadër të procesit janë mbajtur disa shqyrtime dhe takime publike, në të cilat janë prezantuar dhe diskutuar fazat e ndryshme të procesit. Si rezultat i këtyre shqyrtimeve kanë qenë rekomandimet dhe vërejtjet që në vazhdimësi kanë pasur ndikim direkt në ngritjen e nivelit të dokumentit deri në aprovimin e tij përfundimtar.

6.1. Vizioni nga PHK

“Vend i integruar në Bashkësinë Evropiane; Me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë dhe forcë pune të kualifikuar; Një Kosovë që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve; Shoqëri e hapur që promovon lojlojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve duke respektuar të drejtat e të gjithëve.”

6.2. Qëllimet dhe objektivat nga PHK

Pjesë e rëndësishme e procesit ka qenë rishqyrtimi i qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në Planin Hapësinor në fuqi. Një veprim i tillë është mundësuar dhe bazuar në Ligjin dhe udhëzimin administrativ në fuqi UA Nr.10./2016, Neni 9, paragrafi 1.5.) sipas të cilit: duhet të konsiderohet “Përfshirja e ndryshimeve eventuale në strategjitë sektoriale të qeverisë që nga miratimi i Planit Hapësinor të Kosovës”. Kjo nënkupton përfshirjen e veprimeve, masave dhe aktiviteteve që kanë ndodhur pas miratimit të PHK-së në fuqi. Në vazhdim është paraqitur lista e qëllimeve dhe objektivave që janë nxjerrë nga dokumenti i Planit Hapësinor në fuqi:

QËLLIMI: Kosova vend i integruar në Bashkësinë Evropiane

Objektivat:

- Kosova - Shtet demokratik;
- Vend i hapur dhe i integruar në rajon dhe më gjerë;
- Organizimi hapësinor në shtatë rajone;
- Kryeqytet - Prishtina si qendër administrative-politike.

QËLLIMI: Arritja e zhvillimit social të balancuar me mundësi të barabarta të qasjes në shërbime për të gjithë

Objektivat:

- Hapësira adekuate për arsim, shëndetësi dhe kulturë;
- Arsimit cilësor dhe i vazhdueshëm për të gjithë;
- Pajisje dhe infrastrukturë adekuate e teknologjisë informative;
- Sigurimi i mjedisit adekuat për zbatimin e reformave në arsim;
- Shpërndarje e barabartë e përmbajtjeve nëpër të gjitha trevat e Kosovës;
- Shpërndarje adekuate e arsimit profesional dhe arsimit të lartë;
- Shërbime mjekësore me cilësi të lartë dhe të decentralizuara.

QËLLIMI: Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor, zhvillim i balancuar hapësinor, ruajtja dhe respektimi i resurseve - trashëgimisë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve

Objektivat:

- Planifikimi i hapësirës për shfrytëzim racional të territorit;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Zhvillim hapësinor i balancuar;
- Stimulimi i politikave të zhvillimit të zonave rurale;
- Shfrytëzimi i mineraleve për një zhvillim të qëndrueshëm;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Rregullimi i ndërtimeve ilegale dhe vendbanimeve joformale.

QËLLIMI: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, i balancuar, i bazuar në resurse natyrore, njerëzore, teknologji moderne, konkurrencën e tregut dhe përmbushjes së standardeve për mbrojtjen e mjedisit

Objektivat:

- Krijimi i vendeve të mjaftueshme të punës;
- Avancimi i teknologjisë prodhuese;
- Ngritja e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale;
- Krijimi i kushteve për konkurrencë në tregun rajonal;
- Arsimitimi i vazhdueshëm i kuadrit profesional;
- Krijimi i mjedisit atraktiv për investitorë.

QËLLIMI: Infrastruktura dhe komunikimi i integruar duke respektuar standardet e mbrojtjes së mjedisit

Objektivat:

- Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë;
- Përmirësimi i rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme;
- Shërbime publike cilësore;
- Kyçje në korridoret rajonale-evropiane;
- Bashkëpunim rajonal në zhvillimin e infrastrukturës;
- Llojlojshmëria dhe cilësia e telekomunikimeve.

6.3. Prioritetet strategjike

- Kosova vend i hapur dhe i integruar në rajon dhe më gjerë;
- Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë;
- Arsimit cilësor dhe i vazhdueshëm për të gjithë;
- Shërbime mjekësore me cilësi të lartë dhe të decentralizuara;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Ngritja e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale;
- Zhvillim hapësinor i balancuar;
- Krijimi i vendeve të mjaftueshme të punës.

6.4. Analiza e qëllimeve dhe objektivave dhe përshtatja e tyre me kërkesat aktuale

Me përkrahjen e Grupit Punues dhe angazhimin e ekspertëve të sektorëve të ndryshëm qeveritar, jemi dakorduar për plotësimin dhe adaptimin e qëllimeve dhe objektivave me gjendjen dhe kërkesat aktuale hapësinore. Një pjesë e konsiderueshme e kohës është shfrytëzuar në analizën e qëllimeve të përcaktuara në Planin Hapësinor në fuqi dhe përshtatjen e tyre me gjendjen aktuale. Disa nga qëllimet për nga përmbajtja kanë pësuar një ndryshim, të cilat më tepër janë si pasojë e përpjekjes tonë për të bërë më të qartë definicionin e qëllimit dhe ndarjes/dallimit të tij nga objektivi përkatës. Qëllimet nga Plani Hapësinor i Kosovës janë ndryshuar deri në masën e nevojshme pa e humbur thelbin dhe arsyen fillestare për të cilat janë bërë pjesë e dokumentit. Pjesë e kësaj liste të modifikuar janë edhe shumë objektiva të qarta të cilat janë plotësuar me objektiva shtesë nga dokumentet strategjike sektoriale në fuqi, duke përfshirë edhe dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, nga e cila janë përvetësuar disa objektiva dhe aktivitete me rëndësi dhe me ndikim hapësinor.

Një tabelë fillestare është prezantuar në takimin e parë të GPNMs, nga të cilët është kërkuar mbledhja dhe ofrimi i të dhënave aktuale për qëllimet dhe objektivat e sektorëve të tyre. Pas analizave dhe diskutimeve grupore e shpesh edhe bilaterale jemi dakorduar për versionin përfundimtar të tabelës së qëllimeve dhe objektivave të prezantuar në vazhdim.

Lista e Qëllimeve dhe Objektivave të modifikuara

Q1. KOSOVA VEND I INTEGRUAR NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE ME ZHVILLIM HAPËSINOR TË QËNDRUESHËM DHE TË BARASPESHUAR

- Q1.01. - Prishtina – Kryeqytet i Republikës së Kosovës dhe qendër administrative e rajonit të Prishtinës;
- Q1.02. - Integrimi dhe anëtarësimi i Kosovës në politikat e Bashkësisë Ndërkombëtare;
- Q1.03. - Ngritja e cilësisë së planifikimit hapësinor, të mjediseve urbane dhe rurale, në shtatë qendrat rajonale, për shfrytëzim efikas të territorit;
- Q1.04. - Ndarja e territorit të Kosovës sipas rajoneve me karakteristika dhe potenciale të ngjashme zhvillimore;

Q2. ZHVILLIM I BARASPESHUAR SOCIAL

- Q2.01. - Shpërndarja adekuatë e infrastrukturës shkolllore;
- Q2.02. - Riorganizimi i decentralizuar i sektorit të shëndetësisë për shërbime mjekësore më cilësore;
- Q2.03. - Rritja dhe modernizimi i infrastrukturës për sport dhe kulturë sipas standardeve ndërkombëtare;
- Q2.04. - Fuqizimi i sektorit të banimit;

Q3. SHFRYTËZIM I QËNDRUESHËM I MJEDISIT DHE VLERAVE NATYRORE E KULTURORE

- Q3.01. - Menaxhimi efikas dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit;
- Q3.02. - Mbrojtja dhe mirëmbajtja e llojlojshmërisë bimore/shtazore dhe habitateve të tyre si dhe krijimi i korridoreve të gjelbërta;
- Q3.03. - Mbrojtja dhe rritja e sipërfaqeve pyjore dhe bujqësore;
- Q3.04. - Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore;
- Q3.05. - Parandalimi i ndotjes së mjedisit jetësor të ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës;
- Q3.06. - Parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe nga faktori njeri;
- Q3.07. - Rehabilitimi i sipërfaqeve të ndotura të tokës nga hot spotet, mbetjet industriale dhe mbeturinat tjera të rrezikshme;

Q4. ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK

- Q4.01. - Shfrytëzimi racional dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore;
- Q4.02. - Shfrytëzimi racional dhe menaxhimi i qëndrueshëm i sipërfaqeve pyjore;
- Q4.03. - Krijimi i kushteve për shfrytëzimin e potencialit mineral të Kosovës;
- Q4.04. - Krijimi i Zonave Ekonomike në inkurajimin e investimeve për zhvillimin e veprimtarive afariste;
- Q4.05. - Ngritja e kapaciteteve turistike sipas analizave ekonomike, sociale-kulturore, mjedisore;
- Q4.06. - Shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;

Q5. INFRASTRUKTURË MODERNE DHE SHËRBIME PUBLIKE CILËSORE

- Q5.01. - Zhvillimi i infrastrukturës së transportit – promovimi dhe zhvillimi i transportit publik;
- Q5.02. - Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë – shfrytëzimi eficient i energjisë dhe ulja e emisioneve të gazeve serrë;
- Q5.03. - Zhvillimi i infrastrukturës ujore;
- Q5.04. - Zhvillimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike;
- Q5.05. - Zhvillimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave;

6.5. Prioritetet strategjike të modifikuara

Lista e prioriteteve strategjike të mëposhtme është si rrjedhojë e shqyrtimit të listës nga Plani Hapësinor në fuqi, e modifikuar dhe e përshtatur me kërkesat më të rëndësishme që aktualisht vendi ynë ka nevojë. Përmbajtja e saj është gjithashtu rezultat i diskutimeve në grupin punues dhe e harmonizuar me planet zhvillimore të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës.

Lista e prioriteteve strategjike

1. Ndarja e territorit të Kosovës sipas rajoneve me karakteristika dhe potenciale të ngjashme zhvillimore;
2. Shpërndarja adekuate e arsimit profesional dhe arsimit të lartë;
3. Riorganizimi i decentralizuar i sektorit të shëndetësisë për shërbime mjekësore më cilësore;
4. Rritja dhe modernizimi i infrastrukturës për sport dhe kulturë;
5. Fuqizimi i sektorit të banimit;
6. Menaxhimi efikas dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit;
7. Përshtatja dhe adaptimi i zhvillimeve ndaj ndryshimeve klimatike;
8. Mbrojtja, shfrytëzimi racional dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe sipërfaqeve pyjore;
9. Mbrojtja dhe menaxhimi i mjedisit jetësor të ajrit, ujit dhe tokës;
10. Parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe nga faktori njeri;
11. Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore;
12. Krijimi i kushteve për shfrytëzimin e potencialit mineral të Kosovës;
13. Krijimi i Zonave Ekonomike;
14. Ngritja e kapaciteteve turistike;
15. Zhvillimi i infrastrukturës së transportit – promovimi dhe zhvillimi i transportit publik;;
16. Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë – shfrytëzimi eficient i energjisë dhe ulja e emisioneve dhe ulja e emisioneve të gazeve serrë;
17. Zhvillimi i infrastrukturës ujore;
18. Zhvillimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike;
19. Zhvillimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave.

II. ZONAT E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Kjo është njëra ndër pjesët më të rëndësishme të dokumentit, në të cilën pas një përshkrimi të shkurtër për të dhënat themelore janë dhënë rekomandimet dhe veprimet e duhura për përmirësimin e gjendjes në zonat përkatëse. Përgjegjës për implementimin e tyre janë të gjithë sektorët relevant e posaçërisht niveli lokal për planifikim hapësinor dhe urban. Komunitatet përmes drejtorive përkatëse obligohen që të marrin në konsideratë dhe të trajtojnë ato në dokumentet e tyre përkatëse. Këto rekomandime janë të harmonizuara edhe me përkrahjen e drejtpërdrejtë të anëtarëve të grupit punues ndërministror, duke përfshirë edhe ndihmën që është ofruar nga përfaqësuesit kompetent të sektorëve jo anëtarë. Të gjitha rekomandimet janë në harmoni të plotë me listën e prioriteteve strategjike. Ky kapitull është përcjellë edhe me tabelën e planit të veprimeve si kapitull i veçantë, në të cilën në mënyrë të veçantë përshkruhen aktivitetet konkrete, përcaktohen institucionet përgjegjëse, janë vendosur periudhat e zbatimit, janë caktuar burimet buxhetore dhe është vendosur kostoja e zbatimit për aktivitetin përkatës.

Lista e zonave të trajtuara në dokument

1. ZONAT RAJONALE STATISTIKORE;
2. ZONAT BUJQËSORE;
3. ZONAT PYJORE;
4. ZONAT E INFRASTRUKTURËS TEKNIKE;
5. ZONAT URBANE;
6. ZONAT RURALE;
7. ZONAT E BANIMIT;
8. SIPËRFAQET E MBROJTURA;
9. ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA;
10. ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË EKONOMIK;
11. ZONAT E SHËRBIMEVE – ARSIMI;
12. ZONATE E SHËRBIMEVE – SHËNDETËSIA;
13. ZONAT TURISTIKE;
14. ZONAT REKREATIVE SPORTIVE;
15. ZONAT E GJËORREZIQEVE;
16. ZONAT UJORE;
17. GURTHYESIT;
18. ZONAT QYMYRMBAJTËSE;
19. ZONAT USHTARAKE TË SIGURISË.

Lista e mësipërme është rezultat i kërkesave që rrjedhin nga Ligji dhe Udhëzimi administrativ përkatës dhe në bazë nevojave për zhvillimet e ardhshme hapësinore në vend. Kriter me rëndësi për përcaktimin dhe ndryshimin e listës së zonave është përpjesa ($P=1:25.000$) e aplikuar në hartën e nivelit qendror, e cila për disa zona ka qenë e paaplikueshme. Zonat Rajonale Statistike nuk janë pjesë e listës që rrjedhë nga Ligji, por përfshirja dhe trajtimi i tyre është i domosdoshëm. Në respektim të direktivave evropiane, është hapur mundësia që në listë të përfshihen edhe zonat rajonale. Vendi ynë duhet që edhe formalisht të përcaktojë rajonet statistikore, të cilat janë instrument i domosdoshëm për përfshirjen e Kosovës në programe dhe projekte ndërkombëtare.

1. ZONAT RAJONALE STATISTIKORE

Në procesin e integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian, duhet të zhvillohen aktivitete që janë në përputhje me politikat dhe rregulloret/direktivat në fuqi të kësaj bashkësie. Një ndër aktivitetet më të rëndësishme është ndarja e territorit në rajone statistikore, të nevojshme për grumbullimin dhe grupimin e të dhënave sociale, ekonomike, kulturore, hapësinore, mjedisore dhe të sigurisë. Momentalisht, në varësi të zyrave rajonale apo njësive tjera administrative, të mbështetura nga dikastere përkatëse të qeverisë ose veprimtari të ndryshme sektoriale, ekzistojnë ndarje konfuze dhe jofunksionale të grupimit të të dhënave në pesë, gjashtë dhe më së shpeshti në shtatë zona rajonale statistikore.

Sipas direktivave evropiane

Klasifikim i zonave rajonale statistikore ose nomenklaturë e njësive territoriale për statistika, është i njohur me shkurtesën **NUTS** (Nomenclature of Territorial Units for Statistics). Sipas Direktivës së Parlamentit dhe Këshillit Evropian (REGULATION EC No. 1059/2003, Maj 2003) ky klasifikim ka hierarkinë e vet. Sipas kësaj hierarkie ekziston:

- niveli qendror NUTS-0;
- niveli më i vogël i rajoneve statistikore NUTS-1 dhe NUTS-2; dhe
- niveli më i ulët NUTS-3 (që përbëhet prej disa komunave).

Një klasifikim i tillë, ka për qëllim: matjen, pasqyrimin dhe krahasimin e vlerave për indikatorë të ndryshëm zhvillimor socio ekonomik, si dhe ngritjen e fondeve që do të shfrytëzohen si instrumente përcjellëse të politikave të caktuara, me ndikim në përmirësimin dhe balancimin e zhvillimeve nëpër rajonet e klasifikuara statistikore (NUTS).


- Numri i popullsisë – është kriteri i vetëm për ndarje rajonale nga rregullorja e BE-së.

Prandaj, duke pasur parasysh direktivat e BE-së, duke u bazuar në rekomandimet e Planit Hapësinor të Kosovës 2010 – 2020+ në fuqi, në bashkërendim me Grupin Punues Ndërministror, duke përfshirë edhe ndihmën e ekspertëve të angazhuar dhe përkrahjen e Shoqërisë Civile, është vendosur për ndarjen jo administrative të territorit të Kosovës në 7 (shtatë) zona rajonale statistikore të nivelit NUTS 3 (Harta Nr.12). Një veprim i tillë do të plotësojë kriterin e përcaktuar nga BE dhe do të ndikojë në mënyrë direkte në rregullimin, funksionalizimin dhe zhvillimin e balancuar të rajoneve në fjalë.

Tabela e rajoneve statistikore në Kosovë

Zonat rajonale statistikore NUTS-3	Komunat e përfshira	Sip. (në km ²)	% e Sip. pjesëmarrëse	Nr. popullsisë	% e popullsisë pjesëmarrëse
Zona rajonale e Prishtinës	Komuna e Prishtinës – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Drenas, Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan, Obiliq dhe Podujevë.	2081	19.0	469.583	26.4
Zona rajonale e Mitrovicës	Komuna e Mitrovicës së Jugut – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Mitrovicë e Veriut., Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan dhe Zubin Potok.	2051	18.8	232.833	13.1
Zona rajonale e Pejës	Komuna e Pejës – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Deçan, Istog dhe Klinë.	1660	15.2	214.254	12.0
Zona rajonale e Prizrenit	Komuna e Prizrenit – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Dragash, Mamushë dhe Suharekë.	1433	13.1	277.007	15.6


Zona rajonale e Ferizajt	Komuna e Ferizajt – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Hani Elezit, Kaçanik, Shtërpcë dhe Shtime.	1021	9.4	185.695	10.4
Zona rajonale e Gjilanit	Komuna e Gjilanit – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Kamenicë, Kllokot, Novobërdë, Ranillugë, Partesh dhe Viti.	1413	13.0	188.188	10.6
Zona rajonale e Gjakovës	Komuna e Gjakovës – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Junik, Malishevë dhe Rahovec.	1247	11.4	211.461	11.9



Harta e rajoneve statistikore NUTS-3. Burimi: IPH / MEA me të dhënat nga ASK 2013.

Zona Rajonale e Pejës

Njëra nga shtatë zonat rajonale statistikore - 15.2% e territorit të Kosovës.



Në një situatë më të favorshme ekonomike dhe politike duhet të merret në konsideratë edhe propozimi për ndarjen e Rajonit të Prishtinës në dy (2) zona rajonale statistikore. Në Rajonin e Prishtinës me territorin e komunave përbërëse (me 308.832 banorë) dhe Rajonin e Kryeqytetit të Prishtinës (me 161.751 banorë), me territorin e Bashkësive Lokale (apo lagje të mëdha). Një veprim i tillë do të krijojë kushte që kryeqendra e Kosovës të bëhet pjesë e rrjetit të kryeqendrave dhe në këtë mënyrë të përfitojë nga fondet e caktuara për politika të ndryshme zhvillimore rajonale.



Zona Rajonale e Prizrenit

Njëra nga shtatë zonat rajonale statistikore - 13.1% e territorit të Kosovës.

2. ZONAT BUJQËSORE

Bujqësia, është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë vendore, që prodhimet e saj, në njërën anë varen nga cilësia e përshtatshme e sipërfaqes së tokës, si resurs natyror më elementar për shumicën e aktiviteteve biologjike e njerëzore, e në anën tjetër identifikohet si një industri që ndikon në mjedisin jetësor.

Kosova ka potencial të konsiderueshëm të tokës bujqësore për të zhvilluar bujqësi moderne, ku mbi 80% të saj i përkasin klasave të tokës me cilësi shumë të lartë 1 – 4 (Harta Nr. 5). Angazhimi i mëtijshëm në ngritjen e nivelit të produkteve bujqësore do të siguronte zhvillim më të qëndrueshëm për vendin, si në pjesëmarrje më të madhe se 20 % në Bruto Produktin Vendor (*GDP*) ashtu edhe ushqim të mjaftueshëm për popullsinë e vet.

Sipas të dhënave të ASK (2014, Prishtinë) në Kosovë:

- **47 %** e territorit (512.000 ha) mbulohet nga toka bujqësore (pjesa më e madhe 80% e saj e kat. 1-4);
- **41 %** e saj shfrytëzohet, ndërsa pjesa tjetër mbetet ende djerrinë;
- Përbërësit kryesorë të tokës bujqësore:
 - Kullota dhe livadhe me 224.600 ha (54.3 %);
 - Ara apo tokë e punueshme me 180.381 ha (43.6 %);
 - Pemishte me 4.400 ha apo (1.1 %) ku 3.520 ha janë plantacione; dhe
 - Vreshta me rreth 3.200 ha (0.9 %);
- **10%** e sipërfaqes së tokës bujqësore është nën sistem të ujitjes, prej të cilave pak më shumë se gjysma e tyre e shfrytëzojnë sistemin në fjalë;
- Toka shfrytëzohet nga 130.775 Ekonomi Bujqësore, që merren me prodhimin e kulturave bujqësore, prej të cilave:
 - 113.231 kultivojnë kultura njëvjeçare Drithëra (grurë 50%, misër 19%, etj.) dhe Perime (4%);
 - 11.677 kultivojnë kultura shumëvjeçare Pemë (mollë 56%, kumbull 20%, etj.), dhe
 - 6.242 të tjera që kultivojnë Rrush (për verë 59% dhe për tryezë 41%); ndërsa
 - 91.227 Ekonomi Bujqësore (me 281.747 njësi blegtove) merren me rritjen e gjedheve (71%), shpezëve (17%), deleve (7%), etj.;
- **0.25 ha/b** – sipërfaqja e tokës bujqësore për banorë në Kosovë;
- **0.52 ha/b** – sipërfaqja e tokës bujqësore për banorë në BE.
- **0.17 ha/b** – kufiri kritik i sipërfaqes bujqësore për sigurimin e ushqimit për popullsinë e një vendi!



Zonat Bujqësore
~47% e territorit të Kosovës

Megjithatë, niveli i zhvillimit aktual të bujqësisë është akoma në shkallë të vogël, meqë pronësia e tokës është shumë e fragmentuar dhe joefikase, dhe se shfrytëzimi i tokës rurale nuk gëzon kujdes të mjaftueshëm në organizimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e saj. Fatkeqësisht, një sasi e konsiderueshme e tokës bujqësore po humbet gjithnjë e më tepër (si pasojë e shndërrimit saj në tokë ndërtimore), për të plotësuar kërkesat e shumta për zhvillime të ndryshme në funksion të aktiviteteve socio– ekonomike e infrastrukturore. Shkaktarë të kësaj gjendje, janë edhe vendimet e nxituara për zhvillime të reja, me ose pa planifikim të ndërtimeve nëpër zonat rurale apo periferike urbane, të cilat, rrallë herë janë bazuar në të dhëna për vetitë fizike të tokës, që mund të ndikojnë në kufizime të zhvillimeve ose edhe në vet ndërtimet.

Nga të dhënat në vazhdim, që janë raporte dhe vlera të ndryshme numerike, të përmbledhura nga rezultatet e dala prej regjistrimit të bujqësisë në Kosovë (ASK, Prishtinë 2014), kuptojmë më shumë për potencialin dhe kapacitetet ekzistuese të tokës bujqësore si dhe mënyrën e përdorimit aktual të këtij resursi bazik jetësor.

Bazuar në këto informata, mbi përdorimin dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore nga funksione sektoriale dhe nën-sektoriale, me numrin e përdoruesve dhe llojin e produkteve të kultivuara, janë dhënë rekomandimet dhe veprimet e ardhshme zhvillimore strategjike për përmirësim të gjendjes aktuale, në veçanti dhe në favor të zhvillimit të qëndrueshëm të vet sektorit bujqësor në përgjithësi.

Rekomandimet dhe veprimet e nevojshme

Për arritjen e qëllimit / objektives për ruajtjen e këtij resursi natyror, nga sektori i bujqësisë dhe jo vetëm, do të zhvillohen këto veprime, masa, aktivitete dhe projekte:

- Krijimi i sipërfaqeve të reja të tokës bujqësore dhe rehabilitimi i sipërfaqeve ekzistuese;
- Kufizimi i ndërtimeve/zgjerimeve të mëtejme në vendbanime dhe korridore infrastrukturore;
- Stimulimi i fermerëve dhe të NVM-ve, që merren me kultivim, ruajtje, përpunimin dhe shitje të prodhimeve bujqësore;
- Rritja e nivelit të cilësisë së prodhimeve bujqësore e sidomos atyre bio-ekologjike;
- Rritja e kapaciteteve prodhuese që mundësojnë edhe krijimin e vende të reja të punës;
- Rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve qendrore dhe lokale për monitorim më rigoroz dhe efikas ndaj humbjes së sipërfaqeve bujqësore;
- Ndarja e përgjegjësiwe institucionale, të nivelit qendror dhe lokal, mbi proceset e planifikimit, miratimit dhe monitorimit të zbatimit të zhvillimeve si nga sektori bujqësor ashtu edhe ai urban/ndërtimor;
- Promovimi i zhvillimit kompakt në zonat urbane dhe rurale;
- Inventarizimi dhe ndërtimi i kadastrave për zonat më të përshtatshme për kultivimin e prodhimeve bujqësore, si për arat (drithëra e perime), vreshtat (rrush), plantacionet (pemë) e fidanishtet (hortikulturë), livadhet (ushqime kafshësh), etj;
- Azhurnimi dhe procedimi i të dhënave për kadastrën e ndërtuar të vreshtarisë;
- Komasoni / rregullimi i tokave të fragmentuara bujqësore dhe krijimi i rrjetit të rrugëve fushore;
- Realizimi i projektit “Sistemi i Identifikimit të Parcelave” (LPIS);
- Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore duke adoptuar zonat kodrinore ose ato më pak të përshtatshme nën ujitje;
- Rehabilitimi i rrjetit të Sistemit të Ujitjes dhe zgjerimi i tij, me qëllim të rritjes së sipërfaqeve të tokës bujqësore dhe të cilësisë së prodhimit;
- Ruajtja e standardit ekologjik të tokës bujqësore për prodhimin e kulturave cilësore pa përdorim të preparateve kimike;
- Inspektimi i kujdesshëm dhe në kohë reale si gjatë monitorimit të zbatimit të zhvillimeve të lejuara (sipas Planeve të miratuara) ashtu edhe në parandalimin e zhvillimeve të palejuara;

- Përditësimi dhe shkëmbimi ndërinstitucional i informatave më të hollësishme, për të gjitha hartat e modeleve hapësinore;
- Krijimi dhe zhvillimi i rrjetit të Bazës së të Dhënave Kombëtare, në aplikacionin GIS për të dyja nivelet, dhe përditësim të informatave më të hollësishme nga njësitë lokale të qeverisjes;
- Ruajtja e tokës së mbetur kualitative që siguron të ardhme të konkurrencës në bujqësi;
- Minimizimi i shpenzimeve për zhvillime të infrastrukturës dhe të shërbimeve tjera publike, që përmes urbanizimit sa më të koncentruar të lehtësoj barrën e financimit për zbatim të tyre;
- Në kuadër të këtyre zonave përfshihen kategoritë 1-4 dhe sipas të dhënave në dispozicion edhe kategoritë tjera për të dy nivelet (HZKos dhe HZKom);
- Varësisht nga përpjesa e hartës, përgjegjësia e trajtimit, interpretimit dhe paraqitjes me fokus në zonat e kat. 1-4 i takon maksimalisht nivelit qendror të planifikimit (HZKos). Ndërsa, niveli i komunave, përveç bartjes së këtyre të dhënave në HZKom, janë të obliguar të trajtojnë, të interpretojnë dhe të paraqesin edhe detaje tjera për gjendjen, shfrytëzimin dhe planifikimin e të gjitha kategorive të tokës bujqësore.

3. ZONAT PYJORE

Pyjet janë stabilizuesit më të rëndësishëm të mjedisit. Stabilizojnë regjimin termik dhe hidrologjik duke ulur shkallën e avullimit të ujërave sipërfaqësor, zvogëlojnë fuqinë erozive të ujit, zvogëlojnë fuqinë shkatërruese të vërshimeve, stabilizojnë furnizimin e rezervave të ujërave nëntokësor, etj. Pyjet janë faktorë që shërbejnë për normalizimin dhe vazhdimësinë e jetës në tokë, janë rregullator të pazëvendësueshëm të parametrave ekologjik të planetit. Si një ekosistem kompleks dhe vetërregullues, pyjet janë gjithashtu zona të rëndësishme çlodhjeje me vlera kulturore e turistike.

Disa informata nga sektori i pyjeve në Kosovë

- Fondi i përgjithshëm i sipërfaqeve pyjore në Kosovë është rreth 45% (481.000ha) të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës, prej të cilës:
 - o Rreth 300 mijë ha janë pyje publike, ndërsa pjesa tjetër i takon pyjeve private;
 - o 0.5% ose rreth 2.000 ha/vit është mesatarja vjetore e shtimit natyror të pyjeve në Kosovë;
 - o Afërsisht 84% të sipërfaqes totale të pyjeve janë pyje të pastra me lloje gjethore;
- Dushku dhe ahu janë llojet kryesore të pyjeve në Kosovë, ndërsa pjesa tjetër është e llojit halor.
- Bredhi, hormoqi, pisha e zezë, hartina dhe rrobulli janë llojet kryesore halore;
- Në Kosovë mesatarisht pyllëzohen rreth 390 ha/vit, kryesisht me lloje halore;
- Në Kosovë ripyllëzohen mesatarisht 260 ha/vit, ku kryesisht janë ripyllëzuar sipërfaqet e mbi shfrytëzuara, të djegura ose sipërfaqet me dendësi të ulët drunore;
- Gjatë 10 viteve të ardhshme planifikohet të pyllëzohen dhe ripyllëzohen afërsisht 30.000ha.

Për të përmirësuar gjendjen e pyjeve në Kosovë (Harta Nr. 5) dhe për të arritur objektivat e sektorit të pyjeve, "Programi kombëtar i pyllëzimit dhe ripyllëzimit 2016-2025" ka paraparë për pyllëzim 73.853 ha. Brenda kësaj sipërfaqe, 32.406 ha janë identifikuar si sipërfaqe më e përshtatshme për krijimin e llojeve primare autoktone, që nënkupton lloje të cilat përputhen me vendin.

Ndërsa, fokus i ripyllëzimit është sipërfaqja prej 6.536 ha, e identifikuar si e përshtatshme për ripyllëzim. Brenda kësaj sipërfaqeje, fillimisht duhet të përqendrohet në hapësirën prej 4.114 ha, e cila paraprakisht është identifikuar si më e përshtatshme për ripyllëzim dhe aty duhet të mbillen llojet e fidanëve që përputhen me zonën dhe lokacionin.

Veprimet dhe rekomandimet e nevojshme:

- Të hartohet programi kombëtar për mbrojtjen e pyjeve;

- Të promovohet programi për pyllëzim dhe ripyllëzim në përputhje me mbrojtjen e mjedisit. Gjatë promovimit të programit të pyllëzimit është e rëndësishme të përfshihet edhe sektori privat;
- Përcaktimi i kriterëve të veçanta për të vlerësuar dhe përzgjedhur lokacionet e përshtatshme për pyllëzim dhe ripyllëzim (p.sh. variablat: lartësia mbidetare, ekspozicioni, përbërja pedologjike, etj.);
- Të përcaktohet sipërfaqja e tokës që është në dispozicion dhe e përshtatshme për mbjelljen e pyjeve;
- Të bëhet vlerësimi i disponueshmërisë së sipërfaqes së tokës dhe marrëveshjes për profilin e specieve kombëtare;
- Të zgjidhen sipërfaqet më të favorshme nga nëngrupe të ndryshme që janë më të përshtatshme për çdo specie/lloj. Për shembull, të zgjidhet lartësia mbidetare, ekspozicioni, klasa pedologjike e tokës më të favorshëm për *Fagus sylvatica* ose *Quercus cerris*;
- Të bëhet menaxhimi i buxhetit të dedikuar për pyllëzim dhe ripyllëzim dhe shpërndarja e tij në zona dhe rajone të duhura;
- Të zbatohet programi vjetor i pyllëzimit dhe të përcaktohet kodi i praktikave më të mira;
- Të përcaktohet plani i veprimit në baza vjetore, i cili do të përfshijë veprime konkrete sipas intervalit financiar dhe hapësinor;
- Të përcaktohen standardet e pranueshme të punës dhe monitorimit të vazhdueshëm dhe kontrollit të këtyre standardeve. Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe e rregullt është me rëndësi jetike për zbatimin e suksesshëm të programit;
- Të mbikëqyret zbatimin e strategjisë të miratuar, ku janë aprovuar zonat për pjesëmarrje si në programin e pyllëzimit ashtu edhe atë të ripyllëzimit, duke kryer inspektime të zonave para aktiviteteve të pyllëzimit, deri sa të realizohen ato dhe pas kompletimit të tyre;
- Të mbikëqyret programin për mirëmbajtjen e pyjeve, i cili ka për qëllim të definojë përgjegjësinë për mbrojtjen e pyjeve dhe zbatimin e tij në të gjitha zonat, ku gjatë katër viteve të para janë realizuar pyllëzimet dhe ripyllëzimet;
- Të bëhet furnizimi afatshkurtër dhe afatgjatë i rezervave të përshtatshme për mbjellje;
- Të bëhet koordinimi me fidanishtet vendore lidhur me profilet e specieve të prodhuara duke siguruar që ato plotësojnë kërkesat, sasinë dhe standardet e dëshiruara të fidanëve;
- Të bëhet lëshimi i çertifikatave për fidanët, të cilët do të importohen në Kosovë, që dëshmojnë gjendjen e tyre për t'u përdorë për programin e pyllëzimit ose ripyllëzimit;
- Të bëhet hulumtimi dhe përcaktimi i zonave të rrezikuara nga zjarri dhe të parashihen masat mbrojtëse;
- Të zbatohet një sistem i vazhdueshëm për zhvillimin profesional (ZHV), duke siguruar që stafi profesional i APK-së të merr njohuri të vazhdueshme përmes trajnimeve, seminareve dhe punëtorive të ndryshme.

Zonat Pyjore

~45% e territorit të Kosovës.



4. ZONAT E INFRASTRUKTURËS TEKNIKE

Infrastruktura e transportit

Infrastruktura e transportit është njëra nga premiset kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Zhvillimi i saj do të krijojë kushte për rritjen e komunikimit dhe qarkullimit të lirë të qytetarëve dhe të mallrave, si dhe lidhjen e vendit tonë në rrjetin e infrastrukturës rajonale dhe ndërkombëtare.

Sipas të dhënave ekzistuese në Kosovë:

Rrugët

- 75% e rrugëve të të gjitha kategorive janë asfaltuar;
- Autoritetet qendrore janë kompetente për autoudhët, rrugët nacionale dhe rrugët rajonale;
- 96% e rrugëve të rangut të lartë janë të asfaltuara;
- Rrugët lokale janë nën kompetencën e komunave;
- 35% e rrugëve lokale të paasfaltuara;
- Ndërtimet përreth rrugëve problemi kryesor;
- Në nivel rajonal Kosova hyn në kuadër të vendeve me infrastrukturë rrugore të zhvilluar.

Hekurudha

- Linja e fundit hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1963;
- Gjendja aktuale e hekurudhave në nivel shumë të ulët;
- Rrjeti hekurudhor me linja një binarëshe dhe i pa elektrifikuar;
- Gjatësia e përgjithshme afërsisht 350 km, prej të cilave 58 km janë jashtë funksionit;
- Shpejtësia maksimale e lejuar prej 30-70 km/h;

Aeroportet

- 1 aeroport në shërbim të transportit ajror të udhëtarëve - AN "Adem Jashari";
- 1 aeroport ushtarak - Aeroportin e Gjakovës, i cili është jashtë funksionit;
- 12 fusha aviacioni që përdoren për qëllime bujqësore; dhe
- 1 aeroport sportiv në Dumosh të Podujevës.

Për përmirësimin e gjendjes sa i përket infrastrukturës së transportit (Harta Nr. 9) parashihen veprimet në vazhdim:

- Finalizimi i segmentit të mbetur Besi – Merdare të Autostradës Morinë – Merdare (R7);
- Vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale Prishtinë – Pejë (N9) dhe Prishtinë – Mitrovicë (N2);
- Zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë – Podujevë;
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në veriperëndim të vendit sipas varianteve:
 - o V1 – Zgjerimi i rrugës rajonale Istog – Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren (sipas PHK në fuqi);
 - o V2 – Ndërtimi i autoudhës së "Dukagjinit" (propozim i qverisë);
- Ndërtimi i autoudhës Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë;
- Ndërtimi i rrugës automobilistike Kosovë – Maqedoni përmes Fshatit Zapllugjë dhe Fshatit Restelicë, Komuna e Dragashit;
- Gjatë procesit të planifikimit të infrastrukturës rrugore, duhet gjithashtu të analizohet realizimi i Urave Ekologjike të nevojshme për lëvizjen e lirë të faunës;
- Modernizimi i linjës ndërkombëtare hekurudhore në Kosovë, Linja 10 (148 km e gjatë) prej Fushë Kosovës në Maqedoni (linja jugore) dhe prej Fushë Kosovës në Serbi (linja veriore);

Infrastruktura rrugore

Njëra nga premiset kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.



- Ndërtimi i linjës hekurudhore Prizren – kufiri me Shqipërinë (lidhja me portin e Durrësit);
- Rehabilitimi/funksionalizimi i linjës hekurudhore lindje-perëndim (Podujevë-F.Kosovë-Pejë-Prizren);
- Ndërtimi i linjës hekurudhore Ferizaj – Gjiilan;
- Ndërtimi i linjës hekurudhore Ratkoc – Gjakovë
- Modernizimi i terminalit të mallrave në Miradi;
- Ndërtimi i stacionit të ri hekurudhor në Prishtinë bashkë me funksionalizimin e linjës hekurudhore të zonës së Prishtinës;
- Ndërtimi i stacionit hekurudhor në Prizren pranë stacionit të autobusëve;
- Ndërtimi i linjës “Shuttle train” Prishtinë – Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”;
- Zgjerimi i rrugës rajonale Klinë – Gjakovë;
- Funksionalizimi dhe shndërrimi i Aeroportit të Gjakovës në aeroport civil.

Infrastruktura e energjisë

Komponentë shumë e rëndësishme e infrastrukturës është infrastruktura e energjisë. Kjo përfshinë stabilimentet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe stabilimentet e sistemeve të energjisë termike. Sigurimi i energjisë elektrike është kusht për zhvillimin ekonomik, prandaj është shumë e nevojshme rritja e investimeve në zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së energjisë.

Sipas informatave sektoriale

Energjia elektrike

- Më 1984, është ndërtuar kapaciteti i fundit adekuat për prodhimin e energjisë elektrike;
- Kapacitetet aktuale të pamjaftueshme - prodhimi nuk i përmbushë kërkesat për energji elektrike;
- Nga viti 2000 e këndeje, përpos reduktimeve, çdo vit (me përjashtim 2013 dhe 2016) prodhimi i energjisë është më i vogël se konsumi;
- Teknologjia ekzistuese e vjetër dhe shkaktare kryesore e ndotjes mjedisore;
- Aktualisht në Kosovë prodhohen rreth 6% të energjisë së ripërtëritshme.

Energjia termike

- Aktualisht rreth 4% e popullsisë së Kosovës furnizohet me ngrohje nga sistemet publik i ngrohjes qendrore;
- Vetëm Shqipëria dhe Mali i Zi janë në nivel më të ulët se Kosova!.

Gazi natyror

- Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi janë vendet e vetme në Evropë që nuk e kanë të instaluar sistemin e gazsjellësit.
- Aktualisht shpërndarja dhe furnizimi i konsumatorëve bëhet në formën e bombolave.
- Si pasojë e mungesës së infrastrukturës së nevojshme në krahasim me vendet e Evropës, Kosova në

Veprimet që parashihen për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike dhe zgjerimin e furnizimit të qytetarëve me ngrohje qendrore dhe furnizimin me gaz natyror janë (Harta Nr. 8):

- Zbatimi i objektivave të planit të BE-së 20-20-20 për fushën e energjisë;
- Ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re;
- Zgjatja e procesit të dekomisionimit të TC Kosova A deri në funksionalizimin e të TC Kosova e Re;
- Hapja e minierës së re të thëngjillit (Sibofci Jugor);
- Ndërtimi i Hidrocentralit të Zhurit;

- Zhvillimi i Planit Kombëtar të Veprimit për BRE-të për periudhën prej vitit 2021 e më tej në përputhje me kërkesat e Direktivës së BRE-ve dhe bazuar në studimin paraprak;
- Ndërtimi i linjës së re transmetuese 110 kV NS Prizren 1 - NS Prizren 2;
- Instalimi i transformatorit të dytë 40 MVA në NS Gjilani 5;
- Instalimi i transformatorit të dytë 40 MVA në NS Klinë;
- Ndërtimi i stacionit shpërndarës 400 kV SSH Gjakova 3 i cili përmban tre fusha të linjave dhe një fushë lidhëse;
- Ndërtimi i nënstacionit NS Prizreni 4.400/110 kV, 1x300 MVA në vazhdimësi të NS Prizreni 2 i cili përmban dy fusha të linjave 400 kV dhe një fushë lidhëse 400 kV;
- Ndërtimi i linjës 400 kV nga SSH Gjakova 3 deri tek NS Prizreni 4;
- Ndërtimi i linjës 400 kV nga NS Prizreni 4 deri tek NS Ferizaj 2;
- Ndërtimi i nënstacionit NS Dragashi dhe linja 110 kV NS Kukës-NS Dragash-NS Prizren 2;
- Realizimi i Projektit NS Fushë Kosova;
- Realizimi i Projektit NS Malisheva me linjat transmetuese 220 kV;
- Realizimi i një sërë studimesh nga aspektet e ndryshme të sektorit të energjisë që do të përfshijë periudhën deri në vitin 2050 si: “Studimi bazik”, “Studimi mbi kërkesën për energji”, “Studimi i tregut të energjisë elektrike dhe gazit”, “Vlerësimi mbi zhvillimin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, “Vlerësimi mbi investimet në sektorin e energjisë”, “Studimi mbi përballueshmërinë e sektorit të energjisë” dhe “Ndikimi i emetimeve të gazrave serë në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë”
- Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes në Prishtinë;
- Ndërtimi i impiantit të ko-gjenerimit në Ndrohtoren e Qytetit në Gjakovë dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues;
- Ndërtimi i sistemeve të energjisë termike në qytetet Pejë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Drenas dhe përmirësimi i tyre në Mitrovicë dhe Zveçan;
- Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e sistemeve ekzistuese për ofrimin e produkteve tjera të energjisë termike veç atij për ngrohjen e hapësirave;
- Mbështetja e projekteve të gjenerimit për sistemet e energjisë termike që shfrytëzojnë BRE-të si lëndë djegëse;
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e aktiviteteve për procesin e zhvillimit të infrastrukturës së gazit natyror;
- Hartimi i master planit për gazifikimin e Kosovës;
- Përgatitja e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e gazsjellësit Shqipëri-Kosovë;
- Ndërtimi i gazsjellësit Shqipëri-Kosovë në drejtim të Prishtinës.
- Në fazat e mëvonshme përfshirja në sistemin e furnizimit me gaz edhe të qendrave tjera: Prizrenit, Mitrovicës, Pejës, Gjilanit, Gjakovës dhe Ferizajt me komunat përreth;

Energjia elektrike

Impianti i ri energjetik “Kosova e Re” me kapacitet prej 500 MW – pavarësi energjetike për Kosovën.

Infrastruktura ujore

Infrastruktura ujore përfshinë të gjitha ato objekte, konstruksione me anën e të cilave në të shfrytëzojmë apo përdorim ujin, e mbrojmë atë, por edhe mbrohem nga ai. Këtu hyjnë digat për akumulimin e ujit me pajisjet dhe objektet e tyre përcjellëse, objektet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimit, impiantet për përgatitjen e ujit për pije, impiantet për pastrimin e ujërave të zeza dhe infrastruktura mbrojtëse nga vërshimet.

Sipas informatave sektoriale:

Furnizimi me ujë

- ~ 90% e popullatës furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemet publike;
- Pjesa e mbetur furnizohet në mënyra tjera me ujë që nuk është i sigurt në aspektin e cilësisë.

Ujitja

- Sistemi i dobët i ujitjes faktor i rëndësishëm i shkallës së ulët të zhvillimit të bujqësisë;
- Prej 250.000 Ha tokë të punueshme vetëm rreth 12.000 hektarë apo rreth 5% janë nën ujitje.
- Në BE 20% e tokës është nën ujitje;

Mbrojtja e ujërave

- Aktualisht ekziston vetëm një impiant për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet prej rreth 8.000 b.e.
- Ekziston edhe një numër i objekteve të vogla të trajtimit në disa zonat rurale;
- Ky fakt tregon se në Kosovë ujërat e ndotura pothuaj se nuk trajtohen fare duke shkaktuar kështu ndotje të madhe të lumenjve.

Mbrojtja nga ujërat

- 490 km të lumenjve në rrezik nga vërshimet;
- 140 km apo vetëm 28% e gjatësisë është e rregulluar.

Veprimet e parapara për përmirësimin e gjendjes në sektorin e ujërave (Harta Nr. 7 dhe 8):

- Investimet në rrjetin e ujësjellësit në të gjitha kompanitë rajonale të ujësjellësit;
- Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për rajonet e Prishtinës, Gjilanit dhe Mitrovicës;
- Ndërtimi i Hidrosistemit Kremenatë-Desivojcë-Gjyrishevc, Komuna e Kamenicës;
- Faza e dytë e ndërtimit të Hidrosistemit Ibër-Lepenc;
- Rritja e sipërfaqes së mbuluar me rrjetin e ujitjes nga 12.000 ha në 25.000 ha;
- Ndërtimi i rrjeteve grumbulluese për ujërat e ndotura (zeza) si dhe ndërtimi i fabrikave për trajtimin e ujërave të ndotura në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Prizren, Dragash dhe në zonat rurale: Orllan, Marmull, Lekovicë dhe Shallc;
- Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse nga vërshimet përgjatë lumenjve Drini i Bardhë dhe Sitnicë;
- Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse nga vërshimet përgjatë lumit Morava e Binçës;
- Përpilimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të rrezikut nga vërshimet (PMRrV);
- Ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse nga vërshimet në lumenjtë tjerë të Kosovës sipas PMRrV;
- Hartimi i kadastrit të ujërave (sipas UA SIU);
- Rishikimi i master planit të hidroekonomisë së Kosovës sipas të cilit është parashikuar ndërtimi i 21 akumulacioneve ujore;

- Monitorimi i liqeneve akumulues;
- Riparimi i digave ekzistuese;
- Hulumtimi i resurseve ujore nëntokësore në segmentin Sazali – Vushtrri;
- Hulumtime në funksion të zhvillimit të resurseve ujore.

Infrastruktura e komunikimeve elektronike

Pjesë të kësaj infrastrukture janë objektet, rrjeti, sistemet dhe pajisjet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike (telekomunikacionin).

Sipas informatave sektoriale:

- Shpërndarja e TIK-ut e pa balancuar;
- Ka ende mungesë të qasjes në infrastrukturën brezgjërë (broadband) dhe në shërbimet e TIK-ut, ose nuk është përvetësuar teknologjia dhe mjetet e duhura të TIK-ut;
- Kapacitetet humane të pamjaftueshme;
- Kompanitë e teknologjisë informative (TI) në Kosovë shfaqin mungesë të shkathtësive të specializuara teknike, në përgjithësi, ka nivel të ulët të specializimit tek këto kompani për sa i përket teknologjive, industrive të synuara (specializimi vertikal) dhe fushave specifike funksionale (specializimi horizontal);
- Modeli i financimeve nga sistemi aktual bankar në Kosovë nuk i mbështetë sa duhet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) të sektorit të TIK-ut.

Disa veprime të parapara për përmirësimin e gjendjes në fushën e TIK-ut:

- Krijimi i Këshillit Nacional për teknologjinë informative (TI) i cili do t'i koordinojë aspektet e ndryshme të strategjisë së zhvillimit dhe zbatimit të TI;
- Krijimi dhe operimi i fondit për teknologjinë informative dhe komunikuese për ngritje të inovacionit;
- Zbatimi i Programit për Ekonominë Digjitale të Kosovës - KODE i cili do të përfshijë shtrirjen e infrastrukturës me brez të gjerë e me shpejtësi të lartë në tërë vendin, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e vendeve të punës në ekonominë digjitale.

Infrastruktura Ujore

~90% e popullatës e kyçur në sistemin publik të ujësjellësit në Kosovës.



Infrastruktura për menaxhimin e mbeturinave

Kjo infrastrukturë përfshinë deponitë e mbeturinave dhe të gjitha objektet apo pajisjet që janë në funksion të grumbullimit, deponimit dhe trajtimit të mbeturinave.

Sipas informatave sektoriale:

- Menaxhimi i mbeturinave me probleme të mëdha;
- Aktualisht afër 60% e mbeturinave grumbullohen në gjashtë deponitë rajonale. Pjesa e mbetur prej 40% hidhen në mënyra të ndryshme dhe ilegale;
- Infrastruktura ekzistuese e pamjaftueshme dhe nuk përmbush standardet e BE-së;
- Problem të madh paraqesin deponitë industriale, sidomos deponitë e krijuara në kuadër të aktiviteteve punuese minerare, metalurgjike dhe kimike;
- Deponitë e hirit të KEK-Obiliq dhe deponia e Ferronikelit - Glllogovc, paraqesin problemet mjedisore, të cilat vlerësohen si "Hot Spote", me ndikim serioz në shëndetin e njeriut;
- Kimikatet e mbetura nga ish fabrikat pjesërisht të riambalazuara dhe përkohësisht ruhen në vende të caktuara dhe paraqesin rrezik të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

Gjendja e përshkruar më lartë shtron nevojën për veprime të ngutshme për përmirësimin e gjendjes. Disa nga këto veprime, të parapara me strategjitë qeveritare janë (Harta Nr.8):

- Ndërtimi i qendrave për trajtimin e mbeturinave – konstruktiv & demolim në komunat: Gjilan, Ferizaj, Prizren, Shtërpcë, Rahovec, Gjakovë, Shtime, Lipjan, Drenas, Suharekë, Kaçanik dhe Viti;
- Ndërtimi i magazinës për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme;
- Ndërtimi i qendrave për menaxhimin - trajtimin e mbeturinave të biodegradueshme;
- Ndërtimi i impianteve për ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave komunale në lokacionet e deponive komunale;
- Ngritja e 20 transfer stacioneve dhe qendrave për pranimin dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje;
- Ndërtimi i stacionit bartës dhe qendrës për mbledhjen e mbeturinave (Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë).

Menaxhimi i mbeturinave
~60% e mbeturinave
grumbullohen në gjashtë
deponi rajonale në Kosovës.



5. ZONAT URBANE

KONTEKSTI GLOBAL URBAN

Agjenda e Re Urbane⁶ - përcakton një standard të ri global për zhvillimin e qëndrueshëm urban, është udhërrëfyes për ndërtimin e qyteteve që mund të shërbejnë si shtytës të prosperitetit dhe qendra të mirëqenies kulturore dhe sociale për qytetarët e vet. Agjenda gjithashtu ofron udhëzime për arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe siguron mbështetjen e plotë për veprimet që adresojnë çështjen e ndryshimeve klimatike.

Qeveritë kombëtare dhe autoritetet lokale janë të autorizuar për të zbatuar agjendën, me përkrahjen teknike dhe financiare nga bashkësia ndërkombëtare.

Zotimet kryesore të agjendës, të cilat në mënyrë indirekte duhet të jenë edhe zotime të sektorit tonë, përfshirë nivelin qendror dhe lokal të planifikimit hapësinor dhe urban janë:

- **Ofrimi i shërbimeve bazike për të gjithë qytetarët;**
- **Sigurimi qasjes në mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët (zhdukja e diskriminimit)** – të gjithë duhet të kenë të drejtë të përfitojnë nga mundësitë që i ofrojnë qytetet e tyre;
- **Promovimi i veprimeve që mbështesin qytetet më të pastra** – në kuadër të veprimeve duhet të parashihen aktivitete në favor të përdorimit të energjisë alternative;
- **Forcimi i fleksibilitetit urban në qytete për të zvogëluar rrezikun dhe ndikimin e fatkeqësive natyrore** – Shumë qytete e kanë ndjerë ndikimin e fatkeqësive natyrore prandaj planifikimi më i mirë urban, infrastruktura më cilësore dhe ngritja e përgjegjësive janë disa nga veprimet që nevojitet të ndermirren nga autoritetet lokale;
- **Të ndërmerren veprime që adresojnë ndryshimet klimatike duke reduktuar emetimet e gazrave serë** – Është kërkesë e përgjithshme që të ndërmerren veprime që janë në harmoni me Marrëveshjen e Parisit mbi ndryshimet klimatike, e cila kërkon të kufizohet rritja e temperaturës globale deri në nën 2 gradë Celsius;
- **Të respektojmë plotësisht të drejtat e refugjatëve, emigrantëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit pavarësisht nga statusi i tyre i migrimit;**
- **Promovimi i hapësirave publike të gjelbra, të sigurta dhe të qasshme** – Përmes planifikimit urban të nxitet krijimi i hapësirave publike siç janë: trotualet, korsitë për çiklizëm, kopshtet, sheshet dhe parqet e nevojshme. Plani i qëndrueshëm urban luan rol vendimtar në sigurimin e kualitetit të nevojshëm jetësor dhe prosperitetit në qytetet tona;
- **Si të arrihet kjo?** – sipas Agjendës së Re Urbane kërkohet, ndër të tjera, rregulla dhe rregullore të reja urbane, planifikim dhe dizajn të përmirësuar urban dhe financa të mjaftueshme komunale.

Konteksti global⁷

Aktualisht qytetet mbulojnë vetëm 2% të territorit të përgjithshëm të tokës, e në të njëjtën kohë janë:

- **80% pjesëmarrëse në ekonomi (GDP);**
- **80% konsumuese të energjisë;**
- **70% emetuese të gazrave serë;**
- **50% krijuese të mbeturinave të përgjithshme.**

⁶ Agjenda e Re Urbane për Bashkësinë Evropiane është nxjerrë në Maj të vitit 2016 me "Paktin e Amsterdimit". Dokumenti prezanton një metodë të re pune, e cila promovon bashkëpunimin në mes shteteve anëtare, qyteteve, Komisionit Evropian dhe pjesëmarrësve tjerë, për të stimuluar rritjen, inovacionin dhe jetën në qytetet e Evropës, për të identifikuar dhe zgjidhë në mënyrë të suksesshme sfidat e ndryshme sociale.

⁷ <https://www.un.org/en/climatechange/cities-pollution.shtml> ; <https://www.worldbank.org/en/topic/urbandevelopment/overview> ; <https://www.worldbank.org/en/topic/urbandevelopment/brief/solid-waste-management>

Temat me prioritet për qytetet evropiane – të cilat janë të domosdoshme të merren në konsideratë edhe nga dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urban të të dy niveleve të qeverisjes në Kosovë janë:

- Kualiteti i ajrit;
- Ekonomia qarkulluese;
- Adaptimi klimatik;
- Tranzicioni digjital;
- Tranzicioni energjetik;
- Banimi;
- Përfshirja e emigrantëve dhe refugjatëve;
- Prokurimi publik inovativ dhe i përgjegjshëm;
- Vendet e punës dhe aftësitë në ekonominë lokale;
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë;
- Mobiliteti urban; dhe
- Varfëria urbane;

KONTEKSTI LOKAL URBAN

Sipas vlerësimeve nga burime të ndryshme, sot në Kosovë, afërsisht gjysma e popullatës jetojnë në zona urbane (qytetet), e cila situatë është shumë e afërt me trendin aktual botëror. E shndërruar në sipërfaqe, duke ju referuar statistikave në fuqi, zonat urbane nxënë vetëm 1.5% të sipërfaqes së përgjithshme tokësore. Në Evropë, kjo situatë është pak më ndryshe, përqindja e banorëve urban është më e madhe, afërsisht 75% e banorëve jetojnë në qytete dhe sipas parashikimeve deri në vitin 2050, 80%⁸ e popullatës evropiane do të jetojë në zona urbane. Për shkak të kualitetit më të mirë jetësorë, migrimi nga zonat rurale drejtë zonave urbane është gjithnjë e më i lartë. Dëshira e të gjithëve është të qenit afër aktiviteteve ekonomike, afër mundësive më të mëdha për punë dhe përparësive tjera shoqërore dhe ekonomike. Duke qenë dëshmitarë të presionit të shtuar për të siguruar një vendbanim në zonë urbane, mund të konstatojmë se trendi i rritjes së popullatës urbane në vendin tonë shumë shpejtë do ti arrijë shifrat evropiane. Një situatë e tillë kërkon vëmendje të shtuar nga të gjithë përgjegjësit, e në veçanti nga autoritetet përgjegjëse komunale, për gjetjen e zgjidhjeve adekuate dhe të përshtatshme me kërkesat dhe gjendjen aktuale në terren.

Nga hulumtimi i rritjes urbane në Kosovë 2000-2018:

Rritja e zonave urbane në Kosovë 2000-2018:

- **0.9 %** **10.000** ha në vitin 2000
- **1.5 %** **16.000** ha në vitin 2018 ; prej të cilave:
- **50 %** **5.000** ha janë shtuar në periudhën 2000-2012;
- **7 %** **1.000** ha janë shtuar në periudhën 2012-2018;
- **57 %** **6.000** ha janë shtuar në periudhën 2000-2018;
- Sipas rritjes në periudhën e dytë (12-18) - konstatohet se trendi i rritjes është në rënie!!!;
- Rritja e zonave urbane kryesisht në tokë bujqësore;

⁸ Eurostat - Urban Europe Statistics on cities, towns and suburbs 2016 edition;

Rekomandimet dhe veprimet:

- Pjesë e këtyre zonave duhet të jenë qendrat e qyteteve, nëse ka të dhëna edhe zona e qytetit të vjetër. Zonat e tilla janë përgjegjësi maksimale e nivelit lokal dhe të cilat duhet të jenë pjesë e domosdoshme e Hartës Zonale Komunale. Të njëjtat informata duhet të jenë pjesë edhe e Hartës Zonale të Kosovës, por, në rastet kur të dhënat nuk ekzistojnë (komunat nuk i kanë të përcaktuara), zonat në fjalë mund të rekomandohen dhe të paraqiten nga niveli qendror;
- Zonat e trajtuara urbane, të interpretuara dhe të paraqitura në Hartës Zonale të Kosovës, duhet të merren në konsideratë nga niveli lokal gjatë procesit të hartimit të Hartës Zonale Komunale;
- Rekomandohen politika dhe praktika të qarta për shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme të cilat duhet të mundësojnë arritjen e një partneriteti më të fuqishëm në mes zonave urbane dhe rurale;
- Zgjidhimi i zonave urbane duhet të orjentohej në drejtim të tokave me kualitet më të ulët bujqësor dhe e kalkuluar në raport me rritjen e vlerësuar të popullatës;
- Në zonat ku është e mundur, rekomandohet rritja e dendësisë së ndërtimit;
- Planet lokale duhet që përmes zgjidhjeve kreative të ndikojnë në ngritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale. Trendi i “qyteteve të mençura” duhet të jetë pjesë e veprimeve gjatë hartimit të hartës zonale komunale;
- Ofrimi i lehtësirave për shfrytëzim të energjisë alternative, me ndikim në mbrojtjen e cilësisë së ajrit;
- Nga niveli qendror kërkohet zbatimi i standardeve më strikt për lirimet në ajër të ndotësve nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve;
- Menaxhimi i duhur i trafikut, duke i dhënë përparësi krijimit të hapësirave të nevojshme (shtigjeve) për përdorimin e biçikletave dhe transportit publik në të gjitha format;
- Pjesë e rëndësishme e planeve lokale duhet të jetë edhe sigurimi i hapësirave adekuate publike për të gjitha strukturat e popullsisë në nevojë, me theks të veçantë objektet dhe hapësirat e nevojshme për popullsinë e moshuar;
- Planet lokale duhet të promovojnë shfrytëzimin efikas të energjisë, përmes zgjidhjeve inovative arkitektonike, të cilat do të kërkojnë më pak energji për ndriçim, ngrohje dhe sistemet e ftohjes;
- Transporti publik duhet të jetë pjesë e domosdoshme e dokumenteve lokale të planifikimit hapësinor;
- Përfshirja e banorëve në planifikim është parakusht për një proces të qëndrueshëm dhe transparent. Një veprim i tillë siguron që planet tona të jenë lehtë të zbatueshëm dhe në harmoni me kërkesat e qytetarëve;

Zonat Urbane/Qyteti

Forma e trashëguar organike e zonave urbane duhet të ruhet dhe të bëhet pjesë e planeve të reja zhvillimore!



6. ZONAT RURALE

Në Hartën Zonale të Kosovës (Harta Nr.2), Zonat Rurale përkatësisht pjesa e zhvilluar (e ndërtuar) e tyre do të trajtohen si vendbanime, në të cilat kategoria dominuese hapësinore është banimi.

Të dhënat themelore për gjendjen e fshatrave në KS:

- Në Kosovë janë të evidentuara 1425 fshatra;
- Prej tyre 50 fshatra pa banorë;
- Trendi i zbrazjes së fshatrave në rritje!

Kategorizimi i vendbanimeve rurale sipas madhësisë	Numri i banorëve	Numri i vendbanimeve (2011)	%
Të pabanuara	0	50	3.5
Të vogla	< 2.499	1307	91.7
Të mesme	2.500-4.999	60	4.2
Të mëdha	5.000+	8	0.6
Gjithsej		1425	100.0

Aktualisht, i vetmi përkufizim për territorin e fshatit është zona katastrale, në kuadër të të cilës përveç hapësirave të ndërtuara përfshihen edhe përmbytjet tjera përcjellëse (toka bujqësore, pyjore, etj.).

Duke pasur këtë parasysh, dhe me qëllim të unifikimit dhe trajtimit të barabartë të këtyre zonave në të gjithë territorin e vendit, nga autoritetet kompetente komunale kërkohet që në kuadër të Hartës Zonale Komunale, zona rurale (fshati) të konsiderohen vetëm hapësirat e ndërtuara dhe hapësirat e planifikuara për zgjerimin e fshatit, ndërsa përmbytjet tjera (toka bujqësore, pyjore, ujore etj.) duhet të trajtohen në kategoritë tjera të zonimit.

Përgjegjës për përkufizimin dhe paraqitjen e këtyre zonave është maksimalisht niveli lokal dhe varësisht nga të dhënat dhe përpjesa e prezantimit edhe niveli qendror. Në raste të veçanta (në mungesë të të dhënave ose komunat nuk i kanë të përcaktuara) rekomandimi, përkufizimi dhe paraqitja e këtyre zonave mund të realizohet edhe nga niveli qendror. Zonat e rekomanduara dhe të paraqitura në Hartën Zonale të Kosovës, do të merren në konsideratë nga niveli lokal gjatë procesit të hartimit të Hartave Zonale Komunale.

Rekomandimet dhe veprimet e nevojshme:

Politikat e Komisionit Evropian i kanë paraparë tri objektiva gjithpërfshirëse⁹:

- Përmirësimi i konkurrencës në bujqësi;
- Arritja e menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve duke përfshirë edhe veprimet për ndryshime klimatike; dhe
- Zhvillimi i balancuar territorial i zonave rurale.

Këto janë edhe baza mbi të cilën janë përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes në zonat rurale edhe në vendin tonë:

- Veprimet e përcaktuara në hartën zonale komunale duhet të jenë në favor të mbrojtjes dhe promovimit të potencialeve dhe vlerave mjedisore të zonave rurale. Zonat e tilla rurale bëhen më atraktive për zhvillimin e bizneseve të ndryshme dhe zhvillimin e turizmit rural në përgjithësi;
- Duhet të ruhet dhe promovohet kompaktësia e zonave rurale, zgjerimi i këtyre zonave do të ketë ndikim në humbjen e pakthyeshme të tokës bujqësore;
- Të gjitha veprimet duhet të jenë në përputhje me normat dhe standardet në fuqi për zbutjen e ndryshimeve klimatike;
- Veprimet e ndërmarrja duhet të jenë në frymën e zhvillimit të balancuar të zonave rurale për komunën përkatëse dhe në favor të përmbytjes së kërkesave për zbutjen e migrimit drejtë zonave urbane;
- Autoritetet përgjegjëse duke përfshirë nivelin qendror dhe lokal duhet të ndikojnë në lehtësimin e komunikimit në mes zonave urbane dhe rurale;
- Të përcaktohen masat e qarta për menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, duke përfshirë tokën bujqësore dhe pyjore si dhe rritjen e konkurrencës së zonave rurale në përgjithësi;

⁹ https://ec.europa.eu/regional_policy/en/policy/themes/rural-development/

7. ZONAT E BANIMIT

Banimit është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Si shfrytëzues më i madh i hapësirës, banimit ndikon në rrjedhën e zhvillimit gjithëpërfshirës të shoqërisë dhe njëherit është komponent i rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik dhe standardit jetësor në përgjithësi. E drejta në banim gjithnjë e më shumë është prezent në kuadër të politikave globale dhe për të drejtat njerëzore, e definuar edhe me konventa ndërkombëtare.

Gjendja ekzistuese e banimit në Kosovë nuk është në nivel të kënaqshëm për shkak të problemeve socio-ekonomike, mungesës së koordinimit dhe bashkëpunimit institucional përgjegjës për sektorin e banimit të nivelit qendror dhe lokal, si dhe bazës së pamjaftueshme ligjore.

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të v. 2011:

- Numri i njësive të banimit është 412.884, prej tyre të përqendruara në territorin urban janë 43,5% dhe 56,5% në territorin rural, në të cilat jetojnë 297.090 ekonomi familjare me 1.739.825 banorë dhe 4.2 b/nj., pra numri i njësive të banimit është më i madh se sa numri i ekonomive familjare;
- Në Kosovë ka 99.808 (28.7%) banesa të pabanuara nga numri i përgjithshëm i njësive të banimit, e shprehur më shumë në qendrat e mëdha komunale;
- Sipas raporteve të preformancës së komunave, aktualisht numri i kërkesave për banim është në rënie!

Rekomandimet dhe veprimet e nevojshme:

- Sektori i banimit duhet të jetë prioritet i politikave të Qeverisë së Kosovës, sipas të cilave duhet të plotësohet baza ligjore si dhe të hartohen programe dhe strategji përkatëse që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së banimit dhe standardin jetësor në përgjithësi;
- Organet kompetente përgjegjëse për sektorin e banimit duhet të përgatisin analiza dhe hulumtime të nevojshme për të dhëna më të sakta për sektorin e banimit. Të dhënat për banim janë të domosdoshme për të krijuar bazë të qëndrueshme për planifikimin dhe identifikimin e nevojave për banim, duke ju referuar projeksioneve të zhvillimit të popullsisë;
- Të bëhet koordinimi dhe bashkëpunimi i të gjitha institucioneve për të harmonizuar nevojat për banim në raport me numrin ekzistues të njësive të zbrazëta të banimit.
- Autoritetet përgjegjëse komunale, sipas mundësive mund të aplikojnë metodën e bonuseve të banimit për sigurimin e hapësirave adekuate publike, duke përfshirë edhe sigurimin e banesave për kategoritë që nuk janë në gjendje ekonomike të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave;
- Gjatë përcaktimit të zonave të banimit autoritetet përgjegjëse komunale duhet ti marrin në konsideratë kushtet e përcaktuara zhvillimore dhe ndërtimore;
- Sipas Ligji nr. 03/l-164 dhe sipas Ligjit Nr. 03/L-040, në të gjitha komunat duhet të krijohet sektori i banimit;
- Për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme buxhetore të sektorit publik, duhet të krijohen mundësitë për bashkëpunim dhe investime nga sektori privat;
- Të krijohet vija buxhetore për banim në nivelin lokal për të përmbushur kërkesat;
- Nga të gjitha komunat kërkohet që të krijojnë kushte për banim të përballeshëm për familjet ose individët, të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave;
- Të bëhet koordinimi në mes të ministrive të cilat aktualisht merren me zgjidhjen e çështjes së banimit për kategoritë e ndryshme në bazë të ligjit në fuqi;
- Komunat e Kosovës duhet të raportojnë për të dhënat vjetore për kërkesat dhe zhvillimet në sektorin e banimit.

Zonat e Banimit

Zhvillimi kompakt i zonave në favor të ruajtjes së tokës bujqësore!



8. SIPËRFAQET E MBROJTURA

ZONAT ME TRASHËGIMI KULTURORE

Trashëgimia kulturore është njëri ndër sektorët më të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Degradimi i saj është duke vazhduar ende dhe kjo çështje obligon të gjitha institucionet relevante që në kuadër të qëllimit **SHFRYTËZIM I QËNDRUESHËM I MJEDISIT DHE VLERA VEÇANTA NATYRORE E KULTURORE**, të realizojmë objektivin e rëndësishëm i cili merret me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, duke e përfshirë trashëgiminë arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme, shpirtërore dhe peisazhet kulturore.

Sipas analizës së buxhetit të vitit 2018:

- 5.5 mil.€ buxheti për fushën e trashëgimisë kulturore (0.03% e buxhetit të përgjithshëm), prej të cilave 3.7 mil.€ të parapara për renovime, gërmime, masa preventive dhe studime tjera për 60 monumente me vlera të veçanta;

Gjendja e aseteve sipas të dhënave të vitit 2019 është:

- 1620 asete të TK me mbrojtje të përkohshme nga të cilat:
 - o 944 asete të trashëgimisë arkitekturore;
 - o 433 asete të trashëgimisë arkeologjike;
 - o 214 asete të trashëgimia e luajtshme;
 - o 15 asete të trashëgimia shpirtërore; dhe
 - o 14 peisazhe kulturore.
- 23 asete të TK me mbrojtje të përhershme (momentalisht mungojnë të dhënat për Kishën “Shën e Premte”);
- 45 Zona të Veçanta të Mbrojtura;

Veprimet që duhet të ndërmerren për plotësimin e objektivës së mësipërme dhe për ndryshimin e gjendjes aktuale sa i përket çështjes në fjalë janë:

- Sipas hierarkisë së përgjegjësisë, niveli i komunave (HZKom) përkatësisht drejtoritë e tyre, përveç bartjes së këtyre informatave nga niveli qendror, duhet të bëjnë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen edhe të kategorive më të ulëta të zonave me trashëgimi kulturore;
- Kompletimi, harmonizimi dhe zbatimi i legjislacionit që kanë të bëjnë me TK të Kosovës (Ligji për TK, Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për Ndërtim dhe Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura);
- Hartimi i Ligjit të ri për Trashëgimi Kulturore dhe akteve nënligjore të saj;

Trashëgimia kulturore
Aset i rëndësishëm për zhvillimin
ekonomik të Kosovës!



- Identifikimi dhe definimi e Peisazheve Kulturore në tërë territorin e Kosovës;
- Përgatitja e rregullave për identifikimin, klasifikimin dhe trajtimin e pejzazheve duke respektuar Konventën Evropiane për Peisazhe;
- Konservimi i Integruar me përfshirjen e trashëgimisë kulturore në Planet hapësinore, Planet zhvillimore dhe Hartat Zonale të nivelit të Kosovës dhe nivelit komunal;
- Hartimi i Strategjisë për konservim të integruar të TK;
- Hartimi i planeve rregulluese për zonat/qendrat historike me TK dhe Planeve për konservim dhe menaxhim të zonave me trashëgimi kulturore;
- Përcaktimi dhe digjitalizimi i sipërfaqës së mbrojtur për të gjitha asetet nga Lista e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme;
- Monitorimi dhe plotësimi i Databazës së aseteve me trashëgimi kulturore;
- Themelimi i mekanizmave të duhur teknik për administrimin dhe menaxhimin e zonave dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore duke përfshirë edhe arkitekturën e trashëguar moderne;
- Ratifikimi i konventave ndërkombëtare: Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturore të Evropës, Granada (Tetor 1985); Konventa Evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike, Valeta (Janar 1992); Konventa për Peisazhin, Firence (Tetor 2000); Konventa për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jo-materiale, Paris (Janar 2003); Konventa për vlerat e TK të shoqërisë, Faro (Tetor 2005); Përvetësimi i Kartës së BE-së për turizmin kulturor (2007);
- Konkurrimi në fonde ndërkombëtare me projekte që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm në aspekt të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;
- Ngritja e bashkëpunimit me shtetet fqinje dhe të rajonit me plane dhe projekte të përbashkëta në fushën e trashëgimisë kulturore;

ZONAT E Mbrojtura të Natyrës

Në aspektin e zonave të mbrojtura të natyrës, mund të konstatohet se Kosova është relativisht në pozitë të mirë ndaj vendeve tjera të rajonit. Aktualisht, mbi 11.5% e territorit është e mbuluar me zona të natyrës të shpallura nën mbrojtje ligjore. Pjesa më e madhe e kësaj sipërfaqeje¹⁰ mbulohet nga dy parqe kombëtare, ndërsa pjesa tjetër nga zona të kategorive tjera të mbrojtura. Duke iu referuar trendit të BE-së dhe politikave globale për mbrojtjen e natyrës është e domosdoshme rritja e sipërfaqes së këtyre zonave dhe menaxhimi i duhur i tyre (rekomandohet 15-20% e territorit të një vendi të merret nën mbrojtje).

Sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (2019)

- 210 zona të mbrojtura të natyrës mbi 126 mijë ha, të ndara sipas kategorive dhe pjesëmarrjes në sipërfaqen e tërësishme:

IUCN kat.	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja/ha	Pjesëmarrja në ZM %
I	Rezervat Strik i Natyrës	19	10,885.82	0.99
II	Park Kombëtar	2	115,957.00	10.60
III	Monument Natyre	182	6,059.79	0.57
V	Park Natyre	1	5,934.00	0.50
V	Peizazh i Mbrojtur	5	2,437.00	0.20
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109.50	0.01
Totali		210	125,804.1¹	11.53 %

¹⁰ Sqarim nga IKMN: kjo sipërfaqe e zonave të mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna".

Me qëllim të ngritjes së nivelit të trajtimit dhe shtimit të sipërfaqeve të mbrojtura të natyrës, në bashkëpunim me IKMN dhe DMMU, dhe në përkrahje të grupit punues ndërministror janë përcaktuar veprimet si më poshtë:

- Sipas hierarkisë së përgjegjesisë, niveli i komunave (HZKom) përkatësisht drejtoritë e tyre, përveç bartjes së këtyre informatave nga niveli qendror, duhet të bëjnë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen edhe të kategorive më të ulëta të zonave të mbrojtura të natyrës;
- Rishikimi i ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe i ligjeve për PK “Sharri” dhe PK “Bjeshkët e Nemuna”;
- Implementimi i rrjetit ekologjik “Natyra 2000”;
- Hartimi i Planit Hapësinor dhe Menaxhues për PK “Bjeshkët e Nemuna”;
- Shpallja e zonave të reja të mbrojtura si: Mokna (Park i Natyrës) me sip. afërsisht prej 20.000 Ha, Shala e Bajgores (Peizazh i mbrojtur) me sip. afërsisht prej 100 Ha dhe zonave tjera që do të propozohen pas përfundimit të analizave përkatëse;
- Ndërmarrja e masave për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve në zona të mbrojtura;
- Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore në zonat e mbrojtura;
- Hartimi i programeve dhe projekteve për ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimit për mbrojtjen e natyrës;
- Themelimi i drejtorive për menaxhimin e monumenteve me rendësi të veçantë, MNRV “Shpella e Gadimes”, MNRV “Ujëvarat e Mirushës”, dhe ZVM “Ligatina e Hencit – Radevë”;
- Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës;
- Harmonizimi dhe kategorizimi i zonave të mbrojtura sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës;
- Anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare si: IUCN, etj.;
- Rritja e stafit profesional në IKMN, DPK “Bjeshkët e Nemuna” dhe DPK “Sharri”;
- Inventarizimi i llojeve dhe i habitateve;
- Respektimi i rregullave që parashihen në iniciativën e Brezit të Gjelbër Evropian.



Zonat e mbrojtura të natyrës

Mbrojtja e natyrës detyrim i të gjithë qytetarëve të Kosovës!



9. ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA

Këto zona janë pjesë e zonave me trashëgimi kulturore të Kosovës, të cilat në detaje janë të përshkruara në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Sipas Ligjit në fjalë, në territorin e Kosovës janë identifikuar 45 zona të tilla, që kryesisht i përkasin trashëgimisë kulturore ortodokse.

Këto zona janë të ndara në tri grupe me karakteristika të ndryshme:

1. 23 zona për të cilat kufiri i tyre është përcaktuar me hartë;
2. 8 zona të cilat kanë një bufer zonë prej 100m nga perimetri i “oborrit” të tyre;
3. 14 zona të cilat kanë një bufer zonë prej 50m nga perimetri i “oborrit” të tyre.


Duke qenë se këto zona janë pjesë e trashëgimisë kulturore të Kosovës, trajtimi i tyre duhet të bëhet i njëjtë me të gjitha përmbajtjet tjera. Në aspektin hapësinor zonat në fjalë shtrihen afërsisht në të gjitha rajonet e Kosovës. Sipas gjendjes aktuale është e sigurt se një pjesë e konsiderueshme e tyre ka nevojë për një trajtim më të veçantë. Në situatë të ngjashme janë edhe një numër i madhe i aseteve tjera të trashëgimisë kulturore, prandaj është e nevojshme ndryshimi i qasjes për trajtimin e duhur të tyre. Barra më e madhe e përgjegjësive i takon sektorit të trashëgimisë kulturore, nga i cili kërkohet vendosmëri në zbatimin e rregullave dhe përgjegjësive për të gjithë akterët relevant. Qëllimi ynë i përgjithshëm është mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, i cili përveç tjerash nënkupton integrimin dhe përfshirjen e aseteve të trashëgimisë kulturore në programe të ndryshme zhvillimore. Jemi të sigurt se kjo është mënyra më e mirë që këto asete të rëndësishme të ruhen, të shfrytëzohen dhe të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me përfaqësues të sektorit të trashëgimisë kulturore janë përcaktuar disa veprime të nevojshme që e mundësojnë realizimin e qëllimit dhe objektivave të parapara.

Veprimet që duhet të ndërmerren për ndryshimin e gjendjes:

- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes akterëve relevant duke përfshirë edhe KOS-in;
- Krijimi i kushteve për qasje të lirë, që do të ndihmojnë në ngritjen e rolit dhe rëndësisë së trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe prezantimin e vlerave për monumentin në veçanti;
- Organizimi i aktiviteteve që shpalosin diversitetin kulturor dhe lehtësojnë komunikimin në mes grupeve të interesit, me qëllim të ruajtjes, integritetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të ZVM-ve;
- Përfshirja dhe integrimi i ZVM-ve në itineraret e vizitave turistike lokale, rajonale dhe niveleve tjera;
- Hartimi i planeve menaxhuese për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave në fjalë;
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore e në veçanti ZVM-ve në agjendat zhvillimore lokale dhe shtetërore;

Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Diversiteti kulturor burim i çmueshëm dhe unik në shoqërinë kosovare!



10. ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË MINERAL

Zonat me interes të veçantë shpallen nga Qeveria me propozim të Ministrit të Ministrisë përkatëse dhe janë përcaktuar si zona, të cilat në të ardhmen do të trajtohen si zona në të cilat e drejta për hulumtim apo shfrytëzim do të jepet përmes procedurave në fuqi. Për zhvillimin e këtyre zonave me rëndësi të veçantë duhet të bëhet realizimi i programeve hulumtuese gjeologjike dhe minerare si dhe të bëhet promovimi i nevojshëm i resurseve minerare të Kosovës.

Zona me interes të veçantë mineral paraqet një zonë fizike/gjeografike, e cila është përcaktuar si e tillë në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Minierat dhe Minerale.

Gjithsejtë janë të shpallura 11 ZIVM, si:

- Vllahi, Zjaçë (Pb,Zn)	Sipërfaqja e zonës	5.555 km ²
- Gumnishtë (Pb,Zn)	Sipërfaqja e zonës	29.172 km ²
- Karaçë (Pb,Zn)	Sipërfaqja e zonës	44.215 km ²
- Baks (Ni,Co)	Sipërfaqja e zonës	23.148 km ²
- Tërstenik (Fe,Ni)	Sipërfaqja e zonës	4.221 km ²
- Bushincë, Bolec (Pb,Zn)	Sipërfaqja e zonës	60.159 km ²
- Bresalc (Pb,Zn)	Sipërfaqja e zonës	27.881 km ²
- Zhegoc (Pb,Zn)	Sipërfaqja e zonës	41.772 km ²
- Magurë, Golesh (Mg)	Sipërfaqja e zonës	4.375 km ²
- Devë (Cr)	Sipërfaqja e zonës	5.613 km ²
- Debëlldëh (Quarcite)	Sipërfaqja e zonës	3.457 km ²

Zonat ekonomike

Krijimi dhe zhvillimi i zonave ekonomike ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve duke iu ofruar bizneseve infrastrukturë fizike të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë, veçanërisht në hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave, po ashtu në kuadër të zonave ekonomike bëhet edhe përqendrimi i bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimi me i lehtë të tyre, zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet bizneseve, qasje më e lehtë e bizneseve në transport, energji elektrike, ujë dhe shërbime tjera.

Hapësirat në kuadër të zonave ekonomike, ju jepen bizneseve në shfrytëzim për një periudhë deri në 99 vite, si dhe me procedurë të lehtësuara si në nivel komunal dhe në atë qendror.

Në bazë të informatave nga sektori i tregtisë dhe industrisë, janë në funksion këto zona ekonomike:

- Parku i Biznesit në Drenas, me sipërfaqe 24 Ha;
- Parku i Biznesit në Mitrovicë, me sipërfaqe 3.5 Ha;
- Parku Teknologjik - Shtime, me sipërfaqe 10.7 Ha;
- Parku Industrial në "Frashër i Vogël - Zhigovina" në Mitrovicë, me sipërfaqe 48 Ha;
- Zona Agro - Industriale në Suharekë, me sipërfaqe 28 Ha;
- Parku Industrial në Komunën e Lipjanit, me sipërfaqe 56 Ha;
- Parku Industrial në Viti, me sipërfaqe 15.50 Ha;
- Parku Industriale në Suharekë, me sipërfaqe 162 Ha;
- Parku Industrial në Vushtrri, me sipërfaqe 14.86 Ha.

dhe në proces këto zona të lira ekonomike:

- Zona e Lirë Ekonomike në Gjakovë;
- Zona e Lirë Ekonomike në Prizren;
- Zona e Lirë Ekonomike në Mitrovicë.

Të gjithë sektorët relevant duhet të ndërmarrin veprime që janë në drejtim të funksionalizimit të plotë të këtyre zonave të rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si:


- Të zgjidhen problemet pronësore juridike; dhe
- Të parashikohen linjat të veçanta buxhetore.

11. ZONAT E SHËRBIMEVE - ARSIMI

Çështja e arsimit është njëra nga çështjet më të rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Duke iu referuar të dhënave dhe vlerësimeve nga burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, arsimit në përgjithësi ka ngasje dhe kualiteti është jo cilësor në krahasim me vendet tjera të Evropës.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, MASHT-it dhe dokumenteve relevante¹¹:

Numri i përgjithshëm i nxënësve (arsimi para-universitar në sektorin publik dhe privat) është duke u zvogëluar;



- Në Kosovë ka shkolla që kanë numër shumë të vogël të nxënësve apo nuk kanë fare nxënës:
 - o Sh.F “Zenel Hajdini” – 224 m², 4 nxënës; Plitkovicë, Lipjan,
 - o Sh.F+Sh.M.U “Ramiz Sadiku” - 1075 m², 5 nxënës Marec (Bullaj), Prishtinë;
 - o Sh.F “Pjetet Bogdani” - 303 m², 2 nxënës, Kolovicë, Prishtinë;
 - o Sh.F “Halil Alidema” - 346 m², 3 nxënës, Qiflak, Viti;
 - o P.F+Sh.F+ Sh.M.U “Fan S. Noli” - 974 m², 0 nxënës, Dujakë, Gjakovë;
 - o Sh.F “Sadri Duhla” - 213 m², 0 nxënës, Lagja Reshan, Suharekë;
- Aktualisht vetëm 25% e shkollave punojnë në një ndërrim;
- Raporti nxënës/mësimdhënës, nuk ka dallim të madh me vendet tjera të Evropës;

Në një situatë të tillë, është e domosdoshme ndërmarrja e veprimeve që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së arsimit në përgjithësi dhe rritjen e cilësisë në veçanti. Për këtë qëllim, propozohen këto masa që duhet të ndërmerren për evitimin e problemeve që janë shumë të dëmshme për perspektivë më të mirë të sektorit të arsimit në përgjithësi.

Veprimet që do të ndikojnë në zhvillimin e zonave të arsimit:

- Niveli komunal, përkatësisht përgjegjësit e arsimit janë të obliguar që përmes hartave të tyre zonale të vendosin një rregull për trajtimin e duhur të këtyre zonave. Përmes veprimeve, aktiviteteve, masave dhe projekteve duhet të ndikojnë në përmirësimin dhe balancimin e kërkesave në këtë sektor të rëndësishëm shoqëror. Duhet të ofrohen zgjidhje të reja, të përshtatshme me situatën aktuale, në të cilën kryqëzohen çështjet që kanë të bëjnë me hapësirën e nevojshme, numrin aktual të nxënësve dhe stafin e nevojshëm edukativ;
- Duhet të investohet në mënyrë të pandërprerë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënësve në mënyrë që ajo cilësi të përcillet tek nxënësit;
- Në Kosovë, ka ende zona të arsimit që janë më të ngarkuara (kryesisht qytetet) dhe zona me mungesë të nxënësve (zonat më të thella rurale, të cilat janë në rritje të vazhdueshme). Niveli lokal duhet të gjej formë të përshtatshme, të cilat mund të zgjidhen përmes transportit, përmes grumbullimit të nxënësve në një shkollë për fshatrat që kanë numër shumë të vogël të nxënësve, ose alternativa tjera të mundshme. Ndërsa në zonat urbane ku ka ngarkesa të mëdha të nxënësve, të shpërndahen ose të

¹¹ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2019, Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Agjencia e Statistikave të Kosovës; Informata nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) 2018-2019, MASHT, Prishtinë; PLANI I VEPRIMIT TË PLANIT STRATEGJIK TË ARSIMIT NË KOSOVOË 2017-2021, MASHT, Prishtinë, Shtator 2016; Mësimdhënësit sipas niveleve, 2015-2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

zhvendosen në zona ku dendësia e nxënësve është më e ulët. Mundësia/alternativa e fundit duhet të jetë ndërtimi ose shtimi i hapësirave të reja;

- Vëmendje të posaçme duhet ti kushtohet hapësirave përcjellëse shkollore (biblioteka, laboratorë e hapësira sportive) të cilat janë të domosdoshme dhe me ndikim direkt në rritjen e cilësisë në arsim në përgjithësi;
- Rritja e përqindjes së nxënësve që mësojnë në një ndërrim dhe rritja e hapësirës shkollore për kokë nxënësi, duke synuar që të paktën 1/3 e nxënësve të mësojnë në një ndërrim dhe të realizohet rritja e hapësirës nga 3.5m² bruto që është tani, në 4m² për nxënësi;
- Investimet në sektorin e arsimit fillimisht duhet të orientohen në komunat ku kërkesa është më e madhe (sipas MASHT-it komunat e Prizrenit, Prishtinës, Podujevës, Gjilanit dhe Gjakovës);
- Shkollat profesionale të profilizuara me objektet e tyre përcjellëse duhet të jenë objektive të arsimit parauniversitar, shtrirja dhe funksionimi i tyre duhet të jetë në harmoni me kërkesat e tregut.

12. ZONAT E SHËRBIMEVE - SHËNDETËSIA

Duke ju referuar të dhënave dhe vlerësimeve nga burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, shëndetësia në përgjithësi nuk është në gjendje të mirë nëse e krahasojmë me vendet tjera të Evropës. Arsyet janë të ndryshme, prej menaxhimit joefikas dhe përdorimit joadekuat të mjeteve dhe donacioneve, e deri te kapacitetet humane dhe teknike të pamjaftueshme.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe MSH:

- Më shumë se 14.000 persona të angazhuar për shërbime shëndetësore në sektorë të ndryshëm, prej të cilëve më shumë se 5.000 janë mjekë, ndërsa pjesa tjetër personel ndihmës.
- Në sektorin dytësor të shëndetësisë aktualisht janë afërsisht 2.000 shtretër të shpërndarë në shtatë spitalet rajonale, si dhe pak mbi 2.000 shtretër në sektorin e shëndetësisë terciare, përkatësisht në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës;
- 231 shtretër për 100.000 banorë sa është raporti në Kosovë, është vlera më e vogël nga të gjitha vendet e Evropës (538.2 / 100.000 banorë).
- Ndërsa krahasuar me vendet e rajonit Kosova është pas Kroacisë me 561.9, Maqedonisë me 459.1 dhe Turqisë me 251.6 shtretër për 100.000 banorë.
- Sa i përket numrit të mjekëve, Kosova me 325.3 mjekë, në nivel rajoni qëndron me mirë dhe lë pas Kroacinë me 278.4, Maqedoninë me 269.6 dhe Turqinë me 168.8 mjekë / 100.000 banorë.

Njohja me kapacitetin e potencialeve njerëzore e teknike dhe të shtrirjes së objekteve shëndetësore, është i një rëndësie të veçantë, për menaxhim të mirëfillt të sistemit shëndetësor, duke përfshirë edhe planifikimin e zhvillimeve të ardhshme hapësinore për territorin e caktuar. Të dhënat në dispozicion, për shtrirjen dhe gjendjen e objekteve shëndetësore me numrin e shtretërve e të mjekëve, në raportin me numrin e pacientëve dhe dendësinë e popullsisë, na tregojnë për nivelin e zhvillimit të shëndetësisë si dhe na orientojnë në përcaktimin e prioriteteve sektoriale dhe në fokusimin e investimeve të ardhshme, për të plotësuar nevojat e popullsisë të bazuara në këto dëshmi (fakte). Më saktësisht, na drejtojnë për adresimit të kërkesave, për ndërtimin e objekteve të reja shëndetësore, për rikonstruktimin dhe rehabilitimin e objekteve ekzistuese, për rregullimin dhe adaptimin e kthinave për mjekime të veçanta dhe për avancimin e stafit profesional e të pajisjeve mjekësore, me të cilat do të ndikohet në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në përgjithësi.

Veprimet që do të ndikojnë në zhvillimin e zonave të shëndetësisë:

- Shtrirja e objekteve për shërbime shëndetësore në Kosovë duhet të jetë në proporcion me shpërndarjen dhe dendësinë e popullsisë. Pasi që numri i mjekëve qëndron më mirë se numri i shtretërve për 100.000

banorë, duhet te hapen spitale ne vendet ku është më e nevojshme në mënyrë që të rritet numri i shtretërve;

- Në Kosovë, potenciali i kapaciteteve njerëzore dhe teknike, nëpër objektet shëndetësore që ofrojnë shërbime: primare, sekondare dhe terciare, ka pësuar ndryshime gjatë viteve të fundit, ku në vlerat e fituara dallohet një ulje e numrit të shtretërve dhe një rritje e numrit të mjekëve për 100.000 banorë;
- Sikurse në Evropë ashtu edhe në Kosovë, për arsye të mos përmbushjes së kapaciteteve dhe të shkaqeve ekonomike, kemi edhe zvogëlim të numrit të shtretërve apo mungesë të tyre në raport me numrin e kërkesave për stacionim, gjë e cila sjellë mbingarkesë të objekteve shëndetësore. Zvogëlimi i numrit të shtretërve nëpër objektet shëndetësore është bërë për shkak të mungesës së hapësirave të nevojshme, të kthinave të veçanta për mjekime specifike dhe për vendosje të aparaturës ose pajisjeve mjekësore të teknologjisë bashkëkohore;
- Vlera e raportit mjekë/banorë, edhe pse rezulton se është në rritje, është më se e nevojshme të rritet akoma më shumë për të përballuar kërkesat evidente për shërbime të ndryshme nga mjekë me specializime të ndryshme.

13. ZONAT TURISTIKE

Çështja e turizmit është njëra nga çështjet më të ndjeshme dhe sipas ekspertëve njëri nga burimet më me ndikim dhe njëra nga degët më të leverdishme në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Duke ju referuar të dhënave dhe vlerësimeve nga burime të ndryshme, kjo degë e fuqishme ekonomike mbetet mbrapa sektorëve tjerë zhvillimor, me një pjesëmarrje shumë të ulët në GDP-në e përgjithshme të vendit. Të dhënat që ekzistojnë nuk e pasqyrojnë gjendjen adekuate, ato shpesh janë të paqarta, të bazuara në vlerësime dhe me ndikim direkt në krijimin e situatave konfuze lidhur me turizmin dhe çështjet tjera që ndërlidhen me të.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës gjatë vitit 2017:

- Më shumë se 120.000 vizitorë kanë frekuentuar në hotelet e Kosovës, prej të cilëve afërsisht 35.000 vendorë dhe më shumë se 85.000 të jashtëm;
- Vizitorët e jashtëm vijnë kryesisht nga Shqipëria (më shumë se 15 mijë), Gjermania (afërsisht 10 mijë), Turqia, Zvicra, SHBA (me nga më shumë se 5 mijë), etj.;
- Në krahasim me vitin paraprak numri i vizitorëve është në rënie (mbi 8%);
- Prishtina me afërsisht 60% është qyteti më i vizituar, e pasuar nga Prizreni e Peja me afërsisht 15%, Ferizaj me 5%, etj.;
- Janë regjistruar më shumë se 7 mijë fluturime me afërsisht 2 milion udhëtarë, që është afër 5% më shumë se në vitin paraprak;

Sipas INSTAT:

- Në Shqipëri janë regjistruar më shumë se 5 milion turistë;
- Sipas të dhënave zyrtare në Serbi kishte afër 3 milion turistë;
- Në Mal të Zi afërsisht 2 milion;
- Në Maqedoni janë regjistruar afër 1 milion turistë;

Sipas Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC):

- Janë gjeneruar 7.6 trilionë dollarë nga udhëtimet dhe turizmi (më shumë se 10% e BPV botërore);
- Janë krijuar 290 milion vende pune (1 në 10 vende pune të ekonomisë botërore);

Sipas institutit Demokracia për Zhvillim (D4D) buxheti (në milion) i ndarë për turizëm në 2017:

- Kosova **0.1**; Shqipëria **13.5**; Mali i Zi **4.3**; Maqedonia **2.1**; Serbia **8.0**; Kroacia **30**.

Në një situatë të tillë në aspektin e përgjithshëm, sektori i turizmit në Kosovë ka nevojë për ndërhyrje të shpejtë dhe përmbajtësore, duke filluar nga përmirësimi dhe riorganizimi i strukturës administrative,

ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit të turizmit dhe udhëzimeve administrative përkatëse dhe duke krijuar politika të përshtatshme për t'i shërbyer më mirë kërkesave të një industrie vazhdimisht në zhvillim.

Ndërsa, sa i përket aspektit hapësinor, është e domosdoshme ndërmarrja e veprimeve që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së turizmit në përgjithësi, dhe në veçanti vendosjes së vendit tonë në itineraret turistike ndërkombëtare. Planifikimi cilësor i hapësirës është ndër parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit. Hapësira, në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë, është faktori themelor i ardhjes/qëndrimit të mysafirëve, e njëkohësisht edhe faktor i zhvillimit të destinacionit turistik. Planet hapësinore janë njëri nga instrumentet themelore të zhvillimit të turizmit, në bazë të të cilave orientohen dhe përcaktohet planifikimi i të gjitha degëve ekonomike dhe veprimtarive me ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e ofertës së duhur turistike.

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me sektorin e turizmit dhe grupin punues ndërmintor, janë përcaktuar zonat turistike dhe veprimet përkatëse për zhvillimin e tyre. Pjesa më e madhe e veprimeve është në favor të turizmit të integruar, që aktualisht është trend në të gjitha vendet e zhvilluara. Në këtë lloj të turizmit përpos destinacionit final përfshihen edhe faktorë të tjerë siç janë: faktorët natyror (relievi, klima, resurset ujore, flora dhe fauna etj.) dhe faktorët shoqëror që janë: trashëgimia kulturore, me të gjitha përmbajtjet e saja, duke përfshirë edhe doket, zakonet dhe ngjarjet tradicionale të zonës në fjalë. Në këtë mënyrë, zona turistike e kombinuar me faktorët e lartpërmendur, bëhet më atraktive, më joshëse dhe më konkurruese me zonat tjera përreth (përpos destinacionit final, turistëve do t'ju ofrohen edhe përmbajtje tjera interesante).

Veprimet që do të ndikojnë në zhvillimin hapësinor të turizmit dhe zonave turistike në veçanti janë:

- Definojnë zonat turistike sipas kriterëve bazë¹²:

Zona 1 – me Qendër Prishtinën - është epiqendra e të gjitha zhvillimeve turistike të Kosovës dhe llogaritet si qendra më e zhvilluar me nivelin më të lartë të shërbimeve. Kjo zonë karakterizohet me: turizëm afarist; kongresien; turizëm transit; si dhe turizëm kulturor i bazuar në monumentet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe historike. Disa nga monumentet e vjetra të trashëgimisë kulturore në brendi të qytetit të Prishtinës, Qyteti i Vjetër i Ulpianës, Kalaja e Harilaqit, Monumenti i Natyrës “Shpella e Gadimes” (aktualisht njëri nga destinacionet turistike kryesore të vendit) janë vetëm disa nga përmbajtjet kryesore që e rrisin vlerën turistike të zonës;

Zona 2 – me Qendrat Pejë dhe Gjakovë, karakterizohet me turizëm: malor; dimëror-rekreativ, turizëm rural, turizëm të gjuetisë dhe peshkimit, turizëm shëndetësor, alpinist, speleoturizëm, turizëm tranzitor, ndërkufitarë, duke përfshirë edhe turizmin kulturor për shkak të përmbajtjeve të vlefshme të trashëgimisë kulturore dhe historike. Në kuadër të zonës përfshihet një numër i konsiderueshëm i hoteleve dhe bujtinave tradicionale karakteristike për zonën, etj. Këtë zonë e bënë më të veçantë prezenca e PK “Bjeshkët e Nemuna” me pikën më atraktive “Maja e Gjeravicës” dhe “Gryka e Rugovës” me doket dhe zakonet tradicionale të saja. Pjesë e rëndësishme e kësaj zone është “Memoriali i Koshares” ku fillojë të ndërtohet historia më e re e Kosovës, si dhe Monumenti i Mbrojtur i Natyrës “Ujëvarat e Mirushes”, i cili është njëra nga pikat më të vizituara të Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj zone janë edhe qendrat e vogla: Junik, Deçan, Rahovec, Istog dhe Klinë;

Zona 3 – me Qendër Prizrenin, përfshinë masivin e Maleve të Sharrit dhe karakterizohet me Turizëm: kulturor, malor, dimëror-rekreativ, rural, gjueti dhe peshkim, turizëm alpin, dhe me ekskursionet-rekreative. Zonën e bënë të veçantë Prizreni si “Qytet Muze”, prania e Parkut Kombëtar “Mali Sharrë”, në kuadër të të cilit përfshihen qendrat e skijimit si “Brezovica” dhe dy qendra tjera më të vogla Prevala dhe Brodi. Krahas Prizrenit, pjesë e kësaj Zone është Qendra e Ferizajt që ka pozitë të përshtatshme ndërlidhëse dhe atraksioni turistik me shumë perspektivë “Bifurkacioni i Nerodimes”, si dhe dy qendrat e vogla: Kaçaniku dhe Dragashi që shquhen me histori dhe me doke dhe zakone të veçanta;

Zona 4 – me Qendër Mitrovicën, karakterizohet me potencial për zhvillimin e turizmit malor, turizmit rural dhe turizmit kulturo historik. Shala e Bajgores, Mali i Mognës, Liqeni i Ujmanit, Shtëpia e Isë Boletinit, Kompleksi Memorial Adem Jashari në Skenderaj, Muzeu i Trepçës, Kalaja dhe Ura e Vjetër në

¹²Zonat dhe lokalitetet turistike janë definuar duke u bazuar në këto kriterë bazë: Resurseve specifike natyrore dhe të trashëgimisë kulturore; Atraksionet turistike; Kapacitetet hoteliere/akomoduese dhe shërbyese; Numri i turistëve vendor dhe të huaj; Numri i turistëve në sezonin primar dhe sekondar, dhe kohëzgjatja e qëndrimit të tyre;

Vushtrri, duke përfshirë edhe diversitetin kulturor, janë disa nga atraksionet e rëndësishme që e rrisin ofertën turistike të kësaj zone. Pozita gjeografike dhe lidhjet infrastrukturore ndikojnë direkt në ngritjen e vlerës së këtyre përmbajtjeve dhe shtimit të interesimit për vizita, jo vetëm për turistët vendor;

Zona 5 – me Qendër Gjilanin, karakterizohet me turizëm shëndetësor, turizëm kulturo historik dhe turizëm tranzit. Prezenca e Kalasë së “Novo Bërdës” (njëri nga monumentet më të vlefshme të trashëgimisë tonë kulturore) dhe burimeve termale shëndetësore, paraqesin një segment të rëndësishëm të ofertës turistike të kësaj zone në veçanti, dhe në përgjithësi të Kosovës. Kjo zonë përveç Gjilanit si qendër ka lidhje të mira edhe me qendrat dhe nën-qendrat përreth;

- Të bëhet ndryshimi i Infrastrukturës ligjore të turizmit në Kosovë përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të mirë-planifikuar;
- Çështja e turizmit të trajtohet në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor qendror dhe lokal;
- Të ndërtohet baza e mirëfilltë e të dhënave, sipas të cilës vendosen politikat dhe planet e duhura për zhvillimin e turizmit;
- Përgatitja e hartës së shtigjeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Zhvillimi i pakove të integruara të turizmit.
- Hapja sa më e shpejtë e mundur e qendrave Informimit turistik (QIT) në çdo qendër rajonale, e posaçërisht në Prishtinë, si epiqendra e të gjitha zhvillimeve turistike të Kosovës;
- Harmonizimi i standardeve të akomodimit sipas UNWTO, HOTREC, etj.;
- Klasifikimi/ kategorizimi i hoteleve – i obligueshëm;
- Trajtimi i duhur i vendbanimeve rurale duke realizuar programe dhe projekte mbështetëse për zhvillimin e turizmit rural;
- Përkrahje buxhetore dhe lehtësira ekonomike për Komunitet me potenciale të dëshmuara turistike, me theks të veçantë qendrat që bëjnë pjesë në zonat turistike 1,2 dhe 3;
- Niveli komunal përveç bartjes së informatave nga niveli qendror (ZT: 1, 2, 3, 4 dhe 5), bënë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të gjitha përmbajtjeve turistike që janë të kategorive më të ulëta.
- Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare për turizëm dhe statistika (WTO, WTTTC, Eurostat, Forumi Ekonomik Botëror, Komisioni Botëror i Udhëtimeve ETC, UNESCO, UNSTATS, etj.);

Zonat turistike

Turizmi malor, njëri nga potencialet kryesore të zhvillimit turistik në Kosovë!



14. ZONAT REKREATIVE SPORTIVE

Zonat Rekreative Sportive

Sporti është pjesë përbërëse e nevojave sociale të individit, një mjet universal i bashkëpunimit në mes të njerëzve, me qëllim të edukimit fizik dhe shpirtëror, vitalitetit dhe shëndetit, marrëdhënieve shoqërore dhe gatishmërisë për ruajtjen e cilësisë së jetës. Sporti është gjithashtu një kategori ekonomike në funksion të punësimit, drejtuesve të prodhimit dhe rritjes ekonomike, promovimit, reklamimit dhe aktiviteteve të tjera të marketingut në fushën e turizmit, transportit, mediave, argëtimit etj.

Qëllimi kryesor i kësaj fushe është "Zhvillimi i sportit në Kosovë" dhe Objektivat e identifikuar për arritje të këtij qëllimi janë orientuar kah:

1. Modernizimi i infrastrukturës sportive sipas standardeve ndërkombëtare;
2. Masivizimi i sportit me moton "Sport për të gjithë";
3. Mbështetja dhe zhvillimi i sportit cilësor;
4. Ngritja e kapaciteteve profesionale në sport;
5. Ngritja e bashkëpunimit institucional të nivelit qendror dhe atij komunal.

Sipas Draft Planit Strategjik për Sportin 2017-2021 - Sporti në Kushtetutën e Republikës së Kosovës definohet si kategori e interesit të veçantë shoqëror dhe financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në gjendjen aktuale të infrastrukturës sportive, objektet sportive në masën më të madhe janë në gjendje të vështirë dhe pa mbikëqyrje.

Infrastruktura e mbyllur				Infrastruktura sportive e hapur			
N	Objektet sportive	Numri	Në ndërtim	N	Objektet sportive	Numri	Në ndërtim
1	Palestra të sportit	13	8	1	Stadiume të futbollit	25	2
2	Salla të edukatës fizike	65	7	2	Fusha të futbollit	71	
3	Pishina të mbyllura	4	1	3	Poligone sportive	44	11
4	Fusha të mbuluara	55		4	Pishina të hapura	41	
5	Poligone të qitjes	4		5	Fusha sintetike	53	
6				6	Poligone të qitjes	3	
7				7	Shtigje të atletikës	1	1
8				8	Terrene të skijimit	4	
9				9	Hapësira rekreacioni	9	

Veprimet që duhet të ndërmerren për plotësimin e objektivave të cekura më lartë, do të arrihen sipas rekomandimeve dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- Ndërtimi i Qendrës Nacionale për Sport në Bërnice të Poshtme, Komuna e Prishtinës;
- Ndërtimi i Stadiumit të ri Kombëtar;
Lidhur me projektin në fjalë, aktualisht janë në shqyrtim dy opsione: njëri në afërsi të Drenasit (te zona ekonomike) dhe tjetri në Bërnice, në afërsi të Prishtinës.
Në aspektin hapësinor, duke pasur parasysh: kualitetin e tokës; lidhjet infrastrukturore; largësinë me qendrat e tjera urbane, afërsinë me aeroportin dhe stacionin hekurudhor, mund të konstatojmë se duhet ti ipet përparësi lokacionit në afërsi të Drenasit.
- Renovimi i objekteve sportive ekzistuese sipas standardeve ndërkombëtare, Stadiumit të Kombëtares së Kosovës (Stadiumi "Fadil Vokrri" - me interes nacional) në Prishtinë, Stadiumit Olimpik "Adem Jashari" - me interes nacional, në Mitrovicë, Pallatit të Rinisë në Prishtinë dhe Palestrave tipike ekzistuese në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë etj.;
- Ndërtimi i shtigjeve të atletikës në qendrat rajonale, në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Podujevë etj.;
- Ndërtimi i pishinave në qendrat rajonale. Parashihet të ndërtohen pishinat olimpike dhe gjysëm-olimpike në komunat Mitrovicë, Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Drenas etj.;
- Ndërtimi i Qendrës Nacionale të Tenisit në Prishtinë;
- Ndërtimi i Qendrës Nacionale të Xhudos në Pejë.



15. ZONAT E GJEORREZIQEVE NË KOSOVË

Kosova preket nga fatkeqësitë natyrore si dhe shumë shpesh edhe nga fatkeqësitë e shkaktuara nga dora e njeriut. Ato janë nga më të ndryshmet, por kryesoret janë:

1. Zonat sizmike;
2. Zonat e rrëshqitjeve dhe rrokullisjeve të shkëmbinjve;
3. Zonat erozive;
4. Zonat e hotspoteve; dhe
5. Zonat e minierave aktive dhe të braktisura.

Sipas sektorit të Gjeofizikës dhe Gjeologjisë Inzhinierike, në Kosovë janë të pranishme gjeorrezizimet e ndryshme që shkaktojnë humbje të të mirave materiale por edhe humbjen në njerëz.

- **Territori i Kosovës karakterizohet me** aktivitet sizmik relativisht të lartë (3.5-6.2) shkallë të Rihterit;
- Në periudhën mbi 500 vjeçare Kosova është goditur nga më shumë se 156 tërmetet të shkallëve të ndryshme ku 26 prej tyre i takojnë shkallës së lart të rrezikshmërisë VII-IX;
- **Në Kosovë janë identifikuar 21 zona potenciale të rrëshqitjeve dhe 10 zona me rrezikshmëri të rrokullisjeve të masave shkëmbore;**
- Rreth $\frac{1}{4}$ e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës është e përfshirë në kategorinë e erozionit të lartë dhe shumë të lartë;
- Janë të evidentuar 50 zona të **minierave aktive dhe të braktisura** me rrezik për jetën e banorëve;
- Janë të identifikuar 30 zona të mbetjeve industriale që paraqesin rrezik permanent për botën bimore shtazore dhe vet jetën e njeriut;
- Zonat më të rrezikuara nga vërshimet janë Pellgu i Drinit të Bardhë dhe Sitnica.

Zonat sizmike

Hartat e rrezikut sizmik tregojnë se pjesa më e madhe e territorit të Kosovës mund të konsiderohen si zona me rrezik sizmik mesatar. Ndërsa zona me rrezik të lartë mund të konsiderohen zona e Kopaonikut në veri të Kosovës, zona Prizren-Pejë, veçanërisht në lindje dhe juglindje të Prizrenit, pranë kufirit me Shqipërinë, si dhe zona Ferizaj-Viti-Gjilan, veçanërisht në drejtim të Shkupit. (Harta Nr.7)

Veprimet :

1. Përpunimi i hartës së rrezikut sizmik të vendit në bazë të dhënave sizmike për nivele të ndryshme të rrezikut sizmik të pranueshëm për planifikim hapësinor, projektim dhe ndërtim;
2. Punimi i hartave të mikrozonimit sizmik për zonat urbane të Kosovës;
3. Të zbatohet EUROCODI 8 gjatë ndërtimeve të strukturave të mëdha (ura, tubacione, sillose, rezervuar uji, ndërtesa publike, ndërtesa banimi kolektiv etj.)

Zonat e rrëshqitjeve dhe rrokullisjeve të shkëmbinjve

Duke u mbështetur në të dhënat nga shërbimi gjeologjik i Kosovës, shumë pjesë të territorit të Kosovës janë të përfshira nga rrëshqitjet, rrokullisjet dhe shembjet e terrenit. Sipas të dhënave të vitit 2015 zonat më të rrezikuara janë paraqitur në hartën Nr.7.

Veprimet e nevojshme:

- Të bëhet studimi gjeologo-gjeomekanik i tokave ndërtimore;
- Të sanohen dëmet dhe të rehabilitohen zonat;
- Të autorizohen institucionet në bashkëpunim me komunën për hartimin, implementimin dhe menaxhimin planeve për parandalimin dhe menaxhimin e rrëshqitjeve të terrenit dhe zonave ku ka rrokullisje të shkëmbinjve.

Zonat erozive

Erozioni është fatkeqësi natyrore, njëra prej komponentëve mjaftë me rëndësi dhe me ndikim të dëmshëm në sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri.

Përveç dukurive natyrore, shkaktarët tjerë me ndikim serioz në përshpejtimin e kësaj dukurie janë mos shfrytëzimi racional i tokave bujqësore, prerja e pa kontrolluar e pyjeve dhe shfrytëzimi i pa kontrolluar i inerteve nga shtretërit e lumenjve dhe puna e pakontrolluar e gurëthyesve.

Nën rrezik të erozionit sipas të dhënave janë në:

- Kategorinë e parë 714.3 km² ose 6.6% e sip. së përgjithshme të Kosovës;
- Kategorinë e dytë 1890.2 km² ose 17.6% e sip. së përgjithshme të Kosovës;
- Kategorinë e tretë 3367 km² ose 31.3% e sip. së përgjithshme të Kosovës;
- Kategorinë e katërt 3680 km² ose 34.3% e sip. së përgjithshme të Kosovës;
- Kategorinë e pestë 1097 km² ose 10.3% e sip. së përgjithshme të Kosovës;
- Rreth 12 milion/m³/vit produkt për bartje, e shkaktuar nga erozioni në gjithë territorin e Kosovës;
- Nga ky material i eroduar për bartje arrihet të bartet rreth 5 milion/m³/vit ose rreth 450m³/km², ose 5m³/ha.

Veprimet për mënjanimin e efekteve të dëmshme bëhen duke i ndërmarrë masat teknike, biologjike dhe bioteknike të parapara në Ligjin për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 dhe Strategjinë shtetërore të ujërave të Kosovës 2015-2034.

Këto rregulla dhe veprime janë të domosdoshme të parashihen në dokumentet e planifikimit hapësinor lokale.

Masat parandaluese

- Kufizohen dhe ndalohet prerja e druve, shkurreve dhe shpyllëzimi;
- Në rast të rrezikut eroziv në kullosat përkatëse ndalohet dhënia e lejeve për kullotje;
- Ndalohet shndërrimi i kullosave dhe livadheve në toka punuese të rrezikuara nga erozioni;
- Ndalohet ndërtimi i objekteve pa leje mjedisore në zonat erozive;
- Ndalohet ndërtimi i objekteve të cilat rrezikojnë stabilitetin e tokës siç janë penda, kanalet, hurdhat e peshqve;

Veprimet anti-erozive

- Meliorimi i pyjeve dhe kullosave;
- Pyllëzimi me fidanë por edhe me barishte;
- Ndërtimi i tarracave dhe objekteve hidroteknike (mure, rrethoja, penda, gardhe, etj);
- Rregullimi i shtretërve të rrëkeve dhe pastrimi i tyre nga bimët e vetë rritura;
- Pastrimi i shtretërve të rrëkeve dhe lumenjve nga depozitimi i inerteve me leje paraprake ujore.

Zonat e minierave aktive dhe atyre të braktisura

Në territorin e Kosovës ekzistojnë disa miniera të vjetra ku është bërë shfrytëzimi i mineraleve dhe janë zhvilluar hulumtime të ndryshme. Pasojat e këtyre punimeve dhe hulumtimeve ende janë evidente dhe paraqesin rrezik permanent për komunitetin përreth tyre. Disa prej tyre, për shkak të shuarjes së aktivitetit mineral janë shkatërruar dhe shembur dhe shpesh herë janë edhe shkaktar të dëmeve në njerëz dhe në pasuritë e tyre. Vendndodhja e këtyre zonave është e paraqitur në hartën Nr. 3 dhe si e tillë duhet të merret në konsideratë nga sektorët tjerë, duke përfshirë edhe nivelin lokal të planifikimit.

Veprimet e nevojshme:

- Monitorimi i depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi;

- Ndalimi i ndërtimit të objekteve individuale, publike, ekonomike në zonat e braktisura minerare si në ato sipërfaqësore ashtu dhe në ato nën tokësore;
- Rehabilitimi dhe konservimi i galerive minerare.

Zonat e hotspotëve

Në përgjithësi vendi ynë ka trashëguar një numër të madh problemesh mjedisore, të akumuluar me dekada si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore dhe minerare, prodhimit industrial të shoqëruar me një shkallë të lartë të ndotjes, të cilat paraqesin rrezik permanent për komunitetin përreth vendbanimet ku ato shtrihen si dhe vendin në përgjithësi.

Vendndodhja e këtyre zonave është e paraqitur në Hartën Nr. 8 (28 prej tyre me ndotje potenciale mjedisore) dhe si e tillë duhet të merret në konsideratë nga sektorët tjerë, duke përfshirë edhe nivelin lokal.

Veprimet e nevojshme:

- Ri-shfrytëzimi i mbeturinave të ndryshme nga industria (Obiliq, Novobërdë, Strezovcë, Mitrovicë, Hanë të Elezit);
- Rehabilitimi i deponive industriale me prioritet (Obiliq dhe Mitrovicë);
- Trajtimi ose asgjësimi i mbeturinave nga substancat kimike të rrezikshme (Obiliq dhe Mitrovicë);
- Ndërtimi i magazinave për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme (Lokacioni: Harilaq- Fushë Kosovë);
- Eksportimi i mbeturinave me qëllim përdorimi ose asgjësimi;
- Pastrimi i vendeve të kontaminuar me kimikate industriale dhe i minierave (Novobërdë, Kishnicë, Mitrovicë, Obiliq).

Zonat nën rrezik nga vërshimi

Kosova është e ndjeshme ndaj vërshimeve të cilat manifestohen në të gjitha pellgjet lumore me intezitet dhe forma të ndryshme. Rreth 10.000ha janë nën rrezik nga vërshimet me rreth 9.000 objekte banimi dhe rreth 50.000 banor me infrastrukturë përcjellëse (rrugë, kanalizime, ura, energjetik, ujësjellës dhe objekte ekonomike) Harta Nr. 7.

Nën rrezik nga vërshimet sipas të dhënave janë:

- Pellgu i Drinit me rreth 5.000ha toka bujqësore;
- Pellgu Ibër-Sitnicë me rreth 2.400 ha toka bujqësore;
- Pellgu Morava e Binçes me rreth 2.000ha toka bujqësore; dhe
- Pellgu i Lepencit me rreth 600 ha toka bujqësore.

Nën rrezik nga vërshimet janë >10.000 banorë, >8.000 objekte banimi, infrastruktura përcjellëse (ujësjellës, kanalizim, rrugë, energji elektrike) dhe objekte të ndryshme ekonomike e publike.

Në nivel të pellgjeve nën rrezik të vërshimeve janë:

- Pellgu i Drinit 50% e vërshimeve në nivel të Kosovës;
- Pellgu i Ibër-Sitnicë 24% e vërshimeve në nivel të Kosovës;
- Pellgu Morava e Binçes 20% e vërshimeve në nivel të Kosovës;
- Pellgu i Lepencit 6% e vërshimeve në nivel të Kosovës.

Shkaqet kryesore të vërshimeve në Kosovë janë:

- Reshjet;
- Nxjerrja ilegale e inerteve;
- Ndërtimet e pa kontrolluara në hapësirat buzë lumenjve;
- Mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve dhe argjinaturave;
- Hedhja e mbeturinave në lumenj, etj.;

Veprimet e nevojshme:

- Ndalimi i aktiviteteve ilegale të nxjerrjes së materieve inerte (rërë, zhavorr, gurë, argjilë etj.) në sipërfaqe të cilat i nënshtrohen vërshimeve respektivisht në zonat e mbrojtura në afërsi 100 metra nga vija e jashtme të argjinaturës;
- Riparimi i argjinaturave mbrojtëse dhe të ndërtohen të reja në shtretërit e lumenjve të Drinit të Bardhë, Iber-Sitnica, Morava e Binçes dhe Lepenc;
- Mbjellja e drunjëve në afërsi 20 metra nga pjesa e brendshme dhe 10 metra nga pjesa e jashtme e argjinaturave (urbanizimi i shtretërve lumor);
- Ndërtimi i pengesave mbrojtëse (pyllëzim, ngritje të nivelit me shkëmbi dhe masa tjera hidroteknike) në pjesët e tokave që kanë potencial të nënshtrohen vërshimeve përgjatë lumenjve me potencial të rrezikut nga vërshimet;
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga depozitimi i inerteve, mbeturinat e ngurta dhe bimët e vetë rritura (në të gjitha pellgjet lumore).

16. ZONAT UJORE

Resurset ujore, janë faktorë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Vlerësohet se Kosova ka 1600 m³ /ujë/vit për kokë banori. Në aspektin hidrografik Kosova ndahet në 5 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, Lepeneci dhe Pellgu i Plavës. Nga territori i Kosovës në vitin me lagështi mesatare rrjedhin përafërsisht 120 m³ /sek.

Zonat Ujore

Resurset ujore, faktorë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit!



Sipas sektorit të ujërave, në Kosovë nuk ka ujë të mjaftueshëm!

Kosova me vetëm 1600m³/vit për kokë banori, karakterizohet si njëri nga vendet me sasi të limituar të rezervave ujore. Sa për krahasim 1000-3000m³ujë/ kokë banori kanë këto shtete: Bullgaria, Greqia, Çekia, Spanja, Portugalia, Rumania etj.

Ujërat sipërfaqësor (Lumenjtë dhe Liqenet)

- Sasia e ujit: më shumë se 3.5 miliardë m³/vit ose afërsisht 2000 m³/kb në vit;
- Sipërfaqja rrjedhave ujore rreth 12.000 ha;
- Vëllimi - afërsisht 575 milion/m³ - të shfrytëzueshme: 500 milion/ m³ ose 200 m³/kb;
- Sipërfaqja e përgjithshme e liqeneve - rreth 2.200 ha;

Ujërat nëntokësore

- Kapaciteti vlerësues - 24 m³/s;
- Rezerva - 511x10⁶;
- Kapaciteti i ujërave termale dhe termo-minerale - 45 l/s;

Shfrytëzimi i ujërave:

- **Ujë për pije** - 200 m³ për person, që është 20% nën mesataren e standardit;
- **Ujë për ujitje** - rreth 8.000 ha (nga hidro sistemet) dhe 4.000 ha individualisht, konsumi i përafërt rreth 150 milion m³/vit;
- **Ujë për industri** - rreth 25 milion m³/vit;

Sipërfaqja ujore e përgjithshme – rreth 15.000 ha, ose 1.3% e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës.

Karakteristikë kryesore hidrologjike në Kosovë është shpërndarja jo e barabartë dhe jo adekuate e resurseve ujore në krahasim me nevojat. Rezervat kryesore të ujërave nëntokësore shtrihen kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ku edhe rezervat e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha, në krahasim me pjesën lindore me rezerva të pakta dhe pjesën jug-lindore ku nevojat për ujë janë shumë të mëdha. Nevojat për ujë nga të gjithë sektorët janë shtuar andaj rritja e rezervave ujore në Kosovë është veprim i domosdoshëm.

Degradimi, ndotja, tej shfrytëzimi janë dukuri negative që janë prezentë në zonat ujëmbajtëse dhe ato ujë rrjedhëse, andaj kërkohet përmirësim i situatës dhe ndërmarrje e masave në mënjanimin e këtyre fenomeneve negative që po ndikojnë në këtë resurs me rëndësi për jetën e njeriut në përgjithësi.

Veprimet që duhet ndërmerren për përmirësimin e gjendjes:**1. Ruajtja dhe mbrojtja e burimeve ujore dhe rrjedhave ujore:**

- 1.1. Rregullimi i shtratit të Lumit Krena në Gjakovë;
- 1.2. Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc në Kaçanik;
- 1.3. Rregullimi i shtratit të lumit Drenica në Drenas;
- 1.4. Rregullimi i shtratit të lumit Duhlllo në Rahovec;
- 1.5. Rregullimi i shtratit të lumit Rimnik në Rahovec;
- 1.6. Rregullimi i shtratit të lumit Bistrica në Pejë;
- 1.7. Rregullimi i shtratit Toplluha në Suharekë;
- 1.8. Zgjerimi dhe pastrimi i shtratit të lumenjve Llap në Dumnice dhe Batllavë në Podujevë;
- 1.9. Hapja dhe Pastrimi i Shtratit të Lumit Sitnica;
- 1.10. Rehabilitimi i shtratit të lumit Klina në Klinë; dhe
- 1.11. Rregullimi i shtratit të lumit Mirusha në Gjilan;

2. Minimizimi i ndotjes së ujërave

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, lidhur me trajtimin e ujërave të zeza parashihet që në fazën e parë të ndërtohen impiantet në qndrat e mëdha rajonale të Kosovës, për të vazhduar me fazën tjetër në qendrat tjera komunale. Aktualisht është në proces faza e parë sipas të cilës janë duke u realizuar projektet:

- 2.1. Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Prishtinës;

- 2.2.Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Pejës;
- 2.3.Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Gjilanit;
- 2.4.Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Gjakovës; dhe
- 2.5.Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Ferizajt;
- 2.6.Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Mitrovicës;
- 2.7.Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Prizrenit;
- 2.8.Investime (Qeveria Zvicerane) në fushën e trajtimit të ujërave në zonat rurale (në fazën e implementimit janë katër vendbanime: Orllan në Podujevë, Marmull në Gjakovë, Lokvicë në Prizren dhe Shallc në Vushtrri);

3. Mbrojtja nga dukuritë natyrore (vërshimet, erozioni, ndryshimet klimatike etj. përmes:

- 3.1.Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit Drini i Bardhë, Lumit Sitnica dhe Lumit Morava e Binçës;
- 3.2.Studimi i fizibilitetit për segmentet (zonat) në lumin Drini i Bardhë ku mund të nxjerrët rëra dhe zhavorri;

4. Studimi i fizibilitetit për zonat erozive;

5. Hartimi i kadastrit të ujërave (sipas UA SIU);

6. Zhvillimi i resurseve ujore (hulumtime dhe kërkime);

- 6.1.Hulumtimi i resurseve ujore nëntokësore në segmentin Sazali - Vushtrri;

7. Monitorimi i ujërave të lumenjve në Kosovë;

8. Monitorimi i vazhdueshëm i liqeneve akumuluese;

9. Ndërtimi i akumulacioneve ujore (Strategjia Shtetërore e Ujërave) sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Akumulimi	Lumi/rrjedha e ujit	Ujëmbledhësi Km2	Rrjedhja mesatare m3 / sekondë	Rrjedhja vjetore milion m3	Vëllimi
1	Drelaj	Pejë-Bistrica e Pejës	173.0	4.65	146.6	84.5
2	Kërstovc	Lumi i Binçës	118.0	3.20	101.0	40.0
3	Movë	Lumi i Klinës	239.0	1.20	37.8	34.0
4	Morinë	Llabenica	26.0	2.25	70.8	38.0
5	Ripaj	Lumi Trava	59.0	2.38	74.9	36.0
6	Reçan	Lumi Bistrica e Prizrenit	155.0	4.55	143.3	68.0
7	Dragaçin	Lumi Dragaçin	36.0	0.25	7.9	6.8
8	Kremenata	Lumi Kremenatë	56.0	0	15.9	8.8
9	Binçë	Lumi i Madhë	72.0	0.63	19.5	1.0
10	Shipashnice	Desivojce	77.6	0.63	19.9	14.9
11	Hogosht	Hogosht	48.5	0.42	13.2	9.9
12	Firajë	Lumi Lepenc	229.0	5.34	168.3	16.5
13	Shtime	Lumi Topillë	102.0	0.66	20.9	113.0
14	Cecelija	Lumi i Zi	47.0	0.41	12.9	21.0
15	Makovc	Lumi Prishtevka	26.0	0.19	6.0	10.0
16	Majanc	Lumi i Kançandollit	88.0	0.68	21.4	30.0
17	Vaganic	Lumi Lushta	46.0	0.23	7.2	8.0
18	Miraçë	Lumi Tërstena	31.0	0.20	6.3	6.0
19	Dobroshevcë	Lumi Drenica	35.0	1.38	43.4	23.2
20	Pollata	Lumi Llap	111.0	1.23	38.6	37.5
21	Bistrica	Lumi Bistricë e Prizrenit	159.0	1.40	44.2	25.0
Gjithsej			1934.1	31.88	1020	632.1

17. GURTHYESIT, LËNDËT MINERALE NDËRTIMORE DHE INDUSTRIALE

Territori i Kosovës është i pasur më lloje të ndryshme të lëndëve minerale jo metalore. Duke pas parasysh presionin aktual shumë të madh për ndërtim është i domosdoshëm një kalkulum i nevojave të Kosovës për lëndë minerale ndërtimore, në mënyrë që të mund të bëhet planifikimi i shfrytëzimit në nivel vendi. Aktualisht një kalkulum i tillë, sipas ekspertëve të sektorit përkatës është i vështirë, ngase ende:

- Ka zhvillim të aktiviteteve minerare të jashtë ligjshme;
- Mungojnë informacione për lëndët minerale ndërtimore të eksportuara apo importuara;
- Bartësit e licencave për shfrytëzimin e pasurisë minerare nuk raportojnë saktë për: tonazhin, vëllimin, përbërjen, shkallën dhe vlerën e mineraleve të prodhuara;
- Doganat e Kosovës nuk sigurojnë informacione të sakta për llojin e lëndëve minerale ndërtimore të eksportuara apo importuara;

Për të gjitha aktivitetet e identifikuar si veprime minerare të jashtë ligjshme, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) ¹³ ka hartuar dokumentin "Plani i Gurorëve të Kosovës dhe Planin e Menaxhimit të Resurseve", sipas të cilit janë eliminuar të gjitha zonat të cilat janë në konflikt me mjedisin dhe kufizimet e tjera ligjore. Në dokumentin në fjalë janë përcaktuar kushtet për zhvillimin e veprimtarisë duke mënjanuar konfliktet me rrugët, monumentet, vendbanimet, lumenjtë, liqenet, etj. (Harta Nr. 3).

Sipas KPM deri në vitin 2018

- **66 operatorë ilegal nëpër gjykata, prej të cilëve:**
 - 13 operatorë të gurit të fortë ndërtimor;
 - 15 operatorë të rërës dhe zhavorrit;
 - 35 operatorë të fabrikave të përpunimit;
 - 2 operatorë të thëngjillit dhe bitumenit;
- **186 leje dhe licenca në vitin 2017**
- **523 leje dhe licenca në vitin 2018;**
- **~ 11 ha janë rikultivuar dhe mbyllur;**
- **~ 270 ha pjesërisht të rikultivuara;**
- **~ 0.5 ha të pa rikultivuara.**

Çështja e gurëthyesve mbetet problem jo vetëm për Kosovën, po edhe në vendet rajonit që janë me të zhvilluara si: Mal i Zi, Kroaci, Serbi, Shqipëri, Maqedoni, etj. Çdo gurorë, pavarësisht nga teknologjia e punës dhe programi i prodhimit, paraqet një "plagë" në mjedisin natyror dhe jo vetëm në kuptimin estetik të peizazhit natyror, por edhe në tjetërsimin e sipërfaqeve të tokës, prishjen e vendbanimeve të florës dhe faunës, ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës nga pluhuri dhe vajrat e liruara gjatë nxjerrjes, klasifikimit, ngarkimit dhe transportit. Operimet e tilla të jashtëligjshme shkaktojnë humbje shumë të mëdha për Buxhetin e vendit, më pastaj kjo veprimtari shkakton konkurrencë jo të drejtë ndaj Ndërmarrjeve të Licencuara, të cilat i përmbushin të gjitha obligimet Ligjore, dhe po ashtu konsiderohen dëme financiare edhe përdorimi i materialeve jo cilësore në ndërtimin.

Puna në gurorë, pavarësisht të pajisjeve teknike dhe teknologjike, do të shkaktojë ndikime negative të caktuara mjedisore për të cilat është e nevojshme të parashikohen veprimet dhe masat mbrojtëse si në vazhdim:

Veprimet dhe rekomandimet që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes janë:

- Për planifikimin e zonave të resurseve minerale ndërtimore dhe industriale duhet të merren në konsideratë të gjitha licencat aktive, hulumtimet dhe aplikacionet që janë paraqitur për shfrytëzim dhe hulumtim në KPM;

¹³ KPM – Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale – është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. KPM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin e Minerave dhe Mineraleve, aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me Ligjin e Minerave dhe Mineraleve, dhe Strategjinë Minerare.

- Përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen është niveli qendror (HZKos), ndërsa niveli lokal (HZKom) do të bëjë vetëm bartjen e të dhënave nga niveli qendror;
- Niveli komunal do të shfrytëzoi të dhënat nga niveli qendror për shtrirjen hapësinore të pasurive minerare gjatë hartimit të PZHK, në mënyrë që të koordinojë dhe harmonizojë zhvillimet;
- Doganat e Kosovës të sigurojnë informacionet e sakta për sasinë dhe emërtimin e llojit të lëndës minerale ndërtimore të eksportuara apo importuara;
- Organet e drejtësisë - gjykatat të jenë më efikase në shqyrtimin e kallëzimeve penale të proceduara nga ana e KPMM- se;
- Marrja e vendimit me të cilën Policia e Kosovës obligohet që të kontrollojë transportuesit e lëndëve minerale për kontroll, për verifikimin e licencës valide si dhe sasisë që bartin;
- Inkurajimi dhe bashkërendimi me të gjitha institucionet tjera shtetërore për parandalimin dhe ndalimin e veprimtarisë joformale;
- Implementimi i vazhdueshëm i aktiviteteve që rrjedhin nga zbatim i Strategjisë minerare dhe Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale;
- Miratimi i Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Ndalimin e Operueseve të Pa-licencuar nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe/apo institucioneve tjera relevante;
- Duhet të sigurohet koordinim efikas ndërmjet mekanizmave shtetërore nivelit lokal dhe atë qendrorë, për të parandaluar plotësisht operimet ilegale (inspektoratet e komunave, MEA, Policia, Prokuroritë dhe Gjykatat e vendit, etj.).

18. ZONAT QYMYRBAJTËSE

Qymyri (Linjiti) është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon rreth 97% të prodhimit total të energjisë elektrike. Resurset e vlerësuara të qymyrit në gjithë Kosovën janë 12.5 miliardë tonë, ndërsa 8.6 miliardë tonë janë rezerva të shfrytëzueshme. Në Kosovë shfrytëzimi i xehes së linjtit është bërë vetëm në minierën e Basenit qymyrbajtës të Kosovës, dhe atë në shfrytëzim sipërfaqësor. (Harta Nr. 3 dhe 7).

“Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” që është e licencuar nga KPMM, është kompania e vetme, e cila bën shfrytëzimin e lëndëve minerale energjetike.

Vendburimet kryesore të qymyrbajtësve të Kosovës

- **Baseni qymyrbajtës i Kosovës**, me sipërfaqe rreth 850 km², ndërsa pjesa produktive zë një sipërfaqe rreth 300 km²;
- Mbi basenin e Kosovës shtrihen 68 vendbanime që i takojnë pesë komunave: Vushtrrisë, Obiliqit, Fushë Kosovës, Prishtinës, dhe Lipjanit, me sipërfaqe prej 35.65 km², ose 43.31 km² me brezin e sigurisë;
- **Baseni qymyrbajtës i Dukagjinit**, me sipërfaqe rreth 1.700 km²;
- Mbi vendburimin qymyror të basenit të Dukagjinit shtrihen 19 vendbanime që i takojnë Komunave të Istogut dhe Klinës, me një sipërfaqe 5.83 km².
- **Baseni qymyrbajtës i Drenicës** e karakterizojnë dy fusha: Fusha e Skenderajt në veri, me sipërfaqe rreth 3.97 km² dhe Fusha e Gllabarit-Glllogovcit në jug, me sipërfaqe prej 1.5 deri 2.0 km².

Resurset e vlerësuara të linjtit në gjithë Kosovën	
Basenet qymyrbajtëse	Rezervat (t) në miliardë
Fusha e Kosovës	10.2
Dukagjini	2.2
Drenica	0.1
Gjithsejtë:	12.5

Hapja si dhe avancimi i Minierave sipërfaqësore është një çështje shumë komplekse si në aspektin mjedisor ashtu edhe në atë social, duke filluar që nga degradimi i tokës, tek ndotja e mjedisit e deri tek problemet me vendbanimet në afërsi të mihjeve si dhe zhvendosja e komunitetit nga zonat e ardhshme të shfrytëzimit. Planifikimi i dobët për realizimin e shpronësimit të komunitetit sipas etapave të avancimit të mihjes, ka pasoja në pamundësinë e shfrytëzimit të qymyrit për furnizimin e termoelektranave. Një shembull i tillë ka ndodhur gjatë vitit 2017, ku është planifikuar largimi i masave të djerrinës në sasi prej 13 milion m³, ndërsa realizimi është bërë në sasinë prej afërsisht 4 milion m³ ose 30.2%, si pasojë e mos realizimit të shpronësimit. Prandaj është e nevojshme që të planifikohen veprimet dhe masat mbrojtëse si në vazhdim:

Veprimet që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes janë:

- Niveli qendror është përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e minierave sipërfaqësore në HZKos;
- Komunitatet të cilat kanë shtrirje të vendbanimeve mbi qymyrbajtësit e Kosovës, duhet të shfrytëzojnë të dhënat nga niveli qendror për shtrirjen hapësinore të këtyre resurseve gjatë hartimit të HZKom;
- Komunitatet që kanë shtrirje të vendbanimeve mbi qymyrbajtësit e Kosovës do të shfrytëzojnë të dhënat për vendndodhjen e këtyre resurseve në mënyrë që të koordinojnë dhe harmonizojnë zhvillimet;
- Resurset minerale si një pasuri e vendit, duhet të mbrohen dhe të mos bllokohen duke ngritur mbi to apo në afërsi të tyre objekte të ndryshme infrastrukturore apo të tjera;
- Forcimi i institucioneve mbikëqyrëse dhe inspektuese të aktivitetit minerar;
- Forcimi i institucioneve mbikëqyrëse dhe inspektuese për rikultivimin zonave të shfrytëzimit të minierave sipërfaqësore dhe deponive të hirit;
- Përcaktimi i metodologjive të mbylljes së aktivitetit minerar dhe monitorimit post minerar;
- Rehabilitimi i dëmeve mjedisore të bëra në të kaluarën;
- Plotësimi i legjislacionit për shpronësim të drejtë në zonat e destinuara për aktivitete minerare;

Zonat Qymyrbajtëse

Qymyri resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës!



19. ZONA USHTARAKE-SIGURISË

Sektori i Mbrojtjes është njëri nga hallkat kryesore të Republikës së Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë ushtarake multi-etnike, profesionale, e armatosur dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me kompetencat e dhëna kushtetuese dhe ligjore.

Detyrat e përgjithshme të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë: Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës; Mbështetja ushtarake autoriteteve civile; Pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës:

- Sipas ligjit FSK vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues dhe është e përberë me një komponentë aktive prej jo më shumë se pesë mijë (5000) pjesëtarë dhe nga një komponentë rezervë prej jo më shumë se tre mijë (3000) pjesëtarë;
- Struktura e FSK-se përbëhet nga Shtabi i Përgjithshëm, Komanda e Forcës Tokësore; Komanda e Gardës Kombëtare; Komanda e Logjistikës dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, e cila është e shpërndarë në disa lokacione në tërë territorin e Kosovës;
- Lokacionet ku është e vendosur FSK-ja, si dhe lokacionet ku parashihet që të ketë në pronësi, shfrytëzim/përdorim për deponimin e armëve, sistemit të armatimit, organizimin e trajnimeve dhe stërvitjeve, është më se e nevojshme të ketë lokacione të cilat duhet të kenë perimetër të sigurisë së veçantë;
- Këto lokacione dhe perimetri i caktuar i sigurisë janë më rëndësi jo vetëm për FSK-në, por edhe për mjedisin që i rrethon ato.

Bazat ushtarake dhe mjedisi përreth

Bazat ushtarake (Harta Nr.6) janë të vendosura në mjedise ku kushtet ndryshuese - urbanizimi, modelet klimatike, kushtet ekonomike, kufizimet rregullative, burimet e infrastrukturës, opinioni publik dhe kërcënimet rajonale ndaj stabilitetit, i bene këto baza (ZuS) më të ndjeshme për të përmbushur nevojat e misionit.

Bazat ushtarake ekzistojnë brenda një konteksti rajonal - ato ndajnë rrugët, pellgjet ujëmbledhëse, ekosistemet, zhurmat e ajrit, rrethet shkollore, deponimin e mbeturinave dhe shumë burime e procese të tjera me komunitetet e tyre përreth. Këto asete të përbashkëta shpesh janë të koordinuara mirë dhe të planifikuara, por natyra dinamike e kushteve në të dy anët e rrethojës kërkon ndërveprime të shpeshta.

Shumë nga bazat ushtarake nuk kanë pronësi të konsiderueshme të tokave të cilat mund të sigurojnë një tampon zone/zone të sigurisë ushtarake (ZsU) rreth hapësirave të ndjeshme ose të zhurmshme gjate realizimit të aktiviteteve, të tilla si poligone të qitjeve, pista të aeroporteve, depove të municioneve, apo mund të jenë kritike për stërvitjet reale, aftësinë e ushtrisë për të trajnuar realisht, shkallët e zjarrit, testimi i armëve dhe toka të tjera për aktivitete ushtarake intensive.

Qytetet, veçanërisht ato të mëdha, janë fushë e cikleve adaptive urbane. Në këto mjedise, peizazhi urban është në fluks të vazhdueshëm, me banorët e rinj që lëvizin në hapësira ekzistuese urbane, të tjerat shtyjnë kufirin e gjurmës urbane, inovatorët që mbushin boshllëqet dhe gjejnë mundësi për të ofruar shërbime të specializuara urbane - qoftë si zhvillues të pasurive të paluajtshme, shitësit ambulator, ose mbledhësit e plehrave.

Pavarësisht ritmit në rritje të ndryshimeve mjedisore, teknike dhe sociale kjo kërkon një kuptim të ri të misionit ushtarak dhe kulturës ushtarake dhe institucioneve qeveritare që qeverisin dhe formësojnë këtë kulturë.

ZsU është pjesë e përpjekjes së FSK-së për të kufizuar shkeljet dhe për të mbajtur një ekuilibër midis kërkesave të trajnimit ushtarak, dëshirave të komunitetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Zona e sigurisë ushtarake në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë duhet të kontribuojë në ruajtjen e mjedisit në këto aspekte:

- Në mbrojtjen e tokës bujqësore, të pyllëzuar, florës dha faunës, ndihmon në ruajtjen e zonave të rëndësishme ekologjike;
- Në mbrojtjen nga zhurma, nga pluhuri dhe tymi i krijuar nga trajnimet ushtarake në pronat në afërsi të ZsU-së;
- Për të ndikuar në një ambient më i sigurt, gjithashtu, siguron forca të gatshme për mision që mund të ndihmojnë në rast emergjencash të mëdha dhe fatkeqësive natyrore duke ofruar intervenim të shpejte në situata të ndryshme.



Fig. Bazë ushtarake me paraqitje te perimetrit te sigurisë (ZuS me ZsU)

III. KUSHTET PËR ZHVILLIM / NDËRTIM / DISPOZITAT PËR ZBATIM

Kushtet për zhvillim dhe ndërtim duke përfshirë edhe dispozitat për zbatim janë rregulla që duhet të merren në konsideratë gjatë zbatimit të veprimeve të planifikuara. Bazë për përcaktimin e tyre janë ligjet, udhëzimet administrative dhe normat teknike në fushën e planifikimit hapësinor. Kushtet për zhvillim dhe ndërtim të renditura më poshtë janë të ndara sipas zonave të trajtuara në dokument. Përgjegjës për zbatimin e këtyre kushteve janë të gjitha palët e përfshira në proces me theks të veçantë te institucionet udhëheqëse për zbatimin e aktivitetit përkatës. Pësha më e madhe e përgjegjësishë i takon autoriteteve kompetente komunale, të cilat janë të obliguara ti marrin në konsideratë duke i bartur ato në dokumentet relevante komunale.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

- Harta Zonale e Kosovës është dokumenti më i rëndësishëm i sektorit të planifikimit hapësinor qendror, me të cilën planifikohen dhe realizohen të gjitha zhvillimet hapësinore sektoriale;
- Përgjegjës për aprovim është qeveria e Kosovës ndërsa për miratimin përfundimtarë të sajë përgjegjës është Kuvendi i Kosovës;
- Përgjegjës për realizimin e Hartës Zonale të Kosovës është Qeveria e Kosovës me sektorët e saja përkatëse;
- Të gjitha dokumentet tjera të nivelit më të ulët duhet të jenë në përputhje me HZKom;
- Vlefshmëria e dokumentit është së paku 8 vite nga koha e aprovimit dhe miratimit të tij;
- Pas aprovimit të HZKos, të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme duhet të bëhen sipas procedurës së përcaktuar në UA Nr.10/2016.

KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME

- Bazë për përcaktimin dhe realizimin e zhvillimeve hapësinore në territorin e Kosovës është Harta Zonale e Kosovës (HZKos), ndërsa për territorin e komunave është Harta Zonale Komunale (HZKom);
- Zhvillimet e planifikuara nga niveli lokal duhet të jenë në përputhje me rekomandimet dhe veprimet e përcaktuara në dokumentet e nivelit qendror të planifikimit hapësinor, Planit Hapësinor të Kosovës dhe Hartës Zonale të Kosovës;
- Në varësi të përpjesës së hartës, niveli qendror i planifikimit hapësinor është përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të gjitha zonave të përcaktuara në udhëzimin administrativ përkatës, ndërsa niveli lokal, përpos bartjes së këtyre të dhënave në HZKom, janë të obliguar të trajtojnë, të interpretojnë dhe të paraqesin edhe detaje tjera të karakterit lokal;
- Zhvillimet e planifikuara hapësinore duhet të jenë në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor duke përfshirë normat dhe standardet e mbrojtjes së mjedisit dhe normat në fuqi për mbrojtjen dhe trajtimin e trashëgimisë kulturore;
- Ndërtimet/zhvillimet e ardhshme duhet të jenë të koncentruar, me dendësi të ndërtimit të përshtatshme dhe në harmoni me normat teknike të planifikimit hapësinor;
- Përveç objekteve që janë në shërbim të saj, të gjitha ndërtimet/zhvillimet në tokën kualitative bujqësore (kat.1-4) janë të ndaluara. Në kuadër të këtyre zonave mund të parashihen vetëm shfrytëzime dytësore me karakter të përkohshëm;
- Të gjitha tokat, ndërtesat ose strukturat mund të shfrytëzohen nëse është e lejuar, nëse është shfrytëzim dytësor, nëse është shfrytëzim i lejuar i veçantë ose është i cilësuar si shfrytëzim i përkohshëm;
- Të gjitha shfrytëzimet ose ndërtimet dytësore duhet të zhvillohen në përputhje me rregullat e mëposhtme:

- Asnjë shfrytëzim ose ndërtim dytësor nuk duhet të ndodhë para shfrytëzimit ose ndërtimit të strukturës kryesore të cilës i shërben ose ndaj të cilës është vartës shfrytëzimi në fjalë.
- Asnjë shfrytëzim ose ndërtim dytësor nuk do të vazhdojë të ekzistojë pasi shfrytëzimi, ndërtesa apo struktura kryesore të cilës i shërben ose ndaj të cilës është vartëse të kenë pushuar së ekzistuari.
- Sipërfaqja e tokës apo ndërtesave të shfrytëzuara si dytësore në një parcelë kadastrale nuk duhet të tejkalojë sipërfaqen e tokës apo ndërtesës së shfrytëzimit kryesor në të njëjtën parcelë kadastrale.
- Ndryshimi i shfrytëzimit të lejuar të tokës mund të bëhet vetëm duke qenë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe nuk mund të ketë ndryshim i cili shkon në dëm të mjedisit dhe shëndetit të popullatës.
- Ndërtimet e përhershme nuk mund të zhvillohen apo të vendosen në parcelë, pa qasje nga parcela kadastrale në rrugë dhe në shërbimet e nevojshme publike;
- Raporti në mes hapësirës së shfrytëzuar dhe hapësirës së lirë në të gjitha zonat duhet të jetë në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor;
- Në kuadër të zonimit lokal pjesë e domosdoshme e hartave zonale komunale duhet të jenë zonat urbane dhe zonat rurale me kufijtë e tyre të qartë;
- Të gjitha ndërtimet/zhvillimet që kanë ndikim negativ në mjedisin jetësor duhet ta kenë hapësirën e nevojshme dhe të parashihen masat dhe veprimet që do të minimizojnë ndikimin e tyre në shfrytëzimet përreth.
- Zonat e ndërtimit nuk mund të shtrihen në tokat ku janë identifikuar faktorët e mëposhtëm kufizues:
 - Kushtet e pafavorshme të jetesës për shkak të mikroklimës;
 - Rrëshqitjet e dheut;
 - Fushat e eksploatimit;
 - Tokat me aftësi të pamjaftueshëm mbajtëse;
 - Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
 - Tokat me rezerva të larta të ujit nëntokësor;
 - Tokat e përmbytura;
 - Pyjet dhe tokat pyjore;
 - Tokat bujqësore të kategorisë 1-4 të kultivuara intensivisht;
 - Tokat e përdorur ose të destinuar për veprimtari të veçanta;
 - Zonat e ndotura nga aktivitete të caktuara ekonomike;
 - Zonat e mbrojtura;
 - Tokë e pjerrët, pjerrësia e së cilës tejkalon raportin 1: 1.5 (66.67% ose 340).

Kushtet për formësim arkitektonik

Kushtet zhvillimore të përgjithshme lidhur me formësimin arkitektonik do të zbatohen te ndërtimet e reja, duke përfshirë shtesat në ndërtimet ekzistuese, si dhe për riparimin ose rehabilitimin thelbësor të fasadave të jashtme të ndërtesave ekzistuese. Në rast riparimi ose rehabilitimi, zbatohen vetëm ato kushte që lidhen me aktivitetet specifike të riparimit ose rehabilitimit të kryer.

Rregullat e mëposhtme janë rregulla themelore të cilat do të sigurojnë një imazh më të rregulluar të zonave urbane duke bërë përpjekje që format arkitektonike të objekteve, materialet dhe ngjyrat e përdorura të krijojnë një njësi unike estetike dhe vizuale brenda parcelës ndërtimore, rrugës dhe bllokut. Nga aspekti arkitektonik, formësimi arkitektonik i objekteve të reja duhet bazuar në parimet e arkitekturës bashkëkohore duke respektuar traditën e ndërtimit në zonë. Objektet duhet ti përshtaten kontekstit në të cilin do të vendosen dhe shfrytëzimit të planifikuar, duke i aplikuar rregullat për formësim arkitektonik si:

- Çdo ndërtim i ri duhet të përshtatet me stilin dominues të zonës (rrugës, sheshit, bllokut, lagjes, etj.).

- Gjatë mbindërtimit ose adaptimit të ndërtesave ekzistuese, kërkohet që të gjitha pjesët dhe elementet e reja të bëhen në stilin arkitektonik të ndërtesës ekzistuese (format, materialet, ngjyrat);
- Ndërtesat në varg dhe ato dyshe duhet të jenë të harmonizuara në aspekt të formësimit arkitektonik;
- Formësimi i ndërtesës duhet të shfaqë përdorim të qëndrueshëm të ngjyrave, materialeve dhe detajeve në tërë fasadën e ndërtesës; Ndërtesat dytësore duhet të jenë konsistente me formësimin arkitektonik të jashtëm të atyre primare;
- Nga pikëpamja estetike, shmangja nga monotonia dhe arritja e fasadave cilësore duhet të bëhet përmes elementeve arkitektonike, shtyllave, trarëve, raportit të duhur të hapjeve dhe mbylljeve, duke iu shmangur përdorimit të dekorimeve të formave të ndryshme;
- Gjatë përmirësimit dhe rekonstruimit të ndërtesave, vëllimi i tyre në raport me ndërtesat ekzistuese fqinje, këmbësorët ose me ndërtesat e tjera ekzistuese do të ruhet ose përmirësohet. Zgjidhja burimore e fasadave në aspektin arkitektonik dhe ngjyrave të përdorura rekomandohet të ruhet, duke shmangur vendosjen e ngjyrave dhe elementeve dekoruese të cilat nuk kanë ekzistuar në fasadën origjinale;
- Veshja e fasadave duhet të bëhet me materiale kualitative, të qëndrueshme dhe që mirëmbahen lehtë;
- Përzgjedhja e materialeve dhe ngjyrave gjatë formësimit arkitektonik të fasadave të ndërtesave duhet të bazohet në materialin mbizotërues të përdorur tashmë në ndërtesat ekzistuese të zonës. Asnjë ndërtesë ose shtesë e një ndërtese nuk lejohet kur ndonjë fasadë e ekspozuar është e trajtuar me një material i cili është estetikisht i papajtueshëm me fasadat e tjera të ndërtesave në zonë;
- Përzgjedhja e ngjyrave për fasadat e ndërtesave ka një ndikim të rëndësishëm estetik dhe vizual në pronat fqinje prandaj ngjyrat duhet të zgjidhen në harmoni të përgjithshme me ato të ndërtesave ekzistuese të lagjes. Preferohen ngjyrat natyrore ose nuancat e dheut, në tone të buta, neutrale me reflektim të ulët. Nuk lejohen ngjyrat neon, fluorescente, reflektuese apo ngjyrat e forta;
- Materiali për mbulimin e kulmit duhet të jetë në përputhje me stilin arkitektonik të ndërtesës dhe ndërtesat përreth dhe i përshtatshëm për kushtet lokale të mjedisit. Përdorimi i materialeve që shkaktajnë shkëlqim verbues janë të ndaluara, me përjashtim të paneleve solare të cilat kanë për qëllim emetimin e energjisë diellore të absorbuar ose të pa-reflektuar duke zvogëluar akumulimin e nxehtësisë në ndërtesë;
- Të gjitha pajisjet mekanike, të montuara në kulm ose tokë, aq sa është e mundur, duhet të jenë sa më pak të dukshme. Matësit dhe pajisjet tjera të shërbimeve publike, pajisjet e ngrohjes, ajrit të kondicionuar dhe ventilimit duhet të vendosen në atë mënyrë që të mos e prishin pamjen estetike të fasadave ose në vende që nuk janë të dukshme nga rruga publike;

Kushtet për efikasitet të energjisë

Autoritetet përgjegjës për planifikim duhet të sigurojë që objektet e reja si dhe ato që rinovohen apo rindërtohen, të plotësojnë kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave të përcaktuara me Rregulloren për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave (04/18) në fuqi dhe planeve lokale për efikasitet të energjisë.

Përmirësimi i performancës energjetike nënkupton zvogëlimin e konsumit dhe kursimin e energjisë, e cila përdoret në ndërtesa për të plotësuar nevojat që lidhen me shfrytëzimin e objektit (ngrohja, uji i ngrohtë sanitar, ftohja, ventilimi dhe ndriçimi), përmes aplikimit të masave teknike, standardeve të planifikimit dhe projektimit të ndërtesave, kushteve të ndërtimit dhe përdorimit të tyre.

Çdo ndërtesë, varësisht nga lloji dhe përdorimi, duhet të projektohet, ndërtohet, dhe mirëmbahet në pajtueshmëri me performancën energjetike të përcaktuar, duke përfshirë në mënyrë të integruar të gjitha elementet që ndikojnë në kërkesat për energji dhe qëndrueshmërinë e ndërtesës si:

- Faktorët klimatik / ndikimi i lokacionit (diellosja, era, gjelbërimi, uji);
- Faktorët arkitektonik / të ndërtimit: forma e objektit dhe orientimi i tij; fasadat (hapjet dhe muret e plota, kulmet); materialet ndërtimore të përdorura;

- Sistemet e instalimeve dhe pajisjeve për ngrohje, ftohje, klimatizim dhe ndriçim.

Masat për efikasitet të energjisë në ndërtesa përfshijnë:

- Zbatimin e sistemeve solare pasive (shfrytëzimi maksimal i energjisë diellore për ngrohjen e ndërtesës, ngrohjen e ujit sanitar); përdorimi i burimeve të dritës LED për ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm;
- Orientimin e ndërtesave në drejtim të jugut, respektivisht lindjes dhe koncentrimi i hapjeve në këto anë, dhe zvogëlimi maksimal i dritareve në fasadën veriore për zvogëlimin e humbjes së nxehtësisë; ventilimi natyror; formimi mbështjellës efikas të ndërtesës (izolimi termik i mureve, dyshemeve, kulmit), etj.;
- Përdorimin e sistemeve efikase të ngrohjes dhe klimatizimit;

Masat e mësipërme por edhe masat tjera të parapara me dokumente përkatëse janë të obligueshme për të gjithë sektorët e nivelit lokal dhe qendror të qeverisjes.

Kushtet për mbrojtje nga zjarri

Organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtim, rekonstruim mund të jep lejen për ndërtim vetëm atëherë kur të sigurojë se projekti kryesor për ndërtim në bazë të cilit jepet leja e ndërtimit, ka paraparë përmbushjen e kushteve të posaçme të ndërtimit, me qëllim të mbrojtjes nga zjarri, siç është përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji.

Leja e përdorimit të objektit apo objekteve të ndërtuara dhe rekonstruata, jepet atëherë kur vërtetohet se janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zjarri të parapara në projektin kryesor të ndërtimit.

Për të siguruar mbrojtjen nga zjarri duhet të respektohen rregullat e mëposhtme:

- Sigurimi i rripave/brezave të sigurisë në zonat e caktuara me qëllim të ndalimit të përhapjes së zjarrit;
- Sigurimi i largësisë optimale të ndërtesave të banimit dhe hapësirave publike nga zonat industriale dhe prodhuese;
- Sigurimi i distancës së mjaftueshme ndërmjet ndërtesave fqinje për të mundësuar qasje direkte të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe atyre të emergjencës, në të paktën dy anë të ndërtesës;
- Sigurimi i detyrueshëm i rrugëve për qasje/nënkalimeve për automjetet e zjarrfikësve për secilën ndërtesë;
- Gjatë projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave të respektohen rregulloret në fuqi të mbrojtjes nga zjarri;
- Gjatë projektimit dhe ndërtimit të objekteve të banimit kolektiv, objekteve publike, qendrave tregtare, hoteleve, kinemave, teatrove, bibliotekave, postave, spitaleve, hallave sportive, sallave koncertale si dhe objekteve tjera publike, duhet të sigurohen kushtet për evakuim të papengueshëm të njerëzve në rast të shpërthimit të zjarrit me ndërtimin e shkallëve për evakuim si dhe me pajisjet përkatëse për alarm dhe fikje të zjarrit;
- Vendosja e ndërtesave në raport me ndërtesat fqinje bëhet sipas distancave të përcaktuara për të zvogëluar rrezikun e përhapjes së zjarrit;
- Të gjitha ndërtesat dyshe ose në varg, duhet të ndahen nga njëra-tjetra me mur nga materiali me karakteristika rezistuese ndaj zjarrit, i cili nuk duhet të zgjatet mbi sipërfaqen e kulmit;
- Të gjitha ndërtesat duhet të ndërtohen me material të fortë ndërtimi, në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret dhe standardet e mbrojtjes nga zjarri;
- Nëse përdoret druri, atëherë duhet të mbrohet nga një shtresë e cila siguron që i plotësohen kushtet themelore të mbrojtjes nga zjarri, dhe ndërtesat duhet të jenë në distanca të përcaktuara;
- Punët përfundimtare të sipërfaqeve vertikale dhe horizontale të daljeve dhe rrugëve dalëse në objekte, duhet të jenë të ndërtuara nga materiali me karakteristika rezistuese ndaj zjarrit;

- Në kuadër të rrjetit të ujësjellësit të realizohet rrjeti i hidrantëve kundër zjarrit, dhe të hidrantëve në ndërtesa sipas rregullave, në veçanti për ndërtesat prodhuese në zonat ekonomike;
- Ruajtja e materialeve lehtë të ndezshme dhe eksplozive duhet të bëhet në kushtet e përcaktuara me ligj me miratimin e duhur të autoriteteve kompetente për masat e planifikuara të mbrojtjes nga zjarri;

KUSHTET ZHVILLIMORE SPECIFIKE

1. MBULUESHMËRIA E TOKËS PËR KOSOVËN (CLC2018)¹⁴

Harta e mbulueshmërisë së tokës për Kosovën (Harta Nr. 1.) është një inventar i mbulueshmërisë dhe shfrytëzimit të tokës i punuar sipas rregullave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit dhe programit Copernicus. CLC përdor një nomenklaturë të zbërthyer në 44 klasa dhe ka njësinë minimale të hartografimit (NMH) prej 25ha për fenomenet e zonës dhe një gjerësi minimale prej 100m për fenomenet lineare. Seritë kohore të CLC-së plotësohen me shtresa ndryshimi të cilat theksojnë ndryshimet në mbulimin e tokës me një NMH prej 5ha. CLC përfshinë një larmi aplikimesh, duke mbështetur politika të ndryshme të komunitetit në fushat, si: mjedisi, bujqësia, transporti, planifikim hapësinor etj.

Duke qenë seti i informatave më i azhurnuar në Republikën e Kosovës, harta e CLC 2018 është përdorur si bazë e rëndësishme për definimin e të gjitha zonave dhe zhvillimeve tjera në Hartën Zonale të Kosovës 2020-2028.

2. PËRPIJESA DHE GRIDI I ZONIMIT

Gridi i Zonimit (GZ) është një rrjet i qelizave katërkëndëshe me madhësi të barabartë, i cili mundëson që në një format standard të fletës të prezantohen Hartat Zonale në shkallë të standardizuar. Sipas këtij standardizimi, të gjitha Hartat Zonale duke përfshirë nivelin qendror dhe lokal, do të punohen në formatin e fletës A1 të shtrirë (landscape), me përpjesë P=1:25.000 për Hartën Zonale të Kosovës dhe P=1:5.000 për Hartën Zonale të Komunës.

Sipërfaqja e një njësie të GZ-së në natyrë për nivelin qendror është 20,968.75ha, ndërsa sipërfaqja e njësisë për nivelin lokal është 838.75ha.

Përdorimi i GZ-së është i obligueshëm dhe të dhënat për GZ-në mund të sigurohen nga Ministria përkatësisht Instituti për Planifikim Hapësinor.

3. ZONAT E VEÇANTA

3.1. Zonat ekzistuese

Në kuadër të këtyre zonave përfshihen të gjitha zonat që janë identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe në Hartën Zonale të Kosovës. Përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e tyre është niveli qendror përkatësisht Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Ndërsa, niveli i komunave përkatësisht drejtoritë e tyre bëjnë vetëm bartjen e të dhënave në dokumentet e tyre përkatëse (HZKom).

3.1.1 PARKU KOMBËTAR “BJESHKËT E NEMUNA”

Kushtet e zhvillimit dhe dispozitat për zbatim për zonën e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” duhet të përcaktohen me plan hapësinor përkatës.

¹⁴ Harta e punuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Drafti i Planit Hapësinor për PK “Bjeshkët e Nemuna” me dokumentet tjera përcjellëse është i gatshëm dhe shumë shpejtë do të futet në proces të aprovimit. Jemi të sigurt se dokumenti në fjalë i përmbushë të gjitha kriteret dhe kërkesat sipas rregullave në fuqi dhe si i tillë do të ndikojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrueshëm hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

3.1.2 MONUMENTI I NATYRËS “UJËVARAT E MIRUSHËS”

- Territori i përgjithshëm i zonës së Monumentit të Natyrës “Ujëvarat e Mirushës” mbulon sipërfaqen prej 598.4 ha, në të cilën përfshihet komuna e Klinës (me sip. prej 380.07 ha), Malishevës (me sip. prej 208.86 ha) dhe Rahovecit (me sip. prej 9.47 ha);
- Veprimtaritë ekonomike duhet të vendosen në zonën e kategorizuar në bazë të Ligjit për mbrojtjen e natyrës si: Zona e tretë e mbrojtjes;
- Zona e tretë e mbrojtjes është e shtrirë në tri zona: Zona e parë e zhvillimit (ZZH1); Zona e dytë e zhvillimit (ZZH2); dhe Zona e tretë e zhvillimit (ZZH3);
- Të gjitha objektet ekzistuese në kuadër të zonës së tretë të mbrojtjes duhet ti nënshtrohen një regjistrimi dhe incizimi detaj të situatës, për të cilën duhet të jetë autoriteti përgjegjës i komunës përkatëse në territorin e të cilave ndodhen objektet ekzistuese;
- Të gjitha zhvillimet e ardhshme duhet të jenë në përputhje me rekomandimet e Planit Hapësinor të MNUM;
- Sipas rregullave në fuqi, në mungesë të planeve rregulluese urbane, pronarët e objekteve dhe hapësirave të parapara për zhvillim mund të propozojnë zgjidhjet urbane në nivel të planit rregullues urban për objektin/hapësirën e vet, duke e përfshirë edhe territorin përreth në rreze prej 50 metrave;
- Zgjidhja urbane e objektit/hapësirës duhet të jetë në përputhje me rekomandimet që dalin nga Plani Hapësinor për MN “UM”;
- Zgjidhja e propozuar urbane e objektit/hapësirës, paraprakisht duhet të merr pëlqimin në MEA dhe të aprovohet përfundimisht nga autoritetet e komunës përkatëse;
- Zgjidhja urbane e aprovuar nga autoritetet përkatëse komunale është bazë e vetme për lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit të objekteve/hapësirave në kuadër të zonës në përgjithësi;
- **Simboli i zonës** (Logo mbrojtëse) – me sipërfaqe rreth 4m² i dizajnuar me elemente karakteristike të zonës do të jetë pjesë përbërëse e hyrjeve kryesore në zonë. Me qëllim të informimit, simbolet e njëjta me përmasa me të vogla (sipas standardeve) duhet të vendosen në çdo 5 km në të gjitha rrugët magjistrale që të qojnë në drejtim të MN “Ujëvarat e Mirushës”. Përgjegjës për formën dhe përmbajtjen e simbolit, do të jetë autoriteti përgjegjës i zonës;
- Detajet tjera për kushtet e kësaj zone gjenden në PHMN “Ujëvara e Mirushës”;

3.1.3 PARKU KOMBËTAR “MALI SHARRI”

Me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar „Sharri“ (në tekstin e mëtejshëm: Plani) definohen: caqet e rregullimit (planifikimit) të territorit (hapësirës), organizimi dhe destinimi i hapësirës (territorit), kushtet dhe masat e shfrytëzimit, rregullimit dhe mbrojtjes së parkut.

- Plani Hapësinor për PK „Sharri“ mbulon periudhën kohore prej minimum dhjetë viteve nga aprovimi përfundimtarë në Kuvendin e Kosovës
- Rishikimi i Planit bëhet në çdo pesë vjet por mund të bëhet edhe në bazë të kërkesave për ndryshime në terren.
- Përgjegjës për revidimin e Planit është Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.
- Plani është përpunuar në pajtim me konventat dhe parimet ndërkombëtare për planifikim dhe mbrojtje të mjedisit.

- Plani është përpunuar në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Mbrojtje të Natyrës.
- Me dispozitat për zbatim të planit definohe mënyra e rregullimit dhe destinimit të hapësirës dhe regjimit të mbrojtjes, ndërtimit dhe rregullimit në territorin (sipërfaqen) e parkut.
- Në pajtim me ligjet në fuqi, kushtet dhe kriteret e ndërtimit dhe shfrytëzimit të parcelave që ndodhen brenda zonës së tretë të parkut mund të përcaktohen edhe në kuadër të procesit të partneritetit publiko privat për ndërtimin dhe zhvillimin e qendrave turistike në zonën e tretë.
- Të gjitha planet tjera të niveleve më të ultë me ndikim në territorin e parkut, i nënshtrohen Planit Hapësinor për PK „Sharri“;

Sipas planit territori i parkut ndahet në:

- **Zona e parë e mbrojtjes** - Zona e mbrojtjes strikte, në strukturën e saj krejtësisht natyrore (llojlojshmëria biologjike, gjeomorfologjike dhe speleologjike) përfshinë rezervatet strikte dhe zonat me vlera të veçanta si dhe merr 9363.51 ha (17.5 %) të territorit të parkut;
- **Zona e dytë e mbrojtjes** - Zona e menaxhimit aktiv, paraqet zonën me shtrirje më të madhe territoriale me 40311.9 ha (75.4%), e cila kryesisht është e dedikuar për shfrytëzim të kujdesshëm të hapësirës dhe vlerave ekzistuese;
- **Zona e tretë e mbrojtjes** - Zona e shfrytëzimit të qëndrueshëm, është zonë e cila në aspektin territorial me 3769.81 ha (7.1%) paraqet zonën me sipërfaqe më të vogël, ku aktivitetet janë më të lirshme por gjithnjë të bazuar në shfrytëzim të qëndrueshëm.
- Detajet tjera të kushteve e kësaj zone gjenden në PHPK “Mali Sharr”.

3.1.4 ZONA E MBROJTUR DHE ME INTERES TË VEÇANTË “BETEJA E KOSHARES”

- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Planit Hapësinor për Zonën e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë “Beteja e Koshares”.
- Zona e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë ku është zhvilluar “Beteja e Koshares” nga Brigada 138 Agim Ramadani, e emërtuar edhe si Memoriali i Koshares, përfshinë sipërfaqe prej 2488 hektarëve që i përkasin pronësisë private dhe publike (ish shoqërore) në territorin e Komunës së Gjakovës.
- Në zonën e Memorialit të Koshares, nuk duhet të shpronësohen të gjitha pronat private, përveç atyre në bërthamë (zonë qendrore) me rreth 10 ha në Log të Koshares (Oplaz) brenda së cilës janë Varrezat ekzistuese të Dëshmorëve nga Brigada 138.
- Autoritetet përkatëse janë përgjegjëse për realizimin e inventarizimit, vlerësimit të paluajtshmërisë dhe të vendimeve për shpronësimin e pronave që janë këtë zonë.
- Zona e bërthamës në qendër të Memorialit të Koshares, është rezervuar për ngritjen e Elementeve të Kompleksit të Memorialit, në të cilën pas shpronësimit komplet dhe ndërrimit të titullarit të pronës (nga prona private në atë publike) mund të zbatohet Plani Rregullues Urban i hartuar paraprakisht.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht MEA-ja, merr përgjegjësitë për hartimin dhe zbatimin e PRRU-së (Planit Rregullues Urban).
- Detajet tjera për kushtet e kësaj zone gjenden në PHZIV “Beteja e Koshares”.

3.1.5 ZONA ME INTERES TË VEÇANTË „SHP.UÇK. KLEÇKË DHE DIVJAKË”

- Plani Hapësinor i për Zonën me Interes të Veçantë „SHP.UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” është dokumenti kryesor për rregullimin dhe zhvillimin hapësinor të zonës;
- Dokumenti i PH ZIV „SHP.UÇK. Kleçkë dhe Divjakë” mbulon periudhën prej së paku dhjetë vitesh, duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi.

- Të gjitha komunat të cilave përfshihen në këtë zonë, janë të obliguara që planet e veta përkatëse ti harmonizojnë me rekomandimet dhe dispozitat që parashihen me këtë Plan;
- Plani Hapësinorë për Zonën me interes të veçantë „SHP.UÇK. Kleçkë-Divjakë” Përcakton saktë kufijtë e zonave që duhet të kalojnë procesin për shpronësim të përcaktuara me Planin Rregullues urban për Zonën .
- Shpronësimi kryhet konform Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme . Me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010.
- Zonat për shpronësim janë përcaktuar me Plan Hapësinorë:
 - Zona 1 – Shtëpia muze e “Radio Kosova e lirë” 0.23Ha dhe Agjencia e lajmeve “Kosova Press” 0.20Ha;
 - Zona 2 – Selia e Përkohshme e Qeverisë së Kosovës 0.68Ha;
 - Zona 3 – Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe spitali ushtarak 81.84Ha;
 - Zona 4 – Lapidari dhe varrezat e dëshmorëve 1.54Ha;
 - Zona 5 – Shtabi i Brigadës 121; 1.85Ha;
 - Zona 6 – Fshati i UÇK-së; 5.0Ha;
 - Zona 7 – Selia e Shtabit të Komandant Kumanovës. 0.44Ha;
- Rishikimi dhe Revidimi eventual i dokumentit duhet të bëhet në periudhën prej pesë vitesh. Në raste të veçanta revidimi mund të bëhet edhe sipas nevojës;
- Detajet tjera për kushtet zhvillimore dhe ndërtimore gjinden në dokumentin e Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë „SHP.UÇK. Kleçkë dhe Divjakë”;

3.1.6 ZIV “FUSHA E MIHJES SË RE”

- Hapësira brenda kufirit evidentues të zonës me interes të veçantë ekonomik ka sipërfaqe prej 14.986 Ha (hektarëve);
- Hapësira brenda kufijve të mihjes së re në kuadër të basenit të Kosovës duhet ruajtur ekskluzivisht për aktivitetet minerare;
- Hapja e minierës së re duhet të zhvillohet në mënyrë graduale duke shpalosur linjitet e në të njëjtën kohë duke mbuluar hapësirat e shfrytëzuara;
- Në vendbanimet që duhet të zhvendosen, sipas avancimit të zhvillimeve bazuar në Planin Kryesor Minerar, autoritetet komunale marrin vendim mbi ndalimin e ndërtimeve të reja pas inventarizimit të pasurisë së paluajtshme;
- Ndërtimet e objekteve të reja të banimit, në periudhën pas marrjes së vendimit nga autoritetet komunale mbi ndalimin e ndërtimit të tyre deri para fillimit të procesit të zhvendosjes, konsiderohen ndërtime ilegale dhe nuk kompensohet;
- Sipërfaqet e tokës së rregulluara, pas kryerjes së rehabilitimit të zonave të degraduar, kalojnë në pronësi të komunës për rikultivim dhe shfrytëzim të mëtejshëm si resurs bujqësor;
- Për shkak të potencialit rrëshqitës të tokës në këtë zonë edhe pas procesit të rikthimit të tokave, nuk parashihet krijimi i vendbanimeve të reja mbi këto sipërfaqe si dhe mbi gropat e minierave Bardh, Mirash dhe Sitnicë pas mbushjes dhe rikthimit të tyre në hapësira të rrafshëta;
- Në bashkëpunim me Komunat përcaktohet lokacioni i përshtatshëm për zhvendosjen dhe rivendosjen e popullsisë;
- Në bashkëpunim me Komunën dhe në konsultim me Komunitetin caktohet lokacioni për zhvendosje - rivendosje të varrezave;

- Bashkë me institucionet përkatëse për trashëgimi kulturore dhe historike përkujdesen ndaj trashëgimisë kulturore në përgjithësi.
- Trajton problemet e trashëguara mjedisore dhe ato ekzistuese nga veprimtaritë e KEK sh.a. (Deponitë e hirit, e palosjeve të jashtme të djerrinës, etj.).
- Aprovon dhe mbikëqyr zbatimin e të gjitha Planeve të hartuara nga Investitori Privat të cilat kërkohen dhe në bazë të kontratës;
- Organi Shpronësues në kuadër të MEA-së bën aprovimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit për Zhvendosje;
- MEA është përgjegjëse për ofrimin e kushteve urbanistike për Planin Rregullues të Hollësishëm të Kompleksit TC “Kosova e Re”;
- MEA jep pëlqimin mjedisor dhe urbanistik për zonën me interes të veçantë ekonomik “FMR”.
- Institucionet e nivelit lokal, Komunat: Obiliq, Fushe Kosove, Vushtrri dhe Drenas do të bëjnë koordinimin e menaxhimit të pjesëve të caktuar brenda Zonës me interes të veçantë FMR;
- Planet zhvillimore komunale (PZHK) të komunave pjesëmarrëse Obiliq, Fushe Kosove, Drenas dhe Vushtrri duhet të harmonizohen me këtë Plan;
- Zgjerimi i vendbanimeve në përputhje me PZHK, HZKom, PRrH dhe PH të TZHEK-ut për komunat pjesëmarrëse në FMR (Obiliq, Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Drenas);
- Qeveria lokale harton dhe miraton Planet Rregulluese të hollësishme;
- Qeveria lokale, pas marrjes së pëlqimeve nga MEA, miraton Planin Rregullues të hollësishëm për Kompleksin e TC “Kosova e Re”;
- Drejtoritë Komunale për Urbanizëm, gjatë hartimit të planeve rregulluese të hollësishme, duhet orientuar zhvillimet në densifikim apo zgjerim të vendbanimit (për ato që nuk zhvendosen) në zonën e FMR-se, varësisht nga ndikimi i ndotjes nën drejtimin e erërave dhe me largësitë minimale prej 1 km’ nga TC-të si dhe 200 m’ nga zona e mihjes dhe shiritat transportues;
- Siguria në komunikacion (sinjalizimi, mbrojtëset rrugore);
- Ndalimi i qarkullimit të mjeteve transportuese në rrugët lokale të vendbanimeve;
- Sigurimi i minierës me rrethoja për të parandaluar rrezikun;
- Detajet tjera për kushtet e zonës gjenden në PHZIV “Fusha e Mihjes së Re”.

3.2. Zonat e reja – procedura e shpalljes

Zonat e veçanta, në kuptim të ligjit nr. 04/l-174 neni 14, janë zona me interes të përgjithshëm për vendin për shkak të: resurseve zhvillimore; për shkak se janë të identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës (PHK) dhe Hartën Zonale të Kosovës (HZKos); si dhe zonat e reja që mund të shpallen me vendim të posaçëm nga Qeveria e Republikës së Kosovës;

1. Zonat e Veçanta përfshijnë parqet kombëtare dhe zonat tjera me vlera unike natyrore, ekonomike, minerare, bujqësore dhe të trashëgimisë kulturore – historike;
2. Hartimi i Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë në kuptim të ligjit nr. 04/l-174 neni 14 aplikohet për të gjitha zonat të cilat shpallen me vendim nga Qeveria e Kosovës, dhe nëse zonat e veçanta janë të përcaktuara në PHK dhe HZKos;
3. Zona e veçantë për të cilën duhet të hartohet Plani Hapësinor për Zonë të Veçantë duhet ti përmbushë të paktën këto kritere:
 - Sipërfaqja e zonës nuk mund të jetë më e vogël ose baras me (\leq) 1.000 ha. Zonat me madhësi tjetër të sipërfaqes do të trajtohen me dokumente tjera;

- Diversitet i lartë i shfrytëzueshmërisë së tokës. Përfshirje sa më e madhe e shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës e bazuar në resurset ekonomike natyrore dhe të zhvillimeve të trashëguara sipërfaqësore dhe nëntokësore);
 - Diversitet i lartë i aktiviteteve që ndërlidhen përmes sektorëve social, ekonomik, mjedisor duke përfshirë infrastrukturën, shërbimet teknike, sociale, publike dhe kulturore;
 - Diversitet i lartë i interesave të përbashkëta;
 - Interes i lartë i përfshirjes së kapaciteteve të investimeve financiare, duke përfshirë burimet buxhetore vendore dhe të huaja nga të dy sektorët publik dhe privat;
4. Zonat që nuk përshtaten me kriteret e mësipërme duhet të trajtohen me plane tjera sektoriale;
 5. Institucioni përgjegjës për koordinimin e procesit të hartimit të Planit Hapësinor për një Zonë të Veçantë, është Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), përkatësisht Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH);
 6. Institucioni përgjegjës për aprovimin e draftit përfundimtar të Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë bashkë me Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor dhe Raportin nga Shqyrtimi Publik është Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila është gjithashtu përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit në fjalë;
 7. Plani Hapësinor për Zonë të Veçantë, hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe publikimit të tij në Gazetën Zyrtare;

Planet Rregulluese të Hollësishme në Zonat e Veçanta

1. Përmbajtja dhe përgatitja bëhet sipas dispozitave të përcaktuara me UA Nr. 01/18, për përmbajtjen e Planeve Rregulluese të Hollësishme;
2. PRrH-të përgatiten për zonat e identifikuara në Planin Hapësinor për Zona të Veçanta dhe Hartën Zonale të Kosovës, në të cilat, kushtet e përcaktuara zhvillimore dhe ndërtimore nuk janë të mjaftueshme për dhënien e lejeve ndërtimore;
3. Komunitet e përfshira në hartimin dhe aprovimin e këtyre dokumenteve janë të obliguara të njoftojnë Ministrinë për të gjitha fazat e procesit, duke përfshirë Vendimin për hartimin, Vendimin për shqyrtimin publik dhe Vendimin për aprovimin e PRrH-ve përkatëse;
4. Vendimi për aprovimin e PRrH-ve merret nga Komuna përkatëse pasi të sigurohet pëlqimi nga Ministria nëse PRrH është në harmoni me Planin Hapësinor për Zonën e Veçantë përkatëse apo Hartën Zonale të Kosovës;
5. Përgjegjës për hartimin, aprovimin dhe zbatimin e PRrH-ve në Zona të Veçanta është:
 - a. Ministria për zonat ku pronësia është kryesisht publike; dhe
 - b. Komunitet për zonat ku pronësia është kryesisht¹⁵ private.
6. Ministria por edhe Komunitet e përfshira në hartimin dhe zbatimin e PRrH-ve janë të obliguara që për të gjitha fazat e procesit ti përfshijnë dhe ti njoftojnë autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e zonave të veçanta përkatëse;
7. Hartimi i PRrH-ve mund të bëhet edhe nga kompanitë private të angazhuara nga Ministria, përkatësisht Komunitet;
8. Kufiri definitiv i zonës për të cilën duhet të hartohet PRrH, përcaktohet pas realizimit të matjeve gjeodezike në terren, sipërfaqja e të cilës mund të ndryshojë për +/- 5% nga sipërfaqja e definuar në Planin përkatës apo Hartën Zonale të Kosovës;

¹⁵ Fjala është për zonat ku pronësia nuk është kompakte, ka përzierje të pronësisë, prandaj përgjegjësia caktohet në varësi të përqindjes së pjesëmarrjes të llojit të pronësisë.

9. Sipërfaqja optimale e një zone për të cilën hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm në kuptim të Udhëzimit Administrativ Nr.01/18 nuk duhet të jetë më e madhe se 100 Ha.

Në kuadër të Hartës Zonale të Kosovës përcaktohen këto zona të veçanta:

- **Zona e Veçantë e Monumentit të Natyrës “Shpella e Gadimes”** – Zona e propozuar për ZV “Zona e Gadimes” ka një sipërfaqe prej 4,280ha dhe shtrihet në territorin e komunës së Lipjanit.

Brenda zonës përfshihen shtatë (7) vendbanime me gjithsejtë 7,916 banorë (ASK, 2011), kurse vendbanimet më të mëdha janë fshatrat Gadime e Epërme dhe Gadime e Ulët ku janë të përqendruara edhe shërbimet e bashkësisë lokale, qendra e mjekësisë familjare, një ndër shkollat më të mëdha fillore si dhe Shkolla e Mesme “Ulpiana”- paralelja e ndarë në Gadime. Ndërsa vendbanimet tjera më të vogla janë: Babushi i Muhaxherëve, Gllavica, Marevci, Vrella dhe Plitkoviqi.;

- **Zona e Veçantë e Parkut të Natyrës “Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmnicës”** – e shpallur me vendim të Qeverisë së Kosovës më 23.05.2019, shtrihet në një sipërfaqe prej afërsisht 6.000 Ha, prej të cilave 25% janë pjesë të territorit të Komunës së Gjakovës, ndërsa pjesa tjetër i takon territorit të Komunës së Prizrenit. Në kuadër të zonës nuk ka vendbanime, ndërsa sa i përket pronësisë, 98% e territorit është në pronësi publike dhe vetëm 2% është në pronësi private. Zona në fjalë gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës, në kufi me Shqipërinë (vija kufitar në gjatësi rreth 18 km) dhe si e tillë është pjesë e një rajoni më të gjerë, të pasur me peizazhe dhe vlera të shumta natyrore që janë bazë e mirë për zhvillimin e turizmit malor ndërkufitar.

- **Zona me interes të Veçantë Ekonomik për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit** (e shpallur me vendimin nr. 03-V-154 të datës 24 korrik 2009 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.941 Ha) – ndodhet në pjesën jugore të Kosovës, në jug-perëndim të Komunës së Prizrenit dhe në Veri të komunës së Dragashit. Vendbanimet në kuadër të zonës së interesit HC ZHUR, zënë rreth 5% të sipërfaqes së tërësisë të kësaj zone të ndara në: Komunën e Prizrenit vendbanimet Zhur dhe Dobrushë, ndërsa në Komunën e Dragashit vendbanimet - Rrencë, Shajnë, Dragash, Lubovishtë, Kukjan, Dikancë, Glloboqicë dhe Krushevë. Vendbanimet në kuadër të zonës së interesit “HC Zhur”, në bazë të ndikimeve që kanë dhe mënyrës së veçantë të trajtimit që kërkohet për to, ndahen në dy zona: Zona qendrore ku vendbanimet ndikohen drejtpërdrejtë nga grumbullimi i ujit, të cilat i takojnë Komunës së Dragashit (Brenë, Buçe, Plavë, Zym, Bellobrad dhe Kapër); dhe Zona e gjerë (bartja e ujit) ku përfshihen të gjitha vendbanimet tjera që ndikohen në mënyrë indirekte nga infrastruktura e ardhshme për hidrocentral të Zhurit (objektet-elementet për përcjelljen e ujit përmes kanaleve të hapura apo të mbyllura ose tuneleve);

- **Zona e Peizazhit Kulturor “Miniera e Artanës/Novobërdë”** – është e cilësuar si zonë me vlera të larta të trashëgimisë ekonomike, natyrore dhe kulturore - historike, në të cilën objektet minerare, kështjella, vendet fetare dhe ndërtesat tradicionale janë të vendosura në mjedise natyrore të veçanta. Zona në fjalë ngërthen në vete edhe objektin e kalasë së shekullit XII-XIV me pjesët përcjellëse të saj dhe vendbanimet përreth, përfshirë edhe infrastrukturën ekzistuese rrugore e hekurudhore, duke krijuar kështu njërin nga peizazhet kulturore më karakteristike në vend. Zona ka një sipërfaqe prej afro 20.000Ha, në të cilën përfshihen vendbanimet: Novobërdë, Bostan, Jasenovik, Tërniqec, Makresh i Epërm, Dragancë dhe Strazhë);

- **Kompleksi Përkujtimor “Adem Jashari”** – (e shpallur me Ligjin 2004/39) kjo zonë ka rëndësi të madhe historike, kulturore dhe strategjike për të dëshmuar për një ngjarje të rëndësishme, për sakrificën dhe dashurinë për liri për gjeneratat e tashme dhe të ardhme të vendit tonë. Kompleksi me hapësirat dhe objektet përreth do të zgjojë përjetime, respekt dhe pietet të thellë ndaj viktimave që sakrifkuan jetën e tyre për lirinë e vendit.

Zona në fjalë shtrihet në Komunën e Skenderajt dhe ka një sipërfaqe prej rreth 450 Ha, në të cilën përfshihen edhe vendbanimet: lagja Jashari – Prekaz i Ulët; lagja Lushtaku - Prekaz i Ulët; lagja tre Skenderaj; Fshati Klinë e Ulët; dhe një pjese e Prekazit të Epërm;

- **Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës (TZHEK)** – është zonë e cila sipas Planit Hapësinor në fuqi cilësohet si zonë e përshtatshme për zhvillimin ekonomik me efekt në të gjithë vendin. Zona në fjalë me

sipërfaqe pre afërsisht 11.600 Ha shtrihet në kuadër të territorit të komunave: Prishtinë, Graçanicë, Lipjan dhe Fushë Kosovë. Në aspektin hapësinor zona përkufizohet me disa përmbajtje të rëndësishme: Qytetin e Prishtinës, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, Stacionin Hekurudhor në Fushë Kosovë, rrjetin e infrastrukturës kryesore, e cila lidhet me korridoret e rëndësishme rrugore rajonale, dhe në afërsi me stabilimentet energjetike kryesore të vendit.

- **Zona e Veçantë “Mali i Moknës”** - shtrihet në pjesën veri- perëndimore të Kosovës dhe cilësohet si zone me vlera të larta të trashëgimisë natyrore (florë, faunë, vlera gjeomorfologjike, speleologjike, hidrologjike etj.) e cila në të ardhmen planifikohet të përfshihet në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkëve të Nemuna”, me rastin e zgjerimit të sipërfaqes të këtij parku. Në aspekt hidrologjik mali i Moknës përveç që është ujëndarës i detit Adriatik dhe detit të zi, disponon edhe me shumë burime ujore dhe liqene akullnajore.

Me këtë rast sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtar do të zgjerohet për rreth 25 mijë hektar (sipërfaqja e saktë do të përcaktohet me planin hapësinorë për zonën) në territorin e komunave Istog dhe Zubin Potok, duke përfshirë në kuadër të zonës së mbrojtur edhe liqenin e Ujmanit (Gazivodës)

Përveç vlerave natyrore mali i Moknës disponon edhe me vlera të trashëgimisë kulturore të cilat paraqesin potencial të konsiderueshëm për zhvillim edhe të shumë llojeve të turizmit.

- **Zona e mbrojtur e Shtabit të UÇK-së – Zona e Dukagjinit në fshatin Glllogjan** – zonë e cilësuar me vlera të larta të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Zona në fjalë përfshinë objektin me pjesët përcjellëse të tij, vendbanimet përreth përfshirë edhe infrastrukturën rrugore nga ajo pjesë e deri tek kompleksi i Varrezave të Dëshmoreve me sipërfaqe prej afro 0.16 ha, në të cilin vend gjatë kohës së luftës ka qenë i vendosur Shtabi i UÇK-së – Zona e Dukagjinit me sipërfaqe prej afro 0.5 ha. Zona e mbrojtur e Shtabit të UÇK-së me vendbanim ka një sipërfaqe prej afro 20 ha ku përfshihet e tërë qendra e fshatit Glllogjan.

- **Zona e mbrojtur e Verrave të Llukës në fshatin Llukë e Epërme - Deçan** - është cilësuar si zonë me vlera të larta të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Zona në fjalë përfshinë vendin e rrethuar nga muri i gurit si dhe Lumbardhi i Deçanit me infrastrukturën rrugore rreth kësaj zone, në të cilin vend gjatë kohës së mëhershme dy herë gjatë historisë janë mbajtur tubime të mëdha për Kombin Shqiptar ku mbahet mend tubimi i fundit i Verrave të Llukës i viteve të 90 – ta ku është bërë falja e shumë gjaqeve dhe ngatërresave. Zona në fjalë ka një sipërfaqe prej afro 5,5 ha dhe shtrihet në periferi të fshatit Llukë e Epërme.

4. ZONA E INFRASTRUKTURËS TEKNIKE

Në kuadër të kësaj zone përfshihet infrastruktura e transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror. Pjesë e kësaj zone janë edhe infrastruktura energjetike elektrike termike dhe gazsjellësi, duke përfshirë edhe infrastrukturën e ujit, infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave.

4.1. ZONA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE

Niveli qendror është përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e: Autoudhëve, Rrugëve Nacionale dhe Rrugëve Rajonale. Ndërsa niveli lokal, përveç bartjes së të dhënave nga niveli qendror, është përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të gjitha rrugëve lokale;

Kjo zonë përfshinë sipërfaqet e rrugëve (autoudhëve, rrugëve nacionale, rrugëve rajonale dhe rrugëve lokale) bashkë me brezat rrugor dhe brezat mbrojtës të tyre. Brezi rrugor përbëhet prej dy brezave tokësor, njëri në njërin anë e tjetri në anën tjetër të rrugës, me gjerësi minimum 2 metra për autoudhët, rrugët nacionale dhe rrugët rajonale, dhe minimum 1 metër për rrugët lokale¹⁶. Brezi mbrojtës i rrugës përbëhet prej dy brezave tokësor apo sipërfaqeve, njëra në njërin anë e tjetra në anën tjetër të rrugës, të cilat i formojnë skajet e

¹⁶ Sipas Ligjit Nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugët Nr. 2003/11;

jashtme të brezit rrugor dhe vijat e imagjinuara paralele me ta që janë të larguara prej këtyre skajeve në distanca të caktuara. Në brezin mbrojtës ndalohen ndërtimet. Gjerësia e brezit mbrojtës varet nga kategoria e rrugës dhe nga ndërtimet që ndalohen të bëhen në këtë brez.

Zona e infrastrukturës rrugore është paraqitur në Hartën Nr. 9. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë:

1. Gjerësia e brezit mbrojtës në të cilin ndalohet hapja e minierës, ndërtimi i liqenit, objekteve të ndryshme industriale dhe instalimeve që lidhen me to, për autoudhën është 100 metra në të dy anët e rrugës, për rrugën nacionale nga 60 metra në të dy anët, për rrugën rajonale nga 40 metra dhe për rrugën lokale nga 30 metra¹⁷.
2. Gjerësia e brezit mbrojtës në të cilin ndalohet ndërtimi i objekteve, strukturave, rezidencave, zyrave, puseve, gropave septike, shtyllave elektrike dhe instalimeve të ngjashme, për autoudhën është 40 metra në njërin dhe 40 metra në anën tjetër të saj, për rrugën nacionale nga 20 metra në të dy anët, për rrugën rajonale nga 10 metra dhe për rrugën lokale nga 5 metra¹⁸.
3. Për çdo lidhje të re me rrugën nacionale apo rajonale përmes një rruge lidhëse duhet të merret pëlqimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe të respektohet procedura që është caktuar me UA të MEA, nr.10/2016 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës e që ka të bëjë me ndryshim-plotësimet e Hartës Zonale të Kosovës.
4. Në hapësirat ku është planifikuar të vendosen korridore të reja rrugore (Harta Nr. 9) nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të rrugës apo korridorit. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha ato që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë.
5. Rrugët projektohen, ndërtohen dhe rekonstruktohen sipas kushteve që janë të përcaktuara me Ligjin për Rrugët dhe sipas rregullave për kriteret teknike për projektim, ndërtim dhe rekonstruktim të tyre të cilat i nxjerr Ministria e Infrastrukturës. Projektimi, ndërtimi dhe rekonstruktimi duhet të bëhen në bazë të dokumentacionit teknik të ofruar që parasheh zbatimin e të arriturave më të reja shkencore dhe profesionale nga lëmi i projektimit dhe ndërtimit.
6. Gjerësia e korsisë së një rruge publike duhet të jetë¹⁹:
 - a. 2.75 m për shpejtësinë e lejuar të qarkullimit deri në 40 km/h;
 - b. 3.00 m për shpejtësinë e lejuar të qarkullimit 40 km/h deri 60 km/h;
 - c. 3.25 m për shpejtësinë e lejuar të qarkullimit 60 km/h deri 80 km/h;
 - d. 3.50 m për shpejtësinë e lejuar të qarkullimit 80 km/h deri 100 km/h;
 - e. 3.75 m për shpejtësinë e lejuar të qarkullimit më të madhe se 100 km/h
7. Rrugët publike ndërtohen me konstruksion për pranimin e ngarkesave boshtore prej së paku 115 kN (11.5 tonë) për një bosht të automjeteve. Në raste të veçanta rrugët lokale mund të ndërtohen me konstruksion për pranimin e ngarkesave boshtore të automjeteve më të vogla por jo më pak se 60 kN (6 tonë) për një bosht²⁰.
8. Pasi të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi që rregullon ndërtimin e rrugëve dhe ato të përcaktuara me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e lëshon lejen për ndërtim apo rekonstruktim të autoudhës, rrugës nacionale, rajonale dhe objekteve tjera përcjellëse, ndërkaq komuna e lëshon lejen për ndërtimin apo rekonstruktimin e rrugëve lokale dhe objekteve tjera përcjellëse.

¹⁷ Po aty;

¹⁸ Po aty;

¹⁹ Sipas Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;

²⁰ Sipas Ligjit Nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugët Nr. 2003/11;

4.2. ZONA E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Zona e infrastrukturës hekurudhore përfshinë hekurudhat bashkë me brezat mbrojtës hekurudhor. Brezi mbrojtës i hekurudhës përbëhet prej dy brezave tokësor apo sipërfaqeve, njëra në njërën anë e tjetra në anën tjetër të hekurudhës, të cilat i formojnë akset e binarëve të fundit anësor dhe vijat e imagjinuara paralele me ta që janë të larguara prej këtyre akseve në distanca të caktuara. Në brezin mbrojtës ndalohen ndërtimet. Gjerësia e brezit mbrojtës varet nga lloji i ndërtimeve të ndaluara në të.

Zona e infrastrukturës hekurudhore është paraqitur në Hartën Nr.9. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë:

1. Gjerësia e brezit mbrojtës në të cilin ndalohet hapja e minierave, guroreve, ndërtimi i tullave dhe gëlqeres, ndërtimi i ndërtesave industriale apo strukturave të ngjashme është 50 metra në njërën anë dhe 50 metra në anën tjetër të hekurudhës.²¹
2. Gjerësia e brezit mbrojtës në të cilin ndalohet ndërtimi i shtëpive, bizneseve, ndërtesave ndihmëse dhe të ngjashme, gërmimi i puseve, rezervuarëve, gropave septike, ndërtimi i linjave të gjata elektrike etj është 25 metra në njërën anë dhe 25 metra në anën tjetër të hekurudhës.²²
3. Në hapësirat ku është planifikuar të vendosen korridore të reja hekurudhore nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të hekurudhës apo korridorit. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha ato që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë.
4. Gjatë projektimit dhe ndërtimit të hekurudhave duhet të respektohen kriteret teknike për ndërtimin e tyre, të cilat i nxjerr Ministria e Infrastrukturës. Infrastruktura hekurudhore duhet të dizajnohet, ndërtohet, rindërtohet, riparohet, pajiset dhe mirëmbahet në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloret tjera, e gjithashtu edhe me kapacitetin e përcaktuar të hekurudhës, shpejtësitë e trenave, shtypjes boshtore dhe peshës së vagonëve të mallrave për metër gjatësi dhe me normat e standardet e përshkruara nga ministria kompetente për çështje të hekurudhës në përputhje me specifikat teknike të interoperabilitetit, standardet e UIC dhe normat dhe standardet e tjera ekzistuese.²³ Ndërtimi, modernizimi dhe punët e riparimit në infrastrukturën hekurudhore duhet të kryhen në bazë të dokumentacionit teknik të ofruar që plotëson normat dhe standardet e kërkuara.²⁴
5. Infrastruktura hekurudhore duhet t'i plotësojë kërkesat teknike në vijim:²⁵
 - a) Gjerësia e binarëve të hekurudhës është 1435 mm. Ajo nuk mund të jetë më e vogël se 1430 mm dhe as më e madhe se 1470 mm, duke përfshirë zgjerimin e binarëve në një kurbë.
 - b) Rrezja e lakimit në korsinë e hapur është të paktën 300 m, ndërsa në binarin kryesor kalimtar në stacionin hekurudhor është të paktën 500 m; profili i jashtëm hekurudhor, në varësi të madhësisë së rrezes së lakimit dhe kufirit të shpejtësisë, duhet të jetë më i ngritur, por jo më shumë se 150 mm.
 - c) Pjerrësia maksimale e niveletës/shtrirjes vertikale në hekurudhë të hapur është jo më shumë se 25 ‰.
 - d) Pjerrësia maksimale e niveletës/shtrirjes vertikale në stacionin hekurudhor është: për stacion të trenit në drejtim deri në 1 ‰, ndërsa për stacion të trenit në kurbë deri në 2.5 ‰, në varësi të rrezes së lakimit.
 - e) Distanca ndërmjet hekurudhave në stacionin hekurudhor duhet të jenë të tilla që ndërmjet profileve të lira të këtyre hekurudhave të ketë hapësirë të nevojshme për lëvizje të sigurt të udhëtarëve dhe personave të tjerë dhe për vendosje të ndërtesave ndihmëse, pajisjeve mbështetëse dhe shtyllave sinjalizuese, të rrjetit elektrik, ndriçimit, etj.

²¹ Sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës;

²² Po aty;

²³ Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, neni 119, paragrafi 3;

²⁴ Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, neni 120, paragrafi 1;

²⁵ Sipas Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;

- f) Distanca ndërmjet hekurudhave në stacion hekurudhor duhet të jenë të paktën 4.75 m, ndërsa distanca e hekurudhave ndërmjet të cilave bëhet ngritja e platformave me lartësi 0.55 m, mbi skajin e sipërm të hekurudhës është të paktën 6.00 m.
 - g) Distanca e hekurudhave në linjë të hapur tek binarët e dyfishtë dhe linjat paralele duhet të jenë të paktën 4 m.
 - h) Peshat e lejuar në linjat primare është të paktën 22.5 t në bosht dhe 8.0 t për metër gjatësi, ndërsa në linjat sekondare dhe terciare 18.0 t në bosht dhe 6.4 t për metër gjatësi.
6. Pasi të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi që rregullon ndërtimin e hekurudhave dhe ato të përcaktuara me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e lëshon lejen për ndërtim apo rekonstruktiv të hekurudhës;
7. Përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen është niveli qendror (HZKos), ndërsa niveli lokal e bënë vetëm bartjen e këtyre të dhënave në HZKom;

4.3. ZONA E AERODROMEVE

Zona e aerodromeve përfshinë sipërfaqet ku gjenden aerodromet bashkë me zonat mbrojtëse të tyre. Zonat mbrojtëse të aerodromeve definojnë nga operatorët e aerodromeve. Në Republikën e Kosovës janë dy aerodrome: Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” dhe Aeroporti i Gjakovës. Harta Nr.2 tregon ku shtrihet zona e aerodromeve. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë:

1. Të gjitha aerodromet duhet të kenë zona mbrojtëse në të cilat aktivitetet e ndërtimit mund të kufizohen me qëllim të mos-rrezikimit të operimeve të fluturimeve nga çdo pengesë²⁶;
2. Operatorët e aerodromit duhet të definojnë Zonën Mbrojtëse të Aerodromit në të cilin operojnë në përputhje me standardet e Aneksit 14 të Konventës së Çikagos. Këto zona duhet të skicohen në një Hartë Sigurie e cila duhet të pranohet dhe të aprovohet nga AAC²⁷ dhe e cila duhet të vihet në dispozicion të autoritetit kompetent²⁸ përkatës²⁹;
3. Të gjitha aplikacionet për leje ndërtimi për secilin ndërtim që ndodhet brenda territorit të definuar të Zonës Mbrojtëse të një aerodromi, e cila i adresohet autoriteteve kompetente duhet t’i nënshtrohet shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak për përmbushje të dispozitave të paragrafit 3, sipas të cilit Operatori i aerodromit duhet të vlerësojë një aplikacion për leje ndërtimi, i cili hyn brenda kornizës së paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim³⁰:
 - a) Sipërfaqet e kufizimit të pengesave;
 - b) Efektet në pajisjet ndihmëse elektronike dhe vizuele për navigacion ajror;
 - c) Mundësinë për tërheqje të pranisë së zogjve.
4. Autoritetet kompetent duhet që brenda afatit të arsyeshëm, të dërgojnë aplikacionin për leje ndërtimi tek operatori i aerodromit së bashku me të gjitha informacionet e duhura të bashkangjitura me të³¹;
5. Operatori i aerodromit duhet brenda 15 ditëve pas pranimit të aplikacionit të shqyrtoj dhe të jap vlerësimin final të arsyetuar substancialisht tek AAC, duke theksuar ndonjërin nga këto gjetje³²:
 - a) Pa vërejtje lidhur me ndonjë pikë të paragrafit 3;
 - b) Pa vërejtje, por me disa kushte të theksuara në mënyrë të duhur;

²⁶ Rregullore Nr. 4/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit;

²⁷ Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës;

²⁸ Autoriteti kompetent nënkupton ministrinë apo ministrinë relevante të cilat janë përgjegjëse bashkërisht apo veçanërisht për të lëshuar leje ndërtimi në përputhshmëri me Ligjin Nr. 04/L - 110 për Ndërtim apo komunitat që përfshijnë brenda kufijve të tyre sipërfaqësor një aerodrom apo zonat mbrojtëse të tij;

²⁹ Sipas Rregullores Nr. 4/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit;

³⁰ Ky është teksti i paragrafit 3 të Rregullores Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit, i ndryshuar sipas Rregullores Nr. 4/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit;

³¹ Sipas Rregullores Nr. 4/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit;

³² Rregullore Nr. 4/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit;

- c) Me vërejtje, lidhur me ndonjë pikë të paragrafit 3;
6. Operatori i aerodromit mundet përjashtimisht dhe në bazë të ndërlíkueshmërisë së çështjes, të kërkoj zgjatje të afatit të referuar në paragrafin 4³³;
 7. Varësisht nga vlerësimi paraprak i realizuar nga operatori i aerodromit, AAC do të lëshojë vendim përkatës në lidhje me përmbushjen e dispozitave të paragrafit 3 të një aplikacioni për leje ndërtimi³⁴;
 8. Pavarësisht nga pushteti i dhënë Ministrisë dhe Komunave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre në bazë të ligjit të aplikueshëm, këto të fundit duhet të marrin në konsideratë gjetjen në një vlerësim të aprovuar nga AAC, në rastet kur marrin vendim lidhur me një aplikacion për leje ndërtimi i cili hyn brenda kornizës së paragrafit 1³⁵;
 9. Përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e këtyre zonave është niveli qendror (HZKos), ndërsa niveli lokal e bënë vetëm bartjen e këtyre të dhënave në HZKom;

Në mungesë të të dhënave zyrtare për fushat ajrore bujqësore dhe sportive në territorin e Kosovës, është e pamundur që të ofrohen kushtet dhe të bëhet trajtimi i tyre në këtë dokument.

4.4. ZONA E INFRASTRUKTURËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Kjo zonë përfshinë hapësirat ku gjenden stabilimentet e energjisë elektrike (SEE) për të cilat lejen e ndërtimit e lëshon Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, bashkë me zonat e sigurisë rreth këtyre stabilimenteve. Zonat e sigurisë përcaktohen brenda dhe rreth stabilimenteve të energjisë elektrike për t'i mbrojtur stabilimentet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit të energjisë elektrike, sistemet për matje, mbrojtje, kontroll, siguri, informim dhe telekomunikim, në përputhje me rregullat dhe standardet e aplikueshme teknike.³⁶ Zonat e sigurisë rreth stabilimenteve të energjisë elektrike përfshijnë tokën, hapësirën ajrore apo ujën që i rrethon stabilimentet e energjisë elektrike.³⁷ Ministria e Zhvillimit Ekonomik me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe mënyrat e përcaktimit të lokacionit, madhësinë, kufijtë e zonave të sigurisë, rregullimin e tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve.³⁸ Harta Nr.8 e tregon shtrirjen e SEE në territorin e republikës. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë³⁹:

1. Brenda zonës së sigurisë së stabilimentit të energjisë elektrike, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, është i ndaluar ndërtimi, kryerja e çfarëdo aktiviteti të gërmimit, mbushjes, prishjes, përmbytjes, ujitjes apo përmirësimit të tokës dhe mbjellja apo prerja e druve dhe e vegjetacionit.
2. Në linjat nëntokësore, brenda zonës së sigurisë, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë është e ndaluar kryerja e veprimeve të gërmimit në tokë, gërmimit nën ujë për të lundruar apo për të lëvizur me spirancën e lëshuar, me zinxhirë, trungje apo rrjeta, si dhe vendosja e shenjave të trafikut dhe bove për lundrim apo për të shkatërruar apo deponuar akullin.
3. Në linjat nëntokësore brenda zonës së sigurisë, pa lejen e pronarit, apo të ndërmarrjes së energjisë, është i ndaluar operimi i mekanizmave ndikuese në nivel të tokës, kryerja e punëve në thellësi, sipas rregullave dhe standardeve teknike të përcaktuara nga ndërmarrjet e energjisë elektrike;
4. Nën linjat transmetuese ajrore brenda zonës së sigurisë, është e ndaluar:
 - 4.1. Vozitja e makinave apo operimi i makinerisë, lartësia e të cilave, me apo pa ngarkesë, kalon distancën sipas rregullave teknike të përcaktuara nga ndërmarrjet e energjisë;
 - 4.2. Ndërtimi i stallave, rrethojave dhe vendeve të ujit për bagëtinë dhe ndërtime të tjera.

³³ Po aty;

³⁴ Rregullore Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit;

³⁵ Rregullore Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit. Teksti i paragrafit 1 që përmendet këtu është në pikën 3 më lart;

³⁶ Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, neni 7, paragrafi 1;

³⁷ Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, neni 7, paragrafi 2;

³⁸ Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë, neni 31, paragrafi 3;

³⁹ Teksti në vazhdim për pikat 1 deri në 9 është marrë nga Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë;

5. Zona e sigurisë për stabilimentin e energjisë elektrike mund të krijohet apo zgjerohet mbi bazën e një projekti të parashtruar nga ndërmarrja e energjisë sipas standardeve dhe rregullave teknike si dhe legjislacionit përkatës në fuqi;
6. Pronari apo shfrytëzuesi i tokës, që gjendet në zonën e sigurisë duhet t'i paraqesë ndërmarrjes së energjisë kërkesën e cila arsyeton nevojën për ndërtim në tokën që gjendet brenda zonës së sigurisë;
7. Pronari apo shfrytëzuesi i tokës, nëse është e nevojshme, bënë kërkesë në ndërmarrjen e energjisë, stabilimenti i së cilës gjendet në zonën e sigurisë, për masat e kërkuara mbrojtëse që do t'i zbatoj rreth ndërtimit brenda zonës së sigurisë dhe nëse është e nevojshme, edhe objektet, pajisjet dhe mbi instalimet përkatëse;
8. Masat mbrojtëse sigurohen me rastin e dhënies së pëlqimit për aktivitetin e kërkuar në zonën e sigurisë;
9. Ndërmarrja e energjisë duhet të japë miratimin ose refuzimin e vet për ndërtimin e paraparë, në formë të shkruar, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas dorëzimit të kërkesës;
10. Në hapësirat ku është planifikuar të vendosen stabilimente të reja (Harta Nr. 8) të energjisë elektrike nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të këtyre stabilimenteve. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha ato që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë;
11. Ndërtimi i stabilimenteve të energjisë elektrike në zonën e planifikuar dhe të paraqitur në këtë hartë zonale mund të fillojë vetëm pasi të jetë lëshuar leja e ndërtimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Leja lëshohet pasi investitori t'i ketë plotësuar të gjitha kërkesat që dalin nga Ligji Nr. 04/L - 110 për Ndërtim dhe Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor;
12. Niveli qendror është përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e: largpërçuesve të tensionit mbi 110kV dhe e kapaciteteve prodhuese me fuqi mbi 10 Mv, ndërsa Niveli lokal përveç bartjes së të dhënave nga niveli qendror, bënë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të gjitha të dhënave që janë të kategorive më të ulëta.

4.5. ZONA E INFRASTRUKTURËS SË ENERGJISË TERMIKE

Kjo zonë përfshinë hapësirat ku gjenden stabilimentet e sistemeve të energjisë termike (SSET) për të cilat lejen e ndërtimit e lëshon Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, bashkë me zonat e sigurisë rreth këtyre stabilimenteve. Zonat e sigurisë përcaktohen me qëllim të mbrojtjes së sistemit të integruar dhe të ndërlidhur të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë termike⁴⁰. Zonat e sigurisë rreth sistemeve të energjisë termike përfshijnë, tokën dhe ujin përreth sistemit të energjisë termike⁴¹. Ministria e Zhvillimit Ekonomik me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe mënyrat e përcaktimit të lokacionit, madhësinë, kufijtë e zonave të sigurisë, rregullimin e tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve⁴². Harta Nr.8 e tregon shtrirjen e SSET në territorin e republikës. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë:⁴³

1. Brenda zonës së sigurisë së sistemit të energjisë termike, pa lejen e ndërmarrjes të energjisë termike, nuk lejohet ndërtimi, gërmimi, mbushja, dëmtimi, përmbytja, ujitja apo përmirësimi i tokës dhe mbjellja e drunjëve.
2. Zona e sigurisë përfshinë trasenë e termo-përçuesit nëntokësor, të instaluar në kanale nga betoni apo në shtrirje të lirë, në distancë sipas standardeve dhe rregullave teknike.
3. Pronari apo shfrytëzuesi i tokës, që gjendet në zonën e sigurisë duhet t'i paraqesë ndërmarrjes së energjisë kërkesën e cila arsyeton nevojën për ndërtim në tokën që gjendet brenda zonës së sigurisë.
4. Pronari apo shfrytëzuesi i tokës, nëse është e nevojshme, bënë kërkesë në ndërmarrjen e energjisë, stabilimenti i së cilës gjendet në zonën e sigurisë, për masat e kërkuara mbrojtëse që do t'i zbatoj rreth

⁴⁰ Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, neni 8, paragrafi 1;

⁴¹ Po aty;

⁴² Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë, neni 31, paragrafi 3;

⁴³ Teksti në vazhdim për pikat 1 deri në 6 është marrë nga Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë;

ndërtimit brenda zonës së sigurisë dhe nëse është e nevojshme, edhe objektet, pajisjet dhe mbi instalimet përkatëse.

5. Masat mbrojtëse sigurohen me rastin e dhënies së pëlqimit për aktivitetin e kërkuar në zonën e sigurisë.
6. Ndërmarrja e energjisë duhet të japë miratimin ose refuzimin e vet për ndërtimin e paraparë, në formë të shkruar, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas dorëzimit të kërkesës.
7. Në hapësirat ku është planifikuar të vendosen stabilimente të reja të energjisë termike nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të këtyre stabilimenteve. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha ato që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë.
8. Ndërtimi i stabilimenteve të energjisë termike në zonën e planifikuar dhe të paraqitur në këtë hartë zonale mund të fillojë vetëm pasi të jetë lëshuar leja e ndërtimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Leja lëshohet pasi investitori t'i ketë plotësuar të gjitha kërkesat që dalin nga Ligji Nr. 04/L - 110 për Ndërtim dhe Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.

4.6. ZONA E INFRASTRUKTURËS SË GAZIT NATYROR

Zona e infrastrukturës së gazit natyror (Harta Nr. 8) përfshinë hapësirën ku gjenden stabilimentet e sistemit të gazit natyror bashkë me zonat e sigurisë brenda dhe rreth këtyre stabilimenteve. Zonat e sigurisë përcaktohen me qëllim të mbrojtjes së sistemit të ndërlidhur të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror.⁴⁴ Zonat e sigurisë rreth sistemeve të gazit natyror përfshijnë, trasenë e tubacioneve dhe vendin e vendosjes së stabilimenteve të gazit natyror.⁴⁵ Ministria e Zhvillimit Ekonomik me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe mënyrat e përcaktimit të lokacionit, madhësinë, kufijtë e zonave të sigurisë, rregullimin e tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve.⁴⁶ Vendndodhja e kësaj zone është dhënë në hartën x. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë:

- Brenda zonës së sigurisë së sistemit të gazit natyror është i ndaluar ndërtimi, gërmimi, mbushja, prishja, përmbytja, ujitja apo përmirësimi i tokës dhe mbjellja apo prerja e drunjëve dhe vegjetacionit.⁴⁷
- Në hapësirat ku është planifikuar të vendosen stabilimente të reja të sistemit të gazit natyror nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të këtyre stabilimenteve. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha shfrytëzimet që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë.
- Leja e ndërtimit për stabilimentet e energjisë termike në zonën e planifikuar dhe të paraqitur në këtë hartë zonale lëshohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat që dalin nga Ligji Nr. 04/L -110 për Ndërtim dhe Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.

4.7. ZONA E INFRASTRUKTURËS UJORE

Zona e infrastrukturës ujore përfshinë sipërfaqet ku gjenden objektet dhe pajisjet ujore, për ndërtimin e të cilave, lejen e lëshon Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Këto objekte janë: digat e larta për akumulimin e ujit me pajisjet dhe objektet e tyre përcjellëse, objektet ndër rajonale dhe rajonale të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit, impiantet për përgatitjen e ujit për pije me kapacitet mbi katërqind (400) l/s dhe impiantet për pastrimin e ujërave të zeza në vendbanimet me mbi pesëmbëdhjetë mijë (15.000) banorë ose me kapacitet dyzet (40) l/s. Me Udhëzimin Administrativ MEA – Nr. 15/2017 për Kriteret për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit caktohen zonat e mbrojtura sanitare të cilat kanë për qëllim t'i mbrojnë burimet ujore nga ndikimet negative të cilat mund të dëmtojnë gjendjen normale dhe të

⁴⁴ Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, neni 9, paragrafi 1;

⁴⁵ Po aty;

⁴⁶ Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë, neni 31, paragrafi 3;

⁴⁷ Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, neni 9, paragrafi 2;

qëndrueshme të ujit nga aspekti cilësor dhe sasior. Zonat e mbrojtura sanitare ndahen në tri zona: zona e parë – zona e mbrojtjes së regjimit të rreptë; zona e dytë – zona e mbrojtjes së regjimit të kufizuar dhe zona e tretë – zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë. Objektet e infrastrukturës ujore ndodhen në zonën e parë mbrojtëse. Kufiri i zonës së infrastrukturës ujore, kur objektet dhe pajisjet janë pranë akumulimit ujor – liqenit, përputhet me kufirin e zonës së parë mbrojtëse sanitare e cila gjendet rreth këtij akumulimi. Largësia e kufirit nga objektet duhet të jetë minimum 10 metra. Zona e parë mbrojtëse përfshinë liqenin, respektivisht akumulacionin dhe brezin mbrojtës përgjatë akumulacionit me gjerësi 10 (dhjetë) metra nga kufiri i nivelit më të lartë të ujit, veprën ujëmarrëse dhe objektet tjera përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.⁴⁸ Zona e parë sanitare në rastet e burimeve të ujit nga ujërrjedhat përfshinë territorin përreth veprës ujëmarrëse në largësi së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujëmarrëse dhe të gjitha objekteve përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.⁴⁹ Harta Nr.8 tregon ku gjenden objektet e infrastrukturës ujore. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë:

1. Në zonën e parë mbrojtëse duhet të jenë të rrethuara: vepra ujëmarrëse dhe objektet tjera përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.⁵⁰
2. Në zonën e parë mbrojtëse sanitare – zonën e mbrojtjes së regjimit të rreptë ndalohen të gjitha veprimtaritë përveç atyre të nevojshme për marrjen e ujit, përpunimin dhe transportin e ujit deri në sistemin për furnizim.⁵¹ Për më hollësisht rreth ndalesave në këtë zonë shih Udhëzimin Administrativ MEA – Udhëzimi Administrativ MEA Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit
3. Në hapësirat ku është planifikuar të vendosen objekte të reja të infrastrukturës ujore nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të këtyre objekteve. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha ato që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë.
4. Projektimi dhe ndërtimi i digave duhet të realizohet vetëm duke i plotësuar të gjitha kërkesat që dalin nga Udhëzimi Administrativ MEA Nr. 09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave.
5. Digat projektohen, ndërtohen dhe operohen në përputhje me parimet mbizotëruese shkencore dhe teknologjike të kohës ashtu që siguria e tyre të jetë e garantuar për të gjitha rastet e operimit dhe ngarkesave që mund të parashihen.⁵²
6. Ndërtimi i digës në zonën e planifikuar dhe të paraqitur në këtë hartë zonale mund të fillojë vetëm pasi për projektin e digës të jetë marrë pëlqimi nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor dhe më pas leja e ndërtimit nga MEA sipas procedurës së përshkruar në Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim.
7. Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për ndërtim të ri të infrastrukturës ujore janë:
 - a) Infrastruktura e ujësjellësit duhet të planifikohet në lokacionet si në vijim:⁵³
 - 2.00 m nga vija ndërtimore, në rrugët me gjerësi 7.00 m dhe shteg për këmbësorë përgjatë rrugës me gjerësi 1.50 m;
 - 1.50 m nga vija ndërtimore, në rrugët me gjerësi 6.00 m dhe shteg për këmbësorë përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m;
 - Trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësorë përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5.00 m dhe shteg për këmbësorë përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m

⁴⁸ Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 22, paragrafi 1;

⁴⁹ Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 28, paragrafi 1;

⁵⁰ Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 22;

⁵¹ Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit

⁵² Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave, neni 4, paragrafi 1.1.;

⁵³ Udhëzimi Administrativ MMPH-Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;

- b) Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të ndotura, duhet të planifikohet në lokacionet si në vijim:⁵⁴
- Në parcela kadastrale zhvillimore mesatare nga 5 - 10 ha;
 - Në afërsi dhe në drejtim të rrjedhës së jashtme të lumit;
 - Me qëllim të shkarkimit të ujërave të trajtuara;
 - Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore – vërshimet;
 - Në lokacione jashtë vendbanimeve dhe të izoluara nga vendbanimet;
 - 6.60 m në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 7.0 m dhe shteg për këmbësorë përgjatë rrugës me gjerësi 1.50 m;
 - 6.00 m në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 6.0 m dhe shteg për këmbësorë përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m;
 - Trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësorë përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5.00 m dhe shteg për këmbësorë përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m.
1. Trajtimi, interpretimi dhe paraqitja bëhet nga të dy nivelet e planifikimit, varësisht nga kapaciteti apo numri i banorëve të cilët shërbehen:
- Niveli qendror është përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e: Zonave ku janë digat e larta dhe objektet ndër-rajonale dhe rajonale të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit, impiantet për përgatitjen e ujit për pije me kapacitet mbi katërqind (400) l/s dhe impiantet për pastrimin e ujërave të zeza në vendbanimet me mbi pesëmbëdhjetë mijë (15.000) banorë ose me kapacitet dyzet (40) l/s;
 - Niveli lokal përpos bartjes së të dhënave nga niveli qendror, bënë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave që janë të kategorive më të ulëta.

4.8.ZONA E INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Kjo është zona ku gjenden objektet dhe pajisjet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike (telekomunikacionin), rrjeti, sistemet ose pajisjet të cilat janë të rëndësishme ndërkombëtare dhe ato të cilat ndërtohen në territorin e dy apo më shumë komunave. Pjesët e kësaj zone, ato të cilat janë përgjatë linjave komunikuese me tela përputhen me zonën e korridoreve rrugor, sepse kabllot shtrihen paralel me rrugët. Zona e infrastrukturës së komunikimeve elektronike përfshinë gjithashtu zonën e mbrojtur të rrjeteve publike të komunikimeve. Zona e mbrojtur e rrjeteve publike të komunikimeve përbëhet nga një rrip toke përgjatë linjave komunikuese me tela, të rrjeteve publike të komunikimit dhe rreth objekteve të infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duke përfshirë çdo konstruksion dhe strukturë të vendosur në të.⁵⁵ Në hartën nr. 8 tregohet vendndodhja e zonës së infrastrukturës së komunikimeve elektronike. Kushtet zhvillimore për këtë zonë janë:

1. Në zonën e mbrojtur të rrjeteve publike të komunikimeve është e ndaluar të ndryshohet destinimi i tokës, të ndërtohen ndërtesa dhe struktura tjera, të mënjanohe pajisjet dhe materialet, të gërmohet, të shpohen puse, të kryhen shpërthime dhe të kryhen vepra të tjera që mund ta dëmtojnë infrastrukturën e komunikimeve elektronike, pa miratimin paraprak nga pronarët e infrastrukturës së komunikimeve elektronike⁵⁶;
2. Përmasat dhe metodat e përcaktimit të kufijve të zonave të mbrojtura, si dhe procedura për kryerjen e punëve brenda zonave të tilla do të përcaktohen nga Autoriteti⁵⁷;
3. Për distancat minimale në mes të infrastrukturës ekzistuese të komunikimeve elektronike dhe infrastrukturave tjera që do të ndërtohen pranë saj duhet referuar në tabelat 4 dhe 5 të shtojcës 4 të

⁵⁴ Po aty;

⁵⁵ Pjesë nga paragrafi 1 i nenit 26 të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike.

⁵⁶ Bazuar në paragrafin 1 të nenit 26 të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike.

⁵⁷ Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, neni 26, paragrafi 2. Autoriteti nënkupton Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Rregullores (MZHE) Nr. 05/2017 për Ndërtimin, Instalimin dhe Mbikëqyrjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike;

4. Në hapësirat ku është planifikuar të vendoset infrastruktura e re (Harta Nr.8) e komunikimeve elektronike nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të kësaj infrastrukture. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha ato që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë;
5. Projektimi, ndërtimi dhe instalimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike duhet të realizohet vetëm duke i plotësuar të gjitha kërkesat që dalin nga Rregullorja (MZHE) Nr. 05/2017 për Ndërtimin, Instalimin dhe Mbikëqyrjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike;
6. Përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e këtyre informatave është niveli qendror i planifikimit (HZKos), ndërsa niveli komunal përveç bartjes së informatave nga niveli qendro, bënë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të gjitha të dhënave që janë të kategorive më të ulëta.

4.9. ZONA E DEPONIVE RAJONALE TË MBETURINAVE

Kjo zonë përfshinë sipërfaqet ku gjenden deponitë rajonale ose deponitë për deponimin e mbeturinave jo të rrezikshme për zona me mbi 200.000 banorë (Harta Nr.8). Ndërtimet e reja eventuale në afërsi të deponive ekzistuese të mbeturinave duhet të bëhen në largësi të caktuara nga këto deponi, varësisht nga destinimi i ndërtesave:

1. Ndërtesat ku njerëzit banojnë dhe punojnë nuk duhet të ndërtohen në largësi më të vogël se 1.000⁵⁸ metra (m) nga deponia.
2. Spitalet nuk duhet të ndërtohen në largësi më të vogël se 2.000⁵⁹ m nga deponia.
3. Aeroportet nuk duhet të ndërtohen në largësi më të vogël se 4.000⁶⁰ m nga deponia.
4. Hekurudhat nuk duhet të ndërtohen në largësi më të vogël se 100⁶¹ m nga deponia.
5. Gypat e ujësjellësit dhe gazsjellësit nuk duhet të vendosen në largësi më të vogël se 60⁶² m nga deponia.
6. Rrjetet elektrike nuk duhet të vendosen në largësi më të vogël se 100⁶³ m nga deponia.
7. Në hapësirat ku është planifikuar të ndërtohen deponi të reja rajonale nuk lejohet asnjë shfrytëzim i tokës që nuk është me natyrë të përkohshme. Shfrytëzimet me natyrë të përkohshme lejohen deri në momentin e fillimit të ndërtimit të deponive. Shfrytëzime të përkohshme janë të gjitha ato që nuk kanë të bëjnë me ndërtime apo instalime mbitokësore dhe nëntokësore, me përjashtim të ndërtesave montazhe që mund të çmontohen dhe largohen lehtë.
8. Projektimi dhe ndërtimi i deponive rajonale duhet të realizohet vetëm duke i plotësuar të gjitha kërkesat që dalin nga Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 06/2016 mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave.
9. Ndërtimi i deponive të lartpërmendura në zonën e planifikuar dhe të paraqitur në këtë hartë zonale mund të fillojë vetëm pasi të jetë lëshuar leja e ndërtimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Leja lëshohet pasi investitori t'i ketë plotësuar të gjitha kërkesat që dalin nga Ligji Nr. 04/L -110 për Ndërtim, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 06/2016 mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave.

^{58, 44, 46} Bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 06/2016 mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave.

⁵⁹ Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;

⁶⁰ Po aty;

⁶¹ Po aty;

⁶² Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;

⁶³ Po aty;

10. Një deponi e re rajonale e mbeturinave e cila nuk është paraparë me PHK dhe me këtë hartë zonale nuk duhet të ndërtohet në⁶⁴:
- a) Zonat e rrezikuara nga erozioni;
 - b) Zonat e rrezikuara nga vërshimet apo të vërshuar në 25 vitet e fundit;
 - c) Zonat me shkallë të lartë të rrezikshmërisë sizmike;
 - d) Zonat me pjerrtësi të madhe;
 - e) Zonat ku ujërat nëntokësore janë afër sipërfaqes së tokës;
 - f) Zonat me pasuri minerale dhe minimet;
 - g) Zonat me përdorim intensiv të bujqësisë;
 - h) Zonat ku rrezikon llojet e veçanta të florës dhe faunës;
 - i) Distanca më të vogël se 600 metra nga zona e monumenteve kulturore, historike dhe religjioze;
 - j) Distanca më të vogël se 1.000 metra nga shtretërit e lumenjve dhe brigjet e liqeneve;
 - k) Distanca më të vogël se 2.000 metra nga burimet e ujit;
 - l) Mbi strehimore apo tunele nëntokësore;
 - m) Zonat ku distanca nga fundi i deponisë deri tek niveli ujërave nëntokësore gjatë sezonit është më e vogël se 2 metra;
 - n) Zonat ku përshkueshmëria e tokës është më e madhe se 0,00001 cm/s.
11. Niveli qendror (HZKos) është përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e deponive rajonale për hapësirat me mbi 200.000 banorë, ndërsa niveli komunal (HZKom) përveç bartjes së informatave nga niveli qendror, bënë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e kategorive më të ulëta të kësaj infrastrukture;

4.10. ZONA E DEPONIMIT TË MBETURINAVE TË RREZIKSHME

Kjo zonë përfshinë lokacionin e propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në të cilën mbeturinat e rrezikshme do të vendosen për qëndrim të përkohshëm. Këto mbeturina pas një kohe të caktuar qëndrimi në këtë lokacion, dërgohen jashtë shtetit për asgjësim. Kushtet zhvillimore për këto zona janë të njëjta me kushtet e dhëna për zonat e deponive rajonale.

5. ZONAT UJORE

Zonat ujore (Harta Nr. 2) janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës. Këto zona ndahen në: zonat ujore sipërfaqësore dhe zonat ujore nëntokësore. Në funksion të zbatimit të ligjit në fjalë dhe të mbrojtjes së zonave ujore janë nxjerrë edhe disa akte nënligjore – udhëzime administrative.

5.1. Zonat ujore sipërfaqësore

Në kuadër të zonave ujore sipërfaqësore përfshihen: ujë rrjedhat, liqenet dhe kanalet e ujitjes. Me qëllim të mbrojtjes së ujërave sipërfaqësor, Udhëzimi Administrativ MEA Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit i ka caktuar tri zona të tilla. Ato janë: zona e parë – zona e kufizimit, zona e dytë – zona e kontrollimit dhe zona e tretë – zona e mbikëqyrjes.

⁶⁴ Po aty;

5.2. Zonat e mbrojtura sanitare në ujë rrjedhat e hapura

Zona e parë – Zona e I-rë sanitare në rastet e burimeve të ujit nga ujë rrjedhat përfshinë territorin përreth veprës ujë marrëse në largësi së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujë marrëse dhe të gjitha objekteve përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.⁶⁵

Zona e dytë – Zona e II-të e mbrojtur sanitare në rastet e burimeve të ujit nga ujë rrjedhat e hapura përcaktohet në bazë të elaboratit për mbrojtjen e burimit të ujit me ç'rast kufiri i kësaj zone nuk duhet të jetë më i vogël se 1000 (njëmijë) metra nga vepra ujë marrëse në rrjedhën e sipërme të ujë rrjedhës duke përfshirë ujë rrjedhën dhe brezin prej 30 metrash në të dyja anët e ujë rrjedhës.⁶⁶

5.3. Zonat e mbrojtura sanitare të akumulacioneve dhe liqeneve

Zona e parë – Zona e parë përfshinë:

- Liqenin respektivisht akumulacionin dhe brezin mbrojtës përgjatë akumulacionit me gjerësi 10 (dhjetë) metra nga kufiri i nivelit më të lartë të ujit.⁶⁷
- Veprën ujë marrëse dhe objektet tjera përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.⁶⁸

Zona e dytë – Territori i zonës së dytë të mbrojtur për akumulacione përfshinë:

- Brezin e gjerësisë prej 200 (dyqind) metra prej kufirit të zonës së I-rë të mbrojtur përgjatë gjithë liqenit ose akumulacionit.⁶⁹
- Brezin e gjerë prej 50 (pesëdhjetë) metra në të dy anët e ujë rrjedhave që derdhen në liqe dhe akumulacion në tërë gjatësinë e pellgut të akumulacionit.⁷⁰

Zona e tretë – Territori i zonës së III-të të mbrojtur për liqene dhe akumulacione shtrihet jashtë kufijve të zonës së II-të të mbrojtur dhe përfshinë tërë gjerësinë e pellgut natyror që derdhet në akumulacion ose liqe.⁷¹

5.4. Zonat ujore nëntokësore

Në kuadër të zonave ujore nëntokësore përfshihen: akuiferet intergranular dhe akuiferet karstik. Me qëllim të mbrojtjes së ujërave nëntokësor, Udhëzimi Administrativ MEA Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit i ka caktuar tri zona të tilla. Ato janë: zona e parë – zona e kufizimit, zona e dytë – zona e kontrollimit dhe zona e tretë – zona e mbikëqyrjes.

5.5. Zonat e mbrojtura sanitare në akuiferet intergranular

Zona e parë – Kufiri i zonës së I-rë të mbrojtur sanitare të një burimi nëntokësor në akuifer intergranular paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujë marrëse dhe objekteve përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit.⁷²

Zona e dytë

- Territori i zonës së II-të përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së I-rë deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 50 (pesëdhjetë) ditë për të arritur te vepra ujë marrëse.⁷³
- Kufiri i zonës së II-të të mbrojtur për burime dhe puse duhet të jetë së paku 100 (njëqind) metra nga zona e I-rë e mbrojtur.⁷⁴

⁶⁵ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 28, paragrafi 1

⁶⁶ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 30, paragrafi 1

⁶⁷ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 22, nënparagrafi 1.1.

⁶⁸ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 22, nënparagrafi 1.2.

⁶⁹ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 24, nënparagrafi 1.1.

⁷⁰ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 24, nënparagrafi 1.2.

⁷¹ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 26, paragrafi 1;

⁷² UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 10, paragrafi 1;

⁷³ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 12, paragrafi 1;

⁷⁴ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 12, paragrafi 2;

Zona e tretë

- a) Territori i zonës së III-të mbrojtur për burimet në akuifer intergranular përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të të mbrojtur deri te ujëndarësi hidrogeologjik.⁷⁵
- b) Në rastet kur kufiri hidrogeologjik nuk është i njohur, zona e III-të përfshinë hapësirën deri te kufiri prej të cilit ujit nëntokësor i nevojiten së paku 200 (dyqind) ditë për të arritur te vepra ujë marrëse.⁷⁶
- c) Kufiri i zonës së III-të duhet të jetë së paku 500 (pesëqind) metra nga vepra ujë marrëse.⁷⁷

5.6. Zonat e mbrojtura sanitare në akuiferet karstik

Zona e parë

- a) Kufiri i zonës së I-rë të mbrojtur të një burimi nëntokësor në akuifer karstik paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar 20 (njëzet) metra nga vepra ujë marrëse. Kjo zonë duhet të përfshijë edhe të gjitha objektet përcjellës që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit të ujit.⁷⁸
- b) Në rastet kur nuk mund të sigurohet largësia prej 20 (njëzet) metrash, kjo largësi duhet të jetë së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha objektet ujë marrëse me kusht që të vërtetohet se burimi nuk rrezikohet.⁷⁹

Zona e dytë – Territori i zonës së II-të sanitare për burimet e ujit në akuifer karstik përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së I-rë të mbrojtur deri te vija prej të cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 24 (njëzet e katër) orë për të arritur deri në veprën ujë marrëse, me ç'rast ky kufi nuk mund të jetë më afër se 500 (pesëqind) metra prej veprës ujë marrëse.⁸⁰

Zona e tretë

- a) Territori i zonës së III-të sanitare për burimet në akuifer karstik përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të deri te vija prej të cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 20 (njëzet) ditë për të arritur te vepra ujë marrëse.⁸¹
- b) Kufiri i zonës së III-të sanitare duhet të jetë së paku 1000 (njëmijë) metra larg veprës ujë marrëse në drejtim të rrjedhjes së ujit.⁸²

5.7. Kushtet zhvillimore

Kushtet zhvillimore për zonat e mbrojtura sanitare kanë dal nga Udhëzimi Administrativ MEA Nr. 15/2017, i cili përshkruan aktivitetet që lejohen dhe ndalohen në këto zona. Në vazhdim janë dhënë kushtet zhvillimore për secilën zonë të mbrojtur sanitare.

5.7.1. Kushtet zhvillimore për zonat e mbrojtura sanitare përreth ujë rrjedhave të hapura

- Në zonën e parë të mbrojtur sanitare të ujë rrjedhave ndalohet si vijon:
 - Kryerja e të gjitha llojeve të punimeve dhe aktiviteteve, përpos atyre për marrjen, trajtimin dhe transportimin e ujit në sistemin e ujësjellësit;
 - Përdorimi i plehrave dhe preparateve për mbrojtjen e bimëve
- Në zonën e dytë të mbrojtur sanitare të ujë rrjedhave ndalohet si vijon:
 - Kultivimi i produkteve bujqësore, përpos në rastet e prodhimitarisë ekologjike pa përdorimin e plehrave;
 - Prodhimtaria e bagëtisë, përpos për nevojat e bujqësisë, respektivisht fermat deri 20 krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikatat e mira të bujqësisë;

⁷⁵ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 14, paragrafi 1;

⁷⁶ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 14, paragrafi 2;

⁷⁷ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 14, paragrafi 3;

⁷⁸ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 16, paragrafi 1;

⁷⁹ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 16, paragrafi 2;

⁸⁰ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 18, paragrafi 1;

⁸¹ UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 20, paragrafi 1;

⁸² UA MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, neni 20, paragrafi 2;

- Ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;
- Transporti rrugor i materieve kimike, karburanteve të lëngëta dhe materieve tjera të rrezikshme;
- Ndërtimi i auto udhëve, rrugëve nacionale dhe hekurudhave;
- Ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
- Stacionet e riciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
- Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit në ujë rrjedhën e hapur.

5.7.2. Kushtet zhvillimore për zonat e mbrojtura sanitare përreth akumulacioneve dhe liqeneve

- Në zonën e parë të mbrojtur sanitare të akumulacioneve dhe liqeneve, përpos ndalesave që vlejnë edhe për zonën e dytë të mbrojtur sanitare të ujë rrjedhave (shih më lartë), ndalohet edhe:
 - Kryerja e punimeve, ndërtimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike, përpos atyre për marrjen, trajtimin dhe transportimin e ujit në sistemin e ujësjellësit;
 - Përdorimi i plehrave dhe preparateve për mbrojtjen e bimëve;
 - Shkarkimi i ujërave të ndotura nga objektet prodhuese dhe të ujërave që përdoren për pastrimin e pajisjeve për trajtimin e ujit;
 - Shfrytëzimi i të gjitha llojeve të mjeteve të lundrimit me mjete motorike;
 - Sportet e ujit, peshkimi sportive dhe kultivimi i peshkut;
 - Mbajtja dhe furnizimi me ujë i kafshëve;
 - Qarkullimi publik i automjeteve dhe këmbësorëve.
- Në zonën e dytë të mbrojtur sanitare të akumulacioneve dhe liqeneve, përpos ndalesave që vlejnë për zonën e tretë të mbrojtur sanitare të të njëjtave (shih më poshtë), ndalohen poashtu edhe të njëjtat aktivitete të cilat ndalohen në zonën e dytë të ujërrjedhave të hapura (shih më lartë).
- Në hapësirën e zonës së tretë të mbrojtur sanitare të liqeneve dhe akumulacioneve ndalohet:
 - Deponimi i mbeturinave;
 - Shkarkimi i ujërave të ndotura të papërpunuara;
 - Ndërtimi i objekteve për deponim, transport, manipulim dhe përpunim të materieve radioactive dhe materieve tjera të rrezikshme dhe të dëmshme për ujin përfshirë objektet për deponimin e naftës dhe derivative të naftës;
 - Ndërtimi i rrugëve pa objektet për grumbullimin e vajrave dhe yndyrave dhe të atyre për trajtimin e ujërave atmosferike;
 - Eksplotimi i rërës, zhavorit dhe argjilës.

5.7.3. Kushtet zhvillimore për zonat e mbrojtura sanitare të burimeve nëntokësore në akuiferet intergranular dhe në akuiferet karstik

- Në zonën e parë të mbrojtur sanitare të burimeve nëntokësore në akuiferet intergranular dhe në akuiferet karstik ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë.
Përrjashtimisht nga paragrafi i mësipërm, në zonën e parë të mbrojtur sanitare lejohet:
 - Kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve tjera që mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit;
 - Punimi i rjetit të kanalizimit, ujësjellëit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi, me ç'rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim
- Në zonën e dytë të mbrojtur sanitare të burimeve nëntokësore në akuiferet intergranular dhe në akuiferet karstik ndalohet zhvillimi i aktiviteteve dhe kryerja e punimeve që mund ta notin ujin, në mënyrë specifike:
 - Kryerja e aktiviteteve që ndalohen në zonën e tretë të mbrojtur sanitare (shih më poshtë);
 - Përdorimi i plehrave kimike dhe atyre të kafshëve;
 - Përdorimi i pesticideve, herbicideve dhe insekticideve;
 - Ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
 - Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve;
 - Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale;

- Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme;
 - Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme;
 - Eksploatimi i zhavorit dhe rërës;
 - Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit.
- Në zonën e tretë të mbrojtur sanitare ndalohen kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e burimit dhe në mënyrë specifike:
 - Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajtuara të kanalizimit;
 - Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj);
 - Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
 - Përpunimi, deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
 - Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
 - Ndërtimi i autoudhëve, aeroporteve, parkingjeve ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;
 - Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materie tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësor;
 - Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbrojtjen e bimëve;
 - Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese;
 - Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.

6. ZONAT BUJQËSORE

Bazë për përcaktimin e rregullave për shfrytëzimin e zonave bujqësore është Ligji për Tokën Bujqësore, janë qëllimet dhe objektivat për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të bujqësisë sipas të cilave duhet të mërren në konsideratë kushtet e mëposhtme:

- Niveli qendror është përgjegjës për përkufizimin e tokës bujqësore të kategorisë 1-4.

Tokë Bujqësore e kategorisë I – IV

- Duke u bazuar në të dhënat që dalin nga HZKos sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore të kateg. 1-4 është 360.141ha
- Sipas rregullave në fuqi është i ndaluar ndërtimi në kuadër të zonave bujqësore të kategorisë 1-4, përveç nëse objekti i planifikuar për ndërtim është i rëndësishëm së veçantë për shtetin dhe në raste të veçanta është i lejuar ndërtimi i objekteve që e ndihmojnë procesin e zhvillimit të bujqësisë (nëse nuk ka zgjidhje tjetër). Ndërsa, ndërtimet ekzistuese do të trajtohen si jokonformitet;
- Shfrytëzimet e lejuara: prodhimi bujqësor komercial, bujqësia për konsum vetjak si pemëtaria, perimtaria në të hapur dhe në serra, lavërtaria, kultivimi i bimëve foraxhere dhe mjekuese, fidanishtet, si dhe bletaria.
- Shfrytëzimet dytësore të lejuara: infrastruktura e bujqësisë si strehë për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore dhe hapësira për makineritë dhe pajisjet tjera;
- Shfrytëzimet e veçanta të lejuara: infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe për ujitje infrastruktura e transportit si rrugët ekzistuese lokale dhe të pakategorizuara, prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë, hekurudha, infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe shtyllat e telekomunikacionit (nëse nuk ka zgjidhje tjetër).
- Shfrytëzimet e përkohshme të lejuara: shërbime tregtare si mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore/blegtorale, peshkimi si peshkim rekreativ dhe profesional, shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairët.
- Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

Tokë Bujqësore e kategorisë V–VIII

- Sipas UA për NTPH kjo klasë e tokës bujqësore është tokë me përshtatshmëri nën mesatare dhe e dobët që kryesisht është tokë pyjore dhe livadhe, e cila nuk është e domosdoshme të ruhet;
- Shfrytëzimet e lejuara për këtë zonë janë prodhimi bujqësor komercial dhe bujqësia për konsum vetjak si pemëtaria e perimtaria në të hapur dhe në serra, bletaria, kultivimi i fidaneve, dhe i bimëve mjekuese e dekoruese, ndërtesat bujqësore të kategorisë I dhe II ku përfshihen: fermat për kultivimin e kafshëve të trasha (lopë, dele, dhi), ferma të shpezëve, ndërtesa bujqësore përcjellëse për bagëti dhe shpezëtari, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, pleme, hambar, ahur, bodrume të verës, hapësira për makineritë dhe pajisjet bujqësore dhe peshkim.
- Shfrytëzimet dytësore të lejuara janë banimi në rastet kur kemi zhvillim të bujqësisë për konsum vetjak, hapësirë e hapur rekreative, infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes të cilat janë në funksion të plotësimin të përmbajtjeve të lejuara.
- Shfrytëzimet e veçanta të lejuara janë industri për prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit si prodhimi i qumështit, infrastruktura e transportit si rrugët ekzistuese lokale dhe të pakategorizuara, ndalesat e autobusëve, prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë, prodhim i energjisë së ripërtërishme (panele solare), shtigjet për bicikleta dhe këmbësorë, hekurudha dhe infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe shtyllat e telekomunikacionit.
- Shfrytëzimet e përkohshme të lejuara janë shërbime tregtare si mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore/blegtorale, shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairët, peshkim rekreativ dhe profesional.

- Shfrytëzimet e ndaluara: të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.
- Nuk lejohen shfrytëzimet jo bujqësore/blektorale në tokën bujqësore të kategorisë I-IV.
- Ndalohet parcializimi i tokës bujqësore;
- Hyrjet dhe dalje të drejtpërdrejta në parcelën bujqësore duhet të sigurohen më së paku nga një rrugë publike ose private ose nga një servituti kalimi në një parcelë fqinje;
- Ndalohet ndërtimi (duke përjashtuar strukturat e përkohshme) në sipërfaqet e tokës bujqësore nën ujë dhe të planifikuar për ujë. Të gjitha ndërtimet ekzistuese do të trajtohen me programe të veçanta për trajtimin e ndërtimeve pa leje ose do të trajtohen si jo-konformitete.

7. ZONAT PYJORE

Toka pyjore përfshin sipërfaqet e tokës të mbuluara me pemë pyjore në formë të grumbullit pyjor që përfshinë edhe bashkësitë bioekologjike, me sipërfaqe më të madhe se dhjetë (10) ari⁸³. Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në Kosovë sipas të dhënave të HZKos është 432,303ha.

Bazë për përcaktimin e rregullave për zhvillim dhe ndërtim në zonat pyjore (Harta Nr. 5) janë ligjet nga sektori i pyjeve, sektori i natyrës dhe normat teknike për planifikim hapësinor, sipas të cilave duhet të merren në konsideratë kushtet e mëposhtme:

- Sipas HZKos mbesin relevante rekomandimet e dhëna në PHK sipas të cilave kufizohet deri në minimum shfrytëzimi i pyjeve për qëllime ekonomike, përveç në rastet e veçanta dhe në rastet kur lejohet përpunimin i drurit për qëllime artizanale dhe për prodhimin e biomasës, zhvillimin e bletarisë, turizmit dhe rekreacionit.
- Shfrytëzimet e lejuara - HZK përcakton se në zonën pyjore lejohet pylltaria e bazuar në rotacion të shkurtër, klasë e cila përfshinë hapësira pyjore ku periudha e rotacionit të një brezi pemësh është 50 vjet ose më pak, pas së cilës pylli rigjenerohet në mënyrë artificiale apo natyrore, me mbjelljen dhe mbirje fare. Kësaj klase i përkasin poashtu plantacione pemësh dhe drurësh që përdoren për prodhimin e biomasës. Në zonën pyjore lejohet ndërmarrja e masave preventive-kultivuese të parapara me rregullat në fuqi.
- Shfrytëzimet dytësore - përfshijnë ndërtesat në shërbim të menaxhimit të pyjeve, kullosa, infrastrukturë rrugore rajonale, lokale dhe e pakategorizuar (shtigjet), shtigjet kundërzjarrit;
- Shfrytëzimet e veçanta të lejuara - përfshijnë prerjen e pyjeve, ripyllëzimin, meliorimin të gjitha në pajtueshmëri me dispozitat ligjore respektive.
- Shfrytëzimet e përkohshme - Në sipërfaqet e zhveshura të pyjeve lejohen ndërtimi i strukturave të përkohshme apo aktivitete të cilat i kontribuojnë valorizimit të zonës. Në kuadër të këtyre veprime do të përfshihen: kultivimi i bujqësisë dhe blegtorisë, shoqëritë e bletëve (deri në 100), shfrytëzimi i mineraleve, gjuetia, ndërtesat e klubeve/shoqatave të gjyëtarëve e të ngjashme, mbledhja dhe pikat shitëse të prodhimeve bujqësore/blektorale, aktivitete argëtuese e rekreative (hiking, turistike), peshkimi, shfrytëzimi i produkteve jo-drusore (kërpudha, frutat e egra), kultivimi i kafshëve të egra (drerit, kaprollit, lepurit, ujkut etj), etj.
- Në kuadër të shfrytëzimeve të ndaluara ndalohet të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta të lejuara dhe shfrytëzimet e përkohshme.

Në zonat pyjore gjithashtu:

- Ndalohet prerja ilegale e trungjeve dhe pjesëve të tij;
- Ndalohet marrja ilegale e asortimenteve të stivosura – paluara;

⁸³ UA mbi Normat Teknike të Planifikimit hapësinor

- Ndalohet nxjerrja, shkatërrimi ose dëmtimi i fidanëve në fidanishtet e reja dhe fidanët në kulturat pyjore;
- Ndalohet degradimi dhe devastimi i pyjeve;
- Ndalohet kullotja ilegale dhe dëmtimi i lastarëve të trungjeve të reja;
- Ndalohet shkatërrimi dhe dëmtimi i rrugëve, rrethojave, shenjave kufizuese, sinjalizuese dhe ndaluese në pyje;
- Ndalohet ndezja e zjarrit në pyje, si dhe ndezja e zjarrit në largësi deri 200m nga kufiri pyjor;
- Ndalohet vjedhja, dëmtimi ose shkatërrimi i prodhimeve jo drunore, vjelja dhe grumbullimi ilegal i tyre;
- Ndalohet mihja e dheut, nxjerrja e gurëve, zhavorrit, rërës, humusit në pyje dhe tokat pyjore pa leje të organit përgjegjës;
- Ndalohet ndotja e pyllit dhe tokës pyjore, ujërave, burimeve;
- Ndalohet hapja e rrugëve pyjore pa lejen e organit përgjegjës;
- Ndalohet gjuetia nga persona të pa autorizuar sipas Ligjit për Gjuetinë;
- Ndalohet shfrytëzimi dhe qarkullimi i prodhimeve pyjore pa lejen e Autoritetit pyjor komunal;
- Ndalohet hedhja dhe deponimi i mbeturinave në pyje;
- Ndalohet uzurpimi i pyjeve dhe tokave pyjore;
- Mbledhja dhe grumbullimi i frutave të egra në zonat pyjore duhet të bëhet sipas procedurave të caktuara nga ligji për mbrojtjen e natyrës nr. 03/L-233, përkatësisht UA nr. 08/2011;
- Ndalohet futja e llojeve të egra të huaja në natyrë duke përfshirë edhe pyjet në territorin e Republikës së Kosovës dhe në ekosistemet në të cilat ato natyrshëm nuk jetojnë;
- Përdorimi i mjeteve për kapjen dhe vrasjen e llojeve të kafshëve të egra si dhe shfrytëzimi i të gjitha mjeteve të cilat mund të shkaktojnë zhdukjen lokale ose shqetësime serioze të popullacioneve të atyre llojeve e posaçërisht ndalohen: kurthet, shigjetat, pajisjet elektrike vrasëse ose joshëse, pajisjet artificiale ndriçuese, pajisjet tjera zhurmuese ose verbuese, transmetues të zërit-magnetofoni, kasetofoni, të cilët emitojnë zëra të thirrjes, dhembjes ose të lajmërimit, pajisjet për ndriçimin e cakt, shënjestrat optike për gjueti natën me mundësi të rritjes elektronike ose paraqitjes së fotografisë, eksplozivet, helmet ose karremat helmues, armët automatike ose gjysmë automatike me karikatorin i cili mund të zërë më shumë se dy (2) fishekë, fluturaket, mjetet motorike në lëvizje dhe mjetet tjera të përcaktuara me konventa ndërkombëtare;
- Ndalohet vjelja, mbledhja, shkatërrimi, prerja ose shkulja e bimëve dhe kërpudhave strikt të mbrojtura të cilat mbijnë vet;
- Ndalohet mbajtja dhe tregtia me llojet e bimëve dhe kërpudhave strikt të mbrojtura të cilat mbijnë vet;
- Ndalohet shfrytëzimi i të mirave të natyrës në mënyrën e cila shkakton:
 - dëmtimin dhe humbjen e plleshmërisë natyrore të tokës;
 - dëmtimin e vlerave sipërfaqësore ose nëntokësore gjeologjike, hidrologjike dhe gjeo-morfologjike;
 - varfërimin e botës natyrore të bimëve, kërpudhave dhe shtazëve;
 - zvogëlimin e larmisë biologjike dhe peizazhore;
 - ndotjen e ujit dhe rrezikimin e shfrytëzimit të tij.

8. SIPËRFAQET E MBROJTURA

Pjesë e këtyre zonave duhet të jenë zona e mbrojtur duke përfshirë edhe zonën e brezit mbrojtës/buferin. Në kuadër të sipërfaqeve të mbrojtura përfshihen edhe zonat e trashëgimisë kulturore dhe zonat e mbrojtura të natyrës me të gjitha kategoritë e tyre të cilat mund të klasifikohen nga MEA si Zona të veçanta;

8.1. ZONAT E TRASHËGIMISË KULTURORE

- Përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen e këtyre zonave është niveli qendror (HZKos), ndërsa, niveli i komunave (HZKom) përkatësisht drejtoritë e tyre përveç bartjes së informatave nga niveli qendror, bënë trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen edhe të kategorive më të ulëta.
- Sipërfaqet e mbrojtura përbëhen nga perimetri i vend-shtrirjes, të shpallur nën mbrojtje shtetërore dhe të zonës mbrojtëse të mjedisit rrethues me rrethësi (50) apo njëqind (100) metra nga perimetri, apo siç është përcaktuar nga institucioni përgjegjës, për të cilat duhet të respektohen kushtet e mëposhtme sipas të cilave ndalohen:
 - Ndërtimet e rrugëve magjistrale dhe rajonale në afërsi të monumenteve me trashëgimi kulturore nën mbrojtje të përkohshme/ përhershme;
 - Ndërtimet e reja të objekteve më të larta se lartësia e objekteve/ monumenteve të trashëgimisë kulturore në zonën buferike 50/100 m'. Ndërtimet e reja duhet të jenë në harmoni të ndërtimit, arkitekturës dhe përdorimit të materialit ndërtimor;
 - Ndërtimet e industrisë së rëndë në afërsi të monumenteve me TK;
 - Ndërtimet e shtyllave masive dhe furnizuesve me rrymë elektrike;
 - Ndërtimet që ndikojnë në shpyllëzim apo ndotje të mjedisit;
 - Ndërtimet më të larta se monumenti kulturor.
- Të gjitha punët për modifikim ose demolim të një monumenti arkitekturor ose ndonjë veprim konservues ose restaurues që mund të ndikojnë në vlerat atribuese të monumentit, kërkojnë pëlqimin me shkrim të Institucionit kompetent.
- Të gjitha punët për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues për mbulesën e jashtme të ndërtesave të përfshira në ansamble ose zona konservuese arkitekturale kërkojnë pëlqim me shkrim nga Institucioni kompetent.
- Aplikimi për leje për ndërtimin e ndërtesave ose krijimtari tjetër brenda zonës së mbrojtur të një monumenti arkitekturor, ose brenda një hapësire konservuese arkitekturore, ose që ndikon në mjedisin e një asambleje, paraqitet për shqyrtim në Institucionin kompetent. Institucioni kompetent ka veto mbi dhënien e një lejeje të tillë. Nëse Institucioni kompetent nuk përgjigjet brenda 15 ditëve në lidhje me aplikimin për ndërtimin e ndërtesave ose zhvillimeve tjera, leja mund të përcaktohet nga autoriteti relevant për planifikim dhe ndërtim.

Zonat arkeologjike

- Rezervatet arkeologjike janë hapësirat e një rëndësie të veçantë për arkeologjinë të cilat ruhen për gjeneratat e ardhshme dhe përcaktohen në një plan nga Institucioni kompetent.
- Në zonat e ditura arkeologjike nuk mund të marrët leja për të filluar punën, para se të bëhet një studim vlerësues i trashëgimisë arkeologjike nga institucioni kompetent;
- Nuk lejohet asnjë veprimtari që shkakton dëmtim të ndonjë rezervati arkeologjik pa lejen e shkruar nga Institucioni kompetent.
- Çdo aplikim për leje të ndërtimit brenda Zonës së mbrojtur të një vendi të trashëgimisë arkeologjike paraqitet për shqyrtim në Institucionin kompetent. Institucioni kompetent ka veton mbi dhënien e një lejeje të tillë. Nëse Institucioni kompetent nuk përgjigjet brenda 20 ditësh, leja mund të përcaktohet nga autoriteti relevant i planifikimit dhe ndërtimit.

8.2. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS

Në kuadër të këtyre zonave bëjnë pjesë të gjitha kategoritë e mbrojtura të natyrës të ndara sipas nivelit të përgjegjësisë të nivelit qendror ose lokal, të cilët e bëjnë shpalljen dhe merren me trajtimin e duhur të tyre. Me qëllim të mbrojtjes dhe trajtimit të duhur të tyre duhet të respektohen kushtet elementare sipas të cilave:

- Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për shpalljen e: Rezervateve strikte natyrore; Parqeve Kombëtare; Parqeve të natyrës; dhe Monumenteve të natyrës me rëndësi të veçantë;
- Zonat e mbrojtura të natyrës të cilat shtrihen në territorin e dy e më shumë komunave me propozim të Ministrisë i shpallë Qeveria;
- Kuvendi Komunal bën shpalljen dhe trajtimin e duhur të: Monumenteve të natyrës dhe Peizazheve të mbrojtura, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.
- Objektet speleologjike janë pronë e Republikës së Kosovës;

Në bazë të rregullave në fuqi, në të gjitha zonat e mësipërme duhet të respektohen kushtet sipas të cilave:

- Ndalohet shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore në zonat e mbrojtura të natyrës;
- Ndalohet vendosja e pllakave informative, panove reklamuese ose tjera, pa lejen e MEA, përkatësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës;
- Në rezervatin strikt natyror ndalohet kryerja e veprimtarive ekonomike dhe çfarëdo ndërtimi, për hulumtime dhe vizita arsimore pa leje nga MEA;
- Në parkun kombëtar, Monumentin e natyrës, Peisazhin e mbrojtur, ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës dhe veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij duke përfshirë edhe ndërtimin e hidrocentraleve;
- Në parkun kombëtar lejohen punët dhe veprimtaritë me të cilat nuk rrezikohet natyra burimore, veprimtaritë hoteliere – turistike dhe rekreative të cilat janë në funksion të vizitave, arsimimit, të nevojave shëndetësore – rekreative dhe turistike, bujqësia ekstensive tradicionale dhe veprimtari tjera në pajtim me rregullat në fuqi;
- Në parkun e natyrës lejohen veprimtaritë ekonomike dhe aktivitetet tjera me të cilat nuk rrezikohet roli dhe karakteristikat e rëndësishme të tij. Mënyra e kryerjes së aktiviteteve ekonomike dhe shfrytëzimi i të mirave të natyrës në parkun e natyrës përcaktohen me kushtet për mbrojtjen e natyrës;
- Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukturë gjeologjike, sediment etj., gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore;
- Ligatinat paraqesin vlera natyrore dhe për këtë duhet të ruhen në gjendje natyrore ose të përafërt natyrore;
- Zonat ndërtimore në hapësirat e mbrojtura të natyrës (parqe nacionale, parqe rajonale, parqe natyrore etj.) përcaktohen me planet hapësinore dhe planet rregulluese për këto hapësira;
- Në zonat e mbrojtura ndalohet kryerja e ushtrimeve dhe aktiviteteve të tjera ushtarake të cilat mund t'i rrezikojnë vlerat e natyrës;
- Kushtet tjera specifike duhet të merren nga planet hapësinore në fuqi për zonat e veçanta të natyrës.

9. ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA

Në kuadër të këtyre zonave (Harta Nr. 2) duhet të respektohen kushtet e mëposhtme sipas të cilave ndalohen:

- Zhvillimet industriale, si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale;
- Ndërtimi i digave;
- Centraleve elektrike apo linjave të tensionit;
- Furrave;
- Fabrikave;
- Rrugëve tranzite në zonat rurale; dhe
- Zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

Përveç aktiviteteve të ndaluara në kuadër të ZVM janë edhe disa aktivitete kë kufizuara për të cilat Komuna e caktuar duhet të informojë Kishën Ortodokse për marrëveshje, por nëse nuk ka rezultat atëherë duhet të informohet KZM-ja dhe të arrihet një rezultat i caktuar. Aktivitetet e kufizuara janë:

- Ndërtimet komerciale si: ndërtesat më të larta se monumenti kulturor;
- Ndërtimi i rrugëve;
- Super-marketeve, shitoreve;
- Restoranteve, bareve, kafeterive, hoteleve, moteleve;
- Pompat e benzinës, automekanik, punëtorive,
- Klubeve të natës, tubimet publike, dhe
- Urbanizimi i tokës bujqësore.

10. ZONAT E BANIMIT

Bazë për projektimin dhe ndërtimin e njësive të banimit duhet të jenë normat teknike të Planifikimit Hapësinor të hartuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor, Ligjin e ndërtimit dhe UA që dalin nga këto ligje.

Në kuadër të këtyre zonave duhet të përfshihen të gjitha zonat ku pjesa më e madhe e objekteve shfrytëzohen për banim, duke përfshirë të gjitha kategoritë e banimit. Përmbajtja e kësaj zone ndryshon varësisht nga përpjesa e trajtimit, interpretimit dhe nivelit të paraqitjes.

Përgjegjës për trajtimin, interpretimin dhe paraqitjen është niveli qendror, i cili duke iu referuar përpjesës (1:25.000) do të bëjë interpretimin dhe prezantimin në nivel vendbanimi. Kjo do të thotë se zona urbane e komunës dhe zonat e ndërtuara rurale do të përkufizohen si vendbanime me banimin si kategori dominuese, dhe si të tilla do të trajtohen përmes rekomandimeve dhe kushteve përkatëse zhvillimore.

Më tutje, trajtimi, interpretimi dhe paraqitja më e detajuar (përpjesa 1:5.000 ose sipas nevojës) do të vazhdohet nga niveli lokal (komunat), përmes kushteve zhvillimore dhe ndërtimore deri në nivel të parcelës kadastrale (ndërtimore):

Planifikimi i dendësisë së banimit sipas strukturave të ndërtuara:

- Për tu pajisur me leje ndërtimore (kushte ndërtimore) për shtëpi individuale apo ndërtesë të banimit kolektiv duhet të aplikohet në komunë dhe të përgatitet dokumentacioni sipas Kodit të Ndërtimit dhe UA që rregullon procedurën e lëshimit të lejes me qëllim të pajisjes me kushte ndërtimore të parapara në Ligjin për Planifikim Hapësinor.

- Vlerat optimale të planifikimit të banimit duhet të përcaktohen si vlera neto, duke përfshirë rrugët dhe hapësirat publike, që të mund të zbatohen në tërësi dhe në veçanti për çdo parcelë kadastrale për zhvillim.
- Për sipërfaqet rurale me intensitet të ulët dendësia e banimit duhet të jetë: 5-10 banorë/ha;
- Për sipërfaqet rurale me intensitet të lartë dendësia e banimit duhet të jetë: 25-50 banorë/ha;
- Për sipërfaqet rurale të përgjithshme dendësia e banimit duhet të jetë: 1-5 banorë/ha;
- Për sipërfaqet sub-urbane dendësia e banimit duhet të jetë: 30-105 banorë/ha;
- Për sipërfaqet urbane të përgjithshme dendësia e banimit duhet të jetë: 105-200 banorë/ha;
- Për sipërfaqe urbane qendrore dendësia e banimit nuk është e përcaktuar;
- Për sipërfaqe urbane kryesore dendësia e banimit nuk është e përcaktuar;

Dendësia e ndërtesave të banimit me një njësi (në të cilat përfshihen: shtëpitë e veçanta, shtëpitë dyshe, shtëpitë në varg, etj.) duhet të jetë:

- Në sipërfaqet për banim me një apo dy njësi dendësia optimale duhet të jetë prej 80-150 banorë/ha;
- Në sipërfaqet për banim me një apo dy njësi dendësia maksimale duhet të jetë deri 250 banorë/ha;

Dendësia e ndërtesave të banimit me shumë njësi (në të cilat përfshihen ndërtesat e veçanta, ndërtesat në varg, ndërtesat terracore, etj.) duhet të jetë:

- Në sipërfaqet për banim me shumë njësi dendësia optimale duhet të jetë prej 250-350 banor/ha;
- Në sipërfaqet për banim me shumë njësi dendësia maksimale duhet të jetë prej 550 banor/ha;

Distanca ndërmjet ndërtesave përcaktohet në bazë të kriterëve kyçe: diellosjes, ndriçimit natyror, privatësisë dhe sigurisë.

- Distanca ndërmjet ndërtesave të banimit duhet të jetë $\geq 2h$ e ndërtesës më të lartë, për të plotësuar kriterin e diellosjes, ndriçimit natyror dhe privatësisë;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit me hapje primare në fasada, duhet të jetë jo më e vogël se lartësia e ndërtesës më të lartë të banimit. Në rastet kur zona është e ndërtuar me 60% të sipërfaqes së shputës, aplikohet rregulli për sigurinë ndaj zjarrit⁸⁴, përcaktohet nënkalmi për qarkullimin e automjeteve për mbrojtje nga zjarri, që duhet të jetë të paktën 4.00m i gjerë dhe 5.00m i lartë;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit në anët në të cilat nuk ka hapje primare apo ka vetëm hapje të kthinave sekondare, duhet të jetë jo më e vogël se 4.00m, apo në rastet kur distanca është 0.00m duhet të planifikohet nënkalmi për automjete për zjarr-fikje i cili duhet të jetë me gjerësi $\geq 4.00m$ dhe lartësi $\geq 5.00m$;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit (me kthina primare në fasada), ndaj ndërtesave afariste, për krijimin e privatësisë së banimit, nuk duhet të jetë më e vogël se lartësia e ndërtesës afariste;
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe ndërtesat shëndetësore nuk duhet të jetë më e vogël se 1.5 herë lartësia e ndërtesës më të lartë të banimit, në anën jugore ose juglindore;
- Distancat në mes të ndërtesave duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës. Në rast të pamundësisë për të plotësuar këtë kriter, përcaktohet nënkalmi për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4.00m i gjerë dhe 5.00m i lartë;
- Lokacioni për Zonat e banimit duhet të jetë në largësi optimale nga zonat industriale;
- Kushtet tjera specifike duhet të bazohen në normat teknike në fuqi.

⁸⁴ Rregullore nr. 24/2012 për normat teknike për mbrojtje nga zjarri të objekteve të larta

11. ZONAT URBANE

- Autoritetet lokale janë të obligueshme të përcaktojnë kufirin e zonave urbane (Harta Nr. 2) për komunat e veta përkatëse. Pjesë e këtyre zonave duhet të jenë edhe sipërfaqet e planifikuara për zgjerimin e zonës urbane;
- Kufiri i përcaktuar i zonës urbane, me procedurë legale duhet të bëhet pjesë e librave kadastral dhe bazë për përfshirjen e ndërtimeve në kuadër të sistemit të tatimit në pronë;
- Kufijtë aktual urban të prezantuar në HZKos janë rezultat i analizës paraprake të zgjerimit urban në periudhën 2000-2018. Si të tillë, kufijtë mund përvetësohen/legalizohen ose të ndryshohen nga komunat përkatëse;
- Gjatë hartimit të planeve komunale të insistohet në zona kompakte urbane, dhe jo zona të shpërndara, të cilat rrisin koston e implementimit (kërkesa për shërbime dhe infrastrukturë shtesë);
- Të garantohen kushtet për zonë të pastër dhe të shëndetshme urbane, duke përfshirë edhe qasjen e qytetarëve në ujë të pastër dhe të pijshëm (BE Direktiva për ujë të pijshëm 98/8/EC);
- Të gjitha zonat urbane me më shumë se 2.000 banorë duhet të kenë të instaluar dhe funksional rrjetin e kanalizimit duke përfshirë edhe impiantin për pastrimin e ujit (BE Direktiva për trajtimin e ujërave të zeza 91/271/EEC);
- Garantimi i ajrit kualitativ dhe të pastër për banorët e vet me theks të veçantë të atyre që jetojnë në zona urbane (BE Direktiva për ajër të pastër 2008/50/EC). Në zonat ku ky standard nuk mund të sigurohet, duhet të hartohen planet menaxhuese për sigurimin e ajrit të pastër;
- Të vendoset sistemi i qëndrueshëm i bartjes së mbeturinave, duke përfshirë ripërdorimin dhe riciklimin e tyre (një pjesë e konsiderueshme e zonave urbane në Evropë tashmë e kanë funksional një sistem të tillë);
- Të sigurohen hapësira të mjaftueshme të gjelbra dhe të qeta, të rëndësishme dhe me ndikim direkt në mjedis dhe kualitetin e jetës në përgjithësi;
- Zgjerimi i zonave urbane duhet të orjentohej në drejtim të tokave me kualitet më të ulët bujqësor dhe e kalkuluar në raport me rritjen e vlerësuar të popullatës;
- Gjatë planifikimit të zonave të reja dhe adaptimit të zonave të vjetra urbane, të merret në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe shtimi i hapësirave të lira. Përcaktimi dhe planifikimi i duhur i hapësirave të lira kontribuon në përmirësimin e shëndetit të qytetarëve, inkurajojnë qytetarët që të ecin dhe ti përdorin biçikletat më shumë. Në përgjithësi hapësirat e gjelbra publike ndikojnë në reduktimin e ndryshimeve klimatike;
- Sipas BE Direktivës për Zogjtë e Egër, biodiversiteti duhet të jetë pjesë integrale e planeve hapësinore dhe urbane;
- Respektimi i BE Direktivës për zhurmën është i domosdoshëm, me theks të veçantë në zonat e ndjeshme (spitale, shkollat etj.). Harta zonale komunale duhet ti identifikojë zonat në fjalë dhe të propozojë veprime konkrete për sigurimin e qetësisë së nevojshme;
- Planet e transportit publik duhet të jenë pjesë e rëndësishme e dokumenteve lokale duke përfshirë edhe Hartën Zonale Komunale. Transporti efikas urban është bazë për kualitetin jetësor të qytetarëve dhe zhvillimit të përgjithshëm të zonës përkatëse. Planet e tilla përpos rregullimit të trafikut brenda dhe jashtë zonave urbane, duhet të promovojnë përdorimin e transportit publik, biçikletave dhe ecjes, të cilat do të kenë ndikim pozitiv në mjedis;
- Mbrojtja nga ndryshimet klimatike është proces i gjatë dhe me karakter global, në të cilin duhet të përfshihen edhe komunat e Kosovës. Në këtë drejtim, në kuadër të procesit të hartimit të hartës zonale komunale duhet të parashihen veprime të qëndrueshme që ndikojnë në zbutjen e këtij fenomeni. Një pjesë e konsiderueshme e qyteteve evropiane përmes planeve të qëndrueshme të veprimit për energji, kanë ndërmarrë veprime që do të ndikojnë në uljen e CO2 emisioneve për 20% deri në v.2020;

12. ZONAT RURALE

- Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore dhe shfrytëzimit më efikas të hapësirës, zona rurale duhet të konsiderohen vetëm hapësirat e ndërtuara dhe hapësirat e planifikuara për zgjerimin e fshatit (Harta Nr. 2), ndërsa përmbajtjet tjera (toka bujqësore, pyjore, ujore etj.) duhet të trajtohen në kategoritë tjera të zonimit;
- Autoritetet përkatëse komunale duhet përmes Hartës Zonale Komunale të bëjnë përkufizimin e territorit të fshatit, në kuadër të të cilit përpos objekteve ekzistuese duhet të përfshihen edhe sipërfaqet për zhvillimin e ardhshëm të fshatit përkatës;
- Territori i fshatit mund të ketë një ose më shumë njësi (lagje) të përkufizuara, shuma e të cilave përbënë sipërfaqen e tërësishme të fshatit përkatës;
- Objektet që mbeten jashtë kufirit të fshatit do të trajtohen me dispozitën e jo-konformitetit;
- Kushtet e ndërtimit lejohen vetëm në zonat e përkufizuara të fshatit sipas rregullave të përcaktuara në HZKom ose sipas kushteve të definuara në plane rregulluese të hollësishme;
- Kushtet e ndërtimit jashtë kufirit të fshatit do të lejohen vetëm në rastet kur bëhet fjalë për zhvillim të rëndësishëm të veçantë për shtetin;
- Kufiri i përcaktuar i fshatit, me procedurë legale duhet të bëhet pjesë e librave kadastral dhe bazë për përfshirjen e ndërtimeve në kuadër të sistemit të tatimit në pronë;

13. ZONAT MBISHTRESORE

Zonat mbishtresore shtrihen mbi zona të caktuara bazë me qëllim të vendosjes së kushteve zhvillimore apo ndërtimore plotësuese, përveç atyre për zonat bazë. Ato mund ta mbulojnë një ose më shumë zona bazë dhe kufijtë e tyre mund të mos përputhen me kufijtë e zonave mbi të cilat shtrihen. Zonat mbishtresore vendosin edhe masa mbrojtëse për resurse të ndryshme dhe për hapësirat territoriale me vlera, veçori dhe karakteristika specifike siç janë: sipërfaqet nën mbrojtje të shtetit, sipërfaqet me rrezikshmëri nga fenomenet e natyrës, resurset natyrore, kulturore, historike, bujqësore, minerale, turistike, shkencore, shëndetësore dhe ato të sigurisë publike e shtetërore.

Kushtet zhvillimore në zonat mbishtresore të përcaktuara në Hartën Zonale të Kosovës i mbizotërojnë kushtet e përcaktuara në dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit më të ultë. Nëse për ndonjë zonë bazë janë caktuar kushte që janë në kundërshtim me kushtet për zonën mbishtresore, kushtet për zonën mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre për zonën bazë.

Zona mbishtresore janë: zonat me rrezikshmëri të përmytjes, zonat erozive, zonat e rrëshqitjeve dhe rrokullisjeve të shkëmbinjve, zonat sizmike, zonat e pasurive minerale, zonat me potencial për akumulacione ujore, zonat e akuifereve. Disa nga këto zona mbishtresore, në këtë hartë zonale janë konsideruar njëkohësisht edhe si zona bazë dhe për to janë dhënë kushte zhvillimore dhe masa mbrojtëse.

13.1. Zonat me rrezikshmëri të përmytjes

Zonat në fjalë janë hapësira të cilat në mënyrë permanente kërcënohen nga rreziku për t'u përmytur dhe si të tilla gjatë procesit të planifikimit duhet të kenë trajtim dhe kushte të veçanta zhvillimore. Harta Nr. 7 tregon ku gjenden këto zona.

Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona:

- Ndalohet gërmimi i tokës në argjinatura mbrojtëse;
- Ndalohet nxjerrja e inerteve në hapësirën së paku 100 m larg shtratit të lumit;
- Ndalohen ndërtimet në më pak se 20 m largësi nga vepra mbrojtëse e argjinaturës;
- Ndalohet shkarkimi i çdo lloj materie të lëngët apo të ngurtë në shtrat dhe në afërsi të veprave mbrojtëse;

- Ndalohet mbjellja e drurëve në largësi së paku 30 m larg nga vija e nivelit maksimal të ujit;
- Ndalohet çdo intervenim në shtratin e lumit (hapësira e kufirit maksimal të ujit) pa leje paraprake ujore;
- Ndalohet ndërtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit, përkatësisht ndërtimi i puseve dhe rezervuarëve për ujë të pijes;
- Ndalohet ndërtimi i stallave me kapacitet mbi 50 krerë gjedhe, impiantet për rritjen intensive të shpezëve, rritja e peshkut në hurdha;
- Ndalohet ndërtimi i pishinave dhe kapaciteteve hoteliere;
- Ndalohen: varrezat e veturave, autoserviset, industritë që kanë për bazë ose që përdorin materie të lëngshme kimike, deponimi i naftës dhe derivateve të saj, ndërtimi i rrugëve pa sistemin e largimit të ujërave atmosferik, eksploatimi i resurseve minerale, industritë ushqimore, gropat septike, deponitë e mbeturinave dhe të gjitha instalimet për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave;
- Ndalohet zgjerimi i varrezave ekzistuese dhe ndërtimi i atyre të reja;
- Ndalohet ndërtimi i bodrumeve, përveç rasteve specifike kur garantohet me përdorimin e masave inxhinierike shtesë, të përshkruara në mënyrë të detajuar në dokumentacionin teknik të lejes ndërtimore dhe të testuara ndërkombëtarisht;
- Të gjitha ndërtimet duhet të realizohen në atë mënyrë që themelet e ndërtesave, përkatësisht pllaka bazë të jetë në kuotë të njëjtë me urën më të afërt të lumit më të afërt;
- Të riparohen argjinaturat mbrojtëse dhe të ndërtohen të reja në shtretërit e lumenjve të Drinit të Bardhë, Ibër-Sitnica, Morava e Binçës dhe Lepenc;
- Të mbillen drunjt në afërsi 20 metra nga pjesa e brendshme dhe 10 metra nga pjesa e jashtme e argjinaturave (urbanizimi i shtretërve lumor);
- Të ndërtohen pengesa mbrojtëse (pyllëzim, ngritje të nivelit me shkëmbi dhe masa tjera hidroteknike) në pjesët e tokave që kanë potencial të nënshtrohen vërshimeve përgjatë lumenjve me potencial të rrezikut nga vërshimet;
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga depozitimi i inerteve, mbeturinat e ngurta dhe bimët e vetë rritura (në të gjitha pellgjet lumore).

13.2. Zonat erozive

Gjatë procesit të planifikimit kujdes i veçantë duhet ti kushtohet zonave erozive ndaj të cilave, përveç faktorëve natyror, procesin eroziv në shkallë të madhe e ka rritur faktori njeri. Në shkallë globale ky faktor ka ndikuar në rritjen e erozionit 10-40 herë me shumë se faktori natyror, prandaj trajtimi i duhur i këtyre zonave do të ndikojë në zbutjen e efektit të tyre negativ në të gjitha aspektet, duke përfshirë atë ekonomik, social, mjedisor dhe infrastrukturor.

Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona:

- Ndalohet prerja e druve dhe shkurreve;
- Ndalohet shpyllëzimi;
- Në rast të rrezikut eroziv në kullosat përkatëse ndalohet dhënia e lejeve për kullotje;
- Ndalohet shndërrimi i kullosave dhe livadheve në toka punuese të rrezikuara nga erozioni;
- Nevojitet përcaktimi paraprak i mënyrës së punimit dhe shfrytëzimit të tokës;
- Ndalohet pyllëzimi i detyruar pa një studim paraprak;
- Ndalohet nxjerrja e inerteve;
- Ndalohet ndërtimi i objekteve pa leje mjedisore në zonat erozive;

- Ndalohet ndërtimi i objekteve të cilat rrezikojnë stabilitetin e tokës siç janë pendat, kanalet, hurdat e peshqve;
- Ndalohet hedhja e mbeturinave;
- Pyllëzimi i vendeve të zhveshura;
- Meliorimi i pyjeve dhe kullosave;
- Në rajonet kodrinore malore duhet të studiohet mënyra e punimit të tokës dhe të dëgjohen këshillat nga ekspertët bujqësor;
- Pyllëzimi me fidanë por edhe me barishte;
- Ndërrimi i kulturave bujqësore nga ato barishtore në pyjore;
- Ndërtimi i tarracave dhe objekteve;
- Rregullimi i shtretërve të rrëkeve;
- Pastrimi shtretërve të rrëkeve nga bimët e vet rritura;
- Pastrimi i shtretërve të rrëkeve nga depozitimi i inerteve me leje paraprake ujore.

13.3. Zonat e rrëshqitjeve dhe rrokullisjeve të shkëmbinjeve

Në Kosovë janë të identifikuar 21 zona potenciale të rrëshqitjeve dhe 10 zona me rrezikshmëri të rrokullisjeve të masave shkëmbore. Sipas të dhënave të vitit 2015 zonat më të rrezikuara janë paraqitur në hartën Nr.7.

Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona:

- Në zonat ku kanë ndodhur rrëshqitjet dhe rrokullisjet e shkëmbinjeve ndalohen të gjitha llojet e ndërtimeve;
- Të bëhet studimi gjeologo-gjeomekanik i tokave ndërtimore;
- Të autorizohen institucionet në bashkëpunim me komunat për hartimin dhe zbatimin e planeve për parandalimin dhe menaxhimin e rrëshqitjeve të terrenit dhe zonave ku ka rrokullisje të shkëmbinjeve.

13.4. Zonat sizmike


Pjesa më e madhe e territorit të Republikës së Kosovës konsiderohet të jetë me rrezik sizmik mesatar. Harta e mëposhtme tregon se cilat zona janë me rrezik më të lartë sizmik. Duke ju referuar të dhënave nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, Harta në fjalë paraqet Rrezikun Sizmik, me 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (periudhë përsëritje 475 vjet), në termat e nxitimit maksimal të truallit (PGA) për kushte truall-shkëmb, me shpejtësi mesatare të valëve tërthore në 30 metrat e para të tokës $VS=800$ m/sek, që i korrespondon kategorisë A të truallit sipas klasifikimit të Eurokodit 8. Kështu që rezultatet e vlerësimit janë në pajtueshmëri të plotë me standardin e Eurokodit 8 për zonimin sizmik dhe kodet e ndërtimit.

Në përputhshmëri të plotë me kriteret dhe standartet Evropiane, Eurokodi 8 me statusin e normës në të ashtuquajturin Standard Evropian (EN), i cili është tashmë obligim për vendet e Bashkimit Evropian dhe për të gjithë ato vende që synojnë t'i bashkëngjiten atij.

Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona:

- Të gjitha ndërtimet në fazën e projektimit dhe ndërtimit duhet ti nënshtrohen rregullave të EUROCODI 8;
- Shputa/themelet e ndërtesave me kapacitet të lartë, përkatësisht disa nga objektet e kategorisë së dytë dhe të gjitha ndërtesat e kategorisë së tretë duhet t'iu nënshtrohen studimeve gjeomekanike;
- Duhet të përpunohet harta e rrezikut sizmik të vendit në bazë të të dhënave sizmike për nivele të ndryshme të rrezikut sizmik të pranueshëm për planifikim hapësinor, projektim dhe ndërtim;

- Të punohen hartat e mikrozonimit sizmik për zonat urbane të Kosovës;
- Kalkulimet statike për ndërtim duhet të bëhen sipas shkallës së Rihterit të përcaktuar për këto zona në hartën sizmike të Kosovës. Kjo për arsye të sigurimit të stabilitetit të objekteve dhe të sigurisë së shfrytëzuesve.



Harta e rrezikut sizmik për territorin e Kosovës – burim i informatave nga Rrjeti Sizmik - Shërbimi Gjeologjik i Kosovës (2009)

13.5. Zonat e pasurive minerale

Këto janë zonat ku ndodhen rezervat e qymyrit dhe pasuritë tjera minerale.

Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona:

- Ndërtimet pa kufizime lejohen vetëm mbi resurset minerale metalike që gjenden në thellësi të mëdha, atëherë kur shfrytëzimi i tyre nuk përbën asnjë kërcënim për strukturat ndërtimore në sipërfaqe;
- Ndalohet ndërtimi i të gjitha strukturave të përhershme ndërtimore dhe instalimeve permanente teknike në zonat e rezervave të linjitet të parapara me të gjitha strategjitë kombëtare për shfrytëzimin e tyre afatshkurtër dhe afatgjatë për nevoja të furnizimit të TC-A, TC-B dhe TC-Kosova e Re;
- Të gjitha ndërtimet dhe pronat që shtrihen mbi rezervat minerale kombëtare, kurdoherë mund të jenë subjekt i shpronësimit dhe zhvendosjes nga Qeveria e Kosovës;
- Në zonat e rezervave minerare dhe të fushave të eksploatimit duke përfshirë edhe gurthyesit, ndalohet planifikimi apo ushtrimi i ndonjë veprimtarie për shfrytëzimin e resurseve minerare në sipërfaqet që ndodhen:
 - 200 m ose më afër nga kufiri i një vendbanimi;
 - 250 m ose më afër nga ndonjë shtëpi, ndërtesë e banuar ose përkohësisht e pabanuar;
 - 20 m ose më afër (në varësi nga pjerrtësia e lejuar e shpatit të shfrytëzimit e planifikuar kjo në projektin e shfrytëzimit) nga ndonjë tokë e pastruar ose lëvruar, ose në ndonjë mënyrë tjetër të përgatitur për mbjelljen e farërave bujqësore, ose mbi të cilën janë duke u rritur të mbjella bujqësore, përveç kur bartësi i licencës ose lejes ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë;
 - 200 m ose më afër nga ndonjë pendë ose rezervuar;
 - 150 m ose më afër të ndonjë termocentrali, largpërçuesi (35 KW ose më lartë) ose lumi. Termocentrali duhet të jetë jo më afër se 150 m ose jo më larg se 250 m nga largpërçuesit nëse aktiviteti minerar zhvillohet pa minim;
 - 60 m ose më afër nga ndonjë rrugë e sistemit kombëtar;
 - 100 m ose më afër nga varrezat;
 - 100 m ose më afër nga ndonjë monument antik ose kombëtar i mbrojtur me ligj; ose 500 m ose më afër nëse përdoret eksploziv;
 - 500 m ose më afër ndonjë aeroporti ose pjese të zonës së sigurisë së aviacionit;
 - brenda parkut kombëtar ose parkut komunal të mbrojtur me ligj;
 - 500 m ose më afër nga ndonjë ndërtesë e banimit ose institucionale dhe publike, nëse përdoret eksploziv.

13.6. Zonat me potencial për akumulacione ujore

Në këto zona përfshihen të gjitha ato sipërfaqe, në të cilat masterplani i vitit 1983 për menaxhimin e ujërave e ka paraparë të krijohen akumulacione ujore. Këto janë pra vende ku ka mundësi të krijohen liqene artificial, por me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021 është planifikuar që të për të vetëm disa prej tyre të realizohen. Ata janë akumulacioni i Shipashnicës, akumulacioni i Hogoshtit, ai i Kremenatës dhe ai i Gjyrishevcit, të gjithë këta në territorin e Komunës së Kamenicës.

Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona:

- Përveç ndërtesave të përkohshme, ndalohet ndërtimi i të gjitha strukturave të përhershme ndërtimore dhe instalimeve permanente teknike në zonat ku me SKZH 2016-2021 është planifikuar të bëhen liqenet artificial;

- Ndalohen të gjitha aktivitetet që e ndotin dhe e degradojnë mjedisin në zonat me potencial për akumulacione ujore;
- Të gjitha ndërtimet dhe pronat që shtrihen në zonat me potencial për akumulacione ujore, kurdoherë mund të jenë subjekt i shpronësimit dhe zhvendosjes nga Qeveria e Kosovës.

13.7. Zonat e akuifereve

Këto zona përfshijnë sipërfaqet nën të cilat ka rezerva ujore nëntokësore. Zonat e akuifereve janë pjesë e zonave ujore, por këto zona mund të konsiderohen edhe si zona mbishtresore. Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona mbishtresore janë po ato që janë dhënë për zonat ujore, konkretisht akuiferet.

13.8. Zonat e ndikuara nga zhurma⁸⁵

Vlerat e lejuara të emisioneve të zhurmës nga trafiku rrugor:

Mjedisi	Vlerat kufitare të burimeve të zhurmës (dBA)	
	Ditë, L _d	Natë, L _n
Zonat industriale	69	59
Fshatrat dhe zonat e përziera	64	54
Zonat e banuara dhe vendbanimet e vogla	59	49
Spitalet, shkollat, institucionet për rehabilitim dhe shtëpitë e pleqve	57	47

Vlerat e lejuara të emisioneve të zhurmës nga trafiku hekurudhor:

Mjedisi	Vlerat kufitare të burimeve të zhurmës (dBA)	
	Ditë, L _d	Natë, L _n
Zonat industriale	68	58
Fshatrat dhe zonat e përziera	65	53
Zonat e banuara dhe vendbanimet e vogla	57	48
Spitalet, shkollat, institucionet për rehabilitim dhe shtëpitë e pleqve	54	45

Masat e mbrojtjes nga zhurma, kanë për qëllim pengimin e paraqitjes së zhurmës, respektivisht zvogëlimin e zhurmës ekzistuese në nivel optimal. Këto masa përfshijnë:

- Planifikimin e përdorimit të hapësirës në atë mënyrë që mos të rrezikon funksionin e banimit;
- Ndalimin e ndryshimit të përdorimit të planifikuar të hapësirës në përdorim, i cili nuk është në pajtueshmëri sipas dokumentit të planifikimit, në veçanti kur kjo mund ta rrezikon funksionin e banimit;
- Vendosjen e brezave të gjelbër mbrojtës midis ndërtesave ekonomike të planifikuara, të cilat mund të jenë burim i zhurmës me intensitet më të lartë dhe ndërtesave ekzistuese të banimit, apo edhe midis ndërtesave në kuadër të zonave të reja ekonomike/industriale, të planifikuara;
- Detyrimin për marrjen e masave teknike mbrojtëse ndaj burimeve të zhurmës në zonat me ndërtesa ekzistuese (banim, komerciale, industriale), të cilat nuk janë në pajtueshmëri me përdorimin e planifikuar të hapësirës dhe ku pritet ekspozim ndaj vlerave më të larta të zhurmës se ato të lejuara. Këtu përfshihen masat si: izolimi akustik i fasadave, përzgjedhja e pajisjeve që kanë emetim më të ulët të zhurmës, vendosja e barrierave akustike kudo që është e mundur;
- Në zonat e banimit nuk duhet të planifikohen punëtori zejtare si: përpunimi i drurit, metalit, gurit, plastikës apo të ngjashme, të cilat shkaktojnë zhurmë gjatë procesit të punës. Te objektet e tilla duhet detyrimisht të aplikohet izolimi akustik i ndërtesës dhe instalimi i ventilimit jo të zhurmshëm, meqenëse gjatë punës duhet të mbahen të mbyllura dyert dhe dritaret.
- Në ndërtesat shumë-banesore nuk planifikohen veprimtaritë të cilat përfshijnë punën gjatë natës dhe të cilat mund të shkaktojnë nivel më të lartë të zhurmës se ai i lejuar si rezultat i përdorimit të aparateve,

⁸⁵ Kushtet për zhurmë sipas ligjit të zhurmës Nr. 02/L-102 dhe UA nr. 08/2009;

pajisjeve muzikore apo manipulimeve gjatë procesit të punës (furrat e bukës, klubet e natës, shërbimet ushqimore, tregtare, zanatet, etj.)

- Në objektet shërbyese dhe ato me karakter argëtues (kafiteritë, baret, lojëra të ndryshme, etj.) të cilat ndodhen në afërsi të zonave të banimit, veprimtaria duhet të kushtëzohet me vendosjen e izolimit akustik të ndërtesës dhe punës në ambient të mbyllur dhe instalimin e detyrueshëm të ventilimit.
- Për zvogëlimin e efekteve të zhurmës nga rrugët me trafik më të ngarkuar në dy anët e rrugës duhet të vendosen dru-radhitjet, ndërsa tek vendbanimet përgjatë rrugëve rajonale dru-radhitjet me rend të dyfishtë dhe në zonat me ndjeshmëri më të madhe duhet të bëhet vendosja e barrierave akustike.
- Në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duhet të përfshihet edhe vlerësimi i nivelit të zhurmës dhe masat për mbrojtjen nga zhurma.
- Dhe kërkesat tjera specifike për mbrojtjen nga ndotja e zhurmës, shikuar nga aspekti kohor dhe nga vendit ku buron zhurma, që rrjedhin nga ligji për mbrojtje nga zhurma dhe aktet normative përcjellëse.

14. ZONAT E SHËRBIMEVE - SHËNDETËSIA

Në zonat shëndetësore bëjnë pjesë këto kategori objektsh shëndetësore⁸⁶:

- Institucionet e nivelit primar të kujdesit shëndetësor (Qendra kryesore e mjekësisë familjare me njësitë përbërëse);
- Institucionet e nivelit sekondar të kujdesit shëndetësor (Spitali i përgjithshëm dhe special me njësitë përbërëse, Poliklinika specialistike, Ambulanca specialistike, Ambulanca stomatologjike, Qendra e shëndetit mendor me Shtëpinë për integrim në bashkësi, Qendra e transfuzionit të gjakut, Qendra e rehabilitimit fizikal dhe klimatik, Qendra e mjekësisë sportive, Qendra e mjekësisë së punës, Qendrat rajonale të shëndetësisë publike, Qendra për rehabilitimin e të dëgjuarit dhe të folurit);
- Institucionet e nivelit terciar të kujdesit shëndetësor (Qendra klinike universitare, Qendra klinike universitare stomatologjike, Instituti kombëtar i shëndetësisë publike, Qendra kombëtare e mjekësisë së punës, Qendra kombëtare e mjekësisë Sportive, Qendra kombëtare e transfuzionit të gjakut, Qendra kombëtare e telemjekësisë);
- Barnatoret;
- Institucionet në shërbimin shëndetësor të burgjeve (Ambulanca e burgut, Stacionari i burgut, Institucioni shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta, Institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmijës).

Gjatë përcaktimit të lokacionit dhe vendosjes së objekteve në zonat shëndetësore, duhet të merren parasysh këto kushte:

- Lokacioni duhet të parashihet në parcelë kadastrale për zhvillim që mundëson zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- Lokacioni për objektet e nivelit dytësor duhet të parashihen për vendbanimet me më shumë se 10.000 banorë;
- Lokacioni për objektet e nivelit terciar duhet të parashihen për vendbanimet me më shumë se 100.000;
- Lokacioni duhet të jetë në ambient me qasje të lehtë dhe të sigurt për pacientët, personelin dhe publikun⁸⁷, në terren të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël, të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- Lokacioni duhet të jetë në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik, në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore), në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore-vërshimeve dhe në largësi më të madhe se 2000m nga deponitë e mbeturinave.⁸⁸

⁸⁶ Ligji Nr.04-L125 Për Shëndetësi;

⁸⁷ UA_2006/3 Minimumi i kushteve teknike-mjekësore, hapësira dhe personeli, sipas llojit të Institucionit Shëndetësor.

⁸⁸ Udhëzimit Administrativ nr. 01/2009 mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave.

15. ZONAT E SHËRBIMEVE - ARSIMI

Në zonat e arsimit bëjnë pjesë këto kategori të objekteve arsimore:

- Objektet e arsimit parashkollorë (Qerdhet dhe Kopshtet);
- Objektet e arsimit para-universitar (Shkollat fillore; Shkollat e mesme të ulëta; Shkollat e mesme të larta; Bibliotekat, etj.);
- Objektet e arsimit të lartë (Universitetet; Objektet për hulumtime shkencore; Bibliotekat, etj.);

Gjatë përcaktimit të lokacionit për zona shëndetësore, duhet të merren parasysh këto kushte të lokacionit⁸⁹:

- Lokacioni duhet të parashihet në afërsi të zonës së banimit në vendbanime urbane;
- Lokacioni për objektet para-universitare të parashihen për vendbanime me më shumë se 10.000 banorë;
- Lokacioni për objektet e Arsimit të Lartë të parashihen për vendbanime me më shumë se 100.000 banorë;
- Në kuadër të zonës së banimit (Arsimi Parashkollor dhe Para-universitar) ;
- Lokacioni preferohet të jetë i rrafshët ose me pjerrtësi të vogël, të jetë i diellosur dhe i mbrojtur nga erërat e forta, në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transportin publik;
- Rekomandohet gjithashtu që lokacioni për vendosjen e objekteve shkollore të jetë në afërsi të institucioneve të shërbimeve publike, në largësi nga ndërtesat të cilat krijojnë ndotje të mjedisit dhe zhurmë, në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore-vërshimet, në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore, ajrore);
- lokacioni për vendosjen e objekteve shkollore duhet të jetë në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret⁹⁰, në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale⁹¹, dhe në largësi më të madhe se 2.000 m nga deponitë e mbeturinave⁹².

16. ZONAT E SIGURISË

ZsU ne distance minimale 100 m ndahet ne dy breza te sigurisë: Brezi i parë deri në 50 metra nga rrethoja e instalimeve ushtarake, ndërsa brezi i dytë i sigurisë nga 50 metra deri 100 metra. Gjendja faktike ne teren tek disa lokacione i determinon kufizimet, të cilat nuk kërkohet domosdoshmërisht të ndryshohen, por, aktivitetet tjera të më tejme që bien ndesh me piken 1 dhe 2 te përcaktimit te ZsU (tampon zonës) të ndalohen. Vendosja e tampon zonave ose zonave të sigurisë ushtarake (ZsU) rreth një baze ushtarake kufizon efektet e ndërhyrjes në trajnimin ushtarak dhe maksimizon sasinë e tokës së trajnimit në dispozicion brenda kufirit të zonave ushtarake që mund të përdoret për të përmbushur misionin e saj. Zonat e sigurisë gjithashtu kontribuojnë në përfitimet e bujqësisë dhe përdorimit të hapësirës së gjelbër. Kushtet themelore që duhet të merren në konsideratë janë:

- **Zonë Ushtarake – Sigurisë (ZuS)** - Është territori i cili është ne pronësi, menaxhim, mbikëqyrje, kontrollim, dhe shfrytëzim te FSK-se;
- **Zonë e Sigurisë Ushtarake (ZsU)** Është zona ne distancë minimale njëqind metra (100 m), për rreth territorit të ZuS me interes të veçante i cili është ne pronësi shtetërore apo private dhe shfrytëzohet nga aktere te tjerë shtetëror apo privat ku vendosen ndalesa (kufizime) për shfrytëzimin e burimeve ose masa specifike të zhvillimit me qëllim ruajtjen e vlerave dhe te sigurisë.
- **Distanca e perimetrit te sigurisë ushtarake** mund te rritet sipas nevojave te FSK-se.

⁸⁹. Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

⁹⁰. Udhëzues Administrativ nr. 18/2007 për kërkesat teknike për ndërtimin dhe funksionimin e pikave për furnizimin e automjeteve me karburante.

⁹¹. Minimum Set of Terms of Construction, Institutional Support to the Ministry of Environment and Spatial Planning (KS 10 IB EN 01), July 2013.

⁹². Udhëzim Administrativ nr. 01/2009 mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave.

- Bazat ushtarake janë të pozicionuara brenda qyteteve dhe jashtë tyre, lokacione këto të cilat përdoren për stacionim të përhershëm por edhe për stacionim të përkohshëm, ku zhvillohen detyra të përditshme, trajnime, shkollime dhe stërvitje reale (live).
A6	Ndërtimi i stacionit bartës dhe qendrës për mbledhjen e mbeturinave (Klinë, Istog, Skenderaj, Novobërdë)	MEA	MZHE/ MF/ komunat/ KRM	**	BK/ donacion (IPA)/ kredi	6.700.000	Udhërrëfyesi për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
Kosto Q5						4.684.774.400 €	
Kosto e përgjithshme						4.959.510.094 €	

- Me përjashtim të kostove të kalkuluara, të gjitha kostot e veprimeve tjera nuk janë ngarkesë e dokumentit!;
- Periudha e zbatimit: * Afat shkurtë (deri në 2 vjet); ** Afat mesëm (2-5 vjet); *** Afat gjatë (mbi 5vj).

V. ADMINISTRIMI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT

Zbatimi i Hartës Zonale të Kosovës (HZKos) nënkupton realizimin e rekomandimeve, veprimeve, aktiviteteve dhe projekteve zhvillimore, si dhe përmbushjen e kushteve zhvillimore, ndërtimore dhe masave mbrojtëse të parapara në dokument.

1. Administrimi i zbatimit

Realizimi i aktiviteteve dhe projekteve konkrete zhvillimore administrohet nga Qeveria e Kosovës dhe ministritë e linjës si pjesë të saj, ndërkaq MEA, përveç administrimit të zbatimit të projekteve të veta zhvillimore, e ka rolin kryesor në administrimin e zbatimit të HZKos në aspektin e përmbushjes së kushteve dhe masave të cilat ky dokument i ka caktuar.

Administrimi i zbatimit të HZKos konsiston në zbatimin e veprimeve dhe procedurave të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi. Veprimet dhe procedurat të cilat MEA i zbaton në kuadër të administrimit të zbatimit të HZKos janë dhënë në vazhdim:

- MEA lëshon kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore për ndërtimin e objekteve të kategorisë së tretë;
- Shqyrton dhe nxjerrë vendime për kërkesat për ndryshime e plotësime të HZKos, përjashtime dhe për jo-konformitetet sipas procedurave të dhëna në nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të Udhëzimit Administrativ MEA – Nr.10/2016 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës;
- MEA, sipas kërkesës, bën interpretimin e zonimit duke e zbatuar procedurën e paraqitur në nenin 40 të Udhëzimit Administrativ MEA – Nr.10/2016 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës;
- Interpretimet kanë për qëllim të sqarojnë tekstin ose hartën, duke përfshirë shfrytëzimet, kufijtë e zonës, si dhe kuptimin dhe qëllimin e pjesëve të ndryshme të HZKos;
- MEA është përgjegjëse për koordinimin e zbatimit të planit të veprimit për zbatim (PVZ) i cili është pjesë përbërëse e dokumentit të HZKos. Kjo ministri çdo vjet paraqet projeksionet e kostos për zbatim në qeveri me qëllim të shqyrtimit dhe të përfshirjes në buxhetin e vitit të ardhshëm. Koordinimi i zbatimit të PVZ-së nënkupton që sipas përcaktimeve, të koordinohet dhe menaxhohet shpronësimi, projekti, leja ndërtimore, tenderimi, mbikëqyrja e zbatimit të projektit nga ana e institucionit përgjegjës për zbatim, mbikëqyrja e realizimit të projektit nga ana e kontraktuesit dhe krijimi i një mekanizmi për mirëmbajtje. Është shumë me rëndësi që pasi të përfundohet një projekt, i njëjti të përfshihet në listën e pasurive/aseteve publike që do të mirëmbahen;
- Gjatë procesit të administrimit të zbatimit të HZKos, MEA duhet ta sigurojë pjesëmarrjen dhe kontributin e të gjitha ministrive dhe palëve të interesit;

Sa u përket ministrive tjera, punët që ato duhet t'i kryejnë gjatë administrimit të realizimit të projekteve zhvillimore që i kanë planifikuar janë:

- Hartimi i projektit me tërë dokumentacionin përcjellës apo mbikëqyrja e hartimit nëse projekti hartohet nga ndonjë kompani e angazhuar nga ministria;
- Aplikimi për leje dhe marrja e lejes ndërtimore nga MEA për ndërtesat e kategorisë së tretë;
- Përzgjedhja e kompanive që do ta hartojnë dhe zbatojnë projektin;
- Mbikëqyrja e zbatimit të projektit.

Këto punë duhet të kryhen duke i zbatuar procedurat ligjore të cilat i kërkon legjislacioni në fuqi.

2. Monitorimi i zbatimit

Monitorimi, është procesi nëpërmjet të cilit, zbatuesit e Hartës Zonale të Kosovës do të sigurohen që kushtet, masat dhe aktivitetet që janë duke u zbatuar, janë në përputhje me ato të planifikuara në Hartë dhe brenda afateve të caktuara. Monitorimi është një përpjekje sistematike për të krahasuar punën në zbatim por edhe performancën e HZKos në raport me kushtet zhvillimore, ndërtimore, zhvillimet e parapara, projektet, masat, aktivitetet dhe standardet e caktuara dhe në fund për të vlerësuar progresin. Gjithashtu, parashikon dhe marrjen e masave korigjuese ku ka devijime, parashikimin e vështirësive para se të shfaqen dhe kryerjen e korigjimeve të nevojshme për ta mbajtur Hartën Zonale brenda detyrimeve të përcaktuara në të.

Përgjegjësitë për monitorimin e zbatimit - Autoriteti përgjegjës për koordinimin e procesit të hartimit të dokumenteve hapësinore është Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, përkatësisht Sektori për Planifikim Hapësinor (DPHBN dhe IPH). Duke qenë se të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor qendror aprovohen nga Qeveria, është e kuptueshme që barra kryesore për monitorimin e zbatimit të tyre i takon po ashtu Qeverisë së Kosovës. Qeveria si autoritet përgjegjës për monitorim përmes sektorëve dhe njësive të veta kompetente do të bëjë monitorimin e zbatimit përmes treguesve më herët të përcaktuar për këtë qëllim.

Autoriteti përgjegjës duhet të hartojë programin e monitorimit dhe zbatimit, për përgatitjen e të cilit do të mbajë takime dhe do të konsultojë të gjitha institucionet relevante të qeverisë së Kosovës, dhe do të sigurohet që ky aktivitet të jetë gjithashtu në harmoni me programin e Qeverisë, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe programet e investimeve.

Realizimi i programit të monitorimit do të bëhet përmes përgatitjes së raporteve të rregullta vjetore të sektorëve relevant, të cilët duhet të kryhen në afate të rregullta kohore (raporti vjetor duhet të kryhet deri në muajin e dytë të vitit vijues).

Përgatitja e raporteve duhet të kryhet nga të gjitha sektorët relevant duke përfshirë: MASHT, MAPL, MBPZHR, MD, MTI, MZHE, MI, MFSK, MKRS, MEA, etj. Raportet vjetore të monitorimit të zbatimit përfshijnë rekomandime për veprim dhe prezantohen me statistika financiare për çështjet e trajtuara në dokument në baza vjetore dhe për rishikimi katër (4) vjeçar dhe tetë (8) vjeçar.

Treguesit për monitorim të zbatimit të HZKos, duhet të jenë të formës kuantitative (numra, përqindje, forma hartografike) dhe tregues kualitativ. Çdo sektorë bazuar në Planin Vjetor Sektorial, duhet të definojë treguesit e qartë për monitorimin e zbatimit të veprimeve, të masave ose të projekteve. Treguesit duhet të jenë të qartë, të kontrollueshëm, të matshëm, tregues që mund të azhurnohen lehtë, të krahasueshëm me programet apo planet tjera, tregues që ndërliiden me monitorimin e ndikimit në mjedis, etj.

MEA e ka përgjegjësinë ligjore që, duke u bazuar në të dhënat nga raportet e monitorimit të sektorëve relevant qeveritar, të hartojë raporte vjetor të monitorimit të zbatimit të HZKos. Çka duhet të monitorohet në mënyrë që pastaj me anë të raportit të jepet një pasqyrë sa më e saktë e zbatimit të HZKos? Monitorimi duhet të orientohet në disa parametra për të cilët janë përcaktuar treguesit me të cilët matet niveli i arritjes së këtyre parametrave. Parametrat janë: përputhshmëria, përjashtimet, dhe zbatimi i projekteve.

Përputhshmëria – nënkupton përputhshmërinë e kërkesave për zhvillime të caktuara hapësinore me HZKos. Monitorimi i përputhshmërisë i jep përgjigjet në pyetjet: A është zbatuar HZK-ja ashtu siç është miratuar? Sa kërkesa janë dorëzuar që nuk përputhen dhe sa që vetëm pjesërisht përputhen me kushtet zhvillimore? A ka kërkesa të miratuara nga MEA që nuk përputhen dhe a ka kërkesa të miratuara që vetëm pjesërisht përputhen me kushtet zhvillimore? Treguesi me të cilin matet niveli i arritjes së këtij parametri do të ishte **përqindja e kërkesave të miratuara të cilat plotësisht janë në përputhje me kërkesat apo kushtet e HZKos.**

Përjashtimet – ky parametër nënkupton përjashtimet nga kushtet zhvillimore që i ka caktuar HZKos. Me monitorimin e përjashtimeve shihet nëse ka ndonjë zonë që më shpesh gjeneron kërkesa për përjashtime nga HZKos dhe cilat janë arsyet për këto kërkesa. Treguesit me anën e të cilëve matet sa janë miratuar apo realizuar përjashtimet janë: **numri i kërkesave të miratuara për përjashtime dhe arsyet e kërkesave dhe vendndodhjet e kërkesave për përjashtime.**

Zbatimi i projekteve – monitorimi i këtij parametri bëhet që të shihet se a janë zbatuar projektet dhe aktivitetet që i parasheh HZKos brenda afatit të përcaktuar kohor. Treguesi me të cilin matet niveli i arritjes së këtij parametri është **% e projekteve të zbatuara brenda afatit të përcaktuar kohor.**

Me rëndësi të veçantë është matja dhe vlerësimi i performances, e cila përpos që ofron informata lidhur me zbatimin e kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave dhe afateve kohore, mund të shfrytëzohet edhe si bazë për zhvillimet e paparashikuara, për të cilat duhet të ofrohen masa korigjuese.

Masat korigjuese ndërmirën atëherë kur konstatohen devijime nga plani për zbatim që nënkupton ndryshim të planit të zbatimit, mbikëqyrje më e rreptë, dalje më të shpeshta në terren, motivim i pjesëmarrësve, etj.

Metodologjia

Metoda e cila rekomandohet të shfrytëzohet është metoda e orientuar në rezultate dhe në gjendjen në terren. Mund të përdoren edhe metodat tjera sipas nevojës, por që të gjithat duhet të bazohen në planin e punës i cili realizohet sipas hapave të mëposhtëm:

- Identifikimi i Qëllimeve, Objektivave, kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave, afateve kohore, kostove financiare të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të HZKos dhe planeve sektoriale, të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik;
- Më tutje, duhet të përcaktohen treguesit, të cilët duhet të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ varësisht prej sektorëve;
- Grumbullimi i informatave duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara dhe duke u bazuar në formularët e përgatitur për monitorim. Gjithashtu grumbullimi i informatave bëhet edhe nga burimet tjera pos burimeve zyrtare;
- Përcaktimi i përgjegjësve për raportim të sektorëve të Ministrive përkatëse, si dhe stafit përgjegjës për fushat përkatëse për informatat e nevojshme për vlerësim;
- Hartimi i planit transparent dhe profesional për Vlerësim dhe për Formën e Raportimit;
- Raporti përfundimtar i cili hartohet nga autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit duke i integruar dhe strukturuar vlerësimet nga raportet e secilit sektorë të ministrive lidhur me vlerësimin e zbatimit. Raporti në fjalë duhet të prezantohet para Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës.

Raporti i vlerësimit

Vlerësimi bëhet sipas listës së treguesve të paracaktuar, me të cilët duhet të bëhet matja e zbatueshmërisë, e cila bazohet në metodologjinë e vlerësimit të përcaktuar në planin e monitorimit. Katër vite pas fillimit të zbatimit dhe monitorimit, duhet të kryhet një vlerësim afatmesëm i zbatueshmërisë së HZKos-së. Monitorimi duhet të planifikohet ashtu që, në më pak se katër vite duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme për vlerësim të HZKos. Nëse me vlerësim kuptohet se zbatueshmëria e HZKos është më e vogël se 40% nga ajo çka është planifikuar, është i detyrueshëm vendimi për revidimin ose hartimin e dokumentit të ri të HZKos.

Vendimi për revidimin ose hartimin e HZKos së re, do të bazohet në raportet e monitorimit dhe të vlerësimit, mbi të cilat do të vendoset orientimi i zhvillimeve të Hartës Zonale të re.

Raporti i prezantimit duhet të paktën të përmbajë:

- Hyrjen;
- Përmbledhjen e zhvillimeve;
- Prezantimin e raporteve monitoruese. (Rezultatet paraqiten me tekst, grafikone dhe diagrame, sipas kriterëve të paracaktuara të vlerësimit);
- Vlerësimin e aktiviteteve dhe diskutimin e rezultateve të monitorimit, përmes të cilave prezantohen mospërputhje eventuale ndërmjet zhvillimeve të parashikuara dhe të zbatuara dhe ofrohen rekomandimet për vendimmarrjen. Duke u bazuar në raportin dhe rezultatet e vlerësimit, vendimmarrësit mund të marrin vendim për revidim të HZKos;

Grupi punues për hartimin e raportit - Autoriteti përgjegjës për monitorim themelon grupin punues, i cili duhet të angazhohet në përgatitje të Raportit përfundimtar të Monitorimit dhe Zbatimit të HZKos. Ky grup përbëhet nga koordinatori i cili vjen nga autoriteti përgjegjës për planifikim hapësinor si dhe nga përgjegjësit e sektorëve relevant të qeverisë. Autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet për përgatitjen e Raportit të Monitorimit të Zbatimit të HZKos.

Sektorët përgjegjës të qeverisë duhet të jenë përgjegjës për përgatitjen e Raportit vjetor përmbledhës të sektorëve të ministrive përkatëse. Raportet e përfunduara dorëzohen në adresë të ekipit të emëruar nga autoriteti përgjegjës, të cilët janë të obliguar të bëjnë përmbledhjen e raporteve në një raport përfundimtar të monitorimit të zbatimit të HZKos. Raporti përfundimtar dorëzohet në Qeveri për shqyrtim përfundimtar dhe për të nxjerrë vendimin për hapat e më tutjeshëm. Nëse vlerësohet se në katër vitet e para zbatueshmëria e HZKos është më pak se 40% nga ajo që është planifikuar, merret vendim për revidimin ose për fillimin e hartimit të një dokumenti të ri.

Indikatorët e performancës

Për ta ngritur nivelin e korrektësisë në raportimet vjetore dhe ato periodike (4/8 vjeçare), për matjen dhe vlerësimin e zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave specifike të PHK / HZKs, gjatë fazës së monitorimit, duhet që përveç sasisë së veprimeve/projekteve të realizuara nga Plani Veprimi, të vlerësohet edhe ndryshimi i vlerave numerike të arritura për treguesit e performancës nëpër qëllime dhe objektiva të caktuara.


Prandaj, për vlerësimin e nivelit të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave specifike në Hartën Zonale të Kosovës, do të merren në konsideratë kryesisht indikatorët, të cilët duhet të adresojnë listën e prioriteteve strategjike, e cila është vazhdimësi e Planit Hapësinor të Kosovës, e modifikuar dhe përshtatur me kërkesat e aktuale të konkretizuar në qëllime dhe objektivat e tyre specifike.


Lista e indikatorëve të performancës


INDIKATORI	BURIMI	VLERA BAZË	VL. E SYNUAR	KRAHASIMI
Nr. Integrimi në Mekanizmat Ndërkombëtar	Qeveria / MIE, MPJ	MSA	BE – Kand., UN-Anët., Interpol, UNESCO, etj	EJL
Nr. Rajoneve Statistike (sipas qyteteve më të mëdha) në territorin e Kosovës	ASK	1 (38 kom.)	NUTS 0, 1, 2 = 1 NUTS 3 = 7 (+1)	BE: 8
Rajonit Statistikor i Kryeqytetit i ndarë nga Rajoni Statistikor komunave të Prishtinës	ASK	0	NUTS 3 = 1 kryq.	BE: 1
Raporti hapësirë me arsimtarë për nxënës me një ndërrim puna në niv. para-univers.	ASK ; MASHT	3.5 m ² /nxënës; 15 / 1 ; 25 %	5.0 m ² /nxënës; 15 / 1 ; 35 %	BE: ???
Nr. qendrave të kompetencës dhe të arsimit të mesëm profesional	ASK ; MASHT	4 / 77	7 / 100	-
Nr. shtretërve në shërbimin sekondar dhe terciar shëndetësor në 100.000 banorë	ASK ; MSH	231	350	BE: 538
Nr. stadiumeve të futbollit sipas standardit Kombëtarë / Evropian	MKRS / DS	25+2 / 2-ren	40 / 7	-
Nr. palestrave të sporteve / të sallave për edukatën fizike	MKRS / DS	13+8 / 65+7	25 / 85	-
Nr. i qendrave nacionale / lokale për tenis, xhudo dhe sporte tjera	MKRS / DS ; Federatat sport.	0 / ???	7 / ???	-
Nr. i shtigjeve të atletikës, poligoneve të qitjes, fushave për fut-sall,	MKRS / DS	1+1 / 7 / 179	8 / 15 / 200	-
Nr. pishinave të notit, terreneve për të skijuar dhe të hapësirave për rekreacion	MKRS / DS	45+1 / 4 / 9	0 / 8 / 20	-
Nr. shtëpive kulturore me sallat për koncerte, teatër, kino dhe biblioteka	MKRS / DK	???	???	-


Nr. asetëve të mbrojtura të TK në UNESCO dhe Listë të përhershme / përkohshme	MKRS / DTK;	4 / 23 / 1564	8 / 50 / 1500	-
Nr. i njëjësive të banimit me ato të zbrazëta dhe mesatare të banorëve për njësi	MAPL ; MEA	413 (zb.100) mijë / 4.2 b/nj	500 (50) mijë / 3.5 b/nj	EJL: 2.4 b/nj
Nr. ndërtimeve pa leje me raportin e ndërtesave - objekteve që i përkasin kat.III		353.685 / Kat. III - 0.24 %	200.000 / Kat.III – 1.0 %	-
Raporti sipërfaqes habitateve në zonat e mbrojtura të larmisë biol. (biodiversitetit)	MEA / IKMN	11 %	12 %	BE: 10 %
Raporti i sipërfaqes së tokës bujqësore për nr. e popullsisë (TB/kokë banori)	ASK ; MBPZHR ; MEA	0.25 ha/b	0.30 ha/b	0.52 ha/b
Raporti i sipërfaqes së tokës bujqësore nën sistem të ujitjes dhe komasacionit	ASK ; MBPZHR	5.0 % / 6.0 %	10.0 % / 15.0 %	-
Raporti sipërfaqes së tokës pyjore dhe sip. përgjithshme të Kosovës me rritjen vjetore	MBPZHR / APK	45 % (me 5 % rritje - 10 vite)	47 % (me 10 % rritje - 10 vite)	-
Nr. i vizitorëve të huaj e vendor në Kosovë dhe trendi i rritjes së tyre në vite	ASK ; MTI / DTur	120 mijë / rritja 1.5% V; 20.0% H	200 mijë / rritja 4.0% V; 30.0% H	-
Raporti i bilancit tregtar në eksport-import dhe vlera e GDP / kokë banori	ASK ; MTI ; MF	Ex/Im: 13.7 % / 3.000 € (2013)	Ex/Im: 25.0 % / 4.500 € (2025)	-
Raporti i vlerës së remitencës në kuadër të buxhetit të shtetit	ASK ; MF ; MDia	30.0 % (kesh familjarëve)	35.0 % (Investim në prodhimtari)	-
Raporti ndarjes buxhetit shtetit sipas niv. Qev. (lok/qen) e org. buxh./inv. kapitale	MF	25/75 % (org.b : inv.k = 78 : 22 %)	33/66 % (org.b. : inv.k.= 70 : 30 %)	-
Raporti për nivelin e (pa)punësisë dhe për shkallë e varfërisë	ASK ; MPMS	Pa pun.: 35.5 % ; Varfër.: 29.7 %	Pa pun.: 25.0 % ; Varfër.: 20.0 %	BE:
Nr. hot-spotëve dhe i zonave të ndjeshme me potencial ndotje dhe degradimi	MEA / DMM-AMMK; AME	27 / 110	20 / 80	-
Nr. i zonave dhe sipërfaqja e rrezikuar nga degradimi prej vërshimeve e përmbytjeve	MEA / DMM-ARPL ; AME	155 ; 7.112 ha	100 ; 3.500 ha	-
Raporti përfshirjes së popullsisë në shërbime të tele-komunikimit (GSM +3G)	ASK ; MZHE / Komp. Publike	GSM: 99.7 %; 3G: 80.0 %	GSM: 100 %; 3G: 100 %	-
Raporti popullsisë së përfshirë në furnizim me ujë - kanalizim e largim të mbeturinave	ASK ; MZHE / KRU, Dep. Raj.	82.0 % / 56.0 %	90.0 % / 70.0 %	-
Raporti dhe dendësia e rrugëve të asfaltuara në rrjetin rrugor	MI ; ASK	85.0 % / 0.5 km/km ²	95.0 % / 0.6 km/km ²	-
Raporti i popullsisë së përfshirë në sistemin publik të ngrohjes (Pr dhe Gjk)	ASK ; MZHE / Komp. Rajonale	4.3 % (Pr : Gjk = 34.0 % : 7.0 %)	8.0 % (Pr. FK. Ob. Gjk.+ qend. tjera)	-
Raporti burimeve ripërtëritëse n'prodhim final të energjisë dhe varësi të importit	ASK ; MZHE / DEE	4.0 % / 10.0 %	20.0% / 2.0 %	-
<i>*Vlerat e mësipërme tek indikatorët e performancës i janë referuar vlerave në dokumentin e punuar nga IPH në Qershor 2017 dhe të publikuar në Ueb faqen e MEA-së: "Indikatorët për Planifikim Hapësinor në Kosovë". ??? – Mungesë e informatave.</i>				


HARTAT




















HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP

HARTA
 4 **HARTA E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS**
NË ZONAT ME INTERES KOMBËTAR

- Legjenda**
- Zonë e Parë
 - Zonë e Dytë
 - Zonë e Tretë
 - Zonë e mbrojtur e natyrës e propozuara (ZM)
- | | | |
|---|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> Aeroport ndërkombëtar Aeroport nacional Rrjet hëkurorhor Autoudhë Rrugë nacionale Rrugë regionale Rrugë lokale HC Hidrocentral TC Termocentral Largpërques 110kV Largpërques 220kV | <ul style="list-style-type: none"> Largpërques 400kV Trafostacion në largpërques ZM (Largpërques) Zonë Urbane (ZU) Zonë rurale (ZR) Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM) Zonë e Veçantë (ZV) Zonë e Mbrojtur (ZM) Shpeli Bifurkacioni i lirisit "Narodime" | <ul style="list-style-type: none"> Ujëvarat e Mirushës Liqe (SU2) Zonë e Mbrojtur Ujëre (ZMU) Lum (SU1) Akufer A (SUin1) Akufer B (SUin2) Akufer C (SUin3) Kufi kadastral Kufi komunal Kufi shtetëror |
|---|---|---|





	Boris / Denis / Visari Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministria e Ekonomisë dhe Mbrojtjes së mjedisit Ministry of Economy and Environment	Vula / Stamp / Peçat
	Hartini / Design / Plani Instituti për Planifikim Hapësinor Institute for Spatial Planning Institut za Prostorne Planiranje	Data / Date / Datum / / /




HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP


HARTA C6 **HARTA E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS**
NË ZONAT ME INTERES KOMBËTAR


- Legjenda**
- Zonë e Parë
 - Zonë e Dytë
 - Zonë e Tretë
 - Zonë e mbrojtur e natyrës e propozuara (ZM)
- | | | |
|---|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> Aeroporti ndërkombëtar Aeroporti nacional Rrjet hekurudhor Autostradë Rrugë nacionale Rrugë regionale Rrugë lokale HC Hidrocentral TC Termocentral Largpërçues 110kV Largpërçues 230kV | <ul style="list-style-type: none"> Largpërçues 400kV Trafotacion në largpërçues ZbM (Largpërçuesit) Zonë Urbane (ZU) Zonë Rurale (ZR) Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM) Zonë e Veçantë (ZV) Zonë e Mbrojtur (ZM) Shpellë Bifurkacioni i lirisit "Nerodime" | <ul style="list-style-type: none"> Ujëvarat e Mirushës Liqe (SU2) Zonë e Mbrojtur Ujëre (ZMU) Lam (SU1) Akufer A (SU1) Akufer B (SU2) Akufer C (SU3) Kufi kadalstral Kufi komunal Kufi shtetëror |
|---|--|--|



Bërthmë / Owner / Vlasnik	Yllë / Stamp / Peçat
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministry of Economy and Environment	
Hartues / Design / Projektues	Data / Date / Datum
Instituti për Planifikim Hapësinor Institute for Spatial Planning Institut za Prostorno Planiranje	/ /









HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP


HARTA
 6
**HARTA E SIPËRFAQEVE DHE
 NDËRTESAVE ME RËNDËSI
 PËR KOSOVËN**


- Legjenda**
- Zonë ushtarake-sigurtë (ZuS)
 - Zonë e Sigurisë Ushtarake (ZsU1)
 - Zonë e Sigurisë Ushtarake (ZsU2)
 - Zonë e Veçantë e Planifikuar (ZV)
 - Lokacion i propozuar për Zonë të Veçantë (ZV)
 - Aeroportet (ZAT)


- | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|--|--|---|---|--|---|---|---|---|---|---|---|--|--|---|---|--|--|---|---|---|---|---|---|---|---|--|--|--|
| Aeroport ndërkombëtar | Aeroport nacional | Rrjet hekurudhor | Autostradë | Rrugë nacionale | Rrugë regionale | Rrugë lokale | HC Hidrocentral | TC Termocentral | Lëngpërçues 110kV | Lëngpërçues 220kV | Lëngpërçues 400kV | Trafostacion në rreth | ZbM (Lëngpërçuesit) | Zonë Urbane (ZU) | Zonë Rurale (ZR) | Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM) | Zonë e Veçantë (ZV) | Zonë e Mbrojtur (ZM) | Sipelisë | Bifurkacioni i linit "Nerodims" | Ujëvarat e Mirushës | Liqet (SU2) | Zonë e Mbrojtur Ujëre (ZMU) | Lum (SU2) | Akufer A (SUa1) | Akufer B (SUa2) | Akufer C (SUa3) | Kufi lokal | Kufi komunal | Kufi shtetëror |
|---|---|--|--|---|---|--|---|---|---|---|---|---|---|--|--|---|---|--|--|---|---|---|---|---|---|---|---|--|--|--|





	Bërmbë / Owner / Vlasnik Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministry of Economy and Environment	Vendi / Stamp / Peçat
	Hartëtarë / Design / Projektues Instituti për Planifikim Hapësinor Institute for Spatial Planning Institut za Prostorno Planiranje	Data / Date / Datum / /


















HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP

HARTA F7 **HARTA E INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT**

- Legjenda**
- Autoudhë e planifikuar
 - Brez i mbrojtës hekurudhor
 - Brez i rregullës hekurudhor 1
 - Brez i rregullës hekurudhor 2
 - Brez i mbrojtës rrugor 1
 - Brez i mbrojtës rrugor 2
 - Aeroport ndërkombëtar
 - Aeroport nacional
 - Rrjet hekurudhor
 - Autoudhë
 - Rrugë nacionale
 - Rrugë regionale
 - Rrugë lokale
 - HC Hidrocentral
 - TC Termocentral
 - Largpërques 110kV
 - Largpërques 220kV
 - Largpërques 400kV
 - Trifostacion në largpërques
 - ZbM (Largpërquesit)
 - Zonë Urbane (ZU)
 - Zonë Rurale (ZR)
 - Zonë e Vegantë e Mbrojtur (ZVM)
 - Zonë e Vegantë (ZV)
 - Zonë e Mbrojtur (ZM)
 - Shpëtitë
 - Bifurkacioni i lumit "Nerodime"
 - Ujëvarat e Minushës
 - Liqe (SU2)
 - Zonë e Mbrojtur Ujorë (ZmU)
 - Lum (SU1)
 - Akufër A (SUa)
 - Akufër B (SUb)
 - Akufër C (SUc)
 - Kufi kadastral
 - Kufi komunal
 - Kufi shtetëror




Bartës / Owner / Vlastnik: **Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit**
 Ministria ekonomije i životne sredine
 Ministry of Economy and Environment

Hartues / Design / Projektor: **Instituti për Planifikim Hapësinor**
 Institute for Spatial Planning
 Institut za Prostorne Planiranje

Vendi / Stamp / Početak: / /

Data / Date / Datum: / /





HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP


HARTA
10 **HARTA E INFRASTRUKTURËS**
PUBLIKE DHE SOCIALE

- Legjenda**
- ☐ Muze
 - Objekt i trashëgimisë arkitekturore
 - △ Objekt i trashëgimisë arkeologjike
 - 🏛️ Objekt i administratës komunale
 - 🎭 Teatër
 - 🏥 Spital
 - 🎓 Institucion Universitar
 - 🌐 Lokacionet e Propozuara për Satëlinë Kombëtar
 - 🏞️ Zonë turistike e planifikuar

- ✈️ Aeroport ndërkombëtar
- ✈️ Aeroport nacional
- 🛣️ Rrjet hekurudhor
- 🛣️ Autosdhe
- 🛣️ Rrugë nacionale
- 🛣️ Rrugë regionale
- 🛣️ Rrugë lokale
- 🌊 HC Hidrocentral
- 🔥 TC Termocentral
- ⚡ Lartëqarkullim 110kV
- ⚡ Lartëqarkullim 220kV
- ⚡ Lartëqarkullim 400kV
- 🏗️ Trafostacion në lartëqarkullim
- 📍 ZbM (Lartëqarkullim)
- 🏘️ Zonë Urbane (ZU)
- 🌿 Zonë Rurale (ZR)
- 🏡 Zonë e Vegantëve e Mbrojtur (ZVM)
- 🏡 Zonë e Vegantëve (ZV)
- 🌳 Zonë e Mbrojtur (ZM)
- 🌳 Shpëtim
- 🌳 Bifurkacioni i lumit "Nerodime"
- 🏠 Ujëvarat e Minushës
- 🌊 Liqen (LJ)
- 🌊 Zonë e Mbrojtur Ujëre (ZMU)
- 🌊 Lum (LU)
- 🏠 Akuller A (SJA1)
- 🏠 Akuller B (SJA2)
- 🏠 Akuller C (SJA3)
- 📄 Kufi kadastral
- 📄 Kufi komunal
- 📄 Kufi shtetëror



	Bartës / Owner / Vlasnik Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit Ministria ekonomisë dhe mjedisit Ministry of Economy and Environment	Vetitë / Stamp / Pecat
	Hartues / Design / Përpunues Instituti për Planifikim Hapësinor Institute for Spatial Planning Institut za Prostorno Planiranje	Data / Date / Datum / /




HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP


HARTA
G7 **HARTA E INFRASTRUKTURËS**
PUBLIKE DHE SOCIALE

- Legjenda**
- Muze
 - Objekt i trashëgmisë arkitekturore
 - Objekt i trashëgmisë arkeologjike
 - Objekt i administratës komunale
 - Teatro
 - Spital
 - Institucion Universitar
 - Lokacionet e Propozuara për Shtimin Kombëtar
 - Zonë turistike e planifikuar

- Aeroport ndërkombëtar
- Aeroport nacional
- Rrjet hekurudhor
- Autoshow
- Rrugë nacionale
- Rrugë regionale
- Rrugë lokale
- HC Hidrocentral
- TC Termocentral
- Lëngpërçues 110kV
- Lëngpërçues 220kV
- Lëngpërçues 400kV
- Trafotacion në lëngpërçues
- ZbM (Lëngpërçuesit)
- Zonë Urbane (ZU)
- Zonë Rurale (ZR)
- Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM)
- Zonë e Veçantë (ZV)
- Zonë e Mbrojtur (ZM)
- Shpallë
- Bifurkacioni i linit "Nerodims"
- Ujëvarat e Mirushës
- Liqe (SU2)
- Zonë e Mbrojtur Ujëvar (ZmU)
- Lum (SU2)
- Akufer A (SUa1)
- Akufer B (SUa2)
- Akufer C (SUa3)
- Kufi hidrocentral
- Kufi komunal
- Kufi shtetëror





	Bërthmë / Owner / Vizion Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministry of Economy and Environment	Vendi / Stamp / Pezant
	Hartëtar / Design / Program Instituti për Planifikim Hapësinor Institute for Spatial Planning Institut za Prostorno Planiranje	Data / Date / Datum / /




HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP


HARTA
11 **HARTA E DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË FUQI**

- Zonë me Plan Hapësinor të Aprobuar
 - Zonë me Draft Plan Hapësinor
 - Zonë për të cilën do të hartohet Plani Hapësinor
-
- Aeroport ndërkombëtar
 - Aeroport nacional
 - Hekurudhë
 - Autoudhë
 - Rrugë nacionale
 - Rrugë regionale
 - Rrugë lokale
 - HC Hidrocentral
 - TC Termocentral
 - Largpërques 110kV
 - Largpërques 220kV
 - Largpërques 400kV
 - Trafostacion në largpërques
 - ZbM (largpërques)
 - Bifurkacioni i lumit "Nerodime"
 - Ujëvarat e Mirushës
-
- Shpellë
 - Zonë e Vecantë e Mbrojtur (ZVM)
 - Zonë e Vecantë (ZV)
 - Zonë e Mbrojtur (ZM)
 - Zonë Urbane (ZU)
 - Zonë Rurale (ZR)
 - Lum (SU1)
 - Liqë (SU2)
 - Zonë e Mbrojtur Ujëre (ZmU)
 - Akufer A (SUin1)
 - Akufer B (SUin2)
 - Akufer C (SUin3)
 - Kufi kadestral
 - Kufi komunal
 - Kufi shtetëror



Bartës / Çelës / Vizorë	Vula / Stamp / Pecat
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientsit Ministria ekonomije i Uotro sredine Ministry of Economy and Environment	
Hartësi / Design / Pritimes	Data / Date / Datum
Institut për Planifikim Hapësinor Institute for Spatial Planning Institut za Prostorno Planiranje	/ /








HARTA ZONALE E KOSOVËS
ZONALNA MAPA KOSOVO
KOSOVO ZONING MAP


HARTA 12 **NDARJA RRAJONALE E KOSOVËS**
SIPAS PHK-SË


- | | |
|------------------------|-----------------------|
| ★ Kryeqytet | ● Rajoni i Gjilanit |
| ● Rajoni i kryeqytetit | ● Rajoni i Mitrovicës |
| ● Qendër rajonale | ● Rajoni i Ferizajt |
| ● Qendër komunale | ● Rajoni i Prishtinës |
| ■ Rajoni i Ferizajt | ■ Rajoni i Prizrenit |
| ■ Rajoni i Gjakovës | |
-
- | | | | |
|-----------------------------------|-----------------------|---|-----------------------------------|
| ✈️ Aeroport ndërkombëtar | ✈️ Aeroport nacional | ✈️ Aeroport | ✈️ Aeroport |
| 🛣️ Hekurudhë | 🛣️ Autoudhë | 🛣️ Rrugë nacionale | 🛣️ Rrugë regionale |
| 🛣️ Rrugë lokale | ⚡ HC Hidrocentral | ⚡ TC Termocentral | ⚡ Lartëpërues 110kV |
| ⚡ Lartëpërues 220kV | ⚡ Lartëpërues 400kV | ⚡ Trafostacion në rrjetin e lartëpëruesve | ⚡ ZbM (Lartëpëruesit) |
| ⚡ Bifurkacioni i lumit "Nerodime" | 📍 Ujëvarat e Minushes | 🏠 Shoellë | 🏠 Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM) |
| | | 🏠 Zonë e Veçantë (ZV) | 🏠 Zonë e Mbrojtur (ZM) |
| | | 🏠 Zonë Urbane (ZU) | 🏠 Zonë Rurale (ZR) |
| | | 🌊 Liqe (SUZ) | 🌊 Zonë e Mbrojtur Ujëre (ZmU) |
| | | 🌊 Lum (SU1) | 🌊 Akufer A (SU=1) |
| | | 🌊 Akufer B (SU=2) | 🌊 Akufer C (SU=3) |
| | | 📄 Kufi kadastral | 📄 Kufi komunal |
| | | 📄 Kufi shtetëror | |





	Bartës / Owner / Vlasnik	Vetitë / Stamp / Pasat
	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Ministria e Ekonomisë dhe Mbrojtjes së mjedisit Ministry of Economy and Environment	
	Hartuesi / Design / Projektues	Data / Date / Datum
	Instituti për Planifikim Hapësinor Institute for Spatial Planning Institut za Prostorno Planiranje	/ /














PRIORITETET STRATEGJIKE NË RAPORT ME QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

LIDHJA NË MES TË HARTËS ZONALE TË KOSOVËS dhe AGJENDËS PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM 2030

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
<p>Prioritetet Strategjike - HZKos Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm</p>		Ndarja e territorit të Kosovës sipas rajoneve me karakteristika të ngjashme dhe potenciale zhvillimore	Shpërndarja adekuatë e arsimit profesional dhe të lartë	Riorganizimi i decentralizuar i sektorit të shëndetësisë për shërbime mjekësore më cilësore	Rritja dhe modernizimi i infrastrukturës për sport dhe kulturë	Krijimi i kushteve për banim të përballueshëm	Menaxhimi efikas dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit	Mbrojtja, shfrytëzimi racional dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe sipërfaqeve pyjore	Përshtatja dhe adaptimi i zhvillimeve ndaj ndryshimeve klimatike	Mbrojtja dhe menaxhimi i mjedisit jetësor të ajrit, ujit dhe tokës	Parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe faktori njeri	Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	Krijimi i kushteve për shfrytëzimin e potencialit mineral të Kosovës	Krijimi i zonave ekonomike	Ngritja e kapaciteteve turistike	Zhvillimi i infrastrukturës së transportit	Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë	Zhvillimi i infrastrukturës ujore	Zhvillimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike	Zhvillimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave
1	Fundi i varfërisë në të gjitha format e saj kudo;																			
2	Përfundimi i urisë, arritja e sigurimit të ushqimit, përmirësimin e të ushqyerit dhe promovimin e bujqësisë së qëndrueshme;																			
3	Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjitha moshat;																			
4	Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe i barabartë, si dhe promovimi i jetëgjatësisë, mundësi e të mësuarit për të gjithë;																			
5	Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i gjinisë femërore;																			
6	Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe kanalizimit për të gjithë;																			
7	Sigurimi i qasjes për energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë;																			
8	Nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, me punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë;																			
9	Ndërtimi i infrastrukturës fleksibile, promovimi i përfshirjes së industrializimit të qëndrueshëm dhe nxitje të inovacionit;																			
10	Zvogëlim i pabarazisë përbrenda dhe në mes të vendeve;																			
11	Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurta, fleksibile dhe të qëndrueshme;																			
12	Sigurimi i konsumit të qëndrueshëm dhe modeleve të prodhimit;																			
13	Të merren veprimet urgjente për luftimin e ndryshimeve klimatike dhe ndikimeve të saja;																			
14	Konservimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, detërave dhe burimeve detare, për zhvillim të qëndrueshëm;																			
15	Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, luftimin e djerrinave, luftoni dhe ndaloni degradimin e tokës dhe humbjen e biodiversitetit;																			
16	Promovimi i një shoqërie paqedashëse dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, me ofrimin e qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet;																			
17	Forcimi i mjeteve për zbatim dhe rigjallërim të partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm.																			

Lidhja e fortë ■ Lidhja e dobët ■

PJESËMARRËSIT NË HARTIMIN E DOKUMENTIT

Hartues: Instituti për Planifikimin Hapësinor

Luan NUSHI, drejtor

Përgjegjës të fushave dhe temave përkatëse:

Luan NUSHI (arkitekt planer), Arbën RRECAJ (arkitekt planer), Faton DEVA (arkitekt planer), Riza MURSELI (gjeograf planer/GIS), Shpend AGAJ (gjeograf planer), Zana MEHMETI (arkitekt planere), Festa NELA (arkitekt planer/GIS), Gëzime Grajqevci (arkitekt planere), Mimoza KALLABA (gjeograf planere) dhe Atdhe DESKU (arkitekt planer).

Anëtarët e Grupit Punues Ndërministror – GPNM

- MEA:** Luan NUSHI, (IPH) koordinator;
Rizah MURSELI, (IPH) zëvendës koordinator;
Fidan BILALLI, (ARPL) anëtar;
Avni RRUSTEMI (AKK) anëtar;
Përparim GASHI (AMMK) anëtar;
- MZHE:** Naser BAJRAKTARI, anëtar;
- MBPZHR:** Idriz GASHI, anëtar;
- MTI:** Irfan LIPOVICA, anëtar;
- MKRS:** Drenusha Behluli MEHMETI, anëtare;
- AKK:** Sami ZEKA, anëtar;
- ZKM:** Venhar NUSHI, anëtar;
- MI:** Naim KELMENDI, anëtar;
- ASK:** Idriz SHALA, anëtar.

Arsyetim: Grupi punues është themeluar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MEA-së pas propozimit që është ofruar nga IPH. Kriteri kryesor i përcaktimit të pjesëmarrësve ka qenë rëndësia e institucionit dhe ndikimet e tij në hapësirë. Në këtë drejtim janë përzgjedhë sektorët relevant, përkatësisht njësitë e tyre operative duke i përfshirë edhe agjencitë e pavarura, që me veprimet e tyre kanë ndikim maksimal në hapësirë dhe disponojnë me të dhëna relevante hapësinore.

Përgatitja teknike



INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

Literatura:

- MMPH/IPH, Plani Hapësinor i Kosovës 2010–2020 +, Prishtinë, 2010;
- MMPH, Strategjia e Ujërave të Kosovës, 2015-2034, Prishtinë, 2014;
- MMPH, Raport Gjendja e ujërave në Kosovë, Prishtinë, 2010;
- MPB, Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit, 2016-2020, Prishtinë, 2015;
- MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011-2020, Prishtinë, 2016;
- MSH, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017–2021, Prishtinë, 2016;
- MTI/MMPH, Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit, Prishtinë, 2004;
- MTI, Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare), Prishtinë, 2008;
- MZHE, Raporti i hartuar nga SHGJK, Prishtinë, 2018;
- MZHE, Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012–2025, Prishtinë, 2012;
- MZHE, Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare të Kosovës për periudhën 2018-2020, Prishtinë, 2017;
- MASHT, Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë, 2016;
- MASHT, Plani i veprimit të planit strategjik të arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë, 2016;
- AACK, Rregullore Nr.4/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit, Prishtinë, 2016;
- AACK, Rregullore Nr.5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aeroportit, Prishtinë, 2010;
- ASK, Kapacitetet E Turizmit (Njësitë Akomoduese) në Kosovë, Prishtinë, 2016;
- ASK, Raporti “Të Dhënat Kryesore: Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Rezultatet Përfundimtare, Prishtinë, 2011;
- ASK, Raporti “Banesat dhe Ndërtesat Sipas Komunave”, Prishtinë, 2013;
- KE, Fjalor i zhvillimit hapësinor - Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për planifikim hapësinor/rajonal (CEMAT) (përkthimi në gjuhën shqipe), Strasbourg Cedex, 2007;
- KPMM, Raporti vjetor për vitin 2017, Prishtinë 2018;
- KRK, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-159 për Zonat Ekonomike, Prishtinë, 2019;
- KRK, Ligji Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet, Prishtinë, 2010;
- KRK, Ligji Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Prishtinë, 2013;
- KRK, Ligji Nr.04/L-125 për Shëndetësi, Prishtinë, 2013;
- KRK, Ligji Nr.06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Prishtinë, 2019;
- KRK, Ligji Nr.04/L-032 për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 2011;
- KRK, Ligji Nr.03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugët Nr. 2003/11, Prishtinë, 2008;
- KRK, Ligji Nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Prishtinë, 2011;
- KRK, Ligji Nr.05/L-081 për Energjinë, Prishtinë, 2016;
- KRK, Ligji Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike, Prishtinë, 2012;
- KRK, Ligji Nr.02/L- 88 për Trashëgiminë Kulturore, Prishtinë, 2006;
- KRK, Ligji Nr.04/L- 174, për Planifikim Hapësinor, Prishtinë, 2013;
- KRK, Ligji Nr.03/L- 039, për Zonat e Veçanta të mbrojtura, Prishtinë, 2008;
- KRK, Ligji Nr.03/L- 233, për mbrojtjen e natyrës, Prishtinë, 2010;
- KRK, Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës, Prishtinë, 2013;
- KRK, Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, Prishtinë, 2012;
- KRK, Ligji Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimin, Prishtinë, 2010;

- KRK, Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Prishtinë, 2008;
- KRK, Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtën e Natyrës, Prishtinë, 2010;
- KRK, Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Prishtinë, 2009;
- KRK, Ligji Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës, Prishtinë, 2004;
- MASHT, Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore, Prishtinë, 2015;
- MBPZHR, Programi Kombëtar i Pyllëzimit dhe Ripyllëzimit 2016 – 2025, Prishtinë, 2016; MKRS, Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017- 2027, Prishtinë, 2016;
- MKRS, Lista e Trashëgimisë Kulturore per Mbrojtje te përkohshme, Prishtinë, 2018;
- MKRS, material i marr nga Departamenti i trashëgimisë kulturore dhe Departamenti i Sportit;
- MMPH, Udhëzim Administrativ Nr.16/2014 për Përcaktimin e Procedurave për Dorëzimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore dhe për Leje Ndërtimore për Projektet e Kategorisë III, Prishtinë, 2013;
- MMPH, Udhëzim Administrativ Nr.19/2010 për përmbajtjen e bonusit të banimit, Prishtinë, 2010;
- MMPH, Udhëzim Administrativ Nr.08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, Prishtinë, 2017;
- MMPH, Udhëzimi Administrativ Nr.15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, Prishtinë, 2017;
- MMPH, Udhëzimi Administrativ Nr.09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave, Prishtinë, 2017;
- MMPH, Udhëzim Administrativ Nr.01/2009 mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave. Prishtinë, 2009;
- MMPH, material i marr nga DMMU/ Divizioni për mbrojtjen e natyrës dhe AMMK/ Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës;
- MMPH, Udhëzimi Administrativ Nr.15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, Prishtinë, 2017;
- MMPH, Udhëzim Administrativ Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore, Prishtinë, 2016;
- MMPH, Udhëzim Administrativ Nr.04/2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujë rrjedhave dhe Akumulacioneve, Prishtinë, 2016;
- MSH, Udhëzim Administrativ 2006/3 Minimumi i kushteve teknike-mjekësore, hapësira dhe personeli, sipas llojit të Institucionit Shëndetësor, Prishtinë, 2006;
- MSH, Udhëzimi Administrativ 08/2007 Për Shërbimin Spitalor në Kosovë. Prishtinë, 2007;
- MTI, Identifikimi i produktit turistik në rajonin e Prishtinës, Prishtinë, 2017;
- MZHE, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, Prishtinë, 2017;
- QRK, Udhëzimi Administrativ Nr.06/2016 mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave, Prishtinë, 2016;
- QRK, Rregullore Nr.24/2012 për normat teknike për mbrojtje nga zjarri të objekteve të larta, Prishtinë, 2012;
- Udhëzim Administrativ Nr.18/2007 për kërkesat teknike për ndërtimin dhe funksionimin e pikave për furnizimin e automjeteve me karburante. Prishtinë, 2007;
- Ligji për Buxhetin e Kosovës 2018; 2019; 2020.

Ueb faqet:

- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit <https://mea.rks-gov.net/>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë <https://masht.rks-gov.net/>
- Ministria e Shëndetësisë <https://msh.rks-gov.net/>
- Infrastructure for Spatial Information in Europe <https://inspire.ec.europa.eu/>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës <http://ask.rks-gov.net/>
- Zyra e Statistikave të Unionit Evropian <https://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/main/home>

- Hartat Zonale te Distriktit te Kolumbisë (W.D.C) <http://maps.dcoz.dc.gov/>
- <http://habitat3.org/ëp-content/uploads/NUA-Albanian.pdf>;
- https://ec.europa.eu/regional_policy/en/policy/themes/rural-development/;
- Eurostat - Urban Europe Statistics on cities, towns and suburbs 2016 edition;



QEVERIA E KOSOVËS
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

Harta Zonale e Kosovës

2020 – 2028+



Dokument i hartuar nga:



INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

nën përkrahjen e Grupit Punues Ndërmintorror
dhe strukturave relevante të sektorëve të Qeverisë së Kosovës.

Prishtinë
Nëntor, 2020

Vërejtje:

Versioni kompetent i dokumentit është versioni në gjuhën shqipe!